



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Maliq**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**“FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”**  
**TË USHTRUAR NË BASHKINË MALIQ**

**Tiranë 2024**

## PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMbledhje Ekzekutive</b> .....	<b>4</b>
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit. ....	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve. ....	4
3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	12
<b>II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit).....</b>	<b>15</b>
<b>OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA</b> .....	<b>15</b>
1. Objektivat e auditimit.....	15
2. Qëllimi i auditimit.....	15
3. Identifikimi i çështjes.....	16
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	16
5. Përgjegjësitë e audituesve .....	16
6. Kriteret e vlerësimit .....	16
7. Standardet e auditimit.....	17
8. Metodologjia e auditimit .....	18
9. Dokumentimi i auditimit.....	19
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>20</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin. ....	20
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	20
2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.....	20
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	31
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.....	53
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	75
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit. ....	138
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore. .....	153
2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.....	157
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>158</b>
<b>D. MASA DISIPLINORE.</b> .....	<b>174</b>
<b>E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE     KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.</b> .....	<b>176</b>
<b>V. ANEKSET.....</b>	<b>177</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 863/1 Prot, datë 10.10.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, nga data 13.10.2023 deri në datë 27.11.2023, në subjektin Bashkia Maliq u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve, administrimi i aseteve, si dhe çështje të dala gjatë auditimit.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 10 akt konstatime.

Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshtime, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë e materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Pas trajtimit të observacioneve për projektraportin, bazuar në shkresën me nr. 6464/1, datë 02.02.2024, protokolluar në tonën me nr. 863/6, datë 05.02.2024, me anë të së cilës deklarohet se janë njohur me Projektraportin e auditimit, nga Bashkia Maliq nuk është kërkuar që të kryhet takim përmbyllës pranë zyrave të KLSH.

### 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a në raportin përfundi mtar (Nr. Fq)	Rëndësia	Rekomandimi
I	Nga auditimi i 16 procedurave me fond limit 493,118 mijë lekë të vlerësuara për auditim për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej në 5 procedura me vlerë të fondit limit 269,675 mijë lekë të vlerës së fondit limit të audituar, ku OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK për vlerën totale të kontratave <b>223,021</b> mijë lekë. Në këto kushte si dhe në funksion të zbatimit të ligjit “Për prokurimin publik”, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar B/OE e kualifikuar (fitues) duke shpallur përfundimisht fitues B/OE të rradhës, i cili i plotëson të gjitha kriteret e DST-ve, edhe pse realizimi i punëve do të kryej me një vlerë më të lartë monetare. Në ratet kur nuk ka pasur një të tillë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe të zhvillonte një procedurë tjetër me kushte me favorizuese (në rivlerësim të kriterëve) për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedure, me qëllim një përdorim me	32-54	I lartë	Kryetari i Bashkisë Maliq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 223,021 mijë lekë. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën dhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi efektivisht ky veprim ndikon negativisht në qëllimin e AK për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar.

	<p>efektiv të fondeve të prokuruar në vlerën 269,675 mijë lekë, konkretisht procedurat: 1- Procedura me objekt “Ndërtimi i Ujësjellësit Maçurisht-Plasë” me fond limit 178,942 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “N ”&amp; “S” ShPK me vlerë kontrate 159,098 mijë lekë. 2- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III” me fond limit 11,431 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “V” ShPK, me vlerë kontrate 5,909 mijë lekë. 3- Procedura me objekt “Kuz Njësitë Administrative” me fond limit 18,886 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “V ” &amp; “A ” &amp; “XH” ShPK, me vlerë kontrate 12,032 mijë lekë. 4- Procedura me objekt “Ndërtim KUZ Vloçisht faza 2” me fond limit 8,333 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “A. K. 2002” ShPK, me vlerë kontrate 6,274 mijë lekë. 5- Procedura me objekt “Ndërtim stacion pompimi Vreshtas + linja” me fond limit 52,083 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “N” ShPK me vlerë kontrate 39,708 mijë lekë.</p>			
2	<p>Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën <b>87,234 mijë lekë</b>, vlera e borxhit e krijuar <b>gjatë vitit 2022</b> është <b>43,439 mijë lekë</b> dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive <b>në fund të vitit 2022</b> është në vlerën <b>114,176 mijë lekë</b> e cila përbëhet nga: Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit në shumën <b>4,241 mijë lekë</b>; Detyrime nga personat fizikë/juridikë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë” në vlerën prej <b>16,771 mijë lekë</b>, që i përkasin subjekteve të mbartura që nga viti 2016.</p>	32-54	I lartë	<p>Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Maliq, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive <b>114,176 mijë lekë</b>, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimit e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:</p> <p>-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p> <p>- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Maliq, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</p> <p>- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</p>
3	<p>Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e të Ardhurave Bashkia Maliq, për periudhën e vitit 2022, në një rast</p>	32-54	I lartë	<p>Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha</p>

	<p>nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, përsa i përket arkëtimit të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Maliq. Referuar kapitullit II, pikës 1; germës “b” të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar, me VKM nr.344, dt. 19.4.2017. Sipas evidencës së paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e bashkisë Maliq, u audituan pagesat për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, për periudhën objekt auditimi, mbështetur në legjislacionin e taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, Autorizim.</p>			<p>procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjekti “A.K” të vlerës <b>1,000,000 lekë</b>, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë.</p>
4	<p>Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Maliq në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Korçë. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën <b>25,530,138 lekë</b> për 606 persona, kanë paguar detyrimet 222 persona me vlerë <b>6,758,614 lekë</b> dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2022 gjithsej <b>438</b> persona me vlerë <b>16,771,524 lekë</b>, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Maliq. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Maliq për periudhën nën auditim nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Maliq të jetë drejtuar ASHK Dega Korçë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>	32-54	I lartë	<p>Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, dhe arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë për <b>438 persona</b> me vlerë <b>16,771,524 lekë</b>, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Maliq.</p>
5	<p>Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën <b>4,241,736 lekë</b>, ku vetëm për vitin 2022 janë krijuar <b>49</b> debitorë</p>	32-54	I lartë	<p>Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat</p>

	<p>nga biznesi në vlerë <b>1,251,149 lekë</b>, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Maliq. Sa më sipër vetëm për periudhën e vitit 2022 objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël <b>për 44 subjekte në vlerën 942,964 lekë</b> dhe debitorët e biznesit të madh <b>për 5 subjekte në vlerën 308,455 lekë</b>. Drejtoria e të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-<i>“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”</i>, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime. Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 82 subjekte debitorë në vlerën 4,241,736 lekë, janë aktiv 82 subjekte të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa vendore.</p>			<p>tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën <b>4,241,736 lekë</b>, si më poshtë vijon:</p> <p><i>a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.</i></p> <p><i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.</i></p> <p><i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 “Mospagimi taksave dhe tatimeve”.</i></p>
6	<p>Në objektin <b>“Ndërtim KUZ Njësitë Administrative”</b> sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe BOE “V ” sh.p.k &amp; “XH ” sh.p.k &amp; “A ” sh.p.k me Nr. 1717 Prot. datë 16.03.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 14,438,580 lekë me TVSH lekë me afat përfundimi të punimeve 3 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas dokumentacionit të dosjes teknike nga verifikimi i detajuar i analizës së çmimeve rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 1 (një) zë punimesh në shumën 143,686 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.</p>	77-142	I lartë	<p>Bashkia Maliq të marri masa, për arkëtimin e shumës 143,686 lekë pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “V ” sh.p.k &amp; “XH” sh.p.k &amp; “A” sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr.1717 Prot. datë 16.03.2021 për realizimin e punimeve civile.</p>
7	<p>Në objektin <b>“Ndërtim KUZ Vlocisht Faza I”</b> sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe BOE “A” sh.p.k &amp; “N” sh.p.k me Nr.4699 Prot. datë 28.09.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 10,322,460 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 2 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas</p>	77-142	I lartë	<p>Bashkia Maliq të marri masa, për arkëtimin e shumës 106,202 Lekë pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha</p>

	dokumentacionit të dosjes teknike nga verifikimi i detajuar i analizës së çmimeve rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 1 (një) zë punimesh në shumën 106,202 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.			shkallët e gjykimit nga BOE "A" sh.p.k & "N" sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr. 4699 Prot. datë 28.09.2020 për realizimin e punimeve civile.
8	Rezultoni se në 4 procedura (-Rikonstrukcion i fushës së futbollit, të stadiumit të qytetit Maliq; - Përmirësimi i banesave ekzistuese; - Shërbim mirëmbajtje mjetet dhe eskavatorët; - Sistemit asfaltim rrugë në Njësitë Administrative viti 2022), janë evidentuar problematika në fazën e hartimit të specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjes dhe dokumentimit të fondit limit. Shkeljet apo problematikat konsistojnë në këto drejtime: Nuk janë dokumentuar apo pasqyruar analiza në lidhje me sasinë e mallit apo shërbimit që kërkohet të prokurorët; Specifikimet teknike nuk kanë të përcaktuar standartin e cilësisë në lidhje materialet që do të përdoren nga OE për realizimin e kontratës së prokuruar. Shkak i problematikës është moszbatimi i plotë i kuadrit ligjor në fazën e hartimit të specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjes dhe dokumentimit të fondit limit nga personat përgjegjës (Njësia e Prokurimit). Mungesa e analizave në lidhje me sasinë e mallit/shërbimit që kërkohet të prokurorët apo hartimi i gabuar i specifikimeve teknike përbën një risk të shtuar si për realizimin e procedurës së prokurimit ashtu edhe për cilësinë e objektit që prokurorët.	77-142	I lartë	Spektori i Prokurimit Publik, NjP apo komisioni përkatës, në Bashkinë Maliq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, duke hartuar dhe u bazuar paraprakisht, në specifikimet teknike të objektit që prokurorët, të cilat të përcaktojnë qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët.
9	Nga Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq, në vitin 2020 është hartuar projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit "Kuz Njësitë Administrative". Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoni se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit: Ing. M.ZH, Ing. S.K dhe Ark. G.K. Referuar formimit profesional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, konstatohet se vetëm Ing. M.ZH është e pajisur me licencën e projektimit nr. K. 2357. Gjithsesi licenca e znj. M.ZH është për projektim të kategorive 3, 6 dhe 7, ndërkohe që për objektin "KUZ" kërkohet licenca e kategorisë 5 (Projektues vepra hidraulike). Kjo situatë ka ndodhur pasi Bashkia Maliq, me qëllim shmangien e shpenzimeve, ka angazhuar punonjësit e saj për hartimi i projekt/preventivave duke mos kryer një procedurë prokurimi të mirëfilltë për përfitimin e objektit i cili mnd të kryej nga specialistë/inxhinierë të licencuar.	144-159	I lartë	Titullari i Bashkisë Maliq, në lidhje me investimet që do të kryhen në të ardhmen, për të cilat është i nevojshëm hartimi paraprak i një projekt-preventivi, të marrë masa që ky i fundit të hatohet nga specialistë të pajisur me licencë profesionale për kategorinë përkatëse.
10	Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit me objekt "Kuz Njësitë Administrative", konstatohet se KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 13.01.2021, KVO ka pasur detyrimin ligjor që vlerësimi i tyre të kryhet brenda datës 28.01.2022 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit dhe SPE, rezultoni se vlerësimi i ofertave është kryer në datën 02.02.2022, çka do të thotë, jashtë	77-142	I lartë	Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, të marrin masa që vlerësimi i ofertave të kryhet brenda afateve të përcaktuara nga aktet nënligjore në varësi të llojit të procedurës.



	afatit të përcaktuar. Kjo situatë ka ndodhur pasi nga anëtarët e Komisioni të Vlerësimit të Ofertave është neglizhuar zbatimi i afateve të përcaktuara për fazën e vlerësimit.			
11	Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Maliq ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 300,000,000 lekë, ndërsa realizimi 144,402,002 lekë, ose në masën 48.13%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 314,558,000 lekë, realizuar 267,798,000 lekë, ose në masën 85.13 % dhe me mosrealizim në vlerën 46,760,000 lekë, ose 14.87%.	32-54	I lartë	Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Maliq të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.
12	Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga <b>300,000 mijë lekë</b> të parashikuara, janë realizuar në vlerën <b>144,068 mijë lekë</b> ose 48 %, <b>me një mosrealizim në vlerën 155,932 mijë lekë</b> . Në plan janë përfshirë dhe detyrimet e prapambetura, nga viti 2020-2021 të cilat përfshijnë disa zëra, në vlerë 79,089,675 lekë ose 26.3% të totalit të planit. Sa më sipër konstatohet se në planin e të ardhurave për vitin 2022, taksa e tokës është planifikuar për vlerën <b>60,000 mijë lekë ose 20 %</b> e planit, kjo taksë nuk është mbledhur duke ndikuar ndjeshëm në realizimin e të ardhurave. Gjithashtu me mosrealizim të dukshëm dhe që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi, janë taksat dhe tarifave familjeve, për vitin 2022, të ardhurat nga Taksa e tokës, Taksa ndërtese dhe Tarifa pastrimi gjelbërimi e ndriçimi janë planifikuar gjithsej në vlerën <b>155,917 mijë lekë ose 51.9 %</b> e planit vjetor. Janë realizuar <b>74,852 mijë lekë ose 49 %</b> të planit. <b>Taksa e ndërtesës</b> rezulton se në vitin 2022, nga <b>27,197 mijë lekë</b> e planifikuar është realizuar <b>14,178 mijë lekë ose 52 %</b> , me një mosrealizim në vlerën <b>13,019 mijë lekë</b> . <b>Tarifa vendore (pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi)</b> rezulton se në vitin 2022, nga <b>67,830 mijë lekë</b> e planifikuar janë realizuar <b>32,205 mijë lekë ose 47 %</b> , <b>me një mosrealizim në vlerën 35,625 mijë lekë</b> . Nga mosrealizimi i planit të të ardhurave si më sipër ka sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë vetëm për taksat familjare në vitin 2022 në vlerën gjithsej <b>43,439 mijë lekë</b> .	32-54	I lartë	Nga Bashkia Maliq të merren masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të bëhet një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore, kjo duke u mbështetur në burimet e krijimit të të ardhurave dhe arkëtimin e borxhit të akumuluar nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga familjet.
13	Gjatë periudhës 2009-2012 sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nëpërmjet VKM në Bashkinë Maliq janë transferuar 4113 pasuri. Në Bashkinë Maliq me VKM nr. 127, date 02.02.2009 janë transferuar 964 pasuri, me VKM Nr. 1154, date 13.08.2008 i janë transferuar ish komunës Pojan 362 pasuri, me VKM Nr. 660, date 11.06.2009 i	54-77	I lartë	Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZVASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me

	janë transferuar ish komunës Libonik 629 pasuri, me VKM Nr. 826, date 21.11.2012 i janë transferuar ish komunës Pirg 376 pasuri, me VKM Nr. 01.04.2009 i janë transferuar ish komunës Vreshtas 362 pasuri, me VKM Nr. 524, date 30.06.2010 i janë transferuar ish komunës Gore 815 pasuri, me VKM Nr. 734, date 26.10.2011 2010 i janë transferuar ish komunës Moglicë 592 pasuri. Nga pasuritë e transferuara 76 pasuri janë pajisur me certifikatë pronësie, 11 pasuri janë të pajisura me certifikatë përdorimi dhe 29 pasuri janë në proces rregjistrimi. Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e bashkisë Maliq nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezultoi i pa përditësuar.			qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
14	Nga auditimi i 16 procedurave, rezultoi se në 9 procedurat: "Ndërtimi i Ujësjellësit Maçurisht-Plasë", "Sistemi asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III", "Kuz Njësitë Administrative", "Ndërtim KUZ Vloçisht faza 2", "Rikonstrukcion i fushës së futbollit", "Rikonstrukcion objekte ndertimore 2022", "Përmirësimi i banesave ekzistuese", "Sistemi asfaltim rrugë në Njësitë Administrative" dhe "Shërbim mirëmbajtje mjetet dhe eskavatorët" është evidentuar aplikimi i kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës. Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumentuara, për shkak të moszbatimit të kadrës ligjore në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (Njësia e Prokurimit), çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa eventuale e konkurrencës.	77-142	I lartë	Spektori i Prokurimit Publik (NjP përkatëse) në Bashkinë Maliq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet t'i argumentojë teknikisht dhe ligjërisht ato duke pasur gjithmonë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, harmonizimin me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë të OE, duke nxitur gjithashtu konkurrencën midis tyre.
15	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 <b>praktika</b> tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosrespektimin e kushteve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për ndërtimin e objekteve të prodhimit, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, për lejet e ndërtimit me objekt: 1."Magazinë frigoriferike 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq. 2."Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 215-2021/6 Prot., datë 28/04/2021, me zhvillues "N" ShPK, në adresën Fshati Drithas, Libonik, Maliq.	144-159	I lartë	Nga DPZHT Maliq të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara për objektet me funksion prodhimit, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, të plotësojnë të gjitha kriteret dhe rregullat për zhvillimin e tyre, duke respektuar lartësinë, intensitetin, vëllimin dhe distancat.
16	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 <b>praktika</b> tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhshmërinë e planvendosjes së miratuar në lejet e ndërtimit, të dhënave të treguesve të zhvillimit dhe projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje. Gjithashtu në planvendosjen e miratuar nuk evidentohet	144-159	I lartë	Nga DPKZHT Maliq të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar përputhshmërinë ndërmjet planit të vendosjes së strukturave dhe projektit të ndërtimit. Gjithashtu të verifikohet ekzistenca e infrastrukturës

	<p>aksesi për në parcelën në të cilën do të zhvillohet ndërtimi. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt: 1. "Magazinë frigoriferike 1 kat", miratuar me vendimin Nr.2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq. 2. "Objekt 6 kate nga te cilat 5 kate banimi dhe nje kat i alternuar me njësi shërbimi dhe ambiente banimi dhe 1 kat parkimi nëntokë", miratuar me vendimin Nr.78/2, datë 18/02/2020, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në Maliq.</p> <p>Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 <b>praktika</b> tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit edhe për një tipologji të ndryshme ndërtimi nga ajo e lejuar në zonë. Në lejet e ndërtimit të miratuara për zhvillimin e objekteve me destinacion bujqësor/ blektoral, në tokë bujqësore, në projektin e ndërtimit dhe relacionin teknik janë propozuar edhe funksione të tjera, që nuk janë në përputhje me tipologjinë dhe destinacionin e lejuar. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:1." <i>Magazinë frigoriferike 1 kat</i>", miratuar me vendimin Nr. 2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq.2. "<i>Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat</i>", miratuar me vendimin Nr. 215-2021/6 Prot., datë 28/04/2021, me zhvillues "N" ShPK, në adresën Fshati Drithas, Libonik, Maliq.</p>			<p>kryesore dhe dytësore, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.</p> <p>Nga DPKZHT Maliq të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa verifikuar tipologjinë e ndërtimit të propozuar në projektin e ndërtimit, që të jetë në përputhje me tipologjinë dhe destinacionin e lejuar sipas njësine përkatëse.</p>
17	<p>Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të "Certifikatave të përdorimit" u konstatuan 4 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura me objekt: 1. "<i>Rikonstruksion godinë 2 kate + shtesë anësore (përshtatje për agroturizëm)</i>", miratuar me vendimin Nr. 3267/2, datë 26/07/2021, me zhvillues z.TH.N, në adresën fshati Zvirinë, Njësia Administrative Pirg, në Maliq. 2. "<i>Rikonstruksion lokali dhe shtesë kati deri 3 kate</i>", miratuar me vendimin Nr.6205/4 Prot., datë 23/04/2021, me zhvillues z.A.B dhe znj.Z.B, në Maliq. 3. "<i>Banesë individuale (2 kate)</i>", miratuar me vendimin Nr. 5519/2 Prot., datë 14/12/2022, me zhvillues znj.R.M, në adresë Shëngjegj, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.4. "<i>Objekt 6 kate nga te cilat 5 kate banimi dhe nje kat i alternuar me njësi shërbimi dhe ambiente banimi dhe 1 kat parkimi nëntokë</i>", miratuar me vendimin për leje ndërtimi me Nr.78/2, datë 18/02/2020 dhe me vendimin për çertifikatë përdorimi me Nr.1849/2, datë 06/05/2022, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në Maliq.</p>	144-159	I lartë	<p>Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Maliq të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar. Nga IVMT Maliq të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit, përpara miratimit të certifikates së përdorimit.</p>

### 3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinionit i auditimit.

#### OPINIONI I AUDITIMIT

##### **I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2022:**

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Maliq për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2022 - 31.12.2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

##### **Opinionit:**

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinion me rezervë” pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë Maliq më 31 dhjetor 2022, referuar udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

##### **Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale por jo të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Maliq. Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

##### **Përshkrimi i çështjeve kryesore:**

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2022, paraqiten si më poshtë: Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Raportin e Auditimit, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Në mënyrë të gabuar shpenzimet e kryera për investime dhe që rezultojnë në proces (llog. 23), janë kontabilizuar në llog. në llog.21, duke i konsideruar ato si shpenzime të përfunduara, të marra në dorëzim dhe të kapitalizuara. Efektet janë në shumën 131,042,783 lekë;

-Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 8,033,127 lekë.

-Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 75,616,604 lekë.

-Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 185,750,380 lekë.

- Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 22,546,036 lekë.
- Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 108,496,747 lekë.
- Llogaria 26 “Aktivet Afatgjata Financiare” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 582,418,452 lekë.
- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 114,275,347 lekë.

### **Përgjegjësia e Drejtuesve të Bashkisë**

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Maliq, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësia e audituesit të KLSH**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH, është që të shprehë një opinion në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesit të KLSH, lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalie materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën e audituesit. Në gjithashtu identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurën e auditimit të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedurën e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të subjektit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

### **II. Opinioni mbi përputhshmërinë.**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë MALIQ janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin

profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar/modifikuar**.

#### **Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërisë:**

Opinion i modifikuar jepet në ato raste kur audituesi ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe ka konstatuar gabime materiale, ose kur audituesi ka marrë siguri të kufizuar, pasi në bazë të punës së kryer nuk ka siguruar evidencë e mjaftueshme për të mbështetur dhënien e opinionit, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të kenë mospërputhshmëri të aspektit material.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Bashkia MALIQ nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Maliq ka diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 300,000,000 lekë, ndërsa realizimi 144,402,002 lekë, ose në masën 48.13%.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në kenë vlerën **114,176 mijë lekë** nga të cilat **43,439 mijë lekë** lekë i përket vitit 2022.

-Në auditimin e 16 procedurave, rezulton se në 9 procedura është evidentuar aplikimi i kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës.

-Nga auditimi i 16 procedurave me fond limit 493,118 mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej në 5 procedura me vlerë të fondit limit 269,675 mijë lekë të vlerës së fondit limit të audituar, ku OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimi të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK për vlerën totale të kontratave 223,021 mijë lekë.

-Në zbatimin e kontratave të punëve publike, ku nga auditimi i 2 kontratave u konstatua dëm ekonomik në vlerën 249,888 lekë.

-Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë MALIQ:**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia MALIQ.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por

nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

## **II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 863/1 Prot, datë 10.10.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, nga data 13.10.2023 deri në datë 27.11.2023, në subjektin Bashkia MALIQ u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 dhe i përputhshmërisë për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- |    |    |    |                         |
|----|----|----|-------------------------|
| 1. | K. | T. | <i>Përgjegjës grupi</i> |
| 2. | R. | L. | <i>Anëtar</i>           |
| 3. | K. | H. | <i>Anëtar</i>           |
| 4. | Q. | M. | <i>Anëtar</i>           |
| 5. | S. | H. | <i>Anëtar</i>           |

**Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie.

**Marrësi:** Raporti Përfundimtar i Auditimi i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Maliq.

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

### **1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Maliq kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>1</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Maliq është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë

<sup>1</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë MALIQ dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
- Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Maliq.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Bashkinë Maliq.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Maliq, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

### **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Maliq është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Maliq. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-<sup>së</sup> nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;



- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- V.K.M nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023”.
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH<sup>së</sup>”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH<sup>së</sup>”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë Maliq, etj.
- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Maliq grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;

- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë MALIQ me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>2</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-J<sup>a</sup> aplikon<sup>3</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

---

<sup>2</sup> ISSAI 1315

<sup>3</sup> *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit*

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.**

**Zona Gjeografike:** Maliqi kufizohet në veri me Bashkinë Pogradec, në verilindje me Bashkinë Pustec, në lindje me Bashkinë Maliq, në jug me Bashkinë Korçë dhe në lindje me Bashkitë Skrapar dhe Gramsh. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Maliqit.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 41,757 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 64,664 persona. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 656.34 km<sup>2</sup>. Densiteti i popullsisë sipas censurit është 64 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas regjistrit civil është 99 banorë/ km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e Maliqit shtrihet në një nga zonat më pjellore bujqësore të Shqipërisë, më së shumti në një ish-kënetë të tharë me shumë mund dhe sakrifica njerëzore në vitet 1950. Qyteti i Maliqit u krijua si një qendër e rëndësishme e industrisë ushqimore në rang vendi me disa produkte të rëndësishme si sheqeri, melasa apo niseshteja si dhe e industrisë së përpunimit të drurit, por falimentimi i kësaj industrie solli papunësi të lartë në qytet dhe largimin e një pjese të konsiderueshme të banorëve.

Në zonat malore banorët i kanë dhënë prioritetet blegtorisë dhe bletarisë ndërsa problematike mbetet prerja masive e pyjeve.

Problematikë e pazgjidhur mbetet mungesa e tregut për prodhimet bujqësore ndërsa fermerët janë kryesisht të pa orientuar drejt kulturave që duhet të kultivojnë në përputhje me kërkesat e tregut Fshatrat e fushës së Korçës kanë pasur zhvendosje të popullsisë, ndërkohë që në zonat malore fenomeni i braktisjes është tejet i përhapur. Të rinjtë zgjedhin të studiojnë në kryeqytet dhe pas përfundimit të studimeve nuk kthehen më, çka ka sjellë për pasojë plakjen e fshatrave në zonat malore.

Në aspektin kulturor e gjithë zona është e varfër, mungojnë ambientet por edhe aktivitetet të cilat do të mund të nxisnin edhe me tepër zhvillimin e kultures.

Misioni i Bashkisë Maliq është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. duke garantuar vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

#### **2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

##### **2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.**

**2.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Vepërimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.**

##### **Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

Në zbatim të pikës nr. 1, dhe nënpikës nr. 1.1, të programit të auditimit nr. 863/1 prot., datë 10.10.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit.
2. Struktura organizative me ndryshimet përkatëse.
3. Urdhrat për caktimin e nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues.
4. Kod sjellje, etike ose udhëzim mbi zbatimin e etikës.
5. Urdhrat për caktimin e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit strategjik.
6. Deklarata e cilësisë, raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, pyetësorët e vetëvlerësimit të dorëzuar në Ministrinë e Financave.

7. Dokumentacion tjetër mbështetës.

**Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:**

**Drejtimit kryesore të auditimit të MFK-së janë:**

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Maliq, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

## **1. MJEDISI I KONTROLLIT**

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

### **1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues:**

Bashkia Maliq ushtron funksionet e veta me Rregulloren e brendshme “*Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Maliq*”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” neni 9 pika 1/1 germa b, në Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit Bashkiak të çdo viti “*Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe njësisve administrative*” si dhe në Vendimin e Kryetarit “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Maliq*”. Kjo Rregullore është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 115 datë 19.12.2022, vendim i cili kishte ndryshuar rregulloren e parë, të miratuar në vitin 2016 me vendimin nr.15, datë 11.07.2016 “*Për organizimin, funksionimi, detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Maliq*”. Bashkia Maliq ka miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Maliq nr.87 datë 20.12.2016 “*Rregullat e etikës për administratën e Bashkisë Maliq*”. Këshilli Bashkiak ka miratuar numrin e përgjithshëm të punonjësve: për vitin 2021 me VKB nr. 94, datë 24.12.2021, “*Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Maliq për vitin 2022*”. Struktura organizative është konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.1288 prot, datë 12.01.2022.

**Konstatim:** Bashkia Maliq nuk ka hartuar “*Rregulloren e posaçme për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike në kundërshtim me Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” neni 9, pika 1/1 germa b, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*” i ndryshuar.

## **1.2. Politika menaxheriale dhe stili i punës:**

Punësimi në Bashkinë Maliq bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pikat 1 dhe 2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë Maliq:

- Drejtoria ligjore dhe burimeve njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pikat e, ë, f dhe g të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për vitin 2022, Komiteti i Përhershëm i pranimit në Bashkinë Maliq është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 441/1 datë 04.10.2021 me nr. 5272/1 prot., datë 04.10.2021, konform VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu III pikat 2 dhe 3.

Struktura përgjegjëse e bashkisë harton në fillim të çdo viti “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për nënpunësin civil” neni 18 dhe 69, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si edhe të atyre me kontratë pune konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Maliq”. Nga verifikimi i dokumentacionit që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se për vitin 2022 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të bashkisë nr. 662 datë 31.12.2021 dhe nr. 6890 prot., datë 31.12.2022, gjithashtu është hartuar Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil, i cili bazohet mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësisë përbërëse në strukturë. Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për vitin 2022 në Bashkinë Maliq është miratuar nga titullari i institucionit me shkresën nr.6 datë 11.02.2022 Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Maliq, bëhet në faqen zyrtare të saj si dhe në, Portalin Kombëtar të Punësimit të Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, konform Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19, pika 1, 2; VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” pika 13; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II, pika 6.

- Për vitin 2022 nga Bashkia Maliq është hartuar dhe miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil me datë 11.02.2022 dhe me nr. 697 prot., me 10 vende vakante.

- Nga punonjësit e larguar nga puna me motivacion shkarkim me masë disiplinore apo largim nga detyra, për vitin 2022 nuk ka asnjë padi dorëzuar në Komisionerin e Nëpunësit Civil apo në Gjykatë.

Nga Bashkia Maliq me shkresën nr. 1134 prot., datë 27.02.2023 janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar, Kontrollit Pyetësorët e Vetëvlerësimit dhe Deklaratën për Cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2022. Bashkia Maliq nuk shpreh qartë mangësitë në aktivitetet e kontrollit, në moszbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**Konstatim:** Nga auditimi rezultoi se “Formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës” nuk janë bërë pjesë e dosjes së personelit, apo shtojcë në kontratën e punës për ata punonjës që marrëdhëniet

e punës me bashkinë iu rregullohen me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

### **1.3. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit:**

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Maliq funksionon me një strukturë të bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative nuk shoqërohen edhe me organigramën përkatëse për t’u miratuar nga Këshilli Bashkiak, por janë miratuar pa to.

- Në Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Maliq është miratuar struktura organizative në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 1. 1/c. Struktura organizative për vitin 2022 është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 94 datë 24.12.2021. Strukturat organizative janë shoqëruar me organigramën përkatëse. Organigrama si një paraqitje grafike e strukturës organizative, pasqyron një informacion të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë, mbi pozicionet, klasifikimin por edhe mbi numrin e personelit të planifikuar dhe atë faktik. Organigrama është një mjet informues dhe administrativ, pasi përfaqëson njësitë e strukturës (departamente, drejtori e sektorët e tyre) shpërndarjen e tyre, funksionet dhe kompetencat. Organigrama institucionale, paraqet një informacion statistikor në kohë reale mbi kategoritë e proceseve të punës, por edhe numrin e personelit (faktik apo vakant) që u përket. Përsa më lart në zbatim të “Manualit të MFK-së” të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, nr. 108, datë 17.11.2016 dhe atë nr.; Ligjin nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”; Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 21 pika 1,2.

### **1.4. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore:**

Bashkia Maliq aktivitetin e saj funksional e mbështet në Rregulloren e Brendshme, e miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 115 datë 19.12.2022 Rregullorja e Brendshme përmban bazën ligjore dhe fushën e zbatimit, strukturën organizative, funksionet menaxheriale, rregulla të përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e çdo njësie dhe pozicioni, të drejtat dhe detyrat e personelit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. Bashkia Maliq deri më sot nuk disponon “Organigramën” ku të jenë pasqyruar të gjitha proceset e punës dhe “Gjurmët e auditimit” për njësitë kryesore të Strukturës.

### **1.5. Aftësitë profesionale të punonjësve:**

Për të audituar dosjet e personelit, përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitin 2022 në aparatin e bashkisë dhe në ndërmarrjet e varësisë për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil me kod pune si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Maliq. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 “Për nënpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

**Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit:** Kërkuam një kampion nga dosjet e punonjësve të emëruar në bashkinë Maliq për vitin 2022 për të gjitha kategoritë, lëvizjeve të personelit/ngritjet në detyrë si dhe të punonjësve të larguar të periudhës nën auditim.

**Konstatim:** Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e Bashkisë Maliq (DBNJ), nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore efektive për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t’i kryer me efikasitet ato dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e njësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni

64, pika h, Ligjit nr. 10296 /2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kapitulli III, pika 3.1

### **3.2. MENAXHIMI I RISKUT**

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut.

Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund ti delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës konkretisht nëpunësit zbatues.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

Kordinatori i riskut për Bashkinë Maliq është emruar zj. G.M me urdhër nr.1/1 datë 06.01.2021 të titullarit të institucionit.

Kryetari i Bashkisë Maliq me vendim nr.1, datë 17.01.2022, “Për disa plotësime dhe ndryshime në Grupin për Menaxhim Strategjik(GMS) të Bashkisë Maliq” ka caktuar personat përgjegjës.

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 GMS ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje dhe ka marrë 6 vendime, për zhvillimin e mbledhjeve të GMS ishin hartuar protokollat përkatëse, ishin marrë vendimet për çdo mbledhje dhe ishin shoqëruar me relacionet dhe shpjegimet përkatëse.

GMS ka hartuar dhe miratuar “Regjistrin e Riskut” me shkresën nr.2123 prot të datës 08.04.2022 me vendim nr.2, datë 08.04.2022 “Për miratimin e misionit, deklaratën e politikës, pemën e programeve buxhetore dhe regjistrin e riskut viti 2022”, i cili është në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matja e riskut” si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i riskut”.

#### **Konkluzione:**

**1.**Regjistri i Riskut është hartuar nga GMS duke marrë në konsideratë vetëm raportet e auditimit të kontrollit të brendshëm, dhe kontrollit të jashtëm (Kontrolli I Lartë I Shtetit), drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë Maliq nuk kanë identifikuar riskun që mbartin objektivat e përcaktuara në



Bashkinë Maliq në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016 , Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i Riskut”.

### **3.3. AKTIVITET E KONTROLLIT**

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për rregjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Është i miratuar sistemi me dy firma me shkresën nr. 346/2 prot, datë 05.04.2016.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësive dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Duke u bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi Autorizues i njësive publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës”.

Bazuar në Udhëzimin nr. 16, date 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Riskut në njësitë publike” në rolin e Koordinatorit të MFK në Bashkinë Maliq me shkresë nr. 32/2 prot., datë 06.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë Maliq është caktuar zj. G.M me detyrë “Specialiste Finance” tek Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

➤ Kontrolllet parandaluese;

- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, që duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
- Procedurat e sinjalizimit.

### **Konkluzione:**

**1.** Bashkia Maliq nuk ka hartuar procedurat antikorrupsion dhe antimashtrim të cilat duhet të bazohen në Ligjin nr. 9508, datë 03.04.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, Ligjin për MFK-në, i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr.10294, datë 01.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.112/2015 e të tjera akte ligjore në fuqi.

**2.** Për vitin 2022 Bashkia Maliq nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmën e auditimit në kundërshtim me Ligjin Nr.110/2015 datë 15.10.2015 neni 16 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3 “Aktivitetet e Kontrollit.

### **3.4. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI**

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Maliq dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

### **3.5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive.

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësozin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Me shkresën nr. 1242 prot., datë 27.02.2023, nga Bashkia Maliq është hartuar dhe dërguar pranë Ministrisë së Financave, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Raporti Vjetor për Funksionimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm, Pyetësozin e Vetëvlerësimit për Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm dhe Plani i Veprimit për ngritjen e sistemit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar në ligjin 115/2015 datë 15.10.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në

njësine publike”, pika 15 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 Aneks Nr.6 “Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Gjithashtu është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.6, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

**Titulli i gjetjes:** KLSH ka konstatuar se, në Bashkinë Maliq funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht.

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, gjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

**“Mjedisi i kontrollit”:**

-Bashkia Maliq nuk ka hartuar “Rregulloren e posaçme për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Nuk janë përcaktuar objektivat konkret, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

**“Menaxhimi i Riskut”:**

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

**“Aktivitetet e Kontrollit”:**

- Për vitin 2022 Bashkia Maliq nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.
- Nuk ka hartuar procedurat antikorrupsion dhe antimashtrim të cilat rregullojnë procesin për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

**Ndikimi/Efekti:** Mosnjohje e plotë dhe sa duhet e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Maliq, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e gjurmës së auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit dhe rregulloren për parandalimin e konflikteve të interesit.

Struktura e Burimeve Njerëzore, të evidentojnë nevojat e stafit për trajnime dhe të hartojë dhe zhvillojë programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen profesionale të tij.

### **1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të programit të auditimit sa i përket çështjes mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së kësaj njësie, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të NJAB Bashkia Maliq.
2. Plani strategjik për vitet 2022-2024 dhe pasqyrat shoqëruese.
3. Planifikimi vjetor për vitin 2022 dhe pasqyrat shoqëruese.
4. Dosjet e përhershme dhe koherente të subjekteve të audituara.
5. Projekt Raportet dhe Raportet Përfundimtare të realizuara nga NJAB Bashkia Maliq.
6. Rekrutimi i punonjësve në NJAB si dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

### **1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe sipas Vendimit nr. 94, datë 24.12.2021, të Këshillit Bashkiak Maliq është miratuar struktura organizative e Bashkisë Maliq ku pjesë e saj është dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (në vijim NJAB) e përbërë nga tre pozicione konkretisht, 1 përgjegjës njësie dhe 2 specialist auditit. Përgjatë periudhës objekt auditimi pjesë e NJAB kanë qenë punonjësit si më poshtë:

Periudha: 01.01.2022-31.12.2022:

- Z. A.B me detyrë përgjegjës i njësisë së auditit të brendshëm.
- Znj. P.D me detyrë specialiste auditit. (larguar në datë 01.08.2022)
- Z .E.K me detyrë specialist auditit.
- Znj. K.D detyrë specialiste auditit. (Emëruar me urdhër Nr.605 datë 07.11.2022).

Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm është kryer në kundërshtim me ligjin 114/2015 datë 22.10.2015

Zj. K.D me detyrë specialiste e NJAB nuk është e certifikuar në kundërshtim me ligjin 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik sipas nenit 11, pika 2 shkronja “c”.

Struktura e njësisë AB për periudhën 2022, është paraqitur në **Pasqyrën AB1**, në Anekset bashkëlidhur.

### **1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.**

Gjatë periudhës 2022, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Maliq, janë kryer gjithsej 7 auditime, ndarë si më poshtë vijon:

-Plani vjetor për vitin 2022 është përgatitur dhe miratuar me shkresën nr. 5448 prot., datë 12.10.2021 dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vitin 2022 me shkresën nr. 4642/1 prot., datë 12.10.2021, i ndryshuar me shkresën nr. 5850 prot., datë 15.11.2022 në përputhje me standardin

e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.1. Referuar planit vjetor për vitin 2022 synohen të realizohen 7 auditime për vitin 2022 dhe janë realizuar 7 auditime. Plani vjetor është paraqitur në **Pasqyrën AB2**, në Aneksat bashkëlidhur.

-Plani Strategjik për periudhën 2022-2024 është përgatitur dhe dërguar në “Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” për vitet 2022-2024 me shkresën Nr.4642/1 prot, datë 12.10.2021 në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika

- Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.1 “Planifikimi strategjik” që kryhet nga vetë nga kjo njësi.

Për vitin 2022 nuk është rishikuar planifikimi strategjik në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.100 datë 25.10.2016 Kap III, Formati Standart Nr 5.Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB.

-Raporti Vjetor i Veprimtarisë Audituese për vitin 2022 është dërguar me shkresën Nr.887 prot datë 14.02.2023, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Pika 3.6.

- Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi janë mbajtur të plotësuara në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI,

-Karta e Auditimit të Brendshëm për NJAB të Bashkisë Maliq është miratuar me datë 08.01.2019., në përputhje me nenin 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, e cila nuk është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

**Titulli i Gjetjes:** Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik.

**Situata:** Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sa i përket çertifikimit të punonjësve nuk ka qenë në përputhje përcaktimet ligjore sipas VKM nr 83 datë 03.02.2016.

Struktura e NJAB për vitin 2022 është parashikuar me tre punonjës, një përgjegjës dhe dy specialistë. Gjatë viti 2022 struktura e NJAB ka funksionuar me 3 punonjës, nga të cilët dy janë të çertifikuar ku përgjegjësi është i certifikuar në vitin 2008 dhe një specialist është çertifikuar në vitin 2021 ndërsa një specialist është i pa certifikuar.

Zj. K. D. me detyrë specialiste e NJAB e cila është punësuar në Bashkinë Maliq në datë 07.11.2022 nuk është e certifikuar në kundërshtim me ligjin 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik sipas nenit 11, pika 2 shkronja “c”.

**Kriteri:** Ligji nr.114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

**Ndikimi/Efekti:** Punonjësit e pa çertifikuar mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të njesisë së auditimit.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandimi:** Bashkia Maliq të marr masa që njësia e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të funksionojë me punonjës të çertifikuar, kërkesë e parashikuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.

## **2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

**2.1.** Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2022;

**2.2.** Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

**2.3.** Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

**2.4.** Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

**2.5.** Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;

- Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit’;

- PBA dhe buxheti vjetor;

- Raportet e monitorimit;

- Vendimet e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq”;

- Vendime të tjera të Këshillit Bashkiak, në lidhje me ndryshimet buxhetore;

- Dokumente të bankës etj.

### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet :**

**2.1.** Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mall e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

**Për vitin 2022** buxheti bazë fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 95 datë 24.12.2021, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë me shkresën nr 1288/1 datë 06.01.2022. Buxheti vjetor është miratuar brenda afateve që përcakton pika e nenit 41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (brenda datës 25 dhjetor).

Në këtë VKB të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 300,000,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 309,640,368 lekë, transfertat specifike ka vlerën 165,898,724 lekë. Në total të ardhurat sipas buxhetit të vitit 2022 janë 775,539,092 lekë.

Të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm 78,701,213.23 lekë

Në total të ardhurat kanë vlerën 854,240,305.23 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 854,240,305.23 lekë.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2022 sipas tabelave në vijim:

	Emërtimi	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Projekt Buxhet 2022
600	Paga	310,292	310,292	318,198
601	Sigurime Shoqërore	51,819	51,819	54,422
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	193,784	193,784	156,325
604	Transferta Korente të brendshme	0	0	11,377
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	19,569	19,569	7,097
609	Frezerve emergjenca	1000	1000	1000
<b>I</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>576,464</b>	<b>576,464</b>	<b>548,419</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara			2,467
231	Kapitale të Trupëzuara	214,538	214,538	224,653
	<b>Shp. Kapitale me financim te brendshëm</b>	<b>214,538</b>	<b>214,538</b>	<b>227,120</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara			
	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>			
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>			
<b>III</b>	<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti</b>			
	<b>I+II +III Totali I Shpenzimeve</b>	<b>791,002</b>	<b>791,002</b>	<b>775,539</b>

Gjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2021). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr.14, datë 04.02.2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Maliq për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 78,701,213.23 lekë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë me shkresën nr 155/1 datë 15.02.2022

-Me VKB nr.22 , datë 25.02.2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Maliq për miratimin e një shtese në buxhet për financimin e projektit “vemendje,kujdes dhe sherbime cilesore për moshën e tretë”, të fituar nga Këshilli i Qarkut Korçë , për paga, sigurime ,shpenzime operative dhe investime ,në vlerën 1,000,000 lekë.

- Me VKB nr.83 , datë 30.09.2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Maliq për miratimin e buxhetit shtese transferta specifike për rritjen e pagave për arsimin parashkollor për vitin 2022 , duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 1,814,807 lekë.

- Me VKB nr.103 , datë 13.12.2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Maliq për miratimin e buxhetit shtese për detajimin e fondeve për pagesën e detyrimeve të prapambetura, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë me shkresën nr 1108/1 datë 21.12.2022, ne vleren 9,549,000 lekë.

Përdorimi për shpenzime operative dhe investime sipas objekteve:

1. Ndertim KUZ Faza II-të 2021 në vlerën, 3,173,832 lekë.
2. Sistemim asfaltim rruge ne Nja Faza III-të 2021 në vlerën, 1,588,699 lekë.
3. Sistemim asfaltim rruge Gryka Vloçisht-Drithas në vlerën, 1,596,303 lekë.
4. Detyrim ton mbetje të përziera në vlerën 1,080,050 lekë.
- 5.Shërbim pastrimi në vlerën 2,110,116 lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për investime për vitin 2022 ka vlerën 314,558,000 leke , realizimi i këtij plani është, në vlerën 267,798,000 lekë në 85.13%. Nuk janë realizuar në shumën prej 46,760,000 lekë, si rezultat i mos realizimit të ardhurave të parashikuara. Kanë mbetur disa objekte



të përcaktuara sipas parashikimit të domosdoshme këto për komunitetin , të miratuara në buxhet, si: Qendra komunitare kulturore Maliq Faza I-rë, Rikonstruksion stadiumi Faza II-të, Sistemim asfaltim rruge + sheshe Maliq, Sistemim asfaltim rrugë në Nja, Sistemim asfaltim rruga Vlocisht-Drithas poshtë, Rjeti i brendshëm ujësjellsa, KUZ në Njësitë administrative etj.

Pasqyrë përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 në 000/lekë :

**Tabela nr.2**

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 95, datë 24.12.2021	Buxheti shtesë i Miratuar VKB nr. 14, datë 04.02.2022	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, Miratuar me VKB nr. 95dt. 24.12.2021	Buxheti shtesë i Miratuar VKB nr. 14, datë 04.02.2022	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2+3		4	5	
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	300,000	0	300,000	Art. 600 Paga	318,198	1.248	<b>319,446</b>
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2021		20,352	20,352	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	54,422	256	<b>54,678</b>
Të ardhurat e veta të planifikuara për shpenzim për vitin 2022		0	0	Art.602 Shpenzime operative	156,325	33,207	<b>189,532</b>
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>300,000</b>	<b>20,352</b>	<b>320,352</b>	Art. 603 Sponsorizime	0		<b>0</b>
Të ardhura të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar	0	1,854	1,854	Art.604 Transferime korrente të brendshme	11,377	586	<b>11,963</b>
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifikë	0	56,495	56,495	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	7,097	0	<b>7,097</b>
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022	309,640	0	309,640	Art. 230-231 Investime	227,120	43,404	<b>270,524</b>
Transferta specifikë e çelur për llogari të vitit 2022	165,899	0	165,899	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	1,000	0	<b>1,000</b>
<b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit.</b>	<b>475,539</b>	<b>58,349</b>	<b>533,888</b>				
<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>775,539</b>	<b>78,701</b>	<b>854,240,</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>775,539</b>	<b>78,701</b>	<b>854,240</b>

Burimi: Bashkia Maliq

**2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.**

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundimtar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601)	374,124	372,620	1,504
2	Shpenzime (602.604.609)	209,592	175,799	33,793
3	Investime Bashkia	270,524	227,120	43,404
4	Investime nga FZSH	0	0	0
	<b>Total i planit fillestar</b>	<b>854,240</b>	<b>775,539</b>	<b>78,701</b>
	<b>Shtesat nga Pushteti Qendror</b>	<b>11,364</b>	<b>11,364</b>	<b>0</b>
5	Investime	6,359	6,359	0

6	Shpenzime për paga dhe sigurime	1,815	1,815	0
7	Shpenzime operative	3,190	3,190	0
	<b>Gjithsej</b>	<b>865,604</b>	<b>786,903</b>	<b>78,701</b>

Burimi: Bashkia Maliq

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej **78,701 mijë** lekë nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar janë pasqyruar rritja e grantit të pakushtëzuar, transfertat specifike dhe të ardhurat e trashëguara të cilat për shkak se alokohen pas miratimit të buxhetit fillestar, nuk janë pjesë e këtij të fundit.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të graveve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të graveve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, graveve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Tabela e ndryshimeve në buxhetin 2022 paraqitet në vijim në 000/lekë :

**Tabela nr. 3**

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe rishpërndarja e fondeve						
Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë	Shtesat dhe Pakësim et ne buxhet në total		Rishpërndarjet : Shtesa/ Pakësime të Buxhetit	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)

	Miratu ar me VKB nr. 95 dt 24.12.2021	Mirat uar me VKB nr. 14 datë 04.02. 2022	Miratu ar me VKB nr. 22 dt 25.02.2 022	Mirat uar me VKB nr 83 dt 30.09. 2022.	Miratu ar me VKB nr 103 dt 13.12.2 022		Mirat uar me VKB nr. 18dt. 04.02. 2022	Miratu ar me VKB Nr.40d t29.04. 2022	Mirat uar me VKB Nr.79 dt31. 08.20 22	Rishp ër ndarj e total	
	1	2	3	4	5	7=2+3+ 4+5+6	8	9		12=8+ 9+10+ 11	13=1+7+12
Art. 600 Paga	318,198	1.248	360	1,555		3,163					321,361
Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	54,422	256	60	260		576					54,998
Art.602 Shpenzime operative	156,325	33,207	495		3,190	36,892	200		250	450	193,667
Art. 603 Sponsorizime	0					0					0
Art.604 Transferime korrente të brendshme	11,377	586				586					11,963
Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	7,097	0				0					7,097
Art. 230-231 Investime	227,120	43,404	85		6,359	49,848	-200	382	-250	--68	276,900
Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	1,000					0		-382		-382	618
<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>775,539</b>	<b>78,701</b>	<b>1,000</b>	<b>1,815</b>	<b>9,549</b>	<b>91,065</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>866,604</b>

*Burimi: Bashkia Maliq*

### **2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Plani dhe fakti i buxhetit të Bashkisë viti 2022 000/lekë*

Art.	Emertimi	Plan	Fakti	%
600	Paga	320,433	306,246	95,57%
601	Sigurime Shoqërore	52,158	52,158	100%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	153,784	145,091	94,35%
604	Transferta Korente të Brendshme	20,165	19,748	97,93%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	542,652	539,900	99,49%
609	Fondi Rezervë	618	0	0%
230	Kapitale të Patrupëzuara	80	80	100%
231	Kapitale të Trupëzuara	314,478	267,718	85,13%
	<b>TOTAL</b>	<b>1,403,450</b>	<b>1,340,304</b>	<b>95,5%</b>

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën 1,403,749,705 lekë e cila nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën 1,565,774,682 lekë, ose 162,024,977 lekë më shumë se plani buxheti i gjeneruar nga thesari.

**Më poshtë paraqitet buxheti përfundimtar plan-fakt për vitin 2022.**

#### **Tabela nr. 4**

Nr	Buxheti përfundimtar Plan-Fakt. Në 000/lekë	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit të realizuar				
					Nga të ardhurat e veta	Nga Granti Qeveritar			
						Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet
1	Paga600	320,433	306,246	95.57	11,690	178,575	112,049	3,934	0
2	Sigurime shoqërore 601	52,158	52,158	100	11	32,758	18,733	657	
3	Shp. Operat 602	153,784	145,091	94.35	87,060	24,645	33,384	0	
4	Fond. Emergj . 609	618	0	0	0	0	0	0	
5	Transferta Korrente te brendshme 604	20,165	19,748	97.93	5,326	6,000	0	8,422	
6	Transferta per familje dhe individe 606	542,652	539,900	99.49	4,237	5,906	3,130	526,627	
7	Investime 230-231	314,558	267,798	85.13	50,540	74,160	21,158		121,939
8	Mjete ne ruajtje llog 466	0	9,363			9,363			
	<b>Totali</b>	<b>1,403,450</b>	<b>1,340,304</b>	<b>95.5</b>	<b>158,864</b>	<b>331,407</b>	<b>188,454</b>	<b>539,640</b>	<b>121,939</b>

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transfertat e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **1,403,450 mijë** lekë, ndërsa realizimi **1,340,304 mijë** lekë, ose në masën 95.5%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 320,433 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 306,246 mijë lekë, ose në masën 95.57%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 100 %.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 153,784 lekë dhe është realizuar në vlerën 145,091 lekë, ose në masën 94.35%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 314,558 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 267,798 mijë lekë, ose në masën 85.13 %.

**Konkluzion:** Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Maliq ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar.

Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 300,000,000 lekë, ndërsa realizimi 144,402,002 lekë, ose në masën 48.13%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 314,558,000 lekë, realizuar 267,798,000 lekë, ose në masën 85.13 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave , angazhimet buxhetore (lidhja e kontratave) është bërë në fund të vitit buxhetor dhe disa procedura prokurimi nuk kanë perfunduar brenda vitit buxhetor 2022, që do të thotë se nga Bashkia Maliq në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetarin e Bashkisë Maliq z.G.T, si dhe znj.A.M, me detyrë Drejtore e Financës.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

*“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.*

**Titulli i gjetjes:** *Mangësi në programimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2022.*

**Situata:** Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Dimal ka diferenca me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **300,000,000** lekë, ndërsa realizimi në vlerën **144,402,002 lekë**, ose në masën **48.13%** të planit.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **314,558,000** lekë, realizuar **267,798,000** lekë, ose në masën **85.13 %**.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Maliq në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

**Kriteri:** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

*“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.*

**Ndikimi:** Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Maliq dhe performancës në përgjithësi.

**Shkaku:** Zbatimi jo i duhur i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë në zbatimin e buxhetit vjetor.

**Rëndësia: E mesme:**

**Rekomandimi:** Bashkia Maliq, të marrë masat për programimin e buxheteve afatmesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

#### ➤ **Fondet e shpenzuara për përballimin e situatës së pandemisë nga Covid 19**

Për vitin 2022 nuk është përdorur fond për situatën Covid -19

#### ➤ **Fondi rezervë**

Bazuar në pikën 6 neni 40 i nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, është planifikuar fod rezervë deri në 3% të totalit të shpenzimeve të planifikuara (duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara) .

Përdorimi i fondit rezervë gjatë vitit 2022 është bërë me vendimet e këshillit si më poshtë:

VKB nr 40 datë 29.04.2022 konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr 460/1 datë 11.05.2022, përdorim fondi rezervë në masën 381,725 lekë, përdorur për investime,bashkefinansim me fondacionin Dorkas.

➤ **Subvencionet**

Në vitin 2022 Bashkia Maliq ka marrë subvecion nga Ambasada Bullgare për Blerjen e nje automjeti per transportin e femijeve me aftesi te kufizuara dhe shpenzime opertive,celur për vitin 2022 në vlerën 1,513,436 lekë nga .(Projekti i fituar per vitet 2022 dhe 2023).

Subvencion nga organizata “Save the children” ne vlren 502,000 lekë ,për Blerje lodrash për ambient të jashtëm.Objekti ka përfunduar është vënë në funksionim.

Sipas raportimit nga Drejtoria e Financës, Bashkia Maliq nuk ka dhënë subvencione për vitin 2022.

*1.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)*

➤ **Detyrimet e prapambetura viti 2022**

Vlera e raportuar nga Bashkia Maliq në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është 10,618,288 lekë, ndërsa vlera e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me degën e thesarit dhe pasqyruar në pasqyrat financiare të bashkisë është 10,618,288 lekë. (Bashkia Maliq nuk ka njësi vartëse).

Diferenca midis vlerës së detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE me vlerën e rakorduar me degën e thesarit është 0 lekë .

Bashkia Maliq në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 62,083,430 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 62,083,430 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 62,083430 lekë, ose 100 % e vlerës së planifikuar. Gjatë vitit 2022 angazhimet e reja buxhetore si detyrime të prapambetura kapin vlerën 10,618,288 lekë.

Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 10,178,049 lekë, ose në masën 95.9% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta bashkisë.

Pra, në datën 31.12.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur me 51,465,142 lekë, ose në masën prej 82.9%.

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022 jepen në tabelën në vijim:

Në/ lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022 (situata më 31.12.2022)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2022
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
4864100	Detyrime të .p. per vend.gjyqesore	2,758,066	2,758,066	0	0	0
4864200	D.P.per sherbime	6,896,862	6,896,862	0	0	0
4864300	D.P.per mirembajtje		0	0	0	0
4864400	D.P.per investime	52,398,626	52,398,626	0	10,178,049	10,178,049
4865600	D.P per mallra	29,876	29,876	0	440,239	440,239
	<b>Totali me burime nga të ardhurat e veta</b>	<b>62,083,430</b>	<b>62,083,430</b>	<b>0</b>	<b>10,618,288</b>	<b>10,618,288</b>
4864400	D.P.per investime (drejtoria e Pergjithshme Ujesjelles Kanalizime )	50,784,897	50,784,897	0	0	0

	Detyrime ne total	112,868,327	112,868,327	0	10,618,288	10,618,288
--	-------------------	-------------	-------------	---	------------	------------

Burimi: Bashkia Maliq

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Gjendja me 01.01.2022 e shpenzimeve gjyqësore ka qënë 2,758,066 lekë .Shtesa gjatë viti 2022 vlera 427,804 lekë, pakesime viti 2022 në vlerën 2,987,970 lekë. Mbetja më 31.12.2022 ne vlerën 197,900 lekë.

Bashkia Maliq për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 2,987,970 lekë, nga e cila vlera 753,680 largime nga puna te punonjësve, vlera 2,234,290 lekë i përket vendimeve gjyqësore pagesë indeksimi i pagesave tek paaftësia per vitet 2005-2010. Likuidimi i vlerës 2,234,290 lekë është bërë nga fondet e celura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2022 janë financuar me fonde të buxhetit të shtetit 4 investime publike, për 1 prej të cilave kontrata është lidhur në vitin 2020, 1 (një) në vitin 2021 ndërsa për 2 (dy) investime kontrata është lidhur në vitin 2022, sipas të dhënave në tabelën në vijim:

Nr	Objekti i prokurimit	Kontrata nr..datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSH	Vlera e likuaduar 2021-2022	Vlera e pa likuaduar/ lekë	Arsyet e mos likuidimit
1	Ndertim ujesjellsi Macurisht Plasë	Nr 132 dt 12.01.2021 N	189,769,930	100,000,000	89,769,930	Objekti ska përfunduar likuidimi deri në vitin 2024
2	Supervizim punimesh për objektin Ndërtim Ujësjellsi Macurisht Plasë	Nr 4800 dt 01.10.2020 E	2,896,733	650,000	2,246,733	Objekti ska perfunduar likuidimi deri ne vitin 2024
3	Permirësimi i banesa eksiztuete per komunitete te verfra	Nr 5251 dt 11.10.2022 N	22,189,753	18,475,169	3,714,584	Objekti per likuidim me afat 2 vjecar 2022,2023
4	Ndertim stacion pompimo Vreshtas + linja	Nr 5187 dt.07.10.2022 N	45,250,027	16,196,425	29,053,602	Objekti per likuidim me afat 2 vjecar 2022,2023
5	SHUMA		<b>260,106,443</b>	<b>135,321,594</b>	<b>124,784,849</b>	

*Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr.8 dhe subjekti i audituar nuk ka paraqitur kundërshtime.*

**Nënpika 2.6.** “Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.”, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022.
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifavat vendore;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e tatim-taksave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

**Për vitin 2022** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 94, datë 24/12/2021, “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së të Ardhurave, e cila përbëhet nga 49 Punonjës, me përbërje 1 Drejtor, 3 Përgjegjës, 6 specialistë dhe 6 Inspektorë në administratën e Bashkisë Qendër, 6 Ekonomistë të Taksave dhe 27 Inspektorë në Njësitë Administrative. Struktura e Drejtorisë të Ardhurave për vitin 2022 është paraqitur në *Aneks nr. 2.6/2* bashkëlidhur. Nga auditimi konstatohet se: struktura e DTV Bashkia Maliq ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit të të ardhurave, pasi nuk ka një Sektor të Mbledhjes së Borxhit, i cili do të ishte një nga sektorët më të rëndësishëm në DTV Bashkia Maliq, pasi evidentohet se ka një numër të lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), në vlerën **87,235 mijë lekë**, nga e cila: 82 subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetëror në vlerë **4,242 mijë lekë** dhe abonentë familjarë në vlerë **82,993 mijë lekë**, veprime në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

**Për vitin 2022**, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 94 datë 24.12.2021, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë. Nga të dhënat e disponuara shihet se për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave është në vlerën **300,000** mijë lekë të planifikuara. Janë realizuar **144,068** mijë lekë ose 48 %, mos realizim në vlerën **155,932** mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit. Konstatohet se:

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Drejtoria e të Ardhurave, duke mos patur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë (DRTB), Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Korçë (ASHKK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTR).

Taksë e tokës, taksë ndërtese, tarifë pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi, për abonentët familjarë Bashkia Maliq nuk e realizon nëpërmjet agentit tatimor që në rastin konkret është mund të ishte UK Maliq, sipas kushteve të një akt-marveshje, në të cilën të sanksionohet të përfshijë në faturën e ujit për kategorinë abonentë “Familjarë” detyrimet për Taksa e tarifa.

**Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2022” në 000/lekë:**

Nr.	Emërtimi	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
	<b>Të ardhura tatimore</b>			
1	Taksë Ndërtese	27,197	14,178	52%
2	Taksë Trualli	2,554	2,300	90%
3	Taksë Toke	60,890	25,469	42%
4	Taksë tabele	227	187	82%
5	Taksë Tregu	600	346	58%
6	Taksë Ndikimi në infrastrukturë	18,600	7,489	40%
7	Tatimi I thjeshtuar	0	203	
8	Regj. Automjeti në përd.	12,500	14,646	117%
9	T.Renta Minerale	550	266	48%
10	Të ardhura nga ASHK	150	378	252%
11	Të Ardhura nga Qeraja	10,714	10,873	101%
12	Tatim mbi TAP	5,000	12,970	259%



Nr.	Emërtimi	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
13	Lejë për shitje me pakicë të karburanteve	2,600	800	31%
	<b>Shuma I</b>	<b>14,1582</b>	<b>90,105</b>	<b>64%</b>
	<b>Të ardhura jotatimore</b>			
1	Tarifë Pastrimi	44,698	24,840	56%
2	Tarifë Ndricimi	19,725	8,418	43%
3	Tarifë Gjelberimi	3,407	1,947	57%
4	Regj. Autom. Në Bashki	170	467	275%
5	Tarifë Parkimi	513	585	114%
6	Tarifa të ≠ në Bashki	2,500	1,536	61%
7	Kullotat	600	179	30%
8	Të ardhura nga drutë e Zjarrit.	60,000	463	1%
9	Mjete Korrëse	110	150	136%
10	Tarife Uji per uitje	11,200	1,905	17%
11	<b>Tarifë për mirëmbajtje kanale kulluese</b>	<b>6,106</b>	<b>2,016</b>	<b>33%</b>
12	<b>Tarifë Mirm Varrezash</b>	<b>6,779</b>	<b>3,192</b>	<b>47%</b>
13	Bileta spoti, Kulture, udhëtimi	210	155	74%
14	Tarifa Administrative	400	1,552	388%
15	Kazan Rakie	40	25	63%
16	Leja Non Stop	90	60	67%
17	Gjoha	1,000	1,158	116%
18	Tarifë mjedisore	820	785	96%
19	Tarifë për mbrojtje nga zjarri	0	68	
20	Tarifë e drejtë televizive	0	200	
21	Sponsorizime	0	2261	
22	Tarifë zenije hapësirë publike	50	101	202%
23	Ekspert Shpenzime gjyqesore	0	9	
24	Grande	0	1,000	
25	Divident nga ndarja e sektorit publik	0	891	
	<b>Shuma II</b>	<b>158,418</b>	<b>53,963</b>	<b>34%</b>
	<b>Shuma I+II</b>	<b>300,000</b>	<b>144,068</b>	<b>48%</b>
<b>Totali</b>		<b>300,000</b>	<b>144,068</b>	<b>48%</b>

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Maliq, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Maliq dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Korçë.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave krahasuar me vitin e kaluar ka pasur përmirësime, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korespondencë me Ministrinë e Financave.

- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithëshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat

dhe detyrimet e agentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”.

Konstatojmë se sipas DTV Bashkia Maliq, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Korçë, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Maliq është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse.

Gjithashtu Bashkia Maliq, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën nr. 3** më poshtë:

AGJENTI TATIMOR	LLOJI I TAKSËS	2022
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE	Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	203,000
DPRSHTRR	Taksa vjetore e mjeteve të perdorura	14,646,000
	TOTAL	<b>14,849,000</b>

**Burimi:** *Bashkia Maliq*

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

*Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve*

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve sipas gjendjes civile dhe censusit të vitit 2011.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrimit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Nga auditimi u konstatua se bashkia Maliq nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Maliq për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese.*

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata, pasi shumë prej shërbimeve apo dokumente të tjera tashmë lëshohen online në e-albania.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familiar në vlerën **82,993,502 lekë, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimorë janë në vlerën 43,439,626 lekë** sipas rakordimit me Drejtorinë e Financës. Vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Maliq, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjar deri në datën 31.12.2022. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e

Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. Në **Pasqyrën nr. 4** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura në vlerë progresive detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifatat vendore të vitit ushtrimor 2022 si vijon:

në/lekë

Nr.	Emërtim i taksës/tarifës vendore	Kategoria e taksapaguesit		Numri i debitorve	Vlera progresive e debitorëve në datën 31.12.2021, raportuar nga subjekti në auditimin e mëparshëm (të kryer gjatë vitit 2022)	Vlera progresive e debitorëve në datën 31.12.2021, raportuar nga subjekti në auditimin e radhës (të kryer gjatë vitit 2023)	Pagesat e kryera gjatë vitit 2022 për llogari të gjendjes së debitorëve progresiv në datën 31.12.2021	Vlera e debitorëve të rinj, krijuar vetëm gjatë vitit 2022, nga mos pagesa e detyrimeve të vitit 2022	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2022
		Privat	Familjar						
	a	b	c		d	e (e =d)	f	g	h=e+g-f
1	Taksë toke		9279		29,870,604	29,870,604	13,914,266	16,697,199	32,653,537
2	Taksë ndërtese		5738		10,662,252	10,662,252	3,754,907	6,000,593	12,907,938
3	Taksë trualli		6924		523,328	523,328	289,895	237,791	471,224
4	Tarifë Pastrimi		5705		13,752,200	13,752,200	6,165,205	11,092,217	18,679,212
5	Tarifë Ndrëçimi		5705		7,176,700	7,176,700	3,171,453	5,952,753	9,958,000
6	Tarifë Gjelbërimi		5644		931,800	931,800	308,800	738,544	1,361,544
7	Tarifë mirembajtje kanale kulluese		6783		3,041,375	3,041,375	940,652	1,592,249	3,692,972
8	Tarifë varreze		4499		3,414,700	3,414,700	1,273,905	1,128,280	3,269,075
	<b>TOTAL Debitor</b>		<b>50277</b>		<b>69,372,959</b>	<b>69,372,959</b>	<b>29,819,083</b>	<b>43,439,626</b>	<b>82,993,502</b>

**Burimi:** Bashkia Maliq

➤ **Taksa e tokës:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2022, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti, evidentohet konkretisht sipas pasqyrës si vijon.

**Pasqyra nr.5 .** Pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitin 2022.

Kategoria e tokës	Sip/HA Qendër	Sip/HA Nj.A. Pojan	Sip/HA Nj.A. Libonik	Sip/HA Nj.A. Vreshtas	Sip/HA Nj.A. Pirg	Sip/HA Nj.A. Gorë	Sip/HA Nj.A. Moglicë	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria II				824.9				2 800	2 309 720
Kategoria III	49	478.2	1426.54	1022.28	226.9	0	0	2 240	7 174 540
Kategoria IV	79	1759	970	797.9	906.9			1 840	8 303 552
Kategoria V	106	1959	717.85	273.6	315.39	0	0	1 520	5 125 197
Kategoria VI	143.54	301.2	299	391.6	445	859.9	238.1	1 280	3 428 275
Kategoria VII-X	107.46	355.93	107.69	300.73	248.15	173.64	405.1	1 120	1 902 544
<b>Totali sip. ha sipas planifikimit</b>	<b>485</b>	<b>4 853.33</b>	<b>3 521.08</b>	<b>3 611.01</b>	<b>2 142.34</b>	<b>1 033.54</b>	<b>643.2</b>		<b>28,243,828</b>

**Burimi:** Bashkia Maliq

-Më poshtë paraqiten në mënyrë progresive paraqiten vlerat e trashëguara në celje të periudhës 2022, gjithashtu dhe maturimi, likuidimi dhe mbetja në fund të vitit 2022 sipas njësieadministrative numrit të poseduesve dhe sipërfaqes. Për sa është konstatuar ka një rritje të lehtë në arkëtime duke mbajtur nën kontroll debitorët, gjithsesi vlera prej 32,653,537 lekë është sërish një vlerë që duhet arkëtuar dhe jo mbajtur në të njëjtin nivel.

## Pasqyra nr.6

NJ.A.	Debitorë krijuar në vitin 2022 (Lekë)						TOTAL DEBIA PROGRESIVE 2022
	Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2022	Familje me tokë bujqësore	Sip (m2)	Maturimi	Likujdimi	Debia	
Maliq	953,595	609	4,850,000	720 324	235 398	484 926	1 024 570
Pojan	8,544,916	4,305	48 533 300	8 069 590	2 852 243	5 217 347	9 782 066
Libonik	5,133,024	3 229	35 210 800	6 574 712	3 680 902	2 893 810	4 885 725
Vreshtas	9,660,581	2 421	36 110 100	7 321 700	2 035 663	5 283 037	11 089 650
Pirg	3,125,618	2 412	21 423 400	3 503 876	2 211 600	1 292 276	2 898 680
Gorë	1,492,855	1 362	10 335 400	1 295 147	321 437	973 710	2 065 328
Moglicë	96,0015	841	6 432 000	758 479	206 386	552 093	907 518
<b>Totali</b>	<b>29,870,604</b>	<b>15,179</b>	<b>162,895,000</b>	<b>28,243,828</b>	<b>11,543,629</b>	<b>16,697,199</b>	<b>32,653,537</b>

**Titulli i gjetjes:** Mosrealizim i të ardhurave dhe mos ndjekje e plotë e procedurave ligjore për realizimin e tyre.

**Situata:** Në Bashkinë Maliq, Drejtoria e të Ardhurave, me 3 Sektorë (*Spektori i të Ardhurave, Spektori i Kontrollit të biznesit/Licensimit dhe Spektori i Njësisve Administrative*). Paketat fiskale për periudhën objekt auditimi janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 94 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale 2022” dhe Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 93, date 24.12.2021 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, për vitin 2021”. Bashkia Maliq sipas VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit për vitin 2022.

Për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga **300,000 mijë lekë** të parashikuara, janë realizuar në vlerën **144,068 mijë lekë** ose 48 %, **me një mosrealizim në vlerën 155,932 mijë lekë**. Në plan janë përfshirë dhe detyrimet e prapambetura, nga viti 2020-2021 të cilat përfshijnë disa zëra, në vlerë 79,089,675 lekë ose 26.3% të totalit të planit.

Sa më sipër konstatohet se në planin e të ardhurave për vitin 2022, taksa e tokës është planifikuar për vlerën **60,000 mijë lekë ose 20 %** e planit, kjo taksë nuk është mbledhur duke ndikuar ndjeshëm në realizimin e të ardhurave.

Gjithashtu me mosrealizim të dukshëm dhe që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi, janë taksat dhe tarifave e familjeve, për vitin 2022, të ardhurat nga Taksa e tokës, Taksa ndërtese dhe Tarifa pastrimi gjelberimi e ndriçimi janë planifikuar gjithsej në vlerën **155,917 mijë lekë ose 51.9 %** e planit vjetor. Janë realizuar **74,852 mijë lekë ose 49 %** të planit. **Taksa e ndërtesës** rezulton se në vitin 2022, nga **27,197 mijë lekë** e planifikuar është realizuar **14,178 mijë lekë ose 52 %**, me një mosrealizim në vlerën **13,019 mijë lekë**.

**Tarifa vendore (pastrimi, ndriçimi dhe gjelbrimi)** rezulton se në vitin 2022, nga **67,830 mijë lekë** e planifikuar janë realizuar **32,205 mijë lekë ose 47 %**, **me një mosrealizim në vlerën 35,625 mijë lekë**.

Nga mosrealizimi I planit të të ardhurave si më sipër ka sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë vetëm për taksat familjare në vitin 2022 në vlerën gjithsej **43,439 mijë lekë**.

**Kriteri:** Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 22 dhe neni 23, VKB nr. 93, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale 2022” .

**Ndikimi:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjellë mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disjplinojnë taksat dhe tarifave vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

## **Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Maliq të merren masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të bëhet një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore, kjo duke u mbështetur në burimet e krijimit të të ardhurave dhe arkëtimin e borxhit të akumuluar nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga familjet.

### ➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet se informacionet që kërkohen të dhënat nuk dalin të analizuara për çdo zë tatimor që DTV Bashkia Maliq aplikon.

Referuar të dhënave të marra nga DTV Bashkia Maliq, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të periudhës
	Biznes i vogël	2022	446	60	67	439
	Biznes i madh	2022	88	12	7	93
	Institucione	2022	12	0	0	12
	<b>TOTAL</b>		<b>546</b>	<b>72</b>	<b>74</b>	<b>544</b>

**Burimi:** *Bashkia Maliq*

**Titulli i gjetjes:** Mos ndjekje e plotë e procedurave ligjore për mbledhjen e detyrimeve debitorë.

**Situata:** Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **4,241,736 lekë**, ku vetëm për vitin 2022 janë krijuar **49** debitorë nga biznesi në vlerë **1,251,149 lekë**, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Maliq.

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve në mënyrë të detajuar paraqitet në **aneksin nr.2.6/1** bashkëlidhur.

**Pasqyra dhe vlera subjekteve debitorë, datë 31.12.2021 dhe 31.12.2022 me pakësime dhe shitesa të vitit.**

Nr.	Emërtim i taksës/tarifës vendore	Kategoria e taksapaguesit		Vlera progresive e debitorëve në datën 31.12.2021, raportuar nga subjekti në auditimin e mëparshëm (të kryer gjatë vitit 2022)	Vlera progresive e debitorëve në datën 31.12.2021, raportuar nga subjekti në auditimin e radhës (të kryer gjatë vitit 2023)	Pagesat e kryera gjatë vitit 2022 për llogari të gjendjes së debitorëve progresiv në datën 31.12.2021	Vlera e debitorëve të rinjë, krijuar vetëm gjatë vitit 2022, nga mos pagesa e detyrimeve të vitit 2022	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2022
		Privat	Familjar					
	a	b	c	d	e (e=d)	f	g	h=e+g-f
1	Taksë toke		-					
2	Taksë ndërtese	82	-	1 339 298	1 339 298	181 872	442 109	1 599 535
3	Taksë trualli	82	-	253 924	253 924	48 636	129 946	335,234
4	Tarifë Pastrimi	80	-	1 646 602	1 646 602	429 113	496 498	1 713 987
5	Tarifë Ndriçimi	81	-	278 875	278 875	47 100	90 900	322 675
6	Tarifë Gjellbërimi	81	-	182 783	182 783	38 900	58 117	202 000
7	Tarifë varreze		-					
8	Tarifë administrative	82	-	27 804	27 804	3 216	8 849	33 437
9	Tarifë ndikimi në mjedis	1	-	3 333	3 333	3 333	25 000	25 000

10	Kamatëvonesë	3	-	9 868	9 868	-		9 868
	<b>Total</b>	82	-	3,742,487	3,742,487	746,170	1,251,419	4,241,736

➤ **Menaxhimi i borxhit tatimor për biznes nga taksat e tarifave vendore.**

Sa më sipër vetëm për periudhën e vitit 2022 objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël për 44 subjekte në vlerën 942,964 lekë dhe debitorët e biznesit të madh për 5 subjekte në vlerën 308,455 lekë.

Drejtoria e të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime. Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 82 subjekte debitorë në vlerën 4,241,736 lekë, janë aktiv 82 subjekte të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa vendore. Ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

**Kriteri:** Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj. Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

**Ndikimi:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifave vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën 4,241,736 lekë, si më poshtë vijon:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro

dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 “Mospagimi taksave dhe tatimeve”.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitoare nga taksat e ndikimit në infrastrukturë:**

**Titulli i gjetjes:** Burimi krijimit i të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Situata:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Maliq në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Korçë.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **25,530,138 lekë** për 606 persona, kanë paguar detyrimet 222 persona me vlerë **6,758,614 lekë** dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2022 gjithsej **438** persona me vlerë **16,771,524 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Maliq (sipas listës të administruar në CD)

Natyra e debitorëve	Detyrime gjithsej 2016-2022		Arkëtuar deri 31.12.2022		Debitorë me 31.12.2022	
	Persona	Lekë	Persona	Lekë	Persona	Lekë
Taksa infrastrukture (legalizim)	660	23,530,138	222	6,758,614	438	16,771,524

-Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Maliq për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Maliq të jetë drejtuar ASHK Dega Korçë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksat e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1 dhe ngarkohen me përgjegjësi Drejtorinë e PZHT dhe DTV Bashkia Maliq.

**Kriteri:** Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore” i ndryshuar, neni 27 “Taksat e ndikimit në infrastrukturë”, pika 3, VKM nr.860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.

**Impakti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disjelojnë strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për realizimin e të ardhurave.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, dhe arkëtimin taksës së ndikimit

në infrastrukturë për **438 persona** me vlerë **16,771,524 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Maliq.



Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Maliq dhe në Njësitë Administrative, ushtronin aktivitetin 12 subjekte që rezultojnë aktiv dhe tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, si vijon:

Nr.	Subjekti	Adresa	Nipt	Pajisur me Licensë		Licence		Pagesa e kryer	Detyrimi
				Po	Jo	Fillon	Mbaron		
1	G.	Vashtemi	K.....T	X		01.02.2019	31.01.2024	1,000,000	
2	A.	Leminot	J.....A	X		04.04.2018	03.04.2023	1,000,000	
3	M.	Rembec	K.....H	X		09.03.2021	08.03.2026	1,000,000	
4	M.	Vloçisht	K.....H	X		24.01.2020	23.01.2025	1,000,000	
5	F.	Plasë	K.....E	X		18.06.2021	17.06.2026	600,000	
6	S.	Libonik	K.....M	X		18.11.2019	17.11.2024	1,000,000	
7	T.	Pojan	L.....K	X		01.02.2019	30.01.2024	1,000,000	
8	C.	Pojan	J.....H	X		23.10.2020	22.10.2025	1,000,000	
9	D.	Sovjan	K.....C	X		01.02.2019	31.01.2024	1,000,000	
10	K.	Symiz	K.....O	X		16.04.2020	15.04.2025	1,000,000	
11	A.K	Orman	K.....R		X	X	X	X	1,000,000
12	H.A	Podgorie	L.....U	X		04.02.2020	03.02.2025	100,000	

**Burimi:** *Bashkia Maliq*

-Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Maliq dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre

Nga 12 subjekte janë pajisur me autorizim 11 subjekte, të cilat janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe nuk janë pajisur me autorizim tregtim karburanti, gjithsej **1 subjekt** i cili ushtron aktivitet papaguar detyrimin fiskal në **vlerën 1,000,000 lekë, shumë e cila cilësohet** e ardhur e munguar e paarkëtuar në buxhetin e Bashkisë Maliq.

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:**

- 1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35.
- 2) VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4.
- 3) VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 ku citohet:

*15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë*



*të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi Drejtorinë e të Ardhurave.*

**-Titulli i gjetjes:** Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga Tarifa e dhënies së licencës për tregtimin e naftës gazit në përputhje me dispozitat ligjor.

**-Situata: Nga auditimi ka rezultuar se:** Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Maliq, për periudhën e vitit 2022 nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, përsa i përket arkëtimit të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Maliq. Referuar kapitullit II, pikës 1; germës “b” të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, në të përcaktohet që: *II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

*1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësisive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:*

*b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësisive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.*

*9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.*

*- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.*

*"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."*

Sipas evidencës së paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e bashkisë Maliq, u audituan pagesat për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, për periudhën objekt auditimi, mbështetur në legjislacionin e taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (Autorizim), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, u konstatua se:

Në bashkinë Maliq gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 12 subjekte të cilat janë pajisur në kohë të ndryshme me Autorizim/Licencë nga Bashkia. Për vitin 2022 rezultojnë të pajisur me

Autorizim/Licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 12 subjekte, të cilët 1 prej tyre nuk ka likujduar detyrimin për 1,000,000 lekë. Subjekti “A.K” shpk, me NIPT nr. K....C, nuk është i pajisur me Autorizim për ushtrim aktiviteti duke krijuar të ardhura të me vlerë prej **1,000,000 lekë**, sa më sipër për këtë subjekt, nuk është aplikuar saktë tarifa vendore për pajisen e subjekteve, me Autorizim/Licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante, dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, me pasojë **mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Maliq, në vlerën 1,000,000 lekë.**

**Kriteri:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, si dhe pika 15.1, 15.2 të këtij akti normativ.

**Impakti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifaf vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Rëndësia: E lartë.**

**Rekomandimi:** Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjekti “A.K” të vlerës **1,000,000 lekë**, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë.

*Përsa më sipër subjekti i audituar nëpërmjet shkresës nr.6464/1, datë 02.02.2024, administruar nga KLSH me nr. 863/6, datë 05.02.2024, ka paraqitur komente dhe shpjegime për gjetjet e trajtuara në Projekt Raporin e Auditimit, në lidhje me dhënien e licencës për tregtimin e naftës gazit në përputhje me dispozitat ligjore.*

**Pretendimi subjektit:**

Nga auditimi i dokumentacionit i ushtruar në Drejtorinë e të Ardhurave mbi pajisjen me Licencë Tregëtimi për subjektet që tregëtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre është konstatuar së subjekti A.K ushtron aktivitet pa paguar detyrimin fiskal.

**Sqarojmë:**

Me shkresën me Nr.2257 prot, datë 20.05.2021 me lëndë:” Njoftim”, Bashkia Maliq ka vënë në dijeni Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Insustrial lidhur me gjendjen e mos pajisjes me Leje Tregëtimi të Hidrokarbureve të subjektit A.K. Në vijim të komunikimit ISHTI ka dërguar shkresën me Nr.2783/1prot, datë 9.06.2021 me lëndë: “Kthim përgjigje” ku citon se subjekti A.K do të inspektohet nga ana e tyre.

Subjekti A.K në datën 19.01.2022 ka aplikuar për pezullimin e aktivitetit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, aplikim i cili bazuar në Ligjin 9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Ttimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 44/ c dhe Udhëzimin nr. 24 datë 2.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pika 44 “kalimi në rregjistrin pasiv”, pika 44.1.1 c) është refuzuar nga ana e Institucionit për arsyen se subjekti është debitor për gjobë të aplikuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë. Për sa më sipër subjekti nuk mund të kryejë veprime për pezullim apo ç’rregjistrim të veprimtarisë së tij. Bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin si më poshtë:

Shkresa me nr.2257 prot, datë 20.05.2021 me lëndë: “Njoftim”.

Shkresa me nr.2783/1 prot, datë 9.06.2021 me lëndë: “Kthim përgjigje”.

Shkresa me lëndë “Njoftim dhe kërkesë për të paguar”.

Formular aplikimi me nr dojse CN-849847-01-22, datë 19.01.2022 “Për pushim të përkohshëm të aktivitetit” pranë QKB.

Vërtetim Nr.109530131 datë 07.12.2023 “Për pagim detyrimesh”.

Detyrimet në kohë reale të subjektit A.K .

**Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se: Lidhur me njoftimin e ISHTI nga ana e Bashkisë Maliq, ky është vetëm një hap ligjor detyruar nga ana juaj. Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), me shkresën nr.2783/1 Prot, datë 09.06.2021, ju ka kthyer përgjigje duke ju cituar se: Zgjidhja e këtij problemi gjendet në pikën 6.1 të VKM nr.344, datë 19.04.2017 në të cilën përcaktohet se : Në rast se personi juridik nuk riparaqet dokumentacionin e kërkuar, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, autoriteti licencues në përputhje me parashikimet ligjore ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në riparaqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e personit juridik, për pajisjen e tij me licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë”. Sa më sipër nga ana juaj nuk rezultojn të jenë ndjekur plotësisht hapat ligjorë e administrativë për bllokimin e aktivitetit. Në thelb, grupi i auditimit konsiston në arkëtimin e detyrimit nga ky subjekt i cili operon pa paguar tarifën e përcaktuar në ligj. Masat e marra me njoftim, nuk janë eficente përse kohë ky subjekt vijon aktivitetin tregëtar në territorin e Bashkisë Maliq, pa u pajisur me licensë nga ana juaj. Për sa më sipër nga ana juaj nuk janë paraqitur argumente te reja të cilat mund të ndryshonin qëndrimin tonë. Grupi i auditimit nuk merr parasysh kundërshtimet tuaja.**

➤ **Ligjshmëria e lidhjes së kontratave dhe arkëtimi i detyrimeve.**

Kontratat publike me qira për toka, kullota/ose objekte, që janë lidhur gjatë vitit 2022. Konstatohet se: Bashkia Maliq ka lidhur 16 kontrata me persona fizik dhe Juridik. Kryesisht konsistojnë në fondin pyjor e kullosor. Gjatë auditimit të këtyre kontratave nuk kemi evidentuar mangësi si në ligjshmëri apo dhe në vjeljen e detyrimeve. Më poshtë në formë tabelare paraqiten subjektet me të cilët Bashkia Maliq ka lidhur kontratë.

**Pasqyra nr.7**

Nr.	Qiramaresi	Zona	Objekti	Afati Vjet	Kontrate Nr., Datë	Detyrim vjetor lek/ha	Paguar	Pa paguar
<b><i>Për vendosje antene të telefonisë celulare kontrata si më poshtë:</i></b>								
1	Albtelekom Moglice	Moglicë	Antenë	9 vjet	Nr.225 REP;Nr.125KOL datë 03.02.2022	167 000	167 000	
2	Albtelekom Pojan	Pojan	Antenë	9 vjet	Nr.224 REP; Nr.124KOL datë 03.02.2022	160 000	160 000	
3	Albtelekom Libonik	Libinik	Antenë	9 vjet	Nr.1085 REP; Nr.542KOL datë 11.05.2022	200 000	200 000	
<b><i>Për tokë bujqësore të pandarë kontrata si më poshtë:</i></b>								
4	F.shpk	Vreshtas	tokë	99 vjet	Nr.4478 REP ; Nr.2968 KOL datë 20.01.2022	266,399.28	266 399.28	
5	F.dhe A.M	Vreshtas	tokë	99 vjet	Nr.6308 REP ; Nr.4170 KOL datë 19.10.2022	271,304.46	271,304.46	
<b><i>Për ndërtesa që janë pasuri shtetërore kontratat si më poshtë:</i></b>								
6	K.K	Pojan	Ndërtesë	5 vjet	Nr.1146 REP ; Nr.754KOL datë 01.03.2022	36,000	30,000	
7	A.	Maliq	Ndërtesë	12 vjet	Nr.61 REP ;Nr.37 KOL datë 16.02.2022	255,304	255,304	
8	E.P	Maliq	Banesë soc		Nr. 315 Prot datë 27.01.2022	15,310	15,310	
<b><i>Dhënia në përdorim e fondit pyjor për vendosje anemometri për qëllime studimi</i></b>								

Nr.	Qiramaresi	Zona	Objekti	Afati Vjet	Kontrate Nr., Datë	Detyrim vjetor lek/ha	Paguar	Pa paguar
9	A.	Moglicë	Tokë anenometer	5 vjet	Nr. 3987 Prot datë 26.07.2022	35,000	35,000	
10	A.	Moglicë	anenometer	5 vjet	Nr. 4981 Prot d atë 28.09.2022	781,000	781,000	
<b>Kontrata për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullosor për kullotjen e bagëtime, me afat një vjeçar</b>								
11	A.Xh	Pirg	kullotë	1 vit	Nr.2990 Prot. datë 30.05.2022	27,800	27,800	
12	R.Xh		kullotë	1 vit	Nr.3228 Prot datë 13.06.2022	41,800	41,800	
13	G.M		kullotë	1 vit	Nr.3245 Prot datë 14.06.2022	9,550	9,550	
14	J.M		kullotë	1 vit	Nr.3396 Prot datë 22.06.2022	20,000	20,000	
15	K.H		kullotë	1 vit	Nr.3814 Prot Datë 19.07.2022	72,000	72,000	
16	F.Q		kullotë	1 vit	Nr.3813 Prot Datë 19.07.2022	8,000	8,000	

### **Konkluzion:**

*Masat shtërguese për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe jo tatimore.*

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Maliq në vlerën totale **114,176 mijë lekë** në progresiv.

Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve në vlerën **82,994 mijë lekë**, ku vetëm për vitin 2022 janë krijuar debitorë në vlerën **43,439 mijë lekë**.

1. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën **4,241 mijë lekë**, ndërsa për vitin 2022 janë krijuar **1, 251 mijë lekë**.

2. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën **16,771 mijë lekë**.

3. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën **1,000 mijë lekë**.

4. Të ardhura të munguara nga mospagimi i gjobave të vendosura nga IMT-ja në vlerën **9,170 mijë lekë**.

5. **Për vitin 2022** ka ecuri lidhur me masat shtërguese por gjithsesi në nivele të ulëta vendosje apo ekzekutimi. Masat shtërguese nuk janë ezauruar të plota sipas përcaktimeve ligjore. Nuk është kryer një analizë e detajuar për secilin nga këta debitor tatimpagues për nxjerrë shkakun e mos mbledhjeve të detyrimeve. Analiza dhe planet operacionale janë një hap i cili duhej dhe duhet të jetë në të ardhmen në fokus si indikator orientues për vijimin e marrjes së masave me qëllim arkëtimin e detyrimeve për secilin debitor, biznes i madh i vogël apo cdo lloj debitori. Trendi i rritjes së detyrimeve të pa paguara mbetet akoma i lartë dhe për pasojë ka sjellë të ardhura të munguara, të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë Maliq, të ardhura këto që mund të përdoshin nga Bashkia për investime në infrastrukturë dhe rritjen e shërbimeve me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve të kësaj bashkie. Në formë tabelare informacioni mbi detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtas, paraqiten të përmbledhura në rubrikën anekse bashkëlidhur.

*Për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjor ngarkohen punonjësit si vijon: z. A.G i cili ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Ardhurave Vendore për periudhën 21.07.2022-31.12.2022. Znj. A.SH me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave, znj. E.Ç me detyrë, Përgjegjëse e Kontrollit të Biznesit dhe z. M.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Njësive Administrative.*

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore”.

### **2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.**

**3.1.** Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

**3.2.** Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

**3.3.** Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

**3.4.** Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

### **Pika 3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Në zbatim të pikës 3, të programit të auditimit Nr. 863/1, datë 10.10.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

1. Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese të vitit 2022,
2. Procedurat e inventarizimit të aktiveve për 2022,
3. Akt Rakordimet me Degën e Thesarit MALIQ për mbylljen e vitit buxhetor 2022,
4. Vendime dhe urdhra të Bashkisë Maliq në lidhje me të dhënat e pasqyrave financiare.

**“Vlerësim i raporimit financiar për të parashikuar Opionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022.**

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:***

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Bashkia Maliq” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Maliq për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Maliq pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Korçë për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr.1394 prot.datë 28.03.2022 konfirmuar nga dega e thesarit Korçë. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Maliq dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

• ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e

kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Maliq për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 nuk rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; **Totali i Aktivit për vitin 2021 është në vlerën 2,991,758,714 lekë dhe për vitin 2022 është 3,108,879,064 lekë.**

**Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022:**

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

**Pasqyra e pozicionit financiar** të Bashkisë Maliq në 31.12.2022, sipas formatit **F1**, është paraqitur më poshtë:

**1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).**

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=2,867,370,131 lekë.**

- Aktivet 3,108,879,064 lekë

- Detyrimet 241,508,933 lekë

- Aktivet Neto 2,867,370,131 lekë

**Aktivet afatshkurtra:**

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **276,258,001 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujalentet e tyre” në shumën 132,790,435 lekë;

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 49,071,105 lekë;

- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 94,396,461 lekë

**Fondi i Konsoliduar:**

**Llogaria 101 “Teprica (Fondi I akumuluar/Deficit i akumuluar)**

Në llogarinë 101 është paraqitur në vlerën 2,867,370,131 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF1: Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.**

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Nxjerrje jashtë përdorimit	7,951,868	2,669,797,902	Çelje
Amortizim i vitit	141,742,963	296,622,788	Investime + Dhurime
		11,619,368	Ndryshim i gjendjes së inventarit
	149,694,831	2,978,040,058	
<b>Shuma</b>		<b>2,828,345,227</b>	

**Burimi:**Bashkia Maliq

Sipas tabelës së mësipërme e përlllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” vlera e raportuar në bilanc është mbivlerësuar në vlerën 8,033,127 lekë.

**Titulli gjetjes:**Mbi kontabilizimin e llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar”

**Situata:**Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreditohet nga investimet, dhurimet dhe ndryshimi i gjendjes së inventareve dhe pakësohet nga amortizimi i vitit dhe nxjerrjet jashtë përdorimit.Vlera e raportuar në bilanc e ka mbivlerësuar këtë llogari për vlerën 8,033,127 lekë.

**Kriteri:** Udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Ndikimi/Efekti:**Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar”

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:**Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” për të dhenë informacion kontabël të drejtë.

**Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:**

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 131,433,695 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 30,991,777 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 24,825,314 lekë.

Lëvizjet e klasës 5“Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, paraqitet në **pasqyrën PF3** në anekset e raportit përfundimtar.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 131,433,695 lekë nuk kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje".

Sipas shkresës Nr.659 prot datë 07.02.2023 dërguar Degës së Thesarit Korçë kemi akt mbajtjet e të ardhurave për vitin 2022 si mëposhtë:

1-Trasferte e pakushtëzuar Viti 2022 e papërdorur 7,002,759 lekë.

2-Trasferte specifike viti 2022 e papërdorur 33,844,716 lekë.

3-Të ardhurat viti 2022 të papërdorura 5,555,519 lekë.



Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 46,402,994 fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2023.

Llogaria 85 është nënvlerësuar në shumën 15,411,217 lekë

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Pika 49. Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pika 50. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

**Titulli gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”

**Situata:** Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” përbëhet nga gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 30,991,777 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 24,825,314 lekë. Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 131,433,695 lekë nuk kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje". Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” është mbivlerësuar për vlerën 75,616,604 lekë.

**Kriteri:** Udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

**Ndikimi/Efekti:** Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” për të dhënë informacion kontabël të drejtë.

**Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Maliq në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 49,071,105 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 16,784,777 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 32,286,328 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =-11,619,368 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 11,619,368 lekë.

**Llogaria 312 “Materiale”,** ka vlerën 16,784,777 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	10,464,533
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2022	58,381,173
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	52,060,929
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>16,784,777</b>

Burimi: Bashkia Maliq

**Llogaria 327 “Objekte inventari”**, ka vlerën 32,094,482 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	33,274,559
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2022	
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>32,094,482</b>

Burimi: Bashkia Maliq

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Maliq ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit datë 19.10.2022, ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.e klasës 3“Gjendje inventari qarkullues”, paraqitet në **pasqyrën PF4** në anekset e raportit përfundimtar.

### **Inventarizimi i aktiveve:**

Gjatë vitit 2022, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.493 datë 23.09.2022 për ngritjen e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe asgjesimit të aktiveve për vitin 2022 të Bashkisë Maliq, përfshirë këtu dhe 6 njësitë administrative në territorin e Bashkisë Maliq.

Komisioni për vlerësimin dhe inventarizimi është është i përberë nga të njëjtë punonjës. Komisioni për asgjesimin e aktiveve është i përbërë nga punonjës të ndryshëm në përputhje me udhëzimin Nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit më datë 31.12.2022 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit. Sipas procesverbalit komisioni ka vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit aktivet si mëposhtë:

#### **-Llogaria 214**

<b>Llogaria 214</b>	<b>1,289,400</b>
Për asgjesim	209,400
Shitje për skrap	1,080,000

#### **-Llogaria 218**

<b>Llogaria 218</b>	<b>3,523,564</b>
Për asgjesim	3,406,894
Shitje për skrap	116,670

#### **- Llogaria 327**

<b>Llogaria 327</b>	<b>1,242,605</b>
Për asgjesim	1,152,473
Shitje për skrap	90,132

**- Llogaria 312**

<b>Llogaria 327</b>	<b>2,500</b>
Shitje për skrap	2,500

Me urdhër Nr.263 datë 02.06.2022 të Titullarit Bashkia Maliq është ngritur komisioni për vlerësimin e gjendjes teknike të mjeteve të Bashkisë Maliq.

Nga komisioni janë mbajtur procesverbalet për vlerësimin e mjeteve dhe rezultuan 6 mjete jo në gjendje pune si mëposhtë.

-Autoveturë KO9500B më vlerë fillestare 396,000 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Autoveturë AA540DL me vlerë fillestare 400,000 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Kamjon Daf VJ-91-JB me vlerë fillestare 1,413,000 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Autokarro BOB0649 me vlerë fillestare 187,010 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Kamjon DV158A me vlerë fillestare 1,300,000 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Eskavator me zinxhir K-408 me vlerë fillestare 296,228 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

Eskavatori ka qënë i regjistruar në llogarinë 214 “Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune”.

Me urdhër Nr.593 datë 02.11.2022 të Titullarit Bashkia Maliq është ngritur komisioni për asgjesimin e aktiveve të mjeteve të Bashkisë Maliq.

**Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ”&“Të tjera aktive afatshkurtra”:**

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF5** në anekset e raportit përfundimtar.

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”**, në fund të vitit 2022 është 63,463,222 lekë e cila përbëhet nga një pjesë e debitorëve të trashëguara nga ish-komunat dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite.

<b>Lëvizjet e llogarisë</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Gjendja në 01.01.2022	57,566,699
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>63,463,222</b>

Burimi:Bashkia Maliq

**Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 30,933,239 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 30,933,239 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF6:** Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

<b>Emërtimi i llogarive</b>	<b>Vlera</b>
Llogari 401-408	
Paga personeli llog 42	22,442,639
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	893,424
Sigurime shoqërore llog.435	6,676,744
Sigurime shëndetësore llog.436	920,432
<b>Totali</b>	<b>30,933,239</b>

Burimi:Bashkia Maliq

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur e nënvlerësuar në bilanc me vlerën 185,750,380 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

### **Llogaritë e Marrëdhënieve me shtetin**

Në marrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

#### **a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:**

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;

Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

#### **b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:**

Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;

Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

#### **c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi:**

Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4);

Kreditohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.

#### **d) Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër:**

Debitohet llogaria 476” Të ardhura të caktuara për tu përdorur”;

56

Kreditohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

**Titulli gjetjes :** Mbi kontabilizimin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

**Situata:**Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” përbëhet nga gjendja e llogarive të klasës 4 llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 60,57,133 lekë , 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 33,192,639 lekë ,431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa në vlerën 893,424 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 6,676,744 lekë, 436 “Sigurime shëndetsore” në vlerën 920,432 lekë dhe llogaria 467 “Kreditor të ndryshëm” në vlerën 114,473,247 lekë.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është nënvlerësuar për vlerën 185,750,380 lekë.

**Kriteri:** Udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

**Ndikimi/Efekti:**Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:**Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) për të dhënë informacion kontabël të drejtë.

### **Aktivitet Afatgjata jomateriale (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo materiale”,** përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 3,464,088 lekë. Sipas llogarisë analitike (Tabela anekse nr.1) vlera e kësaj llogarie është lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF7:** Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata jo materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	3,464,088
Shtesa gjatë vitit 2022(D)	446,666
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	446,666
<b>Gjendja në 31.12.2022 (D)</b>	<b>3,464,088</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

**Llogaria 202“Studime dhe Kërkime”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto 3,464,088 lekë. Sipas inventarit kontabël, gjendja e kësaj llogaritje është në vlerën neto 3,464,088 lekë dhe përbëhet nga 4 projekte për investime të kryera.

### **Aktivitet e afatgjata materiale (AAM)**

**Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”,** AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, paraqiten në shumën 2,783,843,161 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,629,410,002 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 296,622,788 lekë, shtesa që kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje , në Bashkinë Maliq dhe NJ.A Administrative si dhe pakësimet nga amortizimi dhe lëvizjet brenda aktiveve në shumën 149,692,831 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF8:** Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2021	Shtesa	Amortizim 2022	Pakësime	Gjendja me 31.12.2022
210	Toka,Troje,Terre	0	0		0	0
211	Pyje, Kullota, Plantacione	13,174,567	0		0	13,174,567
212	Ndërtime e Konstruksione	704,727,234	51,094,487	35,236,362	0	720,585,359
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,787,318,469	222,694,504	89,893,848	0	1,920,119,125
214	Instalime dhe paisje	58,834,240	8,527,743	2,941,712	1,585,628	64,420,271
215	Mjete Transporti	33,143,834	5,102,001	6,628,767	2,396,010	31,617,068
218	Inventar Ekonomik	32,020,978	8,757,387	7,042,274	3,523,564	33,736,091
	<b>Shuma</b>	<b>2,629,410,002</b>	<b>296,176,122</b>	<b>141,742,963</b>	<b>7,505,202</b>	<b>2,787,307,249</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

**1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene”** është paraqitur në bilanc në vlerën 0 lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik.

**2. Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”**

Kjo llogari për vitin 2022 është paraqitur në bilanc për vlerën 13,174,567 lekë. Vlera e llogarisë 211 është e pandryshuar edhe në vitin 2021.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF9:** Detajet e nënrubrikës “Pyje, Kullota, Plantacione”.

Nr	Pyje Plantacione	Vlera 2021	Shtesa 2022	Total 31.12.2022
1	Gjelberim Territori 1 Bashkise, Plantacion Supervizim, Kolaudim	1,810,016		1,810,016
2	FV Shk dekorative Bush 30-35.cm	936,000		936,000
3	Pyje ,kullota, plantacione	2,633,400		2,633,400
4	Mbjellje pemë dekorative	3,143,340		3,143,340
5	Gjelbërim i territorit publik, Pirg	1,796,712		1,796,712
6	Gjelbërim territoret e komunës	1,180,522		1,180,522
7	Pyje kullota	1,674,577		1,674,577
	<b>Shuma</b>	<b>13,174,567</b>	<b>-</b>	<b>13,174,567</b>

**Burimi:** Bashkia Maliq

Nga auditimi i llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” ka rezultuar se, nga këto objekte, asnjë prej tyre nuk është pajisur me titull pronësie dhe asnjë prej tyre nuk është në proces regjistrimi. Kjo ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

**3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”** cila pasqyron gjendjen 176 asetëve për llogari të Bashkisë Maliq, në fund të vitit 2021 rezulton me një vlerë neto 704,727,234 lekë dhe në fund të vitit 2022 rezulton me një vlerë neto 720,585,359 lekë. Diferenca në rritje vlere prej 15,858,25 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2022 nga viti 2021.

Kjo rritje në vlerë vjen për shkak të kapitalizimit të investimet e kryera në vitin 2022.

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, paraqitet në **pasqyrën PF10** në anekset e raportit të auditimit.

Kapitalizimi (shtesat) për vitin 2022 është në vlerën 51,094,487 lekë për objektet si mëposhtë:

- 1-Maternitet i vjetër (shtesa 30,000 lekë)
- 2-Rikonstruksion objekte ndërtim magazina ( 1,565,236 lekë)
- 3-Suvatim i jashtëm magazina (1,304,040 lekë)
- 4-Rikonstruksion stadium Faza I ( 6,546,720 lekë)
- 5-Rikonstruksion pallati viti 2021 (4,052,067 lekë) objekti në proces nuk është kolauduar
- 6-Ndërtim fari, mbikqyrje, kolaudim (1,343.613 lekë)
- 7-Godina Dorcas (1,181,725 lekë)
- 8-Rikonstruksion kopshti Maliq (8,422,703 lekë)
- 9-Përmirësim i banesave viti 2021 (6,988,308 lekë)

10- Përmirësim i banesave viti 2021 (18,493,969 lekë) objekti në proces nuk është kolauduar Amortizimi vjetor për këtë llogari ka qënë në vlerën 35,236,362 lekë.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”

**Situata:**Kapitalizimi (shtesat) për vitin 2022 në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” janë në vlerën 51,094,487 lekë. Objektet rikonstruksion pallati viti 2021 në vlerën (4,052,067 lekë) dhe përmirësim i banesave viti 2021 (18,493,969 lekë) janë kapitalizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” këto investime për keto objekte janë akoma në fazë investimi të cilat duhet të rregjistrohen në llogarinë 231 “Investime në proces”.

**Kriteri:**Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”.

**Hyrjet e AAGJ dokumentohen:**

1)Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).

2)Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt-marrëveshja dhe akti I marrjes në dorëzim të aktivitetit.

3)Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim.

4)Për rivlerësimet, si dokument shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve.

**Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike.**

-Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e aktiveve afatgjata.

-Për rrjedhim,aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim pra të jenë funksionale ato detyrimisht duhet të gjenden në proces. Në formën e shpenzimeve që grupohen më analiza në llogarinë 23 “Investime”.

-Këto janë investime në proces ,pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksion dhe nuk është kapitalizuar.

-Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto behën funksionale dhe kapitalizohen në grupet 0 dhe 21 të aktiveve të përfunduara.

**Ndikimi/Efekti:**Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në fund të vitit 2022, nuk pasqyron vlerën e drejtë dhe reale të saj.

**Shkaku:**Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:I Mesëm.**

**Rekomandim:**Drejtoria e Financës Bashkia Maliq të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.212 “Ndërtesa e Konstruksione”.

**4. Llogaria 213 “ Rrugë,rrjete,vepra ujore”** cila pasqyron gjendjen 246 aseteve për llogari të Bashkisë Maliq, në fund të vitit 2021 rezulton me një vlerë neto 1,787,318,469 lekë dhe në fund të vitit 2022 rezulton me një vlerë neto 1,920,119,125 lekë.

Llogaria 213 “Rrugë,rrjete,vepra ujore”, paraqitet në **pasqyrën PF11** në anekset e projekt raportit. Diferenca në rritje vlere prej 132,800,656 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2022 nga viti 2021. Kjo rritje në vlerë vjen për shkak të kapitalizimit të investimet e kryera në vitin 2022. Kapitalizimi për vitin 2022 është në vlerën 222,020,883 lekë për objektet si më poshtë:

1-Çezma Publike (shtesa 1,016,787 lekë)

2-Rehabilitim Rrjeti Kuz (87,979,587 lekë)

- 3-Rikualifikim Sheshi Komsj (3,633,757 lekë)
  - 4-Rruga lidhëse Sheshi Komsj (3,268,592 lekë)
  - 5-Sifoni Karicë (1,012,228 lekë)
  - 6-Rikualifikim urban sheshi Lis (5,169,102 lekë)
  - 7-Diga Ujëmbledhësi Shoshaj (shtesë 11,444,083 lekë)
  - 8-Sistemim-Asfaltim rruga Vloçisht-Drithas, mbikqyrje, kolaudim (1,946,352 lekë)
  - 9-Mbushje gropash 2022 (3,460,216 lekë)
  - 10-Ndërtim stacion pompimi Vreshtas, projekt (16,563,091 lekë)
  - 11-Ujësjellësi Mancurisht-Plasë, mbikqyrje (80,450,000 lekë)
  - 12-Rehabilitim ujëtar SEP Pojan ,F.II (6,077,088 lekë)
- Amortizimi vjetor për këtë llogari ka qënë në vlerën 40,768,970 lekë.

#### **Aktivitet në proces të kontabilizuar:**

- 1- Sistemim-Asfaltim rruga Vloçisht-Drithas, mbikqyrje, kolaudim (1,946,352 lekë)
- 2- Mbushje gropash 2022 (3,460,216 lekë)
- 3- Ndërtim stacion pompimi Vreshtas, projekt (16,563,091 lekë)
- 4- Ujësjellësi Mancurisht-Plasë, mbikqyrje (80,450,000 lekë)
- 5- Rehabilitim ujëtar SEP Pojan, F.II (6,077,088 lekë)

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”

**Situata:** Kapitalizimi (shtesat) për vitin 2022 në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë në vlerën 222,020,883 lekë. Objektet sistemim-asfaltim rruga Vloçisht-Drithas, mbikqyrje, kolaudim në vlerën 1,946,352 lekë, mbushje gropash 2022 në vlerën 3,460,216 lekë, ndërtim stacion pompimi Vreshtas në vlerën 16,563,091 lekë, ujësjellësi Mancurisht-Plasë mbikqyrje në vlerën 80,450,000 lekë dhe Rehabilitim ujëtar sep Pojan faza II në vlerën 6,07,088 lekë janë kapitalizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” këto investime për këto objekte janë akoma në fazë investimi të cilat duhet të rregjistrohen në llogarinë 231 “Investime në proces”.

**Kriteri:** Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”.

#### **Hyrjet e AAGJ dokumentohen:**

- 1) Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).
- 2) Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt-marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit.
- 3) Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim.
- 4) Për rivlerësimet, si dokument shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve.

#### **Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike.**

-Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e aktiveve afatgjata.

-Për rrjedhim, aktivitet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim pra të jenë funksionale ato detyrimisht duhet të gjenden në proces. Në formën e shpenzimeve që grupohen më analiza në llogarinë 23 “Investime”.



-Këto janë investime në proces ,pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksion dhe nuk është kapitalizuar.

-Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto behën funksionale dhe kapitalizohen në grupet 0 dhe 21 të aktiveve të përfunduara.

**Ndikimi/Efekti:**Llogaria nr.213 “Rrugë,rrjete,vepra ujore”në fund të vitit 2022, nuk pasqyron vlerën e drejtë dhe reale të saj.

**Shkaku:**Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandim:**Drejtoria e Financës Bashkia Maliq të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete,vepra ujore”.

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është **mbivlerësuar me vlerën 108,496,747 lekë.**

**5. Llogaria 215 “Mjete transporti”.** Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Maliq më datë 31.12.2022 në shumën 31,617,068 lekë.

Kjo llogari është shtuar në vlerën 5,102,001 për blerjen e 2 mjeteve. Llogaria është pakësuar nga amortizimi vjetor në vlerën 6,628,767 lekë dhe mjete nxjerrë jashtë përdorimit në vlerën 2,396,010 lekë. Zbritja neto e llogarisë 215 “Mjete transporti” për vitin 2022 është në vlerën 1,526,766 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	33,143,834
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	5,102,001
Pakësimet gjatë vitit 2022 (K)	9,024,777
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>31,617,068</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

Me urdhër Nr.263 datë 02.06.2022 të Titullarit Bashkia Maliq është ngritur komisioni për vlerësimin e gjendjes teknike të mjeteve të Bashkisë Maliq.

Nga komisioni janë mbajtur procesverbalet për vlerësimin e mjeteve dhe rezultuan 6 mjete jo në gjendje pune si mëposhtë.

-Autoveturë KO9500B më vlerë fillestare 396,000 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Autoveturë AA540DL me vlerë fillestare 400,000 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Kamjon Daf VJ-91-JB me vlerë fillestare 1,413,000 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Autokarro BOB0649 me vlerë fillestare 187,010 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

-Kamjon DV158A me vlerë fillestare 1,300,000 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë

-Eskavator me zinxhir K-408 me vlerë fillestare 296,228 lekë dhe vlerë të mbetur 0 lekë.

Eskavatori ka qënë i regjistruar në llogarinë 214 “Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune”.

Me urdhër Nr.593 datë 02.11.2022 të Titullarit Bashkia Maliq është ngritur komisioni për asgjësimin e aktiveve të mjeteve të Bashkisë Maliq.

**6. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”.** Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Maliq. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Maliq gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2022 paraqitet në vlerën 33,736,091 lekë. Krahasuar me vitin 2021 llogaria 218 “Inventari ekonomik” është rritur me vlerën 1,715,113 lekë.

Lëvizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2022, vlera në lekë	
Çelje në 01.01.2021	32,020,978
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	
Dalje (K)	
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>33,736,091</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

**Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Maliq në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën (680,552,301) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2022. Krahasuar me vitin 2021 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (141,742,963) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2022.

Lëvizja e llogarisë 219“Amortizimi i AAGJM & AAJM”, paraqitet në **pasqyrën PF12** në anekset e raportit të auditimit.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Maliq, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

### **Aktivet Afatgjata Financiare**

**Titulli gjetjes:**Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 “Aktivet Afatgjata Financiare”

#### **Situata:**

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2021 dhe 2022 në vlerën 0 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2022 është paraqitur në vlerën zero siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar -Bashkia Maliq, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 11% të aksioneve të “K” SH.A me NUIS “K.....O” e cila është shoqëri aksionere me objekt “Mbledhja,transporti,administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale”.Numri i aksioneve është 226 me vlerë nominale 16,550 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,740,300 lekë. Nga këto Bashkisë Maliq i përkasin 24.86 aksione me kapital në vlerë monetare 411,433 lekë

-Bashkia Maliq në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “K” sh.a me NUIS “L.....R” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Projektim,financim,zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve të sporteve të të gjitha llojeve me qëllim nxitjen dhe masivizimine sportit.Numri i aksioneve është 350 me vlerë nominale 10,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,500,000 lekë.

-Bashkia Maliq në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 8.67% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë” sh.a me NUIS “M.....N” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 8,670 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 867,000 lekë.

-Bashkia Maliq në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “Kombinati i Sheqerit” sh.a me NUIS “K.....P” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Dhenia me qera e objekteve për të mundësuar kryerjen e aktivitetit të shoqërisë në përputhje me këtë status”. Numri i aksioneve është 582,418 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 582,418,452 lekë.

Vlerat e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2022 ,më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje”.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 587,196,885 lekë dhe investori është Bashkia Maliq.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne Pjesëmarrje me vlerë kontabël 587,196,885 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

**Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

**Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, gjendje kjo e nën vlerësuar me 587,196,885 lekë.

**Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 “Investime në Pjesëmarrje”.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Maliq, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar me vlerë kontabël 587,196,885 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**4. Investimet:**

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2022 paraqitet në vlerën 45,313,814 lekë Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 45,313,814 lekë, përkatësisht 0 lekë në llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 45,313,814 lekë në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Nga auditimi u verifikuar se kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 131,042,783 lekë e përbërë nga 7 projekte të cilat janë kontabilizuar në llogaritë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” .

Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”.

**Pasqyra PF 13:** Investimet sipas kontratave të lidhura në vitet 2020-2022 të cilat janë në proces punimësh.

Emërtimi	Operatori Ekonomik	Nr.Fature	Dt.Fature	Shuma
Blerje ndricuesa 2022	I.	34373	19.12.2022	3,984,600
Rikonstruksion Qendra komunitare kult Dh Orgocka Faza I	S.	70	07.11.2022	7,899,420
Mbushje gropash ne rruge 2022(Diference)	I.	17	07.11.2022	1,925,545
Sistem asf rruga gryka Vlocisht Drithas poshte sit perfundimtar	V.	363	18.11.2022	3,725,647
Sistemim asfaltim rruge Ne Nja viti 2022 SIT NR 1	V.	367	16.12.2022	12,493,428
Rehabiltim I ujitjes SEP pojan viti 2021	SH.	111	27.12.2022	5,107,125
Blerje karburant per mjetet	M.	338	12.10.2022	440,239
Sit nr 1 Sistem asf rruga Gryka Vlocisht -Drithas	V.	279	13.09.2022	10,178,049
<b>Totali</b>				<b>45,754,053</b>

**Burimi:** Bashkia Maliq

**Titulli i gjetjes:** Pasqyrim jo i saktë i llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” duke mos përfshirë investimet të cilat janë në proces.

**Situata:** Nga auditimi u verifikuar se kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 131,042,783 lekë e përbërë nga 7 projekte të cilat janë kontabilizuar në llogaritë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Në llogarinë 231 “Investime në proces” rregjistrohet vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”.

Investimet e kontabilizuara në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”

1-Sistemim-Asfaltim rruga Vloçisht-Drithas, mbikqyrje, kolaudim (1,946,352 lekë)

2-Mbushje gropash 2022 (3,460,216 lekë)

3-Ndertim stacion pompimi Vreshtas,projekt (16,563,091 lekë)

4-Ujësjetllësi Mancurisht-Plase, mbikqyrje (80,450,000 lekë)

5-Rehabilitim ujitje SEP Pojan ,F.II (6,077,088 lekë)

Investimet e kontabilizuara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”

1-Rikonstruksion pallati viti 2021 në vlerën (4,052,067 lekë)

2-Përmirësim i banesave viti 2021 (18,493,969 lekë)

**Kriteri:** Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23.

**Ndikimi/Efekti:** Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

**Shkaku:** Mos zbatimi i rregullave kontabël.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” dhe pas

realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

## PASIVET (DETYRIMET)

### Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Maliq më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

#### Pasqyra PF14: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	60,527,133	161,924,774	(101,397,641)
42	Detyrime ndaj personelit	33,192,639	20,847,230	12,345,409
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	893,424	1,040,849	(147,425)
435	Sigurime shoqërore	6,676,744	6,222,206	454,538
436	Sigurime shëndetësore	920,432	857,742	62,690
467	Kreditor të ndryshëm	114,473,247	61,623,275	52,849,972
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	0	0	0

Burimi: Bashkia Maliq

**Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, në fund të vitit 2022 është në vlerën 60,527,133 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Maliq më 31.12.2022. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si më poshtë: Analiza e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në **pasqyrën PF15** anekset e raportit të auditimit.

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 60,527,133 lekë përbëhet nga fatura të palikujduara. Fatura të palikujduara të cilat kanë kaluar afatin 60 ditor janë në vlerën 10,618,288 lekë dhe përbëhen nga 2 fatura tatimore.

Stoku i detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE është në vlerën 10,618,288 lekë dhe përbëhet nga 2 fatura tatimore.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF 16** më poshtë.

Objekti	Operatori	Nr fature	Dt. fature	Shuma
Blerje karburant per mjetet	M.	338/2022	12.10.2022	440,239
Sit nr 1 Sistem asf rruga Gryka Vlocisht -Drithas	V.	279/2022	13.09.2022	10,178,049
<b>TOTALI</b>				<b>10,618,288</b>

Burimi: Bashkia Maliq

**Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”,** sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Maliq, paraqitet në vlerën 33,192,639 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar në muajin janar 2022 në shumën 33,192,639 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF17** më poshtë.

Urdhër Shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
1	01.01.2023	Pagat dhjetor 2022	17,069,935
2	01.01.2023	Pagat dhjetor 2022	5,261,221
3	01.01.2023	Pagat dhjetor 2022	111,483
976	30.12.2022	Mbeshtetje financiare urdhri 711 dt 30.12.2022 VKB 898 DT 29.12.2022	5,600,000
976	30.12.2022	Mbeshtetje financiare urdhri 711 dt 30.12.2022 VKB 898 DT 29.12.2022	1,530,000
976	30.12.2022	Mbeshtetje financiare urdhri 711 dt 30.12.2022 VKB 898 DT 29.12.2022	3,600,000
976	30.12.2022	Mbeshtetje financiare urdhri 711 dt 30.12.2022 VKB 898 DT 29.12.2022	20,000
<b>Shuma</b>			<b>33,192,639</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”,** paraqitet në vlerën 893,424 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në Janar 2022.

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
5	01.01.2023	Tatim Page	893,424
<b>Shuma</b>			<b>893,424</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 4,978,327 lekë dhe 684,318 lekë.

**Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”**

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
5	01.01.2023	Sigurime Shoqërore 9.5%	2,616,319
6	01.01.2023	Sigurime Shoqërore 15%	4,060,425
<b>Shuma</b>			<b>6,676,744</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

**Llogaria 436 “Sigurime shëndetsore”**

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
5	01.01.2023	Sigurime Shëndetsore 1.7%	460,216
6	01.01.2023	Sigurime Shëndetsore 1.7%	460,216
<b>Shuma</b>			<b>920,432</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

**Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”,** sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Maliq, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 24,825,314 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Maliq.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466.

Përfundimisht për vitin 2022; Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 1,638,158 lekë për vitin 2022, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë.

**Titulli i gjetjes:** Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, në pasqyrat financiare.

**Situata:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Maliq më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 15,628,003 lekë ndërsa në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 24,825,314 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Në lidhje me shtesat apo pakësimet për këtë llogari, Drejtoria e Financës nuk disponon informacion. Për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Maliq janë ngurtësuar fonde në vlerën 1,638,158 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Korçë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve dhe Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 1,638,158

lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në në **Pasqyrën PF18** në aneksët e projekt raportit.

**Kriteri:** Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Pika 30: “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50: “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”.

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10 ku përcaktohet:

Pika 10: “Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.”

**Ndikimi/Efekti:** Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

**Shkaku:** Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Maliq, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

### Llogari 467 “Kreditorë të ndryshëm”

Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në datën 31.12.2022, është rregjistruar në vlerën 114,473,247 lekë.

**Titulli i gjetjes:** Mbi kontabilizimin e saktë të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”

**Situata:** Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Maliq më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 61,623,275 lekë ndërsa në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 114,473,247 lekë. Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Llogaritë e rregjistruara	Shuma
Debitorë llogaria 468	63,463,222
Vlera e detyrimeve per pulla	860,000
Vlera e detyrimeve per bileta	496,740



Detyrime per shpenzime gjyqesore	197,900
Mbeshtetje financiare Ndhima ekonomike dhjetor 2022	21,200,000
MBESHTETJE FINANCIARE Nihma ekonomike 6% dhjetor 2022	2,676,000
Mbeshtetje financiare Paftesia DHJETOR 2022 pagese ne poste	6,776,000
Mbeshtetje financiare Paftesia DHJETOR 2022 pagese ne raifeisen bank	40,000
Mbeshtetje financiare Paftesia DHJETOR 2022 pagese ne FI bank	1,736,000
NDIHMA EKONOMIKE DHJETOR 2022	17,027,385
<b>TOTALI</b>	<b>114,473,247</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

Në këtë llogaria është kontabilizuar llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” sipas udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kundër parti e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” është llogaria 470 “Të ardhura për tu marrë”.

Vlera e pullave dhe biletave rregjistrohen në llogarinë 532 “Vlera të tjera”.

Mbeshtetja financiare për ndihmë ekonomike dhe paaftësinë janë fonde që vijnë nga buxheti i shtetit dhe rregjistrohen në llogaritë 520 “Disponibilitete në Thesar” në debi dhe 7202 “Grant korent nga buxheti për pagesa të posaçme të ISSH”.

Rregjistrimet e mësipërme kanë mbivlerësuar këtë llogari për vlerën 114,275,347 lekë.

**Kriteri:**Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes,paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”.

**Ndikimi/Efekti:**Llogaria nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” në fund të vitit 2022, nuk pasqyron vlerën e drejtë dhe reale të saj.

**Shkaku:**Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:**I Mesëm.

**Rekomandim:**Drejtoria e Financës Bashkia Maliq të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”.

#### **ASETET E BASHKISË MALIQ:**

Në zbatim të nënpikës 3.4 mbi “Menaxhimin e asetëve, inventari dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, të programit të auditimit nr.863/1 datë 13.10.2023, janë administruar evidencat si më poshtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Maliq
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastër

#### **I. PASURITË E PALUAJTSHME**

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të

detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t'u transferoheshin. Për bashkinë Maliq lista e pronave është miratuar me VKM e mëposhtme -VKM nr. 127, date 02.02.2009 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen, ne pronesi ose ne perdorim, te Bashksie Maliq, te Qarkut te Korces".

-VKM Nr. 1154, date 13.08.2008 "Per miratimin e listes paraprake te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen, ne pronesi ose ne perdorim, te Komunes Pojan, te Qarkut te Korces".

VKM Nr. 660, date 11.06.2009 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim, te Komunes Libonik, te Qarkut te Korces".

VKM Nr. 826, date 21.11.2012 "Per miratimin e listes paraprake te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen, ne pronesi ose ne perdorim, te Komunes Pirg, te Qarkut te Korces".

VKM Nr. 01.04.2009 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen, ne pronesi ose ne perdorim, te Komunes Vreshtas, te Qarkut te Korces".

VKM Nr. 524, date 30.06.2010 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen, ne pronesi ose ne perdorim, te Komunes Gore, te Qarkut te Korces".

VKM Nr. 734, date 26.10.2011 "Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen, ne pronesi ose ne perdorim, te Komunes, te Qarkut te Korces". Nga totali prej rreth 4113, pasuri që i janë transferuar Bashkisë Maliq (964), përfshirë pasuritë e paluajtshme të ish-komunave Vreshtas (362), Pojan (362), Pirg (376) Moglicë (592), Libonik (629) dhe Gorë (815) vetëm **76 pasuri janë certifikuar**.

Njësitë Administrative	Prona gjithsej	Çertifikuar	Çertifikatë përdorimi	Proces
Nj.Vreshtas	362	5	3	5
Nj.Pojan	362	10	1	7
Nj.Pirg	376	14	2	6
Nj.Moglicë	592	2	0	2
Maliq	964	23	1	5
Nj.Libonik	629	21	3	4
NJ.Gore	815	1	1	
<b>Total</b>	<b>4113</b>	<b>76</b>	<b>11</b>	<b>29</b>

Burimi: Bashkia Maliq

Nga verifikimi i deritanishëm i evidencave, rezulton se:

Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Maliq nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se “*bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës,*

*nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”.*

**Titulli i gjetjes:** Mosregjistrimi i pasurive të paluajtshme të Bashkisë Maliq dhe mungesa e përditësimit të inventarit të pasurive të paluajtshme.

**Situata:** Gjatë periudhës 2009-2012 sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nëpërmjet VKM në Bashkinë Maliq janë transferuar 4113 pasuri. Në Bashkinë Maliq me VKM nr. 127, date 02.02.2009 janë transferuar 964 pasuri, me VKM Nr. 1154, date 13.08.2008 i janë transferuar ish komunës Pojan 362 pasuri, me VKM Nr. 660, date 11.06.2009 i janë transferuar ish komunës Libonik 629 pasuri, me VKM Nr. 826, date 21.11.2012 i janë transferuar ish komunës Pirg 376 pasuri, me VKM Nr. 01.04.2009 i janë transferuar ish komunës Vreshtas 362 pasuri, me VKM Nr. 524, date 30.06.2010 i janë transferuar ish komunës Gore 815 pasuri, me VKM Nr. 734, date 26.10.2011 2010 i janë transferuar ish komunës Moglicë 592 pasuri.

Nga pasuritë e transferuara 76 pasuri janë pajisur me çertifikatë pronësie, 11 pasuri janë të pajisura me çertifikatë përdorimi dhe 29 pasuri janë në proces rregjistrimi.

Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e bashkisë Maliq nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezulton i papërditësuar.

**Kriteri:** Neni 37 i ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

**Impakti:** Mospërditësimi i inventarit dhe mosregjistrimin e pasurive në pronësi të bashkisë sjell si pasojë riskun e zaptimit të këtyre asetëve, mosvënien në përdorim në funksion të komunitetit dhe potencialisht mungesë të ardhurash nga qiratë që mund të mblidhen nga këto pasuri.

**Shkaku:** Mungesë burimesh logjistike dhe njerëzore në bashkinë Maliq, mos marrja e masave për përditësimin e inventarit si dhe mos rakordim me ZVASHK mbi statusin juridik të pasurive.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZVASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

## **2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.**

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrimit të prokurimeve.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

- **Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrimit të prokurimeve.**

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë periudhë ushtrimore 2020-2022.

Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra.

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet:**

*Të dhëna mbi Regjistrin e Realizimeve të Prokurimit Publik:*

<b><i>Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020</i></b>			
Lloji i procedures së prokurimit të përdorur nga AK	Procedura gjithësej të realizuara nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020	Totali i fondit limit (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.	Vlra e kontratës së lidhur (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.
“blerje me vlerë të vogël”	64 procedura	<b>15.772.116</b>	<b>10.461.341</b>
“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	18 procedura	<b>1.255.005</b>	<b>1.045.838</b>
“e hapur e thjeshtuar”	31 procedura	<b>87.700.665</b>	<b>57.719.920</b>
“e hapur ”	8 procedura	<b>305.298.190</b>	<b>242.210.777</b>
“negocim pa shpallje”	2 procedura	<b>6.727.995</b>	<b>6.213.081</b>
<b>TOTALI</b>	<b>123 procedura</b>	<b>416.753.971</b>	<b>317.650.957</b>

<b><i>Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021</i></b>			
Lloji i procedures së prokurimit të përdorur nga AK	Procedura gjithësej të realizuara nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021	Totali i fondit limit (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.	Vlra e kontratës së lidhur (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.
“blerje me vlerë të vogël”	83 procedura	<b>19.321.943</b>	<b>12.328.222</b>
“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	43 procedura	<b>2,736,123</b>	<b>2,280,103</b>
“e hapur e thjeshtuar”	24 procedura	<b>90.477.668</b>	<b>64.445.052</b>
“e hapur ”	7 procedura	<b>137.311.906</b>	<b>84.537.246</b>
<b>TOTALI</b>	<b>157 procedura</b>	<b>249.847.640</b>	<b>163.590.623</b>

<b><i>Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022</i></b>			
Lloji i procedures së prokurimit të përdorur nga AK	Procedura gjithësej të realizuara nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022	Totali i fondit limit (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.	Vlra e kontratës së lidhur (në lekë pa tvsh) për procedurat përkatëse.
“blerje me vlerë të vogël”	53 procedura	<b>20.358.342</b>	<b>14.128.332</b>
“blerje nën vlerën 100 000 lekë”	26 procedura	<b>1.768.813</b>	<b>1,474.011</b>
“e hapur e thjeshtuar”	26 procedura	<b>114.879.972</b>	<b>91.514.510</b>
“e hapur ”	10 procedura	<b>313.620.455</b>	<b>236.950.328</b>
<b>TOTALI</b>	<b>115 procedura</b>	<b>450.627.582</b>	<b>344.067.181</b>

Referuar të dhënave të tabelës, nga grupi i auditimit janë vlerësuar për auditim, në bazë të materialitetit, **16** procedura me fond limit **493,118** mijë lekë dhe vlera e kontratave të lidhura **384,221** mijë lekë pa TVSh. Diferenca e fondit limit me kontratat fituese është **108,896** mijë lekë pa TVSh e shprehur në përqindje 22% nga fondi limit.

Nga auditimi i **16** procedurave me fond limit **493,118** mijë lekë janë konstatuar shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP si vijon:

- Në **9** procedura është evidentuar aplikimi i kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës;
- Në **4** procedura, në lidhje me argumentimin e fondit limit janë konstatuar parregullsi në përllogaritje;
- Në **5** procedura është evidentuar se OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST, pavarësisht rëndësisë së tyre.

## **Rastet e shkeljeve sipas procedurave paraqiten si vijon:**

**Titulli i gjetjes 1:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kritereve të pjesëmarrjes kundrejt OE, duke përdorur kritereve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë apo të panevojshme për realizimin e objektit të prokurimit, konstatuar kjo në **9 procedura prokurimi**.

### **Situata:**

Në auditimin e 16 procedurave, rezulton se në 9 procedura është evidentuar aplikimi i kritereve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Lloji i shkeljes
1	Ndërtimi i Ujësjetës Maçurisht-Plasë	178,942,269	159,098,275	kritere të paargumentuara
2	Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III	11,431,546	5,909,640	kritere të paargumentuara
3	Kuz Njësitë Administrative	18,886,937	12,032,150	kritere të paargumentuara dhe jo të lidhura ngushtë me tipologjinë
4	Ndërtim KUZ Vloçisht faza 2	8,333,049	6,274,200	kritere të paargumentuara dhe jo të lidhura ngushtë me tipologjinë
5	Rikonstrukcion i fushës së futbollit	17,153,307	16,128,430	kritere jo të lidhura ngushtë me tipologjinë
6	Rikonstrukcion objekte ndertimore 2022	11,666,577	9,564,639	kritere të paargumentuara
7	Përmirësimi i banesave ekzistuese	25,007,176	18,491,461	specifikime jo të lidhura ngushtë me tipologjinë
8	Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative	74,997,785	51,347,160	specifikime jo të lidhura ngushtë me tipologjinë
9	Shërbim mirëmbajtje mjetet dhe eskavatorët	3,047,601	2,940,810	specifikime jo të lidhura ngushtë me tipologjinë

Shkeljet konsistojnë në këto drejtime:

- Janë kërkuar kategori licensë jo në përputhje me procedurën, pasi referuar zërave të preventivit këto licensa nuk janë të domosdoshme.

- Janë kërkuar numër punonjësish të paargumentuar dhe jo me analizë dhe në përputhje me volumin e zërave të preventivit, kërkesë kjo e mbështetur në dispozitat e VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

- Është kërkuar për punonjësit “Çertifikatë për sigrimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik” edhe në lidhje me procedura për të cilat, referuar preventivit, ekzistojnë vetëm punime ndërtimi dhe nuk ka punime elektrike.

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, “pajisja me Çertifikatë për sigrimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik” shërben për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, pra nuk është në përputhje me objektin e prokurimit të ndërtimit të KUZ pasi në preventivin e këtij të fundit ekzistojnë vetëm punime ndërtimi dhe nuk ka punime elektrike. Referuar dispozitave të ISHTI, dëshmitë jepen për kategoritë: Naftën dhe Gazin Natyror, Pajisje nën Presion, Instalime Elektrike dhe Laborator të Kontrollleve. Në kushtet kur projekt-preventivi nuk ka asnjë pajisje në proces pune që ka të bëjë me rjetin, apo skemat elektrike, atëherë është e qartë se kjo dëshmi e sigurimit teknik nuk ndikon në vlerësimin e kualifikimit të stafit. Nga ana tjetër, Çertifikata për sigrimin teknik ose Dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik nuk zëvendëson në asnjë rast dëshminë profesionale (trajnimi etj.) të punonjësit, të cilën AK në rastin konkret nuk e ka kërkuar por që do të ishte e mjaftueshëm për natyrën e kontratës.

- Është kërkuar për punonjësit “kontrata pune të firmosur përpara noterit (e vlefshme)”.

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, nënshkrimi i kontratave të punës përpara noterit nuk është një akt i detyruar ligjërisht as për punëdhënësin dhe as për punëmarrësin. Jo vetëm kaq, por Kodi i Punës, sipas të cilit regullohen marrëdhëniet midis palëve në rastin konkret, përcakton në nenin 21, pika 1 se: “kontrata e punës mund të lidhet ose ndryshohet me gojë ose me shkrim”. Prezenca e punonjësve të caktuar në listpagesat e një OE është një fakt i mjaftueshëm që ky i fundit të provojë disponimin e tyre. Në rastin konkret, kërkesa për një kontratë të shkruar, aq më tepër përpara noterit, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

- Është kërkuar për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, kërkesa që në kontratën e qirasë të specifikohet objekti i kontratës (procedurës së prokurimit), është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Një kërkesë e tillë, e paarsyeshme, do të vështirësonte marrëdhëniet midis OE duke rritur pa asnjë efekt shpenzimet e tyre (përsëritje e panevojshme e kontratave të qirasë). Paraqitja e një kontrate qiraje me afat të vlefshëm ku të përcaktohen mjetet e marra me qira është një akt i mjaftueshëm që OE të provojë disponimin e tyre, duke e shoqëruar këtë të fundit me deklaratën e mosangazhimit në kontrata të tjera.

- Njësia e Prokurimit, për hartimin dhe argumentimin e kriterëve, në pjesën më të madhe të tyre, është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik në referim të grafikut, volumeve të punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter apo liçence të kërkuar (psh. për cilat zëra konkretë të punimeve të preventivuara kërkohet një liçencë, mjet, pajisje apo ISO e caktuar, etj.).

- Gjithashtu në këto procedura është konstatua se, dosjet e procedurave edhe pse janë të shoqëruara me një inventar paraprak, nuk janë të numëruara në cdo faqe me laps të zi, në kundërshtim me germën (g), të nenit 8- *Përpunimi tekniko-shkencor i dokumentacionit të prapambetur*, të Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH”, ku citohet se”...*Organizimi i brendshëm i dosjes (sistemin) përfshin rënditjen e dokumenteve brenda dosjes sipas disa kriterëve që janë të njëjta me ato të krijimit të njësisë së ruajtjes. Kriteri i objektivit poërdoret kur dosja është krijuar me koncept të gjërë dh dokumentet grupohen me nëncështje. Kur volumi i dokumentave është i konsiderueshëm dhe ka të bëjë me emra personash, përdoret edhe kriteri alfabetik, më pas bëhet numërimi i dokumenteve. Të gjitha fletët e dosjes (përvec fletëve të bardha) numërohen me laps të zi grafiti në kndin e djathtë, pa cënuar teksin”.*

**Kriteri:** Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efektiviteti:** Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumentuara, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa eventuale e konkurrencës.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Njësia e Prokurimit*).

**Rëndësia: E lartë.**

**Rekomandim:** Sektori i Prokurimit Publik (NjP përkatëse) në Bashkinë Maliq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet t’i argumentojë teknikisht dhe ligjërisht ato duke pasur gjithmonë parasysh

tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë të OE, duke nxitur gjithashtu konkurrencën midis tyre.

*(Gjerësisht problematikat në lidhje me mos zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të LPP-së për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt OE, duke përdorur kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë apo të panevojshme për realizimin e objektit të prokurimit, janë trajtuar në Akt konstatimin nr. 3 dhe 8 datë 30.12.2023, protokolluar në subjekt (Bashkia Maliq) përkatësisht me nr. 6464/7 prot. dhe nr. 6464/2 prot., datë 30.12.2023.)*

**Titulli i gjetjes 2:** *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e pjesëmarrjes, konstatuar kjo në 5 procedura prokurimi.*

**Situata:** Nga auditimi i 16 procedurave me fond limit 493,118 mijë lekë të vlerësuara për auditim për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej në 5 procedura me vlerë të fondit limit 269,675 mijë lekë të vlerës së fondit limit të audituar, ku OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK për vlerën totale të kontratave 223,021 mijë lekë.

Në këto kushte si dhe në funksion të zbatimit të ligjit “Për prokurimin publik”, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar B/OE e kualifikuar (fitues) duke shpallur përfundimisht fitues B/OE të rradhës, i cili i plotëson të gjitha kriteret e DST-ve, edhe pse realizimi i punëve do të kryej me një vlerë më të lartë monetare. Në ratet kur nuk ka pasur një të tillë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe të zhvillonte një procedurë tjetër me kushte me favorizuese (në rivlerësim të kriterëve) për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedure, me qëllim një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar në vlerën 269,675 mije lekë, konkretisht procedurat:

1- Procedura me objekt “Ndërtimi i Ujësjellësit Maçurisht-Plasë” me fond limit 178,942 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “N ” & “S ” ShPK me vlerë kontrate 159,098 mijë lekë.

2- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III” me fond limit 11,431 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “V ” ShPK, me vlerë kontrate 5,909 mijë lekë.

3- Procedura me objekt “Kuz Njësitë Administrative” me fond limit 18,886 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “V ” & “A ” & “XH ” ShPK, me vlerë kontrate 12,032 mijë lekë.

4- Procedura me objekt “Ndërtim KUZ Vloçisht faza 2” me fond limit 8,333 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “A. K. 2002” ShPK, me vlerë kontrate 6,274 mijë lekë.

5- Procedura me objekt “Ndërtim stacion pompimi Vreshtas + linja” me fond limit 52,083 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “N” ShPK me vlerë kontrate 39,708 mijë lekë.

Në procedurat e mësipërme janë konstatuar kriteret të paplotësuara nga OE/BOE e shpallur fitues nga KVO dhe të miratuara nga titullari i AK (kriteret ligjore/ dhe teknike), mangësi të cilat eventualisht ndikojnë edhe në zbatimin e kontratës, respektivisht:

- Mos pagesë të taksave lokale në të gjitha bashkitë ku subjektet, referuar ekstarktit historik, kanë ushtruar aktivitetin e tyre.
- Mungesë e licencës të lëshuar nga QKL me kodin III.7.B., edhe në rastin e BOE kur njëri prej tyre e disponon por të dy OE të bashkimit kanë pjesëmarrje në të gjitha zërat e punimeve sipas preventivit.
- Mos disponimi i makinerive sipas kriterëve apo kapaciteteve standarte të kërkuara.
- Mungesa e një preventivi ose akti ku të përcaktohet saktësisht pjesa e punës dhe elementet konkrete (zërat e preventivit) që do të kryejë secili nga anëtarët në rastin e Bashkimit të Operatorëve, sikundër kërkohet nga neni 74, pika 1 dhe 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

- Mungesa e një vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve (për të gjithë muajt) të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

**Kriteri:**

Në shkëlqje të dispozitave të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Në kushtet kur për zbatimin e një kontrate publike, nga Autoriteti Kontraktor, kontraktohet një operator ekonomik i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, efektivisht ky veprim mbart gjithashtu një risk potencial të shtuar për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjor, mangësi gjatë verifikimit të plotësimit të të gjitha kriterëve nga B/OE pjesëmarrës, në fazën e vlerësimit të ofertave, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Kryetari i bashkisë Maliq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 223,021 mijë lekë.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkëlqje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën dhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi efektivisht ky veprim ndikon negativisht në qëllimin e AK për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar.

*(Gjerësisht problematikat në lidhje me mos zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e pjesëmarrjes, janë trajtuar në Akt konstatimin nr. 8, datë 30.12.2023, protokolluar në subjekt (Bashkia Maliq) përkatësisht me nr. 6464/7 prot., datë 30.12.2023. )*

**1-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtimi i Ujësjellësit Maçurisht-Plasë, si vijon:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht si vijon:

**Të dhëna mbi objektin e prokurimit:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i Ujësjellësit Maçurisht - Plasë”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-67943 -08 – 06 -2020 Urdhëri nr.63, datë 28.07.2020	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese (DST)</b> Urdhëri nr. 63 prot., datë 28.07.2020 1. G.F 2. G.G 3. S.K	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. G.F 2. G.G 3. S.K  Urdhëri nr. 465 datë 19.10.2020	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhëri nr.324, datë 28.07.2020. 1. F.D 2. M.ZH 3. M.SH  <b>3/1 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave</b> Urdhri nr. 346, datë 13.08.2020 dhe Urdhri nr. 347, datë 13.08.2020



		“Per nje ndryshim ne Urdhëri nr. 63 prot., datë 28.07.2020 -Z.S.K zëvendësohet me anëtarin S.K	1. K.M 2. G.M 3. N.GJ Urdhëri nr. 448, datë 09.10.2020 1. K.M 2. F.M 3. O.I Urdhëri nr. 486, datë 27.10.2020 1. J.G 2. N. C 3. S.M
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 178,942,269 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 159,098,275 lekë Operatori Fitues: <b>-BOE “N ”&amp; “S” ShPK</b>	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 19,843,994 lekë	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 21.09.2020	<b>8. Burimi Financimit</b> Grand	<b>9. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 <b>B/OE</b> b) S’kualifikuar 2 <b>B/OE</b> c) Kualifikuar 2 <b>B/OE</b>	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 6 muaj			

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet se:**

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

***Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:***

***Së pari***, AK Bashkia Maliq në vitin 2016 ka prokuruar nëpërmjet procedurës “shërbim konsulence” projektin e zbatimit në lidhje me objektin e prokurimit të sipërcituar, i cili është hartuar nga “E ” ShPK. Në lidhje me këtë projekt, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton të jetë pjesë e saj edhe oponenta teknike. Konkretisht, Bashkia Maliq ka kërkuar nga Insituti i Ndërtimit kryerjen e Oponencës Teknike me shkresën “Kërkesë” nr. 3310 prot., datë 26.07.2019. Insituti i Ndërtimit ka kryer Oponencën Teknike dhe e ka përcjellë me shkresën e protokolluar pranë Bashkisë Maliq nr. 4003 prot., datë 20.09.2019.

Në vijim, nga AK është aplikuar për financimin e projektit pranë AKUM. Kjo e fundit, me shkresat nr. 1877/4 prot. dhe nr. 1877/1 prot., datë 23.07.2020, bën me dije AK Bashkia Maliq për miratimin e kërkesës për financim referuar duke akorduar fondin për një vlerë të plotë të punimeve prej 217,076,239 lekë.

***Së dyti***, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se pavarësisht preventivit të objektit, nga ana e AK nuk është ngritur një komision për të materializuar në një dokument të posaçëm fondin limit. Në rastin konkret, edhe pse puna e komisionit për përlllogaritjen e fondit limit do të ishte e kufizuar, minimalisht duhet të konfirmonte saktësinë dhe përlllogaritjen e çmimeve të pasqyruara në preventiv apo nevojën për korrigjimin e tyre. Referuar nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”. Në lidhje me këtë situatë, titullari i Autoritetit Kontraktor, ka vepruar në mospërputhje me LPP, nisur nga fakti se në nenin 56 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 përcaktohet si vijon: “*Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrin të prokurimit...*”.

***AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:***

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “*për përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*” datë 06.08.2020 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkëlje të Ligjit “*Për prokurimin publik*”.

Konkretisht, konstatohet se jo të gjitha kriteret e veçanta për kualifikim, pjesë e dokumenteve të tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, të cilat janë kërkuar me qëllim përmbushjen e kapaciteteve teknike nga OE (liçenca, nr. punonjësish, vjetërsia, ISO, mjete, pajisje, etj.), janë të argumentuara. Mosveprim ky i fundit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 61, pika 2** “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të **argumentohen teknikisht** dhe ligjërish dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Në përgjithësi, edhe pse nuk konstatohen kërkesa apo kriteret e ekzagjeruara të hartuara nga Njësia e Prokurimit, kjo e fundit për hartimin dhe argumentimin e tyre, në pjesën më të madhe, është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik në referim të grafikut, volumeve të punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter apo liçence të kërkuar (psh. për cilat zëra konkretë të punimeve të preventivuara kërkohet një liçencë, mjet, pajisje apo ISO e caktuar, etj.).

Në **përfundim**, për sa konstatuar më sipër, në mospërputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, **ngarkohet me përgjegjësi**: Njësia e prokurimit me përbërje: z. G.F, znj. G.G dhe z. S.K .

**Neni 61, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të **argumentohen teknikisht** dhe ligjërish dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

**AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:**

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 B/OE, për të cilët, referuar procesverbaleve përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	“B.” & “D.” ShPK	151,151,700	Skualifikuar
2	“XH” & “C.”& “B.”& “G.” ShPK	158,584,111	Kualifikuar/Skualifikuar
3	BOE “N ”& “S ” ShPK	<b>159,098,275</b>	<b>Kualifikuar/Fituesi</b>
4	“F” SHPK	169,099,770	Kualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të dates 02.10.2020, rezulton se fillimisht KVO-ja, ka kualifikuar 3 (tre) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur renditjen e BOE ku “XH” & “C” & “B” & “G” ShPK rezulton i pari. Nga ana tjetër, ka s’kualifikuar 1 BOE me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

- BOE “B” & “D” ShPK:** -Në dokumentat për kualifikim të paraqitura nga operatori ekonomik “B”, për këtë procedurë prokurimi kontratat e ngjashme (Sistemi-Asfaltim rrugësh, Rikonstruksion shkolla, Ndërtim pallati), të paraqitura nga operatori nuk janë të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit; - Në dokumentat për kualifikim të paraqitura nga operatori ekonomik “B” dhe operatori ekonomik “D”, mungon kategoria NS-18 C; - Operatori ekonomik “B” nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me nr. Repertori 1255, Nr Koleksioni 601, datë 17.09.2020, (40 % të zërave të preventivit) numri mesatar i punonjësve për tre muajt e fundit është 62 ndërkohë që sipas

*marrëveshjes së bashkëpunimit duhet të jetë 72; -Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me nr. Repertori 1255, Nr. Koleksioni 601, datë 17.09.2020, operatori ekonomik "B" merr përsipër të realizojë 40 % të të gjithë zërave të preventivit. Në dokumentat e paraqitur për kualifikim nga operatori mungon Licensa III.7.B;*

Në vijim, me shkresën nr. 4906 prot., datë 08.10.2020, nga OE i renditur i dyti ("N" ShPK) është bërë ankim pranë AK në lidhje me vlerësimin e ofertave. Në ankim, "N" ShPK ka kërkuar skualifikimin e BOE "XH" & "C" & "B." & "G" ShPK të renditur i pari për arsyet si vijon:

- OE "XH" ShPK si anëtar i BOE nuk ka kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjeëmarrjes në bashkim;

- OE "XH" ShPK si anëtar i BOE nuk ka asnjë nga licencat me kod III.2.A apo III.7.B;

- BOE ka mungesë në plotësimin e ISO, shtojcave dhe deklaratave (dyshimeve të "N" ShPK);

Pas marrjes së ankesës, titullari i AK, në respektim të procedurave dhe afateve të përcaktuara nga LPP, ka ngritur KshA i cili pas shqyrtimit, me vendimin nr. 43, datë 16.10.2020, ka vendosur "pranimin e ankesës së "N" ShPK dhe skualifikimin e BOE "XH" & "C" & "B" & "G" ShPK. Referuar procesverbalit të rivlerësimit të ofertave të dates 20.10.2020 si dhe SPE, rezulton se KVO-ja, pas vendimit të KShA-së, skualifikuar BOE "XH" & "C" & "B" & "G" ShPK duke renditur të parin "N" ShPK.

Në vijim, me shkresën nr. 5207 prot., datë 26.10.2020, nga BOE "XH" & "C" & "B" & "G" ShPK është bërë ankim pranë AK në lidhje me rivlerësimin e ofertave. Në ankim, BOE ka kërkuar rikualifikimin e tij dhe skualifikimin e BOE "N" & "S" ShPK të renditur i pari pas rivlerësimit pasi sipas ankuesit ka dyshime për mungesë dokumentacioni.

Pas marrjes së ankesës së dytë, titullari i AK, në respektim të procedurave dhe afateve të përcaktuara nga LPP, ka ngritur KshA i cili, pas shqyrtimit, me vendimin nr. 44, datë 30.10.2020, ka vendosur "të mos marrë parasysh (mos pranojë) ankesën e BOE "XH" & "C" & "B" & "G" ShPK.

Me shkresën nr. 82 prot., datë 11.11.2020 BOE "XH" & "C" & "B" & "G" ShPK ka paraqitur ankim pranë KPP me të cilin ka kërkuar: "*shfuqizimin e vendimit të KVO dhe KshA në lidhje me kuotimin e ri të datës 20.10.2020 si dhe skualifikimin e BOE N" & "S" ShPK*".

**KPP me vendimin nr. 593 datë 22.12.2020 ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE "XH" & "C" & "B" & "G" ShPK duke i lejuar AK vijimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit.**

Në këto kushte, KVO ka shpallur fitues në SPE, me njoftimin e datës 24.12.2020, BOE "N" & "S" ShPK me ofertë 159,098,275 lekë pa TVSh. Nga KVO është hartuar raporti përmbledhës, i cili është miratuar nga titullari i AK në datën 24.12.2020. Palët kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me nr. 132 prot., datë 12.01.2021 duke pasqyruar në SPE edhe njoftimin në lidhje me këtë të fundit.

Në lidhje me mbikqyrjen e zbatimit të punimeve, nga ana e AK, rezulton të jetë kontraktuar mbikqyrësi "E" ShPK me NUIS K.....K dhe numër licence MK.1015/12.

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime të cilat bien ndesh me Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, konkretisht si vijon:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë (BOE) e cila përfundimisht është shpallur fituese, "N" & "S" ShPK, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar. Mospasqyrimi i mangësive në rastin konkret, ka shkaktuar shpalljen fitues padrejtësisht të BOE përkatës.

Konkretisht mangësi të OE “S” ShPK, të papasqyruara në procesverbalet e vlerësimit të datës 02.10.2020, janë si vijon:

1-OE “S” ShPK, referuar ekstarktit historik të shoqërisë, kjo e fundit ushtron aktivitetin e saj, ndër të tjera, edhe në Krujë për të cilën nuk ka paraqitur një vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore.

2-Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se OE “S” ShPK nuk është i pajisur me licensë e lëshuar nga QKL me kodin III.7.B “Për shpues profesionist për ujë”. Referuar kërkesave të përcaktuara në DST, në lidhje me këtë kriter, AK ka kërkuar: “Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë”. Në rastin e bashkimit të operatorëve, neni 74, pika 3 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 përcakton se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Referuar dispozitës së sipërcituar, pavarësisht se lloji i licencës në fjalë plotësohet nga njëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve, kriteri duhet të konsiderohej dhe vlerësohej nga KVO si i përmbushur vetëm në rastin e përmbushjes së tij nga të dy anëtarët e bashkimit.

**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë.

Në kushtet si më sipër, dhe në funksion të zbatimit në mënyrë literale të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar BOE “N” & “S” ShPK duke shpallur përfundimisht fitues operatorin ekonomik të rradhës, i cili i plotëson të gjitha kriteret e DST-ve, edhe pse realizimi i punëve do të kryej me një vlerë më të lartë monetare.

Në kushtet kur për zbatimin e një kontrate publike, nga Autoriteti Kontraktor, kontraktohet një operator ekonomik i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, efektivisht ky veprim mbart gjithashtu një risk potencial të shtuar për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar.

Nga kualifikimi i gabuar i BOE “N” & “S” ShPK, nisur nga fakti i mungesës së plotësimit të të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, veprimet e KVO-së, edhe pse kanë marrë formë përfundimtare me vendim të KPP-së, kanë shkaktuar kontraktimin në kushte paligjshmërie të vlerës 159,098,275 lekë pa TVSh, vlerë e cila përbën një shpenzim të njësisë, në mungesë të një menaxhimini me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, janë **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, 1. F.D, 2. M.ZH , 3. M.SH.**

*Për sa është trajtuar më lart është përgatitur Projekt Raporti i Auditimit i dërguar në subjektin (Bashkia Maliq) mbi të cilin, ky i fundit, nëpërmjet shkresës nr. 6464/1, datë 02.02.2024, protokolluar në KLSH me nr. 863/6, datë 05.02.2024, ka observuar kryesisht në të njëjtën mënyrë si në fazën e dorëzimit të akt-konstatimeve, si më poshtë:*

**Pretendim i subjektit:**

*Me Urdhërin nr 324, datë 28.07.2020, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të ofertave, të cilët kanë bërë vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesmarës. KVO ka vlerësuar dhe kualifikuar BOE “XH ” shpk. Pas ankesës së paraqitur nga BOE “N & S ” shpk, AK ka ngritur KSH i cili ka vlerësuar se ankesa është e drejtë dhe duhet të merret parasysh. Kundër vendimit të KSHA është*

bërë anikm nga BOE "XH" shpk në Komisionin e Prokurimit Publik. KPP me vendimin nr.593, datë 22.12.2020 ka vendour të mos pranojë ankimin e bërë nga BOE "XH" shpk, duke lënë në fuqi Vendimin e Ksha për shpalljen fitues të BOE "N & S" shpk.

Duke qënë se për këtë procedurë prokurimi vendimi për shpalljen fitues është nga Komisioni i Prokurimit Publik, i cili është një organ Vendimatar dhe Autoriteti Kontraktor është i detyruar ta zbatojë. Në këto kushte vendimet e marra nga Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk kanë përgjegjësi.

Për mendimin tonë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave nuk kanë përgjegjësi mbi vendimarrjen pasi Vendimarrja është marrë nga një organ publik më i lartë.

### **Qëndrimi i grupit të KLSH:**

Për sa keni kundërshtuar, sqarojmë se pavarësisht faktit që vendimarrja përfundimtare në lidhje me procedurën është marrë nga një organ publik më i lartë, KPP në rastin konkret, veprimet apo mosveprimet e anëtarëve të KVO-së gjatë fazës së vlerësimit të ofertave janë gjithsesi në kundërshtim me LPP dhe nuk ka asnjë bazë ligjore përjashtuese për këtë rast.

Për sa më sipër, observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

## **2-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: "Sistemin asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III, si vijon:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, konkretisht si vijon:

### **Të dhëna mbi objektin e prokurimit:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemin asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> "Kërkesë për propozim" REF -77999-11-09-2020 Urdhëri nr. 110, datë 21.10.2020	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese (DST)</b> Urdhëri nr. 110, datë 21.10.2020 4. G.F 5. G.G 6. S.K	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 4. G.F 5. G.G 6. S.K	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhëri nr. 511, dt. 05.11.2020. 1. O.I 2. M.ZH 3. S.M
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 11,431,546 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 5,909,640 lekë Operatori Fitues: OE "V." ShPK		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 5,521,906 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 20.11.2020	<b>8. Burimi Financimit</b> Të ardhurat e Bashkisë Maliq		<b>9. Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër 12 B/OE b) S'kualifikuar 10 B/OE c) Kualifikuar 2 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 1 muaj			

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

**Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:**

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, projekt-preventivi është hartuar nga punonjësit e DPZHT Bashkia Maliq (zyra e projekteve). Me urdherin e prokurimit nr. 110 datë 21.10.2020 të nxjerrë nga titullari i AK z. G.T, është përcaktuar fondi limit 11,431.546 lekë pa

TVSh, forma e procedurës e tenderit “Kërkesë për propozim” me mjete elektronike ku është përcaktuar NjP. Gjithashtu me urdhërin nr. 511, datë 05.11.2020 është përcaktuar KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 20.11.2020.

**AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:**

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e krieteve të pranimit/kualifikimit” datë 09.11.2020 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”.

Konkretisht, konstatohet se jo të gjitha kriteret e veçanta për kualifikim, pjesë e dokumenteve të tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, të cilat janë kërkuar me qëllim përmbushjen e kapaciteteve teknike nga OE (liçenca, nr. punonjësish, vjetërsia, ISO, mjete, pajisje, etj.), janë të argumentuara. Mosveprim ky i fundit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i krieteve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Në përgjithësi, edhe pse jo të gjitha kërkesat apo kriteret janë të ekzagjeruara, Njësia e Prokurimit, për hartimin dhe argumentimin e tyre, në pjesën më të madhe, është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik në referim të grafikut, volumeve të punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter apo liçence të kërkuar (psh. për cilat zëra konkretë të punimeve të preventivuara kërkohet një liçencë, mjet, pajisje apo ISO e caktuar, etj.).

Në lidhje me pjesën e krieteve të cilat, në vlerësimin e grupit të auditimit, janë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në mospërputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 9643 , datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 27 “Kontrata e mallrave” dhe neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar, vlerësohen konkretisht:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një Deklarate (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin/it Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i perfshirë në liçensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet të jete Inxhinier Ndërtimi, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

1.Kontratë pune e vlefshme (përkatëse); 2. Diplomë; 3.Drejtuesi teknik duhet të figurojë i regjistruar në listepagesa për 3 muajt e fundit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Drejtuesin teknik për punimet).

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listpagesat për 3 muajt e funditku të figurojnë inxhinierat e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi (1); Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet; Kontratë pune e firmosur përpara noterit (e vlefshme); Diplomë; Te figurojnë e listpagesa për 3 muajt e fundit.

2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën 12(dymbëdhjete) punonjësish perfshire stafin inxhinierik, për 3 muajt e fundit të vërtetuar me; a. Vërtetim të lëshuar dhe konfirmuar (me firme dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për 3 muajt e fundit; Dhe b. Listpagesat ekonfirmuar (me firme dhe vule) nga Administrata Tatimore të punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit.

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tete) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- Manovrator (5) perkatesisht për mjetet Eskavator, Rul, Fadrome, Asfaltoshtruese.

Ne rastin kur mjete është ne pronesipër punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet: kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme); Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor; Te figuroje ne listpagesa per 3 muajt e fundit. Ne rastin kur mjete është me qerapër punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune te noterizuar me manovratorin( i cili duhet te kete Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor) deri ne perfundimin e afateve te kontrates.

-Hidraulik (1); -Murator(2) të pajisur me: kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme); Çertifikate per sigrimin teknik te punonjesve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listpagese për 3 muajt e fundit.

**Si konkluzion**, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme që të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi, për sa kohë vërtetohet se janë të punësuar pranë Operatorit ekonomik në përputhje me parashikimet e Kodit të punës së Republikës së Shqipërisë si dhe të figurojnë në listë pagesa në përputhje me legjislacionin përkatës dhe jo kohëzgjatja e disponimit në periudhën e mëparshme.

Për sa i përket kriterit për kontratat e noterizuara të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, bazur në Kodin e punës së Republikës së Shqipërisë kontrata e punës quhet e vlefshme dhe kur është e firmosur nga punëdhënësi dhe punëmarrësi dhe ky kusht quhet i përmbushur kur punonjësi është i regjistruar në listëpagesat e punëmarrësit .

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në mospërputhje me procedurën e zhvilluar, direkt ose indirekt pengon në pjesëmarrjen e OE në procedurë ose ndikon në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Në përfundim**, për sa konstatuar më sipër, në mospërputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ngarkohet me përgjegjësi: Njësia e prokurimit me përbërje: z. G.F, znj. G.G dhe z. S.K.

**Neni 61, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

**AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:**

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 12 B/OE, për të cilët, referuar procesverbaleve përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	“V.” shpk	5,909,640	Kualifikuar/Fituesi
2	“A.” shpk	6,464,805	Skualifikuar
3	“K.” shpk	6,836,460	Skualifikuar
4	“I.” shpk	6,843,400	Skualifikuar
5	“I.” shpk	7,310,330	Skualifikuar
6	BEO “H.” shpk	7,632,495.25	Skualifikuar

7	“S” shpk	8,000,000	Skualifikuar
8	“A.” shpk	8,129,139	Skualifikuar
9	“N.” shpk	8,292,519.2	Kualifikuar
10	“B.” shpk	8,915,905	Skualifikuar
11	“S.” shpk	9,125,800	Skualifikuar
12	“L.” shpk	9,716,814.7	Skualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të dates 07.12.2020, rezulton se fillimisht KVO-ja, ka kualifikuar 2 (dy) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur renditjen e BOE ku “V” ShPK rezulton i pari. Nga ana tjetër, ka s’kualifikuar 10 BOE me arsyetimin, si vijon:

### **“1.Operatori ekonomik “A.” shpk**

-Sipas pikës 2.3.6 në DST,operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- Manovrator (5) përkatësisht për mjetet Eskavator, Rul, Fadrome, Asfaltoshtruese.

Në rastin kur mjeti është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme).

2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

3. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.

Në rastin kur mjeti është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

2. Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketëDëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.

- Hidraulik (1), Murator (2)

3. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

4. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.

• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm.

### **2. Operatori ekonomik “KMK”**

Konkretisht:

-Sipas pikës 2.3.6 në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

-Manovrator (5) përkatësisht për mjetet Eskavator, Rul, Fadrome, Grejder, Asfaltoshtruese.

Në rastin kur mjeti është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

3. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.

Në rastin kur mjeti është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

2. Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketëDëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.

- Hidraulik (1), Murator (2)

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);



2. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.

• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm.

### **3. Operatori ekonomik "I." shpk**

*Konkretisht:*

-Sipas pikës 2.3.6 në DST,operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

-Manovrator (5) përkatësisht për mjetet Eskavator, Rul, Fadrome, Grejder, Asfaltoshtruese.

Në rastin kur mjete është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

3. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.

Në rastin kur mjete është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketëDëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.

- Hidraulik (1),Murator (2)

1.Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2.Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.

• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm.

### **4. Operatori ekonomik "I" shpk**

*Konkretisht:*

-Sipas pikës 2.3.6 në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

-Manovrator (5) përkatësisht për mjetet Eskavator, Rul, Fadrome, Grejder, Asfaltoshtruese.

Në rastin kur mjete është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

3. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.

Në rastin kur mjete është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketëDëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.

-Hidraulik (1), Murator (2)

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.

• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori ka mangësi si në dokumentacion pra nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm. Punonjësi hidraulik i paraqitur nuk është i pajisur me Dëshmi e Kualifikimit të Sigurimit Teknik ose Çertifikatë të Sigurimit Teknik

*si dhe dy punonjës manovrator nuk janë të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionalee lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.*

### **5. Bashkim Operatorësh ekonomik “H” shpk**

*Konkretisht:*

*-Sipas pikës 2.3.6 në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë: Manovrator (5);*

*Në rastin kur mjete është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

- 1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);*
- 2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.*

*Në rastin kur mjete është me qerapër punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

*Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin( i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.*

*- Hidraulik (1), Murator (2);*

- 1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);*
- 2. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.*

*• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori ekonomik “Udha” nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm.*

### **6. Operatori ekonomik “S” shpk**

*Konkretisht:*

*Sipas pikës 2.3.6 në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë:*

*-Manovrator (5) përkatësisht për mjetet Eskavator, Rul, Fadrome, Asfaltoshtruese.*

*Në rastin kur mjete është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

- 1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);*
- 2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.*
- 3. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.*

*Në rastin kur mjete është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

*Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.*

*- Hidraulik (1), Murator (2)*

- 1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);*
- 2. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.*

*• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori ka mangësi si në dokumentacion. Për një punonjës manovrator, murator dhe hidraulik mungojnë kontratat e noterizuara si dhe një punonjës manovrator nuk është i pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesional të vlefshme.*

### **7. Operatori ekonomik “A” shpk**

*Konkretisht:*

*1-Sipas pikës 2.3.6 në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë: Manovrator (5).*

*Në rastin kur mjeti është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

- 1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);*
- 2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.*

*Në rastin kur mjeti është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

*Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.*

*-Hidraulik (1), Murator (2)*

- 1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);*
- 2. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.*

*• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm.*

*Në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar, sipas pikës 2.2.1 në DST, operatori duhet të paraqesë kopje të vërtëtuara të bilancit për vitin 2018 e shoqëruar kjo me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin nr .1001, datë 05.03.2009.*

*• Në dokumentat per kualifikim të paraqitura nga operatori për këtë procedurë prokurimi mungon raporti i auditimit.*

#### **8. Operatori ekonomik “B” shpk**

*Konkretisht;*

*Sipas pikës 2.3.6 në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë: -Manovrator (5);*

*Në rastin kur mjeti është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

- 1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);*
- 2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.*
- 3. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.*

*Në rastin kur mjeti është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:*

*Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.*

*- Hidraulik (1), Murator (2);*

- 1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);*
- 2. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.*

*• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm.*

#### **9. Operatori ekonomik “S” shpk**

*Konkretisht;*

*1-Në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar, sipas pikës 2.2.1 në DST ,operatori duhet të paraqesë kopje të vërtëtuara të bilancit për vitin 2018 dhe 2019 e shoqëruar kjo me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin nr. 1001, datë 05.03.2009.*

*• Në dokumentat per kualifikim të paraqitura nga operatori për këtë procedurë prokurimi mungon raporti i auditimit.*

2-Sipas pikës 2.3.6 në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë: -Manovrator (5);

Në rastin kur mjeti është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.

Në rastin kur mjeti është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.

- Hidraulik (1), Murator (2);

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.

• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm dhe tre punonjës manovrator nuk janë të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale të vlefshme.

3-Në lidhje me kapacitetin teknik, sipas pikës 2.3.7 në DST, operatori duhet të paraqesë Çertifikatat ISO të mëposhtme:

ISO 9001-2015; ISO 14001-2015; OHSAS 18001-2007 ose 45001 – 2018; PASS 99:2012

• Në dokumentat për kualifikim të paraqitura nga operatori në këtë procedurë prokurimi, për të gjitha certifikatat e mësipërme ka mbaruar afati i vlefshmërisë.

#### **10. Operatori ekonomik “L” shpk**

Konkretisht:

Sipas pikës 2.3.6 në DST, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 8 (tetë) punonjës të kualifikuar si më poshtë: -Manovrator (5);

Në rastin kur mjeti është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të figurojë në listpagesa për 3 muajt e fundit.

Në rastin kur mjeti është me qera për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

Deklaratë nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune të noterizuar me manovratorin (i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në përfundimin e afateve të kontratës.

- Hidraulik (1), Murator (2);

1. Kontrata e punës e firmosur përpara noterit (e vlefshme);

2. Çertifikatë për sigurimin teknik të punonjësve (e vlefshme) ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik. Punonjësit e mësipërm duhet të jenë në listëpagesë për 3 muajt e fundit.

• Në dokumentat e paraqitura për kualifikim, operatori nuk ka paraqitur kontrata të noterizuara për punonjësit e mësipërm”.

Në vijim, njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 07.12.2020 dhe njoftimi i fituesit në datë 17.12.2020 duke specifikuar se në lidhje me këtë procedurë prokurimi nuk ka patur ankesa.

Raporti përmbledhës është mbajtur me datë 17.12.2020, raport i cili është konfirmuar dhe nga Titullari i AK z. G.T.

Midis OE “V.” ShPK dhe AK është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 6666, datë 31.12.2020 për “Sistemin asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III” me vlerën 5,909,640 lekë pa TVSh. me afat punimesh 4 javë nga data e lirim të sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë (OE) e cila përfundimisht është shpallur fituese, “V.” ShPK, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar. Mospasqyrimi i mangësive në rastin konkret, ka shkaktuar shpalljen fitues padrejtësisht të BOE përkatës.

Konkretisht mangësi të OE “V.” ShPK, të papasqyruara në procesverbalet e vlerësimit të datës 02.10.2020, janë si vijon:

1-Shoqëria “V.” deklaron se disponon makineri sipas kriterëve të kërkuara në DST (shtojca 9), por nga verifikimi në dokumentat shoqëruese sipas lejes së qarkullimit rezulton se mjetet nuk kanë në kapacitetin standart të kërkuar nga AK.

Konkretisht:

- Mjeti kamion vetëshkarkues me targë AA698NA rezulton me mase maksimale 21.5 ton, ndërkohë masa maksimale e kërkuar sipas pikës 2.3.8 të DST-ve është 7-15 ton.

- Mjeti kamion vetëshkarkues me targë AA754HV rezulton me masë maksimale 18 ton ndërkohë masa maksimale e kërkuar sipas pikës 2.3.8 të DST-ve është 7-15 ton.

- Mjeti kamion vetëshkarkues me targë AA481MG rezulton me mase maksimale 26 ton ndërkohë masa maksimale e kërkuar sipas pikës 2.3.8 është 7-15 ton.

**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë.

Në kushtet si më sipër, dhe në funksion të zbatimit në mënyrë literale të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar OE “V.” ShPK duke shpallur përfundimisht fitues operatorin ekonomik të rradhës, i cili i plotëson të gjitha kriteret e DST-ve, edhe pse realizimi i punëve do të kryej me një vlerë më të lartë monetare.

Në kushtet kur për zbatimin e një kontrate publike, nga Autoriteti Kontraktor, kontraktohet një operator ekonomik i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, efektivisht ky veprim mbart gjithashtu një risk potencial të shtuar për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar.

Nga kualifikimi i gabuar i OE “V.” ShPK, nisur nga fakti i mungesës së plotësimin të të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, veprimet e KVO-së kanë shkaktuar kontraktimin në kushte paligjshmërie të vlerës 5,909,640 lekë pa TVSh, vlerë e cila përbën një shpenzim të njësisë, në mungesë të një menaxhimini me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

Veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, janë **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, 1. O.I, 2. M.ZH, 3. S.M.**

*Për sa është trajtuar më lart është përgatitur Projekt Raporti i Auditimit i dërguar në subjekt (Bashkia Maliq) mbi të cilin, ky i fundit, nëpërmjet shkresës nr. 6464/1, datë 02.02.2024, protokolluar në KLSH me nr. 863/6, datë 05.02.2024, ka observuar, kryesisht në të njëjtën mënyrë si në fazën e dorëzimit të akt-konstatimeve, si më poshtë:*

**Pretendim i subjektit:**

*Autoriteti Kontraktor Bashkia Maliq ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemin asfaltim rrugë në njësitë administrative, faza III”, në lidhje me hartimin dhe dokumentimin e kriterëve, njësisia e prokurimit bazuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”,*

VKM nr. 914, datë 29.11.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” neni 61, pika 2, është mbajtur proces-verbal ku janë argumentuar kërkesat në lidhje me kriteret e vendosura ë DST.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 12 operatorë ekonomik nga ku rezulton se ka patur pjesmarje të mjaftueshme për zhvillimin e procedurës dhe ka patut konkurrencë midis operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me disponimin e punonjësve bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, neni 26 “Kontrata për punë publike”, pika 8, për të vërtetuar se operatori ekonomik zotëron kapacitete teknike dhe profesionale me qëllim realizimin me sukses të procedurës, Autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorri ekonomik të ketë mesatarisht 12 punonjës për 3 muajt e fundit. Ky kriter është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik krijon besueshmëri dhe i jep Autoritetit kontraktor siguri se ka vazhdimisht një numur punonjësish të kualifikuar për realizimin e punimeve.

Në lidhje me procesin e vlerësimit saktësojmë se komisioni i vlerësimit të ofertave ka shpallur fitues Operatorin ekonomik me vlerë me të ulët. Operatori ekonomik i shpallur fitues i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. Lidhur me kërkesat për kapacitetin teknik për disponueshmërinë e mjeteve, KVO ka vlerësuar se operatori ekonomik fitues ka paraqitur mjetet në sasinë e kërkuar nga Aautoritet kontraktor.

Nga ana e KVO është bërë vlerësimi dhe kualifikimi i operatorit ekonomik pasi mjetet e paraqitura plotësojnë tonazhin sipas kapacitetit mbajtës të tyre..

#### **Qëndrimi i grupit të KLSH:**

Për sa më sipër, observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova, një arsyetim tekniko-ligjor apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

### **3-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza 2, si vijon:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, etj., konkretisht si vijon:

#### **Të dhëna mbi objektin e prokurimit:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza 2”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhëri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-46009 -10 – 14 - 2022 Urdhëri nr.113, datë 12.10.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese (DST)</b> Urdhëri nr. 113,datë 12.10.2022 7. G.F 8. G.G 9. M.ZH	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. G.F 2. G.G 3.M.ZH	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhëri nr. 545 , datë 12.10.2022 1. BQ 2. S.H 3. I.P
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 23,652,298 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 19,000,000 lekë Operatori Fitues: “A ” SHPK		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 4,652,298 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 01.11.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Të ardhurat e Bashkisë Maliq		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër 4 B/OE b) S’kualifikuar 2 B/OE c) Kualifikuar 2 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 4 javë			

<b>10.Ankimime</b> <b>AK-s'ka/ka;</b> <b>APP-s'ka/ka;</b> <b>KPP-s'ka/ka</b>	<b>11. Përgjigje Ankesës nga AK</b>	<b>12.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP;</b>
---	-------------------------------------	--

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

***Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:***

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, projekt-preventivi është hartuar nga punonjësit e DPZHT Bashkia Maliq (zyra e projekteve). Me urdherin e prokurimit nr. 113 datë 12.10.2022 të nxjerrë nga titullari i AK z. G.T, është përcaktuar fondi limit në total 23,652,298 lekë pa TVSh, i cili do të likujdohet në tre evite, konkretisht me parashikimin: 3,222,175 lekë në vitin 2022, 12,888,700 lekë në vitin 2023 dhe 12,271,883 lekë në vitin 2024. Forma e procedurës e tenderit “E hapur” me mjete elektronike ku është përcaktuar NjP. Gjithashtu me urdhërin nr. 545, datë 12.10.2022 është përcaktuar KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 01.11.2022.

-Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se pavarësisht preventivit të objektit, nga ana e AK nuk është ngritur një komision për të materializuar në një dokument të posaçëm fondin limit. Në rastin konkret, edhe pse puna e komisionit për përlogaritjen e fondit limit do të ishte e kufizuar, minimalisht duhet të konfirmonte saktësinë dhe përlogaritjen e çmimeve të pasqyruara në preventiv apo nevojën për korrigjimin e tyre. Referuar nenit 76, pika 2 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”. Në lidhje me këtë situatë sjellim në vëmendje të titullarit të AK faktin se në nenin 73, pika 1 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 përcaktohet se “*Titullari i autoritetit/entit kontraktor mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e autoritetit/entit kontraktor, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së dhe është përgjegjës për...ngritjen e njësisë së prokurimit, komisioneve dhe/ose grupeve të punës, sipas rastit, të përfshira në procesin e prokurimit*”.

***AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:***

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “*për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*” datë 14.10.2022 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se: Përgjithësisht, dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 78, pika 2 “*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” ku citohet se: “*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*”.

**Grupi i auditimit konkludon se**, për rastin konkret, nuk konstatohen kërkesa apo kritere të ekzagjeruara, çka krijon kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve eventuale, si dhe mundëson trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit në funksion të konkurrencës.

***AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:***

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “*Për prokurimin publik*”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE në datën 04.11.2022 vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	“V” ShPK	15,300,300	Kualifikuar/skualifikuar
2	“N” ShPK	18,987,500	Kualifikuar/skualifikuar
3	“A” ShPK	19,000,000	Kualifikuar/Fituesi
4	“D” ShPK	19,501,600	Kualifikuar

Referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka kualifikuar 4 (katër) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë ka shpallur fitues OE “A” ShPK, si rezultat i zhvillimit të procedurës në fazat si vijon:

Pas përfundimit të fazës së parë, atë të shqyrtimit dhe vlerësimit të Dokumentacionit Ligjor Tekniko Ekonomik KVO ka analizuar dhe vlerësuar si vijon:

Gjatë shqyrtimit të ofertës ekonomike anëtarët e KVO konstatuan se oferta e operatorit ekonomik të kualifikuar nuk ka gabime aritmetike.

Pas kësaj nga KVO është përlllogaritur nëse oferta rezulton me çmim anomalisht të ulët dhe konstatoi se, oferta ekonomike është anomalisht e ulët. Për këtë arsye KVO i ka dërguar operatorit ekonomik “V.” ShPK kërkesë për sqarim dhe justifikim çmimi, me shkresën nr. 5677 prot, datë 02.11.2022 dhe në mënyrë elektronike. Operatori ekonomik ka dhënë sqarimin për justifikim çmimi me shkresë nr. 5677/1 prot, datë 03.11.2022.

Komisioni në bazë të informacionit të paraqitur, ka vlerësuar anën ekonomike të metodës së procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara nga operatorët, zgjidhjet teknike të ofruara apo kushte favorizuese që kanë operatorët për furnizimin e mallrave apo shërbimeve si dhe origjinalitetin e mallrave apo shërbimeve të propozuara dhe pranon që ofertat është e rregullt në të gjitha elementët e saj.

-Në vijim, pas shqyrtimit të dokumentacionit provues në lidhje me vetëdeklarimet e paraqitura nga OE të renditur të parët, për efekt të shpalljes së fituesit, ka rezultuar si vijon:

Oferta të kualifikuara:

1. “A” shpk
2. “D” shpk

Oferta të s’kualifikuara:

1.“V.” ShPK: Autoboti AA359HV, Grejderi AAMT55, Autobitmunatriçe AA595NN, Kamionçinë AA155NY, në dokumentat shoqëruese leja e qarkullimit rezulton mjet përpërdorim vetjak dhe jo për përdorim për të tretë, sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot datë 14.07.2022 në rastin e mjeteve me qera referuar dokumentacionit, mjetet nuk duhet të rezultojnë vetem për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretët.

Kamioni AA754HV mungon mjeti i deklaruar tek formulari permbledhes i vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te operatorit ekonomik.

Pra operatori ekonomik nuk siguron mjetet e nevojshme për realizimine punimeve.

2.“N” ShPK: Autoboti SH4498E, Kamioni veteshkarkues KO4982B, Autobitumatriçe AA230UL, Kamionçinë AA769KR, në dokumentat shoqëruese leja e qarkullimit rezulton mjet për përdorim vetjak dhe jo për përdorim për të tretë, sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot datë 14.07.2022 në rastin e mjeteve me qera referuar dokumentacionit, mjetet nuk duhet të rezultojnë vetem për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretët.

Kamioni AA769KR: Mungon Çertifikata per leje transporti te leshuar nga Bashkia.

Autobitumatriçe AA230UL: Çertifikata e kontrollit teknikeshte e skaduar (06.07.2022).

Pra operatori ekonomik nuk siguron mjetet e nevojshme për realizimine punimeve.



Në vijim, raporti përmbledhës është hartuar me datë 02.12.2022, raport i cili është konfirmuar dhe nga Titullari i AK z. G.T.

Midis OE “A” ShPK dhe AK është hartuar dhe nënshkruar kontrata nr. 6146 prot., datë 09.12.2022 me objekt: “Sistemim Asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza 2”, vlerë 19,000,000 lekë pa tvsh dhe me afat punimesh 4 javë nga lirimi i sheshit të ndërtimit.

Në këtë rast, grupi i auditimit vlerëson se KVO ka vepruar në përputhje me parashikimet e përcaktuara në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

#### 4-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Kuz Njësitë Administrative, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht si vijon:

##### Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Kuz Njësitë Administrative ”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-81083-12-04-2020 Urdhëri nr.132, datë 20.11.2020	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese (DST)</b> Urdhëri nr. 132 prot., datë 20.11.2020 10. G.F 11. G.G 12. S.K	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 7. G.F 8. G.G 9. S.K	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhëri nr. 544, datë 20.11.2020. 1. F.D 2. N.GJ 3. F.M <b>3/1 Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave</b> Urdhri nr. 568, datë 10.12.2020 4. K.M 5. G.M 6. M.ZH
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 18,886,937 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 12,032,150 lekë Operatori Fitues: <b>-BOE “V” ShPK</b>	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 6,854787 lekë	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 13.01.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Të ardhurat e Bashkisë Maliq	<b>9. Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër 8 B/OE b) S’kualifikuar 5 B/OE, c) Kualifikuar 3 B/OE	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 3 muaj			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ka; KA 1 (një për DST) APP-s’ka/ka; JO KPP-s’ka/ka, JO	11. Përgjigje Ankesës nga AK: PO <b>1-“2N”</b> ShPK më datë 10.12.2020, kthyer përgjigje më dt.17.12.2020, duke mos marrë parasysh ankesën.	<b>12.Lidhja e kontratës</b> Datë: 16.03.2021.	

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

**Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:**

**Titulli i gjetjes 3:** Hartimi i projekt/preventivave nga punonjësit e bashkisë, të cilat nuk kanë licensë profesionale për kategoritë përkatëse.

##### **Situata:**

Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq është hartuar projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit

rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit: Ing. M.ZH, Ing S.K dhe Ark. G.K. Referuar formimit profesional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, konstatohet se vetëm Ing. M.ZH është e pajisur me licencën e projektimit nr. K. 2357. Gjithsesi licenca e znj. M.ZH është për projektim të kategorive 3, 6 dhe 7, ndërkohë që për objektin “KUZ” kërkohet licenca e kategorisë 5 (Projektues vepra hidraulike).

#### **Kriteri:**

Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 5 sipas të cilit: “Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.

*Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit”.*

#### **Ndikimi/Efekti:**

Hartimi i projektit të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.

#### **Shkaku:**

Kjo situatë ka ndodhur pasi Bashkia Maliq, me qëllim shmangien e shpenzimeve, ka angazhuar punonjësit e saj për hartimi i projekt/preventivave duke mos kryer një procedurë prokurimi të mirëfilltë për përfitimin e objektit i cili mund të kryej nga specialistë/inxhinierë të licencuar.

#### **Rëndësia: I lartë**

#### **Rekomandim:**

Titullari i Bashkisë Maliq, në lidhje me investimet që do të kryhen në të ardhmen, për të cilat është i nevojshëm hartimi paraprak i një projekt-preventivi, të marrë masa që ky i fundit të hatohet nga specialistë të pajisur me licencë profesionale për kategorinë përkatëse.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër (gjetja nr. 3), të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, **ngarkohet me përgjegjësi:** znj. M.ZH, z. S.K, z. G.K si dhe znj. E.J.

**Së dyti**, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se pavarësisht preventivit të objektit, nga ana e AK nuk është ngritur një komision për të materializuar në një dokument të posaçëm fondin limit. Në rastin konkret, edhe pse puna e komisionit për përlogaritjen e fondit limit do të ishte e kufizuar, minimalisht duhet të konfirmonte saktësinë dhe përlogaritjen e çmimeve të pasqyruara në preventiv apo nevojën për korrigjimin e tyre. Referuar nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Në lidhje me këtë situatë sjellim në vëmendje të titullarit të AK faktin se në nenin 56 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 përcaktohet se “Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrin të prokurimit...”. **AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriteve”:**

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e kriteve të pranimit/kualifikimit” datë 04.12.2020 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”.

**Së pari**, konstatohet se jo të gjitha kriteret e veçanta për kualifikim, pjesë e dokumenteve të tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, të cilat janë kërkuar me qëllim përmbushjen e kapaciteteve

teknike nga OE (liçenca, nr. punonjësish, vjetërsia, ISO, mjete, pajisje, etj.), janë të argumentuara. Mosveprim ky i fundit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 61, pika 2** “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të **argumentohen teknikisht dhe ligjërish** dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Në përgjithësi, edhe pse jo të gjitha kërkesat apo kriteret e përcaktuara nga NjP janë të ekzagjeruara, kjo e fundit për hartimin dhe argumentimin e tyre është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik në referim të grafikut, volumeve të punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter apo liçence të kërkuar (psh. për cilat zëra konkretë të punimeve të preventivuara kërkohet një liçencë, mjet, pajisje apo ISO e caktuar, etj.).

**Së dyti**, konstatohet se tre prej kriterëve të përcaktuara nga NjP **nuk** janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Konkretisht NjP ka përcaktuar se, ndër të tjera, kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë, si vijon:

- “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 6 (gjashtë) Muratorë dhe 6 (gjashtë) Hidraulikë të pajisur me Çertifikatë për sigrimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik”.

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, “pajisja me Çertifikatë për sigrimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik” shërben për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, pra nuk është në përputhje me objektin e prokurimit të ndërtimit të KUZ pasi në preventivin e këtij të fundit ekzistojnë vetëm punime ndërtimi dhe nuk ka punime elektrike. Referuar dispozitave të ISHTI, dëshmitë jepen për kategoritë: Naftën dhe Gazin Natyror, Pajisje nën Presion, Instalime Elektrike dhe Laborator të Kontrolleve. Në kushtet kur projekt-preventivi nuk ka asnjë pajisje në proces pune që ka të bëjë me rrjetin, apo skemat elektrike, atëherë është e qartë se kjo dëshmi e sigurimit teknik nuk ndikon në vlerësimin e kualifikimit të stafit. Nga ana tjetër, Çertifikata për sigrimin teknik ose Dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik nuk zëvendëson në asnjë rast dëshminë profesionale (trajnimi etj.) të punonjësit, të cilën AK në rastin konkret nuk e ka kërkuar por që do të ishte e mjaftueshëm për natyrën e kontratës.

- “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 6 (gjashtë) Muratorë, 1(një) Hekurkthyes dhe 6 (gjashtë) Hidraulikë të pajisur me kontratë pune të firmosur përpara noterit (e vlefshme)”.

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, nënshkrimi i kontratave të punës përpara noterit nuk është një akt i detyruar ligjërish as për punëdhënësin dhe as për punëmarrësin. Jo vetëm kaq, por Kodi i Punës, sipas të cilit regullohen marrëdhëniet midis palëve në rastin konkret, përcakton në nenin 21, pika 1 se: “kontrata e punës mund të lidhet ose ndryshohet me gojë ose me shkrim”. Prezenca e punonjësve të caktuar në listpagesat e një OE është një fakt i mjaftueshëm që ky i fundit të provojë disponimin e tyre. Në rastin konkret, kërkesa për një kontratë të shkruar, aq më tepër përpara noterit, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

- “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet që: Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj”.

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, kërkesa që në kontratën e qirasë të specifikohet objekti i kontratës (procedurës së prokurimit), është një kërkesë e ekzagjeruar dhe jo e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Një kërkesë e tillë, e paarsyeshme, do të vështirësonte marrëdhëniet midis OE duke rritur pa asnjë efekt shpenzimet e tyre (përsëritje e panevojshme e kontratave të qirasë). Paraqitja e një kontrate qiraje me afat të

vlefshëm ku të përcaktohen mjetet e marra me qira është një akt i mjaftueshëm që OE të provojë disponimin e tyre, duke e shoqëruar këtë të fundit me deklaratën e mosangazhimit në kontrata të tjera.

**Si konkluzion**, kriteret e sipërcituara, rezultojnë në shkelje të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5, "kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...".

Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin që kriteret e sipërcituara mund të sjellin kufizimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës. Fakt, ky i fundit, i vërtetuar në procedurën konkrete për sa kohë KVO, duke u mbështetur në kriteret e panevojshme të përcaktura nga NjP, ka skualifikuar 2 (dy) OE, konkretisht BOE "F.SH" ShPK si dhe "N" ShPK. Nga kualifikimi dhe shpallja fitues i BOE "V" ShPK dhe skualifikimi duke u mbështetur në kriteret e panevojshme të OE "N" ShPK, veprimet e NjP-së, të cilat kanë ndikuar në vendimin e KVO-së, edhe pse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, kanë shkaktuar kryerjen e punimeve me një vlerë më të lartë për 1,435,490 lekë (12,032,150–10,596,660) si diferenca midis ofertave të OE në klasifikimin.

**Në përfundim**, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohet me përgjegjësi:** Njësia e prokurimit me përbërje: z. G.F, znj. G.G dhe z. S.K.

**Neni 26, pika 5 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** ku ndër të tjera, përcaktohet se: "kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...".

**Neni 46, pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** "kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik".

**Neni 61, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** "Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".

**AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":**

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin "Për prokurimin publik".

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 8 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE në datën 02.02.2021 vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	"I" ShPK	9,065,702	Skualifikuar
2	"N" ShPK	10,596,660	Skualifikuar
3	"V" SHPK	12,032,150	Kualifikuar/Fituesi
4	"F.SH" SHPK	12,500,300	Skualifikuar

5	“A” ShPK	13,446,860	Kualifikuar
6	“N” ShPK	13,715,809	Skualifikuar
7	“A” ShPK	15,734,950	Skualifikuar
8	“B” ShPK	16,459,630	Kualifikuar

Referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka kualifikuar 3 (tre) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues BOE “V.” & “XH” & “A” SHPK, ka s’kualifikuar 5 (pesë) B/OE të tjerë me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. *“Operatori Ekonomik “I.” ShPK: Mjetet e paraqitura (Grejder, Rul, Fadrome AA613DL, Betoniere, Kamioncinë AA084YX) janë deklaruar edhe në kontrata të tjera fituese me Bashkinë Maliq .*

2. *Operatori Ekonomik “N” ShPK:*

*-Mungojnë kontratat e noterizuara për punonjësit e specializuar manovrator, murator, hidraulik, hekurkthyes.*

*-Për punonjësit hidraulik dhe murator mungojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik*

*-Mjetet e marra me qira nuk kanë të specifikuar në kontratë në qirasë objektin e prokurimit “K.U.Z Njësitë Administrative”*

3. *BOE “F” SHPK:*

*-Mungojnë kontratat e noterizuara për punonjësit e specializuar manovrator, murator, hidraulik, hekurkthyes për të dy operatoret ekonomik pjesëmarrës.*

*-Për OE “SH” shpk mungojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik të punonjësve.*

*- Mjetet e marra me qira nuk kanë të specifikuar në kontratën e qirasë objektin e prokurimit “K.U.Z Njësitë Administrative.*

4. *Operatori Ekonomik “N” ShPK:*

*-Mjetet e marra me qira nuk kanë të specifikuar në kontratën e qirasë objektin e prokurimit “K.U.Z Njësitë Administrative.*

*-Ka deklaruar të njejtit punonjës si në kontratat e tjera të shpalluara fituese me Bashkinë Maliq.*

5. *Operatori Ekonomik “A” ShPK:*

*-Nuk ka punë të ngjashme në masën e kërkuar.*

*-Nuk siguron numrin e kërkuar të punonjësve për tre muajt e fundit.*

*-Mungojnë kontratat e punës për punonjësit e specializuar.*

*-Nuk ka punonjës hekurkthyes.*

*-Mjetet e marra me qira nuk kanë të specifikuar në kontratën e qirasë objektin e prokurimit “K.U.Z Njësitë Administrative.*

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime të pajustificuara të cilat bien ndesh me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht si vijon:

**Titulli i gjetjes 4:** *Shkelja e afateteve ligjore gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.*

**Situata:**

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 13.01.2021, KVO ka pasur detyrimin ligjor që vlerësimi i tyre të kryhej brenda datës 28.01.2022 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave është kryer në datën 02.02.2022, çka do të thotë, jashtë afatit të përcaktuar.

**Kriteri:**

Neni 66, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla”.

**Ndikimi/Efekti:**

Shkelja e afateve në procedurat e prokurimit, veçanërisht gjatë fazës së vlerësimit të ofertave është problematike. Këto vonesa jo vetëm që mund të shkaktojnë shqetësime për ofertuesit, por ato mund të krijojnë hapësira për praktika abuzive ose të paktën të krijojnë një perceptim të dyshimtë dhe të dëmtojnë sigurinë dhe besimin në praktikën e prokurimit publik të AK-së dhe të gjithë sistemit të prokurimit publik.

**Shkaku:**

Kjo situatë ka ndodhur pasi nga anëtarët e Komisioni të Vlerësimit të Ofertave është neglizhuar zbatimi i afateve të përcaktuara për fazën e vlerësimit.

**Rëndësia: I lartë****Rekomandim:**

Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, të marrin masa që vlerësimi i ofertave të kryhet brenda afateve të përcaktuara nga aktet nënligjore në varësi të llojit të procedurës.

**Së dyti**, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë (BOE) e cila përfundimisht është shpallur fituese, BOE “V” ShPK, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar. Konkretisht mangësitë e BOE “V” ShPK, të papasqyruar në procesverbalin e vlerësimit të datës 02.02.2021, janë si vijon:

**1-**Në lidhje me formimin e Bashkimit të Operatorëve është paraqitur prokura e përfaqësimit si dhe marrëveshja e bashkëpunimit, në të cilën janë përcaktuar përqindjet e pjesëmarrjes, por nuk është paraqitur një preventiv ose një akt ku të përcaktohet saktësisht pjesa e punës dhe elementet konkrete (zërat e preventivit) që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, sikundër kërkohet nga neni 74, pika 1 dhe 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Në mungesë të këtij detajimi, KVO e ka të pamundur të vlerësojë nëse kërkesat profesionale dhe teknike janë apo jo të përmbushura nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen dhe punën konkrete takuese.

**2-**Anëtar i BOE “A” ShPK nuk plotëson kriterin e veçantë të përcaktuar në pikën 2.1 gërma “gj” të shtojcës 12, të DST, sipas të cilës kërkohet “*Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*”. Konkretisht OE nuk ka paraqitur vërtetim që konfirmon shlyerjen detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike pën muajin Nëntor 2020. Në lidhje me këtë mangësi specifike, ndër të tjera, neni 26, pika 7/c e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 përcakton specifikisht se: “*Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik...*”.

**3-**Në lidhje e mjetet, nga 2 kamiona vetshkarkues me kapacitet 7-15 ton të kërkuar nga AK, nga BOE nuk është deklaruar (paraqitur) asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar, pavarësisht se kjo mangësi mund të vlerësohet si devijim i vogël.

**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë.

Në kushtet si më sipër, dhe në funksion të zbatimit në mënyrë literale të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar BOE “V” ShPK duke shpallur përfundimisht fitues operatorin ekonomik të rradhës, i cili i plotëson të gjitha kriteret e DST-ve, edhe pse realizimi i punëve do të kryej me një vlerë më të lartë monetare.

Në kushtet kur për zbatimin e një kontrate publike, nga Autoriteti Kontraktor, kontraktohet një operator ekonomik i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, efektivisht ky veprim mbart gjithashtu një risk potencial të shtuar për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar.

Nga kualifikimi i gabuar i BOE “V” ShPK, nisur nga fakti i mungesës së plotësimin të të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, veprimet e KVO-së kanë shkaktuar kontraktimin në kushte paligjshmërie të vlerës 12,032,150 lekë pa TVSh, vlerë e cila përbën një shpenzim të njësisë, në mungesë të një menaxhimini me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

Në **përfundim**, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi** znj. F.D , znj. N.GJ dhe znj. F.M, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

*Për sa është trajtuar më lart është përgatitur Projekt Raporti i Auditimit i dërguar në subjekt (Bashkia Maliq) mbi të cilin, ky i fundit, nëpërmjet shkresës nr. 6464/1, datë 02.02.2024, protokolluar në KLSH me nr. 863/6, datë 05.02.2024, ka observuar, kryesisht në të njëjtën mënyrë si në fazën e dorëzimit të akt-konstatimeve, si më poshtë:*

**Pretendim i subjektit:**

*Në lidhje me procesin e vlerësimit saktësojmë se komisioni i vlerësimit të ofertave ka shpallur fitues Operatorin ekonomik me vlerë me të ulët nga ofertat e kualifikuara . Operatori ekonomik i shpallur fitues i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. Lidhur me kërkesat për kapacitetin teknik për disponueshmërinë e mjeteve, KVO ka vlerësuar se operatori ekonomik fitues ka paraqitur mjetet në sasinë e kërkuar nga Autoritet kontraktor . Nga ana e KVO është bërë vlerësimi dhe kualifikimi i operatori ekonomik pasi mjetet e paraqitura plotësojnë tonazhin sipas kapacitetit mbajtës të tyre.*

**Qëndrimi i grupit të KLSH:**

Për sa më sipër, observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova, një arsyetim tekniko-ligjor apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Edhe në rast se nga KVO konkludohet se mangësitë e operatorëve ekonomikë përbëjnë “devijime të vogëla”, këto të fundit duhet gjithsesi të pasqyrohen në një procesverbalin e vlerësimit.

***c-Në lidhje me nënshkrimin e kontratës.***

**Titulli i gjetjes 5:** *Nënshkrimi i kontratës së sipërmarrjes jo nga të gjitha palët e përcaktuara në aktet nënligjore.*

**Situata:**

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se midis palëve është lidhur kontrata e sipërmarrjes me nr. 1717 prot., datë 16.03.2021, e cila është nënshkruar nga titullari i AK dhe nga administratori i OE “V” ShPK, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të anëtarëve të BOE, por jo nga anëtari tjetër i bashkimit.

**Kriteri:**

Neni 74, pika 2 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 sipas të cilës, në mënyrë eksplicite, ndër të tjera citohet: “Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi”.

**Ndikimi/Efekti:**

Mungesa e nënshkrimit në kontratë të një prej anëtarëve të një BOE eventualisht shmanë përgjegjësinë (legjitimitetin pasiv) e këtij të fundit në rast konflikti gjyqësor mbi përmbushjen e detyrimeve.

**Shkaku:**

Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e një interpretimi të gabuar të akteve nënligjore, që AK ka kryer, në lidhje me përfaqësimin e palëve.

**Rëndësia: I mesëm**

**Rekomandim:**

Autoriteti Kontraktor (Bashkia Maliq), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, të marrë masa që, në rast se fitues i procedurës do të jetë një bashkim operatorësh ekonomik, kontrata të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të BOE.

***ç-Në lidhje me shqyrtimin e ankesave të OE.***

Pas publikimit të njoftimit të kontratës dhe DST, në lidhje me procedurën e sipërcituar, në datën 10.12.2020 ka paraqitur ankesë (nr. 6176 prot.) OE “2 N” ShPK, duke kërkuar, në mënyrë të përmbledhur, reduktimin e kritereve teknike (mjete, punonjës) të përcaktuara nga AK.

Në zbatim të LPP-së, Titullari i AK, në datën 10.12.2020 ka marrë vendimin (urdhërin) nr. 568 prot., me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimin të procedurës dhe ka caktuar KShA të përbërë nga tre punonjës (z. K.M, znj. M.ZH dhe znj. G.M .

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me ankimin, rezulton se, pas shqyrtimit, KShA, për “2” ShPK, ka kthyer përgjigje me nr. 6176/4 prot., datë 17.12.2020, duke mos pranuar ankesën.

**Si konkluzion**, në lidhje me shqyrtimin e ankesës, janë respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

**5-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara, si vijon:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

**Të dhëna mbi objektin e prokurimit:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhëri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF -05176-09-14-2021 Urdhëri nr. 102, datë 09.09.2021	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)</b> Urdhëri nr. 102, datë 09.09.2021 1.G.F 2.G.G 3.M.ZH	<b>2.Njësia e Prokurimit</b> 1.G.F 2.G.G 3.M.ZH	<b>3Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhëri nr. 328, dt. 09.09.2021. 1. F.D 2. S.M 3. M.K Ndryshuar me Urdhërin nr. 438 date 30.09.2021. 1. B.Q 2. S.M 3. M.K
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 23.946.248 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 15,161,265 lekë Operatori Fitues: BOE “V” & “A” shpk		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 8.784.983 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 30.09.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Ministria e Financave.		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër 7 B/OE b) Skualifikuar 3 B/OE, c) Kualifikuar 4 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 4 muaj			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ka	<b>11. Lidhja e kontratës:</b> Nr. 5707, datë 27.10.2021		<b>12.Përgjigje Ankesës nga</b> APP apo <b>KKP;</b>



**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

***Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:***

***Së pari***, me shkresën nr. 12705/1 prot. datë 19.07.2021 Ministria e Financave ka përcjellë Bashkisë Maliq shkresën për miratimin e fondeve për njoftimin e fituesve për strehimin në këtë njësi vendore.

Nga të dhënat e dosjes së prokurimit konstatohet se, project-preventivi është hartuar nga punonjësit e zyrës së urbanistikës Bashkia Maliq (zyra e projekteve).

Me urdhrin e prokurimit nr. 102, datë 09.09.2021 të nxjerrë nga z. G.T (personi i autorizuar) është përcaktuar fondi limit 23.946.248 lekë pa TVSh, forma e procedurës e tenderit “E hapur” me mjete elektronike ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 328, datë 09.09.2021, ndryshuar me urdhërin 438 date 30.09.2021 njësia KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 30.09.2021.

***AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:***

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “*për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit*” datë 14.09.2021 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se: Përgjithësisht, dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 78, pika 2 “*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” ku citohet se: “*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*”.

Gjithsesi, edhe në këtë procedurë, në disa raste, në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me Ligjin nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” ndryshuar, konkretisht:

1- Nga Njësia e Prokurimit në datën 20.09.2021 është mbajtur një proces verbal shtojce dhe është bërë një ndryshim në DST në pikën 2.3.4 Në lidhje me numrin total të punonjësve të kërkuar nga 48 punonjës të kërkuar për 4 muaj fillimisht në 30 punonjës. Duke marrë shkas nga ky ndryshim specialisti i fushës në njësinë e prokurimit nuk e ka argumentuar sic duhet numrin total të punonjësve sipas zbërthimit të manualit miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”.

2- Në pikën 2.3.7 të DST njësia e prokurimit ka kërkuar mjetin si më poshtë:

Kamion vetshkarekues nga 7-15 ton 1 copë Pronësi ose me qera

Në përshkrimin e kamionit nga 7-15 ton nga njësia nuk është përcaktuar nëse është pesha e kamionit bosh apo pesha masa maksimale e lejuar sipas lejës së qarkullimit.

Aplikimi i kritereve në mënyrë jo të mirëargumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NjP.

***AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:***

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “*Për prokurimin publik*”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE në datën 08.10.2021 vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	E.	Ska ofertë	Skualifikuar
2	N.	15,086,136	Skualifikuar
3	BOE "V" dhe "A"	15,161,265	Kualifikuar/Fituesi
4	A.	18,543,395	Kualifikuar
5	I.	19,675,302	Kualifikuar
6	G.	20,812,935	Kualifikuar
7	L.	21,525,598	Skualifikuar

Referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka kualifikuar 4 (katër) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues BOE "V" & "A" ShPK, ka s'kualifikuar 3 (pesë) B/OE të tjerë me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. OE "E" ShPK: -Operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë asnjë dokumentacion per te dëshmuar se i plotëson kriteret e përgjithshme dhe te veçanta te kualifikimit.
2. OE "N" ShPK: -Nga AK është kërkuar në pikën 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një Deklarate (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete: Inxhinier Ndertimi

"Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë:

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë  
- Sipas Deklaratës së paraqitur nga Opeeratori Ekonomik "N" shpk, Drejtuesi Teknik Ing. Ndërtimi A. K. nuk është i përfshirë në Licensën e shoqërisë.
3. OE "L." ShPK: -Nga AK është kërkuar në pikën 2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 16 (gjashtembdhjete) punonjës të kualifikuar si më poshtë: Murator (5); Elektriciist (1); Karpentier (5); Suvaxhinj (5); "Për punonjësit e mësipërm .në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë:
  1. Kontrata e punës e vlefshme;
  2. Çertifikate per sigrimin teknik te punonjesve (e vlefshme); Ose Deshmi kualifikimi e sigurimit teknik.

Në dokumentat e paraqitura për kualifikim (Shtojca 8), operatori nuk ka paraqitur punonjësit e kualifikuar murator, elektriçist, karpentier dhe suvaxhinj të cilët nëvojiten për përmbushjen e procedurës së prokurimit.

Në vijim, njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 11.10.2021, për të cilin rezulton të mos ketë patur ankesa. Raporti përmbledhës është mbajtur me datë 19.10.2021, raport i cili është konfirmuar dhe nga Titullari i AK z. G.T.

Midis BOE "V" ShPK dhe AK është hartuar dhe nënshkruar kontrata nr. 5707 prot., datë 27.10.2021 me objekt: "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara" me vlerën 15,161,265 (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh. me afat punimesh 4 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë (OE) e cila përfundimisht është shpallur fituese, konstatohet se të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar. Në këtë rast, grupi i auditimit vlerëson se KVO ka vepruar në përputhje të plotë me parashikimet e përcaktuara në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**6-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim KUZ Vloçisht faza 2, si vijon:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Ndërtim KUZ Vloçisht faza 2”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për propozim” REF-90534-03-19-2021 Urdhëri nr. 26, datë 12.03.2021	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese (DST)</b> Urdhëri nr. 26 prot., datë 12.03.2021 13. G.F 14. G.G 15. M.ZH	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 10. G.F 11. G.G 12. M.ZH	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhëri nr. 106/2, datë 12.03.2021. 1. F.D 2. N.GJ 3. O.I
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 8,333,049 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 6,274,200 lekë Operatori Fitues: <b>OE “A” ShPK</b>		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 2,058,849 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 05.04.2021	<b>8. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e bashkisë Maliq		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër 6 <b>B/OE</b> b) S’kualifikuar 5 <b>B/OE</b> , c) Kualifikuar 1 <b>B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 1 muaj</b>			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ka; <b>JO</b> APP-s’ka/ka; <b>JO</b> KPP-s’ka/ka; <b>JO</b>	11. Përgjigje Ankesës nga AK: <b>JO</b>		<b>12.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP; JO</b>

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

**a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

**Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:**

**Së pari**, AK Bashkia Maliq pas reformës territoriale, nga ish-komunat, ka trashëguar ndër të tjera edhe projektin e zbatimit në lidhje me objektin e sipërcituar të prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, në këtë rast, konstatohet se pavarësisht projektit apo preventivit paraprak të objektit, nga ana e AK Bashkia Maliq, është ngritur një komision (grup pune) për të rishikuar projekt-preventivin dhe materializuar në një dokument të posaçëm fondin limit, në zbatim të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”. Në lidhje me këtë situatë titullarit i AK ka vepruar në përputhje nenin 56 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 përcaktohet se “*Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit...*”.

**(NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:**

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “për përcaktimin/hartimin e kriterëve të pranimit/kualifikimit” datë 19.03.2021 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit “Për prokurimin publik”.

**Së pari**, konstatohet se jo të gjitha kriteret e veçanta për kualifikim, pjesë e dokumenteve të tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, të cilat janë kërkuar me qëllim përmbushjen e kapaciteteve teknike nga OE (licenca, nr. punonjësish, vjetërsia, ISO, mjete, pajisje, etj.), janë të argumentuara. Mosveprim ky i fundit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 61, pika 2** “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Në përgjithësi, edhe pse jo të gjitha kërkesat apo kriteret e përcaktuara nga NjP janë të ekzagjeruara, kjo e fundit për hartimin dhe argumentimin e tyre është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik në referim të grafikut, volumeve të punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter apo licençe të kërkuar (psh. për cilat zëra konkretë të punimeve të preventivuara kërkohet një licencë, mjet, pajisje apo ISO e caktuar, etj.).

**Së dyti**, konstatohet se një prej kriterëve të përcaktuara nga NjP **nuk** është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Konkretisht NjP ka përcaktuar se, ndër të tjera, kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë, si vijon:

“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 2 (dy) Muratorë dhe 4 (katër) Hidraulikë të pajisur me Çertifikatë për sigrimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik”.

Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, “pajisja me Çertifikatë për sigrimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik” shërben për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, pra nuk është në përputhje me objektin e prokurimit të ndërtimit të KUZ pasi në preventivin e këtij të fundit ekzistojnë vetëm punime ndërtimi dhe nuk ka punime elektrike. Referuar dispozitave të ISHTI, dëshmitë jepen për kategoritë: Naftën dhe Gazin Natyror, Pajisje nën Presion, Instalime Elektrike dhe Laborator të Kontrolleve. Në kushtet kur projekt-preventivi nuk ka asnjë pajisje në proces pune që ka të bëjë me rrjetin, apo skemat elektrike, atëherë është e qartë se kjo dëshmi e sigurimit teknik nuk ndikon në vlerësimin e kualifikimit të stafit. Nga ana tjetër, Çertifikata për sigrimin teknik ose Dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik nuk zëvendëson në asnjë rast dëshminë profesionale (trajnimi etj.) të punonjësit, të cilën AK në rastin konkret nuk e ka kërkuar por që do të ishte e mjaftueshëm për natyrën e kontratës.

**Si konkluzion**, kriteri i sipërcituara, rezultojnë në shkelje të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Kontrata për punë publike” pika 5, “kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”.

Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin që kriteret e sipërcituara mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.

**Në përfundim**, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohet me përgjegjësi**: Njësia e prokurimit me përbërje: G.F, G.G, M.ZH.

**Neni 26, pika 5 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** ku ndër të tjera, përcaktohet se: “kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të

LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...

**Neni 46, pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** “kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.

**Neni 61, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

**AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:**

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 B/OE, për të cilët, referuar procesverbaleve përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSh	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	“A” ShPK	6,274,200	Kualifikuar/Fituesi
2	“A” ShPK	5,747,140	Skualifikuar
3	“I” ShPK	5,555,550	Skualifikuar
4	“N” SHPK	5,109,993	Skualifikuar
5	“S” ShPK	6,676,119	Skualifikuar
6	“Sh” SHPK	(nuk ka ofertë)	Skualifikuar

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të datës 14.04.2021 si dhe njoftimit të fituesit, rezulton KVO-ja, pasi ka shpallur fitues OE “A. K. 2002” ShPK, ka s’kualifikuar 5 OE me arsyetimin si vijon:

1. OE “A” ShPK: -Mungon raporti i Auditit për bilancin 2019;
2. OE “I” ShPK: -Mungon raporti i Auditit për bilancin 2020; Punonjësit muratorë dhe dy hidraulike nuk kanë Deshmi të Kualifikimit të Sigurimit Teknik;
3. OE “N” ShPK: - Bilanci 2020 mungon; Një punonjes hidraulik me Deshmi të Kualifikimit të Sigurimit Teknik jashtë afateve të vlefshmerisë;
4. OE “S” ShPK: -Mungon vertetimi për likuidimin e Taksave vendore 2021; Një punonjes hidraulik nuk ka Deshmi të Kualifikimit të Sigurimit Teknik;
5. OE “Sh” ShPK: - S’kualifikuar nga sistemi sepse operatori ekonomik ishte paraqitur pas orarit përfundimtar të hapjes së ofertave.

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime të pajustificuara të cilat bien ndesh me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht si vijon:

**a)-** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë (OE) e cila përfundimisht është shpallur fituese, “A” ShPK, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar. Konkretisht mangësitë e OE “A. K. 2002” ShPK, të papasqyruar në procesverbalin e vlerësimit të datës 14.04.2021, janë si vijon:

1-Në lidhje e mjetet, nga 2 kamiona vetshkarkues me kapacitet 7-15 ton të kërkuar nga AK, nga OE është deklaruar (paraqitur) vetëm kamioni me targë AA 452 EA i cili e plotëson përfaqësisht kapacitetin e kërkuar.

2-Nga OE është deklaruar (paraqitur) si Autobitumatrice mjeti me targë AA 879 RY i cili, referuar dokumentacionit shoqërues, nuk është mjet Autobitumatrice por kamion për transport mallrash me kapacitet 3.5-7.5 ton i cili rezulton të jetë modifikuar si autobitumatrice.

**b)-** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit, grupi i auditimit vlerëson se KVO, për një mangësi minimale e cila mund të konsiderohej një devijim i vogël në kuptimin e ligjit “Për prokurimin publik”, ka skualifikuar 1 nga shoqëritë pjesëmarrëse në garë, e cila ka ofertuar me vlerë më të ulët se ajo e shpallur padrejtësisht fituese, konkretisht:

-Në lidhje me skualifikimin e OE “A.” ShPK, KVO ka arsyetuar se: “*mungon raporti i auditit për bilancin 2019*”. Referuar DST, AK ka kërkuar kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Në vlerësimin e këtij kriteri, KVO duhet të udhëhiqej nga qëllimi i mirëadministrimit të fondeve dhe të konsideronte faktin se:

**1- Neni 26, pika 7 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** citon se: “*Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a)kopje certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose*

*b)“kopje të deklaratave të xhiros vjetore”*. Në zbatim të kësaj pike, në momentin që një OE vërteton se nuk është për dy vite me rradhë me bilanc negativ (humbje), si dhe për më tepër kur vërteton edhe vlerën e xhiros të kërkuar nga AK, vërteton njëkohësisht se disponon të gjitha kapacitetet financiare dhe ekonomike të nevojshme për zbatimin e punëve.

**2-** Pika (a) e dispozitës së sipërcituar citon se: “*autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje certifikuara të një ose më shumë bilanceve...*”.

Pra, kërkesa për paraqitjen e *bilanceve të tre viteve të fundit* nuk është taksative dhe fikse sipas LLP por në kuptimin që, AK mund të kërkojë sipas diskrecionit të vet edhe vetëm një bilanc (të vitit të fundit) duke e vlerësuar kriterin e plotësuar, në harmoni dhe pa rënë ndesh dispozitave të LPP-së, në rast se bilanci ka vlera pozitive. Në rastin konkret, me qëllim plotësimin e kapaciteteve financiare dhe ekonomike OE “A.” ShPK ka paraqitur vërtetimin e xhiros të tre viteve të fundit, e cila është disa herë më e madhe se ajo e kërkuar nga AK si dhe kopje të bilanceve (me vlera pozitive) për vitet 2018, 2019, 2020 pavarësisht se ai i vitit 2019 nuk është i shoqëruar me raport. Për KVO dhe AK, në këtë rast, bilanci i konfirmuar i vitit 2020 (i fundit) si dhe vërtetimet e xhiros do të ishin mjaftueshëm për të krijuar bindjen se ofertuesi i përmbush kapacitetet financiare dhe ekonomike, çka është edhe qëllimi i këtij dokumentacioni.

**3-** Referuar nenit 1 të tij, qëllimi i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, është: “*...të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike...*”. Nga kjo dispozitë ligjore rezulton dukshëm i theksur fakti që në veprimtarinë-vendimmarrjen e tij AK duhet të ketë si qëllim parësor mirëpërdorim apo mirëadministrimin e fondeve publike.

KVO-ja, në njoftimin e fituesit, është shprehur në mënyrë të ngurtë për mosplotësimin e kriterit dhe nuk ka specifikuar konkretisht se cili është kriteri apo arsyeja që në rastin konkret përbën një ndryshim thelbësor të karakteristikave, kushteve apo kërkesave e të përcaktuara në dokumentet e tenderit që do të sillte një paaftësi zbatuese për natyrën dhe vlerën e kontratës.

-Në përfundim të vlerësimit të procedurës së prokurimit dhe shpalljes së fituesit, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në datën 22.04.2021 është hartuar Raporti Përmbledhës, në të cilin është specifikuar se për procedurën e vlerësimit “*nuk ka patur ankesa*” dhe më pas, në datën 12.05.2021, është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes midis palëve me nr. 2677 prot.

**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se, nuk janë vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë.

Në kushtet si më sipër, dhe në funksion të zbatimit të LPP-së, KVO-ja ose duhet të kishte skualifikuar të gjithë BOE pjesëmarrës në garë dhe më pas të rishikonte apo rivlerësonte kriteret me qëllim përsëritjen e garës ose midis operatorëve me mangësitë e sipërcituara, për të cilat duhet të argumentonte dhe dokumentonte fillimisht një vlerësim diskrecional në kuadër të një “devijimi të vogël”, të kualifikonte atë me vlerën më të ulët.

Nga kualifikimi i gabuar i OE “A” ShPK, nisur nga fakti i mungesës së plotësimin të të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, veprimet e KVO-së kanë shkaktuar kontraktimin në kushte paligjshmërie të vlerës 6,274,200 lekë pa TVSh, vlerë e cila përbën një shpenzim të njësisë, në mungesë të një menaxhimini me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

**Në përfundim**, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** znj. F.D, znj. N.GJ, znj. O.I, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

*Për sa është trajtuar më lart është përgatitur Projekt Raporti i Auditimit i dërguar në subjekt (Bashkia Maliq) mbi të cilin, ky i fundit, nëpërmjet shkresës nr. 6464/1, datë 02.02.2024, protokolluar në KLSH me nr. 863/6, datë 05.02.2024, ka observuar, kryesisht në të njëjtën mënyrë si në fazën e dorëzimit të akt-konstatimeve, si më poshtë:*

**Pretendim i subjektit:**

*-Në lidhje me kriterin e kërkuar për 2 muarotoë dhe 4 hidraulikë të pajisur me “Çertifikatë për sigurimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik”, sqarojmë se punonjësit me profesion Murator, hidraulik apo suvaxhi duhet të pajisen me Çertifikatë për sigurimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik për efekt të mbojtes gjatë punës për mos rënë në kontakt me ryma elektrike. Kjo është pjesë e detyrueshme në konstruksione të ndërtimeve dhe në ndërtime të rerja.*

*-Në lidhje me procesin e vlerësimit saktësojmë se komisioni i vlerësimit të ofertave ka shpallur fitues Operatorin ekonomik i cili plotëson kriteret e veçanta dhe ato të përgjithshme.*

**Qëndrimi i grupit të KLSH:**

Për sa më sipër, observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Në këto kushte grupi i auditimit i qëndron konstatimit dhe argumentimit të trajtuar për rastin konkret.

**7-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim stacion pompimi Vreshtas + linja, si vijon:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

**Të dhëna mbi objektin e prokurimit:**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim stacion pompimi Vreshtas + linja”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhëri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-38977-08-16-2022 Urdhëri nr.76 prot., datë 11.08.2022	<b>1.1 Specialistët e hartimit të kriterëve kualifikuese (DST)</b> Urdhëri nr.76 prot., datë 11.08.2022 1.G.F 2.G.G 3.M.ZH	<b>2.Njësia e Prokurimit</b> 1.G.F 2.G.G 3.M.ZH	<b>3Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhëri nr. 415 prot.,datë 11.08.2022. 1. I.P 2. B.Q 3. S.H

<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 52,083,781 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 39,708,355.8 lekë Operatori Fitues: OE “N” ShPK	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 12,375,425.2 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 01.09.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Grand.	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>13 B/OE</b> b) Skualifikuar <b>5 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>8 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 6 muaj		
<b>10. Ankimime</b> AK-s'ka/ka APP-s'ka/ka KPP-s'ka/ka	<b>11. Përgjigje Ankesës nga AK:</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP;</b>

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

***Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:***

***Së pari***, pasi AK Bashkia Maliq ka prokuruar nëpërmjet procedurës “blerje me vlerë të vogël” projektin e zbatimit në lidhje me objektin e prokurimit të sipërcituar, i cili është hartuar nga “N.S.” ShPK, me shkresën nr. 171/2 prot., date 14.04.2022 ka aplikuar për financimin e projektit në programin “Emergjencat Civile” 2022. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, me shkresën nr. 888/4 prot., datë 20.07.2022, bën me dije AK Bashkia Maliq për miratimin e kërkesës për financim referuar vendimit nr. 7, datë 13.07.2022 “Për miratimin e projekteve fituese” dhe vendimit nr. 6, datë 13.07.2022 “Për miratimin e AK për zbatimin projektit” duke akorduar fondin prej 59,999,636 lekë.

***Së dyti***, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se pavarësisht preventivit të objektit, nga ana e AK **nuk** është ngritur një komision për të materializuar në një dokument të posaçëm fondin limit. Në rastin konkret, edhe pse puna e komisionit për përllogaritjen e fondit limit do të ishte e kufizuar, minimalisht duhet të konfirmonte saktësinë dhe përllogaritjen e çmimeve të pasqyruara në preventiv apo nevojën për korrigjimin e tyre. Referuar nenit 76, pika 2 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Në lidhje me këtë situatë sjellim në vëmendje të titullarit të AK faktin se në nenin 73, pika 1 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 përcaktohet se “Titullari i autoritetit/entit kontraktor mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e autoritetit/entit kontraktor, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së dhe është përgjegjës për...ngritjen e njësisë së prokurimit, komisioneve dhe/ose grupeve të punës, sipas rastit, të përfshira në procesin e prokurimit”.

***AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:***

- Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit” datë 16.08.2022 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se: Përgjithësisht, dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”.

**Grupi i auditimit konkludon se**, për rastin konkret, nuk konstatohen kërkesa apo kritere të ekzagjeruara, çka krijon kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë



kandidatëve dhe ofertuesve eventuale, si dhe mundëson trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit në funksion të konkurrencës.

**AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:**

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit, konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 13 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE në datën 13.09.2022 vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	“I” & “T” ShPK	37,861,551	Skualifikuar
2	“L” ShPK	38,185,030	Skualifikuar
3	“I.” ShPK	39,559,452	Skualifikuar
4	“N” ShPK	39,708,355	Kualifikuar/Fituesi
5	“I” & Operatori Mbështetës “O.P” P.F.	40,261,862	Kualifikuar
6	“S” & “A” ShPK	42,391,522	Skualifikuar
7	“A” ShPK	42,578,054	Kualifikuar
8	“R” ShPK	43,642,964	Kualifikuar
9	“XH” ShPK	44,562,615	Kualifikuar
10	“2N” ShPK	45,896,914	Kualifikuar
11	“S” ShPK	47,745,566	Kualifikuar
12	“P” ShPK	48,924,433	Skualifikuar
13	“S” ShPK	49,696,301	Kualifikuar

Referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka kualifikuar 8 (tetë) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues OE “N” ShPK, ka s’kualifikuar 5 (pesë) B/OE të tjerë me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. BOE “I” & “T&XH” ShPK: -Vlera në formularin e ofertës ekonomike nuk përputhet me vlerën në preventivin e paraqitur.

2. OE “L” ShPK: -Mungon punonjësi i kualifikuar elektrikist dhe 2 punonjës të kualifikuar muratorë; -Operatori ekonomik nuk ka paraqitur sipas pikes 2.3.8 ne DST akt - mareveshjen me prodhuesin/distributorin e shitjes, te firmosur perpara noterit, per furnizimin me Elektropompe Centrifugale (te specifikuar ne preventivin e punimeve), ku te specifikohet se ne rast te shpalljes fitues ne proceduren e prokurimit operatori ekonomik do te furnizohet me Elektropompe Centrifugale gjate periudhes te realizimit te kontrates. Operatori ekonomik do te paraqese vetedeklarim se prodhuesi eshte konform sistemeve te menaxhimit te cilesise dhe ku ne rast se operatori ekonomik shpallet fitues do te paraqese çertifikaten ISO 9001: 2015 (Per sistemin e menaxhimit te cilesise).

3. OE “I.” ShPK: -Operatori Ekonomik ka tejkalar vlerën e fondit limit për paisje.

4. BOE “S” & “A” ShPK: -Operatori Ekonomik “S. S.A” sipas përqindjes së bashkëpunimit nuk ka paraqitur punë të ngjashme; - Operatori Ekonomik “S” nuk ka paraqitur çertifikatat ISO; - Operatori Ekonomik “S” nuk ka paraqitur vetedeklarimin se prodhuesi eshte konform sistemeve te menaxhimit te cilesise dhe ku ne rast se operatori ekonomik shpallet fitues do te paraqese çertifikaten ISO 9001: 2015 (Per sistemin e menaxhimit te cilesise).

5.OE "P" ShPK:-Preventivi i paraqitur tejkalon vlerën e fondit limit për punimet e ndërtimit.

Në vijim, me shkresën nr. 4695 prot., datë 15.09.2022 AK, ka kërkuar nga OE i renditur i pari ("N" ShPK) dorëzimin e dokumentacionit provues për vetëdeklarimet në kopje origjinale ose fotokopje të noterizuar. Pas paraqitjes të këtij dokumentacioni nga OE i renditur i pari, KVO-ja ka mbajtur procesverbalin e datës 20.09.2022 në të cilin, ndër të tjera, citohet se: "Pas verifikimit nga KVO rezultoi që OE "N" ka paraqitur të njëjtat dokumenta me ato të hedhura në sistem".

Në këto kushte, KVO ka shpallur fitues në SPE, me njoftimin e datës 20.09.2022, OE "N" ShPK me ofertë 39,708,355 lekë pa TVSh. Duke qenë se gjatë afatit ligjor, në lidhje me vlerësimin, nuk ka pasur asnjë ankesë, është hartuar raporti përmbledhës, i cili është miratuar nga titullari i AK në datën 28.09.2022. Pas depozitimit të sigurimit përkatës, palët kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me nr. 5187 prot., datë 07.10.2022 duke pasqyruar në SPE edhe njoftimin në lidhje me këtë të fundit.

Në lidhje me mbikqyrjen e zbatimit të punimeve, nga ana e AK, rezulton të jetë kontraktuar mbikqyrësi P.P P.F. me NUIS K.....N dhe numër licence MK.1967/1.

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime të cilat bien ndesh me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", konkretisht si vijon:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë (OE) e cila përfundimisht është shpallur fituese, "N" ShPK, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar. Mospasqyrimi i mangësive në rastin konkret, ka shkaktuar shpalljen fitues padrejtësisht të OE përkatës.

Konkretisht mangësi të OE "N" ShPK, të papasqyruara në procesverbalet e vlerësimit të datës 13.09.2022 dhe 20.09.2022, janë si vijon:

1-OE "N" ShPK në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit (Shtojca 8) ka deklaruar se ka paguar të gjitha të gjitha detyrimet për taksat sipas legjislacionit në fuqi, por, referuar ekstartit historik të shoqërisë, kjo e fundit ushtron aktivitetin e saj, ndër të tjera, edhe në Malësinë e Madhe për të cilën nuk ka paraqitur një vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore.

2-Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se në lidhje me mjetin kamion vetshkarkues nga 10-18 ton me targë AA786FM të cilin OE e ka marrë me qira, dokumentacioni i këtij të fundit mban referencën "për përdorim vetjak". Ky fakt bie në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.9/a të DST-ve sipas të cilës "Në rastin e mjeteve me qera, referuar dokumentacionit, mjetet nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak por për përdorim nga të tretët".

**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se kjo e fundit **nuk ka vlerësuar drejt** shoqëritë pjesëmarrëse në garë.

Në kushtet si më sipër, dhe në funksion të zbatimit në mënyrë literale të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", KVO-ja duhet të kishte skualifikuar OE "N" ShPK duke shpallur përfundimisht fitues operatorin ekonomik të rradhës, i cili i plotëson të gjitha kriteret e DST-ve, edhe pse realizimi i punëve do të kryej me një vlerë më të lartë monetare.

Në kushtet kur për zbatimin e një kontrate publike, nga Autoriteti Kontraktor, kontraktohet një operator ekonomik i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, efektivisht ky veprim mbart gjithashtu një risk potencial të shtuar për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar.

Nga kualifikimi i gabuar i OE "N" ShPK, nisur nga fakti i mungesës së plotësimin të të gjitha kriterëve të përcaktuara në DST, veprimet e KVO-së kanë shkaktuar kontraktimin në kushte paligjshmërie të vlerës 39,708,355 lekë pa TVSh, vlerë e cila përbën një shpenzim të njësisë, në mungesë të një menaxhimini me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

**Në përfundim**, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi** znj. I.P, znj. B.Q, znj. S.H, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

*Për sa është trajtuar më lart është përgatitur Projekt Raporti i Auditimit i dërguar në subjekt (Bashkia Maliq) mbi të cilin, ky i fundit, nëpërmjet shkresës nr. 6464/1, datë 02.02.2024, protokolluar në KLSH me nr. 863/6, datë 05.02.2024, ka observuar, kryesisht në të njëjtën mënyrë si në fazën e dorëzimit të akt-konstatimeve, si më poshtë:*

**Pretendim i subjektit:**

*Referuar Dokumentave Standarte te tenderit, rezulton se Njësia e Prokurimit ka kërkuar si dokumentacion i cili duhet të plotësohet nga operatët ekonomikë, plotësimi i formularit të vetë deklaramit (shtojca 8), ku operatori ekonomik duhet të deklarojë se Operatori Ekonomik “ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”. Në dokumentat standarte të tenderit nuk rezulton të jetë kërkuar vërtetim i spe.*

*Pavarsisht nga kjo KVo ka vlerësuar se operatori ekonomik “N” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) ka deklaruar se ka paguar të gjitha detyrimet dhe taksat sipas legjislacionit në fuqi dhe gjithashtu operatori ekonomik “N” shpk ka paraqitur edhe një deklaratë ku ka deklaruar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për periudhën vitin 2021, dhe kestet e maturuara të vitit 2022 sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 “Përsistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.*

**Qëndrimi i grupit të KLSH:**

Për sa më sipër, observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Në këto kushte grupi i auditimit i qëndron konstatimit dhe argumentimit të trajtuar për rastin konkret.

**Titulli i gjetjes 6:** *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në fazën e hartimit të specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjes dhe dokumentimit të fondit limit, konstatuar kjo në 4 procedura prokurimi.*

**Situata:**

Rezulton se në 4 procedura (-Rikonstrukcion i fushës së futbollit, të stadiumit të qytetit Maliq; - Përmirësimi i banesave ekzistuese; - Shërbim mirëmbajtje mjetet dhe eskavatorët; - Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative viti 2022), janë evidentuar problematika në fazën e hartimit të specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjes dhe dokumentimit të fondit limit.

Shkeljet apo problematikat konsistojnë në këto drejtime:

-Nuk janë dokumentuar apo pasqyruar analiza në lidhje me sasinë e mallit apo shërbimit që kërkohet të prokurohet;

-Specifikimet teknike nuk kanë të përcaktuar standartin e cilësisë në lidhje materialet që do të përdoren nga OE për realizimin e kontratës së prokuruar.

**Kriteri:**

Nenet 34, 35 dhe 36 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” i VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efektiviteti:**

Mungesa e analizave në lidhje me sasinë e mallit/shërbimit që kërkohet të prokurohet apo hartimi i gabuar i specifikimeve teknike përbën një risk të shtuar si për realizimin e procedurës së prokurimit ashtu edhe për cilësinë e objektit që prokurohet.

**Shkaku:**

Mos zbatimi i plotë i kuadrit ligjor në fazën e hartimit të specifikimeve teknike si dhe përlogaritjes dhe dokumentimit të fondit limit nga personat përgjegjës (*Njësia e Prokurimit*).

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandim:**

Spektori i Prokurimit Publik, NjP apo komisioni përkatës, në Bashkinë Maliq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës, duke hartuar dhe u bazuar paraprakisht, në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, të cilat të përcaktojnë qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

*(Gjerësisht problematikat në lidhje me mos zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të LPP-së për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt OE, fazën e hartimit të specifikimeve teknike si dhe përlogaritjes dhe dokumentimit të fondit limit, janë trajtuar në Akt konstatimin nr. 3 datë 30.12.2023, protokolluar në subjekt (Bashkia Maliq) përkatësisht me nr. 6464/2 prot., datë 30.12.2023.)*

**Rastet e shkeljeve sipas procedurave paraqiten si vijon:**

**8-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i fushës së futbollit, të stadiumit të qytetit Maliq, faza 2, viti 2022”,**

me këto të dhëna:

1. Urdhër Prokurimi Nr.62 datë 16.07.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit <b>Procedurë e Hapur/Punë/Sistem elektronik</b>	2. Njësia e Prokurimit Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike,përlogaritjes fondit limit Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH
4. Fondi limit (pa tvsh) 17,153,307 lekë	5. Burimi i Financimit Të Ardhurat	6. Data e hapjes së tenderit 14.09.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës <b>1. I. shpk me Subjekt Mbështetës 2N shpk dhe O.P P.F, 16,128,430, lekë pa tvsh</b> <b>2.I. shpk me Subjekt Mbështetës L.T.E Construction shpk, K.T.shpk, E. K. shpk, 14,992,740 lekë pa tvsh</b> <b>3. S. shpk 16,736,520 lekë pa tvsh</b> b/1) kualifikuar me vendimi te KPP	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Znj.S. H Znj.B.Q Znj.F.D NDRYSHUAR ME : Znj.N.GJ Znj.K.D Znj.F.D	9. Oferta fituese (pa tvsh) 16,128,430 lekë (Ina shpk)
10. Data e lidhjes së kontratës Nr.5287 Datë 12.10.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,024,877 lekë	12. Ankimime Nuk Ka
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës <b>Pjese e dosjes teknike të mbikqyrjes dhe kolaudimit</b>	14. Fletë hyrja -----	15. Afati i kontratës 3 muaj
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi	17. Likuiduar deri dt -----	

## Etapa përgatitore

### Argumentimi i fondit limit

Në argumentimin e fondit limit fillimisht është miratuar fondi shtesë me vendimin Nr. 44 datë 18.05.2022 nga Këshilli i Bashkisë e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korçë me Nr. 537/2 datë 30.05.2022, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit të bashkisë”, gërma “dh”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”, gërma “c”, të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32, “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore”, të Ligjit Nr.68/2018, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 45, të Ligjit Nr. 115/2021, Për buxhetin e vitit 2022 si dhe Udhëzimit plotësues të MFE Nr. 1 datë 10.01.2022. Më pas nëpërmjet studios së projektimit “N. S.” me vizatimet, planet, skicimet përkatëse është hartuar projekt dhe preventivi përkatës, mbi zërat e punimeve që do të kryhen në lidhje me objektin e prokurimit. Janë hartuar specifikimet teknike nga Inxhinieri i studios E. N. dhe janë ripunuar nga Inxhinierja Drejtorisë së Zhvillimit Urban dhe Territorit M.ZH e cila është e pajisur me licensën e projektuesit nga ku, në specifikimet teknike në ka përcaktuar në mënyrë të detajuar mënyrën e realizimit të kontratës, lloji i materialit që do përdoret i cili duhet të shoqërohet me certifikata e cilësisë si dhe katalogjet përkatëse. Gjithashtu ka të shpjeguar në mënyrë të detajuar tërësinë e shpenzimeve duke u mbështetur në realizimin e të gjithë zërave përkatës. Fondi limit i përlllogaritur është 17,153,307 lekë pa tvsh. Në lidhje me çmimin grupi punës është mbështetur në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike. Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike është kryer nga (z. G.F, znj. G.G , znj. M.ZH). Në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit grupi punës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 pasi janë konstatuar kriterë të cilat janë jo të lidhura ngushtë dhe jo në përpjestim me objektin e prokurimit ndërkohë që hartimi i tyre nuk është shoqëruar me ankesa nga ana e OE.

-Më datë 14.09.2022 u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjesë 3(tre)OE si më poshtë:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	I. shpk me Subjekt Mbështetës 2N shpk dhe O.P P.F	J.....Ë L.....L L.....N	16,128,430	<b>Kualifikuar</b>
2	I. shpk me Subjekt Mbështetës L. shpk, K.T shpk, E. K. shpk,	J.....M	14,992,740	<b>S' kualifikohet</b> pasi: Oferta e operatorit ekonomik ka gabim aritmetik mbi 2%.
3	S.	K.....H	16,736,520	<b>Kualifikuar</b>

Në përfundim KVO vendosi të shpall të rregullt ofertën e OE I. shpk me Subjekt Mbështetës 2N shpk dhe O.P, P.F duke gjykuar dokumentacion e tij të rregullt dhe në përputhje me DST.

### **Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:**

Së pari, hartimi i kriterëve teknike jo në përputhje me objektin e kontratës.

Nga shqyrtimi i kriterëve të vendosura në DST, u konstatua se në kriteret e veçanta (kapacitetet teknike), mbi kërkesën që OE duhet të disponojnë licencën NP-7A (Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje) si dhe licencën NS-20A (Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime për ujë), konstatohet që janë kriterë të tepërta të vendosura nga NJP. Duke qene se sipas objektit dhe natyrës e procedurës nuk kërkohen vepra inxhinierike të mëdha në të cilat nevojat mbi disponimin e këtyre licencave do ishte e domosdoshme, nga ana e NJP duhet të ishte parë e

arsyeshme që procedura të ndahej në lote ose këto kritere të mos kërkoheshin pasi të kufizojnë numrin e OE pjesëmarrës.

VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 42 (Kontrata me lote), neni 78 (hartimi i dokumentave të tenderit); Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, neni 2(Qëllimi), neni 3(Parime të përgjithshme) neni 39, neni 77.

Shkaku i kësaj situate është mosnjohja e e Ligjit/VKM si dhe mos zbatimi i kërkesave ligjore në lidhje me hartimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit (DT).

Sa më sipër ka ndikim pasi nuk nxitet pjesëmarrja e OE në procedurat e prokurimit, krijojnë diskriminim dhe shërbëjnë si pengesë për konkurrencë të hapur si dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Së dyti mos kryerja e analizës për 1(një) nga zërat e preventivit në përllogaritjen e fondit limit.

Në përllogaritjen e fondit limit në lidhje me sasinë e saj, më konkretisht sipas preventivit, zëri (AN-4;Gominë e zezë 1-3mm), nuk është dokumentuar apo pasqyruar analiza në lidhje me sasinë prej 48.000 kg gominë e zezë. Pra duke qenë se është detyrim ligjor argumentimi sasisë, grupi punës nuk ka të përshkruar se çfarë lloj metodologjie është ndjekur apo si është përcaktuar sasia e nevojshme prej 48.000 kg gominë e zezë.

Për sa më sipër, nuk dokumentohet apo pasqyrohet saktë vlera e fondit limit e cila lidhet në mënyrë direkte me përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efikasitet.

Sa trajtuar rezultojnë veprime në kundërshtim me VKM Nr.285, datë 19.05.2021, neni 76 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Ligji Nr.162/2020; Ligjit Nr.139/2015 neni 40; “Për prokurimin Publik”.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën me nr. 863/6 prot, datë 05.02.2024, protokolluar në KLSH, “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

#### **Pretendimet e subjektit:**

*Sa i përket akt konstatimit nr.3, procedura “Rikonstruksion i fushës së futbollit, të stadiumit të qytetit maliq, faza 2, Viti 2022”, në lidhje me hartimin dhe dokumentimin e kritereve, njësia e prokurimit bazuar në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është mbajtur proces-verbal ku janë argumentuar kërkesat në lidhje me kriteret e vendosura ë DST. Në lidhje me ndarjen e procedurës në lote ju sqarojm se nuk kemi të bëjmë më punime të ndara në lote pasi ky objekt është një i plotë dhe duhet të prokurohet i gjithi së bashku. Në këtë procedurë është realizuar konkurrenca mjaftueshme.*

#### **Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:**

*Sa i përket pretendimeve të mësipërme sic e kemi theksuar dhe në akt-konstatim AK, Bashkia Maliq, Njësia e Prokurimit (NJP) në hartimin e kritereve të dokumentave të tenderit (DST), nuk ka mbajtur në konsideratë që hartimi tyre duhet të bëhet në përputhje me objektin e kontratës.Më konkretisht në hartimin e kritereve teknike, në rastet kur nuk kryhen volume punimesh me vlera shumë të mëdha, nevojat mbi mbi paraqitjen e licensave apo kualifikimeve të ndryshme mund të ulin numrin e OE pjesëmarrës, dhe të mos stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Si grup auditimi jemi shprehur që nga ana juaj të shihet e arsyeshme që në bazë të volumeve të punimeve që do të kryhen, në ato raste kur përmbushja e kapaciteteve teknike si dhe përmbushja e kërkesave të cilësisë nga ana e OE vërtetohet pa qenë e nevojshme paraqitja e licensave apo kualifikimeve të ndryshme, duhet të eliminohen këto kërkesa në DST.Ndërkohë që përsa i përket ndarjes me lote jemi shprehur që në ato raste volume punimesh të kryera, në të cilat*

*tipologjia e punës së për disa nga zërat është e ndryshme, bën që dhe kërkesat apo nevojat mbi paraqitjen apo disponimin e licensave të jenë të ndryshme, dhe si rrjedhojë në mënyrë të tillë që të stimuloj pjesëmarrjen e biznesit të vogël ose të mesëm procedura duhet të ndahej në lote, nga ku puna të kryhet nga OE të ndryshëm.*

***Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.***

## **9-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion objekte ndertimore 2022”,**

me këto të dhëna:

<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.82 datë 16.08.2022		
<b>1. Lloji i procedurës së Prokurimit</b> Procedurë e Hapur e Thjeshtuar	<b>2. Njësia e Prokurimit</b> Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH	<b>3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve</b> <b>Teknike, përlogaritjes fondit limit</b> Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH
<b>4. Fondi limit (pa tvsh)</b> <b>11,666,577 lekë</b>	<b>5. Burimi i Financimit</b> Të ardhurat	<b>6. Data e hapjes së tenderit</b> 06.09.2022
<b>7. Operatorët Ekonomikë</b> <b>a) Pjesëmarrës</b> 1. I. shpk me operator mbështetës 2N shpk dhe E. shpk 9,564,639 lekë pa tvsh 2. A. shpk 10,390,915 lekë pa tvsh 3.A shpk 11,035,825 lekë pa tvsh 4.S shpk 11,132,264 lekë pa tvsh 5.V. K. shpk 3,641,100 lekë pa tvsh <b>b) kualifikuar me vendimi te KPP</b>	<b>8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Znj.O.B Znj.K.D Znj.B.Q	<b>9. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 9,564,639 lekë Oferta ka gabime aritmetike dhe operatorit I. shpk i është dërguar shkresa me Nr.4609.prot datë 12.09.2022.Operatori ekonomik pranon korigjimin e gabimit në preventiv dhe ndryshimin e vlerës së ofertës.
<b>10. Data e lidhjes së kontratës</b> Nr.5253 prot Datë 11.10.2022	<b>11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 2,101,938 lekë	<b>12. Ankimime</b> Nuk Ka
<b>13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës</b> Pjesë e dosjes teknike të mbikqyrjes dhe kolaudimit	<b>14. Fletë hyrja</b> -----	<b>15. Afati i kontratës</b> 3 muaj nga data e lirimimit të sheshit të ndërtimit.
<b>16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi</b> -----	<b>17. Likuiduar deri dt</b> -----	

### **Etapa Përgatitore**

#### *Argumentimi i fondit limit*

Në argumentimin e fondit limit fillimisht është miratuar fondi shtesë nga Këshilli i Bashkisë e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korçë, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit të bashkisë”, gërma “dh”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”, gërma “c”, të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32, “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore”, të Ligjit Nr.68/2018, “Për financat e vetqeverisjes vendore”, neni 45, të Ligjit Nr.115/2021, Për buxhetin e vitit 2022 si dhe Udhëzimit plotësues të MFE Nr.1 datë 10.01.2022.Më pas nëpërmjet inxhinieres M.ZH e pajisur me licensen e projektuesit, pranë Drejtorisë së Urbanistikës nëpërmjet vizatimeve, planeve, skicave përkatëse është hartuar projekti dhe preventivi përkatës, mbi zërat e punimeve që do të kryhen. Janë hartuar specifikimet teknike nga znj.M.ZH nga ku, në specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë të

detajuar mënyra e realizimit të kontratës, lloji i materialit që do përdoret i cili duhet të shoqërohet me certifikata e cilësisë si dhe është përcaktuar tërësia e shpenzimeve. Fondi limit i përlogaritur është 11,666,577 lekë pa tvsh. Në lidhje me çmimin grupi punës është mbështetur në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

*Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifitimeve teknike.* Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifitimeve teknike është kryer nga (z.G.F, znj.G.G, znj.M.ZH). Në lidhje me hartimin e kriteve të kualifikimit grupi punës nuk ka vepruar në përputhje me neni 77 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 pasi janë konstatuar kriterë të cilat janë jo të lidhura ngushtë dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit ndërkohë që hartimi i tyre nuk është shoqëruar me ankesa nga ana e OE.

Më datë 06.09.2022u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjesë 5(pesë)OE si më poshtë:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	I. shpk me operator mbështetës 2N shpk dhe E. shpk	J.....Ë L.....L K.....P	9,564,639	<b>Kualifikuar</b>
2	A.shpk	J.....O	10,390,915	<b>Kualifikuar</b>
3	A. shpk	K.....H	11,035,825	<b>Kualifikuar</b>
4	S. shpk	K.....T K.....F	11,132,264	<b>Kualifikuar</b>
5	V. shpk	L.....L	3,641,100	<b>S`kualifikohet pasi</b> -Preventivi I ofruar nuk përputhet me preventivin e DST,janë ndryshuar zëra dhe preverntivi nuk është I plotë. -Mungon formulari I sigurimit të ofertës -Mungojnë certifikatat ISO

Në përfundim KVO vendosi të shpall të rregullt ofertën e OE “I” shpk duke gjykuar dokumentacion e tij të rregullt dhe në përputhje me DST.

#### **Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:**

Mos argumentimi i kriterëve të vendosura duke u mjaftuar me listimin e tyre në terma të përgjithshëm në të cilën evidenton bazën ligjore të cilën i referohet AK por pa argumentuar numrin e makinerive, fuqisë punëtore etj.

Në hartimin dhe miratimin e DST dhe kriterëve të Kërkesave kualifikuese; Për procedurën e prokurimit janë hartuar dhe miratuar dokumentat e tenderit, kërkesat për kualifikim, specifikimet teknike, termat e references me publikimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik të nënshkruar nga NJHDT. Në procesverbal Njësia e prokurimit ka listuar kriteret e kërkesave të vecanta për kualifikim, në të cilin është mjaftuar me pasqyrimin në terma të përgjithshëm se; “...për kriteret e përcaktuara njësia e prokurimit ka zbatuar VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26 Kontrata për punë publike..VKM nr.407, datë 27.12.2012 “për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, ndërsa në asnjë rastë nuk ka argumentim në lidhje me vendosjen e kërkesave dhe kriteret e kualifikimit, por është mjaftuar me vetëm me pasqyrimin se, vendosja e këtyre kërkesave është në mbështetje VKM, pa evidentuar asnjë nen të ligjit “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Baza ligjore së cilës i referohet NJHDT është pjesa e së drejtës që AK, ka për të parashikuar në kriteret e vendosura për nevojën e fuqisë punëtore, makinerive, licencat dhe të tjera mjete të nevojshme, ndërsa numri kërkuar nga AK për mjete, fuqi punëtore, licenca e etj, është detyrimi që ka AK për të argumentuar vendosjen e këtyre kriterëve. Veprime në



mospërputhje me nenin 78, pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 15 dhe 22 të ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citon: “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Mos argumentimi me hollësi i kriterëve për kualifikim shkakton paqartësi kundrejt OE të interesuar pasi nuk përcakton kriteret, kërkesat apo kushtet e tjera që duhet të përmbushin këto OE në lidhje me numrin e makinerive, fuqisë puntore, licensave etj, si dhe nxisin pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit, krijojnë diskriminim dhe shërbëjnë si pengësë për konkurrencë të hapur si dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

**10-Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese”, me këto të dhëna:**

<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.75 datë 05.08.2022		
<b>1. Lloji i procedurës së Prokurimit</b> Procedurë e Hapur/Punë/Sistem elektronik	<b>2. Njësia e Prokurimit</b> Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH	<b>3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve</b> <b>Teknike,përlllogaritjes fondit limit</b> Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH
<b>4. Fondi limit (pa tvsh)</b> <b>25,007,176 lekë</b>	<b>5. Burimi i Financimit</b> Grand	<b>6. Data e hapjes së tenderit</b> 08.09.2022
<b>7. Operatorët Ekonomikë</b> <b>a) Pjesëmarrës</b> 1. N 18,491,461 lekë pa tvsh 2. A.shpk 18,752,403 lekë pa tvsh 3.I.shpk dhe 2N shpk, 19,887,705 lekë pa tvsh 4.V.shpk dhe A shpk 21,907,283 lekë pa tvsh 5.P.shpk 24,582,821 lekë pa tvsh <b>b) kualifikuar me vendimi te KPP</b>	<b>8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Znj.S.H Znj.B.Q Znj. O. B NDRYSHUAR ME Znj.S.H Znj.F.D Znj. O. B	<b>9. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 18,491,461 lekë nga OE N
<b>10. Data e lidhjes së kontratës</b> Nr.5251 Datë 11.10.2022	<b>11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 6,515,715 lekë	<b>12. Ankimime</b> Nuk ka
<b>13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës</b> Pjese e dosjes teknike te mbikqyrjes dhe kolaudimit	<b>14. Fletë hyrja</b> -----	<b>15. Afati i kontratës</b> 4 muaj
<b>16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi</b> -----	<b>17. Likuiduar deri dt</b> -----	

**Etapa Përgatitore**

*Argumentimi i fondit limit*

Me shkresën me Nr.14430 Prot, datë 28.07.2022 është bërë njoftimi mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2022 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga ku ka dalë fituese projekti ndër të tjera dhe Bashkia Maliq. Bazuar në këtë njoftim është hartuar Projekti nga Ark. G. K dhe Ing.M. Zh, preventivi, grafiku i punimeve dhe specifikimet teknike. Numri i familjeve që përfitojnë nga ky projekt është 50 familje. Preventivi i hartuar është mbështetur në VKM Nr.625 datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” nga ku është përlogaritur vlera limit e kontratës mbi cmimet përkatëse dhe analizave të kryera në shumën 25,007,176 lekë pa tvsh. Specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit kanë të përcaktuar në mënyrë të detajuar mënyra e realizimit të kontratës, lloji i materialit që do përdoret të shoqëruar me certifikata e cilësisë si dhe ka të parashikuar tërësinë e shpenzimeve duke u mbështetur në realizimin e të gjithë zërave përkatës.

*Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike.* Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike është kryer nga (z.G.F, znj.G.G, znj.M.ZH). Në lidhje me hartimin e kriteve të kualifikimit grupi punës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 pasi janë konstatuar kriterë të cilat janë jo të lidhura ngushtë dhe jo në përpjestim me objektin e prokurimit ndërkohë që hartimi i tyre nuk është shoqëruar me ankesa nga ana e OE.

-Më datë 08.09.2022 u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjesë 5 (pesë) OE si më poshtë:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	N	J.....U	18,491,461	<b>Kualifikuar</b>
2	A. shpk	K.....A	18,752,403	<b>S`kualifikohet pasi</b> Ka paraqitur ofertë me gabime aritmetike më shume se 2% e vlerës së ofertës së ofruar
3	I. shpk dhe 2N shpk	J.....Ë L.....L	19,887,705	<b>Kualifikuar</b>
4	V. shpk dhe A. shpk	K.....T K.....F	21,907,283	<b>S`kualifikohet pasi</b> Ka paraqitur ofertë me gabime aritmetike më shume se 2% e vlerës së ofertës së ofruar.
5	P. shpk	L.....L	24,582,821	<b>Kualifikuar</b>

Në përfundim KVO vendosi të shpall të rregullt ofertën e OE “N” shpk duke gjykuar dokumentacion e tij të rregullt dhe në përputhje me DST.

**Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:**

-Nuk është përcaktuar mënyrë e përzgjedhjes së familjeve përfituese nga projekti i MFE, “Drejtoria e Strehimit” pranë Ministrisë , mbi projektet e nisura nga kjo e fundit për përmirësimin e banesave ekzistuese për familjet në nevojë.

Në lidhje me aplikimin e bërë nga ana e Bashkisë Maliq për projektin “Përmirësim i banesave ekzistuese”, aplikuar nga 27 bashki në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ,Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Strehimit, në të cilën ka dal fituese kjo e fundit, nga ana e Bashkisë nuk është përcaktuar mënyra e përzgjedhjes së familjeve të cilat do të përfitojnë nga ky projekt. Pra nga ana e Bashkisë në mënyrë të detajuar duhet të ishte përcaktuar si është bërë përzgjedhja famileve përfituese, vendimet si janë marrë, gjendja e objekteve ekzistuese sic janë prova të ndryshme filmike apo evidenca të tjera si garanci shtesë mbi zhvillimin e procedurës.

Për sa më sipër rezulton në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 21, neni 34; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, neni 73, neni 74, neni 76; Ligji nr.10296, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 16.

-Nuk është hartuar plani i sigurisë apo plani koordinimit mbi mbrojtjen e punonjësve ndaj rreziqeve të mundshme në punë.

Nuk është përcaktuar apo hartuar një plan-sigurie dhe një plan-kordinimi mbi mbrojtjen e punonjësve ndaj rreziqeve të mundshme në përputhje me nenin 5(detyrat e koordinatorit për realizimin e punimeve) të VKM Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores së sigurisë në kantier”.Pra pavarësisht se plani masave në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë është detyrim i OE nga ana e NJP duhet të ishte përcaktuar apo vendosur si kriter kualifikues në specifikimet teknike të DST.

Për sa më sipër rezulton në kundërshtim me VKM Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores së sigurisë në kantier”, neni 5; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 36; VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39

-Nuk është përcaktuar në specifikime teknike standarti i cilësisë për materialet që do të përdoren për realizimin e kontratës.

Në specifikimet teknike të hartuara nga inxhinierja M.ZH në cilësinë e specialistes së fushës rezultoi se nuk ka të përcaktuar llojin materialit që do të përdoret mbi realizimin e kontratës si dhe standarti që do të aplikohet e cila duhet të jetë sipas standartit shqiptar SSH në zbatim të VKM Nr.68 datë 15.02.2001, “Për miratimin e standarteve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”.

Për sa më sipër rezulton në kundërshtim me VKM Nr.68 datë 15.02.2001, “Për miratimin e standarteve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” e ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë 863/6 prot, datë 05.02.2024, protokolluar në KLSH, “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

**Pretendimet e subjektit:**

Sa i përket akt konstatimit nr.3, procedura “Rikonstruksion i objekteve ndërtimore viti 2022, AK, Bashkiq Maliq ka zhvilluar procedurën e prokurimit , në lidhje me hartimin dhe dokumentimin e kriterëve, njësia e prokurimit bazuar në ligjin nr.162/2020 si dhe VKM RRPP nr.285 datë 19.05.2021 është mbajtur procesverbali ku janë argumentuar kërkesat në lidhje me to...

**Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:**

Sa i përket pretendimit të mësipërm sic e kemi theksuar dhe në akt-konstatim AK, Bashkia Maliq, Njësia e Prokurimit (NJP), në procesverbalin e argumentimit të kriterëve, kërkesave për kualifikim, nuk ka argumentuar me hollësi secilin kriter të përcaktuar në DST.Argumentimi tyre duhet të bëhet duke mbajtur në konsideratë që të mos mjaftohet me pasqyrimin e tyre vetëm në terma të përgjithshëm, por duhet të trajtojë në mënyrë të imtësishme duke argumentuar: natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punës, kohëzgjatja e kontratës, numri i mjeteve të nevojshme, numri i punonjësve etj.

**Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.**

**11- Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative viti 2022”, me këto të dhëna:**

1. Urdhër Prokurimi  
Nr.38 datë 11.05.2022

<b>1. Lloji i procedurës së Prokurimit</b> Procedurë e Hapur/Punë/Sistem elektronik	<b>2. Njësia e Prokurimit</b> Z.Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH	<b>3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve</b> <b>Teknike,përlogaritjes fondit limit</b> Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH
<b>4. Fondi limit (pa tvsh)</b> <b>74,997,785 lekë</b>	<b>5. Burimi i Financimit</b> Të ardhurat	<b>6. Data e hapjes së tenderit</b> 09.06.2022
<b>7. Operatorët Ekonomikë</b> <b>a) Pjesëmarrës</b> 1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik V. shpk dhe A. shpk 51,347,160 lekë pa tvsh 2. N 51,603,650 lekë pa tvsh 3.I. shpk 54,382,920 lekë pa tvsh 4.B. shpk 59,373,905 lekë pa tvsh 5.A. shpk me mbështetës INERTI shpk 59,734,770 lekë pa tvsh 6.S. shpk 66,666,666 lekë pa tvsh 7.E. shpk 66,750,124 lekë pa tvsh 8.S. shpk 69,625,163 lekë pa tvsh 9.B. shpk 69,741,200 lekë pa tvsh 10.Z. shpk 70,099,370 lekë pa tvsh 11.Sh. shpk 71,366,550 lekë pa tvsh <b>b) kualifikuar me vendimi te KPP</b>	<b>8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Znj.S.H Znj.B.Q Znj.F.D	<b>9. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 51,347,160 lekë Oferta anomalisht e ulët e argumentuar nga OE V. shpk
<b>10. Data e lidhjes së kontratës</b> Nr.4197 Datë 04.08.2022	<b>11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 23,650,625 lekë	<b>12. Ankimime</b> Nuk Ka
<b>13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës</b> Pjese e dosjes teknike te mbikqyrësit dhe kolaudatorit	<b>14. Fletë hyrja</b> -----	<b>15. Afati i kontratës</b> 6 muaj
<b>16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi</b>	<b>17. Likuiduar deri dt -</b>	

## Etapa Përgatitore

### Argumentimi i fondit limit

Në argumentimin e fondit limit fillimisht është miratuar fondi shtëse me vendimin Nr.10 datë 28.01.2022 nga Këshilli i Bashkisë e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korçë me Nr.115/1 datë 08.02.2022, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit të bashkisë”, gërma “dh”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”, gërma “c”, të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32, “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore”, të Ligjit Nr.68/2018, “Për financat e vetqeverisjes vendore”, neni 45, të Ligjit Nr.115/2021, Për buxhetin e vitit 2022 si dhe Udhëzimit plotësues të MFE Nr.1 datë 10.01.2022.Më pas nga Inxhinierja e zyrës së Urbanistikës është hartuar projekti dhe preventivi përkatës, mbi zërat e punimeve që do të kryhen në lidhje me objektin e prokurimit. Janë hartuar specifikimet teknike nga ku është përcaktuar mënyra e realizimit të kontratës si dhe lloji i materialit që do përdoret të shoqëruara me certifikata e cilësisë si dhe katalogjet përkatëse. Gjithashtu ka të shpjeguar në mënyrë të detajuar tërësinë e shpenzimeve që do kryhen.Në lidhje me çmimin grupi punës është mbështetur në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e

manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Fondi limit i përlllogaritur është 74,997,785 lekë pa tvsh.

*Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike.* Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike është kryer nga (z.G.F, znj.G.G , znj.M.ZH.) Në lidhje me hartimin e kriteve të kualifikimit grupi punës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 pasi janë konstatuar kriterë të cilat janë jo të lidhura ngushtë dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit ndërkohë që hartimi i tyre nuk është shoqëruar me ankesa nga ana e OE.

Më datë 09.06.2022 u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjesë 11(njëmbëdhjetë)OE si më poshtë:

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	Bashkimi i Operatorëve Ekonomik V. shpk dhe A.shpk	J.....Q K.....U	51,347,160	<b>Kualifikuar</b>
2	N.	J.....U	51,603,650	<b>Kualifikuar</b>
3	I. shpk	J.....Ë	54,382,920	<b>Kualifikuar</b>
4	B. shpk	K.....H	59,373,905	<b>S`kualifikohet pasi:</b> Mungojnë certifikatat ISO
5	A. shpk me mbështetës I. shpk	J.....Q	59,734,770	<b>Kualifikuar</b>
6	S. shpk	K.....J	66,666,666	<b>S`kualifikohet pasi:</b> Në formularin e shtojcës 8 mungon Inxhinieri I Ndërtimit
7	E.shpk	K.....I	66,750,124	<b>Kualifikuar</b>
8	S. shpk	K.....H	69,625,163	<b>Kualifikuar</b>
9	B. shpk	K.....A	69,741,200	<b>Kualifikuar</b>
10	Z. shpk	J.....K	70,099,370	<b>Kualifikuar</b>
11	Sh. shpk	K.....N	71,366,550	<b>Kualifikuar</b>

Në përfundim KVO vendosi të shpall të rregullt ofertën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik V. shpk dhe Artyka II shpk duke gjykuar dokumentacion e rregullt dhe në përputhje me DST.

#### **Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:**

Nuk është përcaktuar në specifikimet teknike standarti i cilësisë në lidhje me lëndën e parë që prodhohet e cila demonstroi se OE ka një sistem kontrolli të procesit në fabrikë

Në DST, në specifikimet teknike nuk është përcaktuar lënda e parë që do përdoret sipas standartit të cilësisë e cila duhet shoqërohet me teste-raporte fabrike. Në cdo rast OE duhet të vertetojë se cilësia e lëndës së parë që zotëron është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe ato Shqiptare. Veprime këto në përputhje me VKM nr.58 datë 01.02.2006 “Për miratimin e rregullores për procedurat e kontrollit të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, për marrjen e certifikatës së vlerësimit të konformitetit për cimentot për të cilat ka rëndësi parësor rezistenca dhe qëndrueshmëria” ku citon :Prodhuesi demonstroi se ka një sistem kontrolli të procesit në fabrikë ose një sistem cilësie, për të siguruar që çimentoja e prodhuar është konform kërkesave të standardit S SH EN 197-2.

Sa më sipër në kundërshtim me VKM nr.58 datë 01.02.2006, “Për miratimin e rregullores për procedurat e kontrollit të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, për marrjen e certifikatës së vlerësimit të konformitetit për cimentot për të cilat ka rëndësi parësor rezistenca dhe qëndrueshmëria; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 36; VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39.

**12- Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje mjetet dhe eskavatorët”. Loti I-“Shërbim mirëmbajtje mjetet; Loti II-“Shërbim mirëmbajtje eskavatorët”,**

me këto të dhëna:

1. Urdhër Prokurimi Nr.31 datë 20.04.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar/Me lote /Marrëveshje kuadër” REF-29866 -05 –18 -2022	2. Njësia e Prokurimit Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike, përlllogaritjes fondit limit Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH
4. Fondi limit (pa tvsh) 8,635,766 lekë Loti I 3,047,601 lekë Loti II 5,588,165 lekë kë	5. Burimi i Financimit Të Ardhurat+Grand	6. Data e hapjes së tenderit 30.05.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës (BOE)M. Sh. &N. Sh. (Loti I) Anulluar Loti II(Asnjë pjesëmarrës) b) kualifikuar me vendimi te KPP	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave 1. O. B 2. B.Q 3. K.D	9. Oferta fituese (pa tvsh) Loti I 2,940,810 lekë (BOE)Operatori Fitues: “M .Sh & N.Sh”PF
10. Data e lidhjes së kontratës Nr.3677 Datë 06.07.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 106,791 lekë	12. Ankimime Nuk Ka
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 1 vit nga lidhja e marrëveshjes kuadër
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi	17. Likuiduar deri dt	

## Etapa Përgatitore

### Argumentimi i fondit limit

Në argumentimin e fondit limit komisioni i ngritur me Urdhërin nr.8 datë 28.02.2022, fillimisht ka paraqitur kërkesën mbi nevojat në të cilat do të kryhet shërbimi.Më pas nga kërkesa e paraqitur rezultoi se kjo kërkesë është bërë për mjetet e Aparati i Bashkisë, Për Shërbimin Publik, Drejtoria e Rrugëve Rurale, Bordi i Ujitje-Kullim nga ku është kryer dhe përlllogaritja e fondit limit. Cmimi është mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta nga OE, “M&N Sh.” me NIPT K.....O, “S.P” me NIPT K.....K, “P.” shpk me NIPT J.....J në të cilën vlera e fondit limit për lotin e I 3,047,601 lekë.Në lidhje me lotin e II “Shërbim mirëmbajtje eskavatorësh” grupi punës është mbështetur në nevojat mbi mirëmbajtjen e mjeteve të punës në administrim të Bashkisë në të cilat përfshihen 4 mjete eskavator, ndërkohë që në lidhje me çmimin e përlllogaritur grupi punës është mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta të paraqitura nga OE, “S. G.M” me NIPT L.....C, R.P pa të dhëna NIPT si dhe “S.” me NIPT L.....S me vlerë të pritshme kontratash që mund të lidhen gjatë MK 5,588,165 lekë.

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike.Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike është kryer nga (z.G.F, znj.G.G, znj.M.ZH.). Në lidhje me hartimin e kriteve të kualifikimit grupi punës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 pasi janë konstatuar kriterë të cilat janë jo të lidhura ngushtë dhe në përprjestim me objektin e prokurimit ndërkohë që hartimi i tyre nuk është shoqëruar me ankesa nga ana e OE.

-Më datë 14.09.2022 u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjesë 3(tre) OE si më poshtë:

Loti	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
Loti I	1.(BOE) M.Sh & N.Sh	K.....O	2,940,810	<b>Kualifikuar</b>
Loti II	Anulluar; Nuk është paraqitur asnjë OE	-----	-----	-----

### **Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:**

-Në argumentimin e fondit limit të kryer me testim tregu me 3(tre) oferta, rezultoi se njëra nga ofertat nuk është rregullt

Në argumentimin e fondit limit të kryer me testim tregu me 3(tre) oferta, për lotin e II “Shërbim mirëmbajtje eskavatorësh”, rezultoi se oferta e paraqitur e OE “R. P.” nuk ka të bashkangjitur vulën e OE duke e bërë të pavlefshme ofertën e tij.Pra grupi punës nuk i është përmbajtur nenit 76 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021, nenit 34 të Ligjit Nr.162/2020 si dhe neni 40 të Ligjit Nr.139/2020.

**Rekomandime**AK, Bashkia Maliq, Njësia e Prokurimit (NJP), në procedurat e prokurimit ku përlllogaritja e fondit limit bëhet me testim tregu me 3(tre) oferta të adminstrojë saktë ofertat ekonomike nga ku të kenë bashkangjitur vulën si dhe NIPTIN e OE ofertues.

-Nuk janë evidentuar të dhëna në lidhje me automjete si: kartelat e mjeteve, dokumenta mbi gjendjen e tyre, periudha e kaluar e zëvendësimit të pjesëve etj.

Në kërkesat e bëra, për 2 lotet e zhvilluara në lidhje me argumentimin e nevojave grupi punës nuk ka evidentuar të dhëna për automjetet duke u mbështetur në dokumenta justifikues si gjendja reale e automjeteve si dhe niveli amortizimit të tyre numri i Km të përshkuar, periudha e zëvendësimit të pjesëve, jetëgjatësia e pjesëve të ndëruara etj me qëllim identifikimin e saktë të nevojës për riparime dhe shërbime. Pra nuk janë pasqyruar të dhëna të sakta në lidhje me gjendjen e automjeteve mbi bazën e të cilave duhet të ishte argumentuar nevoja e plotë dhe e qartë mbi zhvillimin e procedurës.

Për sa më sipër në kundërshtim me: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 34 VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 76; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15, neni 22.

Mos disponimi i kartelave të mjeteve bën që të mos evidentohen të dhëna të sakta mbi gjendjen e tyre, numrin e Km të përshkuar, periudha e zëvendësimit të pjesëve, jetëgjatësia e tyre etj, me qëllim identifikimin e saktë të nevojës për riparime dhe shërbime duke iu përmbajtur kërkesave dhe dispozitave ligjore të ligjit në fuqi.

-Specifikime teknike nuk kanë asnjë kërkesë që mallrat duhet të jenë sipas standartit CE.

Në specifikimet teknike nuk është kërkuar që mallrat (vaji i motorrit, filtra etj) pjesë konsumi duhet sipas standartit european CE, të cilat duhet të jenë origjinale duke dhënë garanci të arsyeshme mbi zbatimin e këtyrë kërkesave. Standarti European CE është një tregues që produktet përputhen me direktivat e Bashkimit European të cilat lidhen kryesisht me sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjen e konsumatorit si dhe një sërë elementësh të tjerë të cilët garantojnë që prodhuesi është i justifikuar me vendosjen e produkteve në treg si dhe plotëson kërkesat e cilësisë së produkteve.

-Nuk kërkohet që OE të kenë në staf një elektrout për difektet elektrike të mundshme.

Në hartimin e kriterëve të vecanta të DST, nga ana e NJP rezultoi se nuk është kërkuar që OE ofertues duhet të kenë në stafin e tyre një elektrout në lidhje me difektet elektrike të mundshme të mjeteve.Duke qenë se natyra dhe objekti i procedurës konsiston në atë të shërbimit , në të cilat në shumicën e rasteve parashikimi i nevojave fikse për tu kryer apo problematikave të ndryshme që mund të dalin nga kontrata është i vështirë atëherë nga ana e AK duhet të përcaktontë në DST si

kusht për OE nevojën mbi disponimin në stafin e tyre një elektrout në lidhje me difekte elektrike të mundshme të paparashikuara.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë 863/6 prot, datë 05.02.2024, protokolluar në KLSH, “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

**Pretendimet e subjektit:**

*Sa i përket akt konstatimit nr.3, procedura “Shërbim mirëmbajtje mjete dhe eskavator”, në lidhje me kriteret e kërkuara në DST ju sqarojmë se janë të argumentuara dhe dokumentuara në procesverbalin e hartimit të mbajtur nga njësia e prokurimit.Në lidhje me kriterin e përcaktuar nga ana juaj për kërkesën që OE duhet të disponojnë në stafin e tyre një elektrout ju shpjegojmë...*

**Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:**

*Sa i përket pretendimit të mësipërm sic e kemi theksuar dhe në akt-konstatim AK, Bashkia Maliq, Njësia e Prokurimit (NJP), në DST, duhet të përcaktonte si kriter kualifikues që OE duhet të kenë në stafin e tyre një elektrout për difektet e mundshme elektrike që mund të ndodhin. Duke qenë se kemi të bëjmë me një shërbim i cili ka natyrë specifike, nga ku është e nevojshme në të gjitha rastet të analizohen apo parashikohen të gjithë elementet e mundshme të shërbimit, përfshirë dhe difekte e ndryshme elektrike të cilat janë të shpeshta sidomos për mjetet të cilat vihen cdo ditë në lëvizje, nga ana e AK, duhet që në cdo rast si kusht kualifikimi ndaj OE, të përcaktohet nevoja mbi disponimin e një elektrout.*

***Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.***

**13- Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim mirëmbajtje mjetet dhe eskavatorët” Loti II -“Shërbim mirëmbajtje eskavatorët”, me këto të dhëna:**

1. Urdhër Prokurimi Nr.53 datë 21.06.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar/Me lote /Marrëveshje kuadër” <b>Loti II, REF-36779 -07 – 21 -2022</b>	2. Njësia e Prokurimit Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve <b>Teknike,përlllogaritjes fondit limit</b> Z.G.F Znj.G.G Znj.M.ZH
4. Fondi limit (pa tvsh) Loti II 5,686,433 lekë kë	5. Burimi i Financimit Grand	6. Data e hapjes së tenderit 02.08.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës 1.Loti II-OE “P” shpk  b) kualifikuar me vendimi te KPP	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave 1. O.B 2. B.Q 3. J.H	9. Oferta fituese (pa tvsh) Loti II 5,663,900 lekë Operatori Fitues: “P”shpk
10. Data e lidhjes së kontratës <b>Nr.5287</b> <b>Datë 12.10.2022</b>	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 22,533 lekë	12. Ankimime Nuk Ka
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 1 vit nga lidhja e marrëveshjes kuadër
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi	17. Likuiduar deri dt	



## Etapa përgatitore

### Argumentimi i fondit limit

Në argumentimin e fondit limit në lidhje me lotin e II “Shërbim mirëmbajtje eskavatorësh” grupi punës është mbështetur në nevojat mbi mirëmbajtjen e mjeteve të punës në administrim të Bashkisë në të cilat përfshihen 4 mjete eskavator, ndërkohë që në lidhje me çmimin e përlllogaritur grupi punës është mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta të paraqitura nga OE, “S. G. M” me NIPT L.....C, R.P pa të dhëna NIPT si dhe “S.” me NIPT L.....S me vlerë të pritshme kontratash që mund të lidhen gjatë MK 5,588,165 lekë.

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike. Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike është kryer nga (z.G.F,znj.G.G,znj.M.ZH.). Në lidhje me hartimin e kriteve të kualifikimit grupi punës ka vepruar në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 nga ku hartimi i tyre nuk ka mangësi si dhe nuk është shoqëruar me ankesa nga ana e OE.

Më datë 14.09.2022 u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjese 3(tre)OE si më poshtë:

Loti	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
Loti II	1. “P” shpk	J.....Ë	5,663,900	Kualifikuar

U shpall fitues “P.” shpk me dokumentacion të rregullt kualifikues si dhe oferta e vetme e paraqitur.

## 14- Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rrugë + sheshe qyteti Maliq” me këto të dhëna:

1. Urdhër Prokurimi Nr.67 datë 07.08.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit E hapur” REF-68323 -08 – 11 -2020	2. Njësia e Prokurimit G.F G.G S.K	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike,përlllogaritjes fondit limit G.F G.G S.K
4. Fondi limit (pa tvsh) 12,498,750 lekë	5. Burimi i Financimit Grand	6. Data e hapjes së tenderit 14.09.2020
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës Numër 3 B/OE S’kualifikuar 1 B/OE, Kualifikuar 2 B/OE b) kualifikuar me vendimi te KPP	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave F.D N.GJ A. P	9. Oferta fituese (pa tvsh) Operatori Fitues: BOE “V” ShPK
10. Data e lidhjes së kontratës Datë 14.09.2020	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,256,930	12. Ankimime Nuk Ka
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës Pjesë e dosjes teknike të mbikqyrjes dhe kolaudit	14. Fletë hyrja -----	15. Afati i kontratës 3 muaj
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi -----	17. Likuiduar deri dt -----	

## Etapa përgatitore

### Argumentimi i fondit limit

Në argumentimin e fondit limit fillimisht është miratuar fondi nga Këshilli i Bashkisë e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korçë në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit të bashkisë”, gërma “dh”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”, gërma “c”, të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 32, “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore”, të Ligjit Nr.68/2018, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Më pas nga Inxhinierja e zyrës së Urbanistikës është hartuar projekti dhe preventivi përkatës, mbi zërat e punimeve që do të kryhen në lidhje me objektin e prokurimit. Janë hartuar specifikimet teknike nga ku është përcaktuar mënyra e realizimit të kontratës si dhe lloji i materialit që do përdoret të shoqëruara me certifikata e cilësisë si dhe katalogjet përkatëse. Gjithashtu ka të shpjeguar në mënyrë të detajuar tërësinë e shpenzimeve në lidhje me zërat përkatës të preventivit të hartuar. Në lidhje me çmimin grupi punës është mbështetur në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Fondi limit i përllogaritur është 12,498,750 lekë pa tvsh.

*Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike.* Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike është kryer nga (z.G.F, znj.G.G, znj.M.ZH.). Në lidhje me hartimin e kriteve të kualifikimit grupi punës ka vepruar në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 nga ku hartimi i tyre nuk ka mangësi si dhe nuk është shoqëruar me ankesa nga ana e OE.

Më datë 14.09.2022 u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjesë 3 (tre) OE si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	BOE “V” SHPK	7,241,820	Kualifikuar/Fituesi
2	“A” SHPK	7,893,450	Kualifikuar
3	“B” SHPK	9,516,845	Skualifikuar

Referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka kualifikuar 2 (dy) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues BOE “V.” & “A” shpk, ka s’kualifikuar 1 (një) B/OE të tjerë me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

Operatori Ekonomik “B” SHPK:

*-Nuk siguron stafin e kerkuar te punonjesve te kualifikuar muratore, bojaxhi, pllakashtrues*

*-Mungon vertetimi i shlyerjes se taksave vendore per vitin 2020 ne Bashkine Maliq.*

## 15- Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitim i ujitjes me SEP Pojan, Maliq.” me këto të dhëna:

1. Urdhër Prokurimi		
<b>Nr. 86., datë 15.07.2021</b>		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit <b>E hapur” REF-01412 -07 – 22 -2021</b>	<b>2. Njësia e Prokurimit</b> G.F G.G M.ZH	<b>3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike,përlogaritjes fondit limit</b> G.F G.G M.ZH
4. Fondi limit (pa tvsh) 25,883,003 lekë	<b>5. Burimi i Financimit</b> Grand	<b>6. Data e hapjes së tenderit</b> 20.08.2021

7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës <b>7 B/OE</b> b) S'kualifikuar <b>5 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>2 B/OE</b> ) kualifikuar me vendimi te KPP	<b>8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> 1.F.D 2 S. M 3 A.T	<b>9. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 15,659,544 lekë "Sh" shpk
10. Data e lidhjes së kontratës <b>Datë 14.09.2020</b>	<b>11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 10,223,459 lekë	<b>12. Ankimime</b> Nuk Ka
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës <b>Pjesë e dosjes teknike të mbikqyrjes dhe kolaudimit</b>	<b>14. Fletë hyrja</b> -----	<b>15. Afati i kontratës</b> 3 muaj
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi -----	<b>17. Likuiduar deri dt</b> -----	

### Etapa Përgatitore

#### Argumentimi i fondit limit

Në argumentimin e fondit limit fillimisht është miratuar fondi nga Këshilli i Bashkisë e konfirmuar dhe nga Prefektura e Qarkut Korçë në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit të bashkisë", gërma "dh", neni 64, "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë", gërma "c", të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 32, "Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore", të Ligjit Nr.68/2018, "Për financat e vetqeverisjes vendore", Më pas nga Inxhinierja e zyrës së Urbanistikës është është hartuar projekti dhe preventivi përkatës, mbi zërat e punimeve që do të kryhen në lidhje me objektin e prokurimit. Janë hartuar specifikimet teknike nga ku është përcaktuar mënyra e realizimit të kontratës si dhe lloji i materialit që do përdoret të shoqëruara me certifikata e cilësisë si dhe katalogjet përkatëse. Gjithashtu ka të shpjeguar në mënyrë të detajuar tërësinë e shpenzime në lidhje me zërat përkatës të preventivit të hartuar. Në lidhje me çmimin grupi punës është mbështetur në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Fondi limit i përlogaritur është 12,498,750 lekë pa tvsh.

*Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike.* Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike është kryer nga (z.G.F, znj.G.G, znj.M.ZH.). Në lidhje me hartimin e kriteve të kualifikimit grupi punës ka vepruar në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 nga ku hartimi i tyre nuk ka mangësi si dhe nuk është shoqëruar me ankesa nga ana e OE.

Më datë 14.09.2022 u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjesë 7(tre) OE si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	"Sh" SHPK	15,659,544	Kualifikuar/Fituesi
2	"N " SHPK	17,337,689.58	Kualifikuar
3	"I" SHPK	17,948,057.28	Skualifikuar
4	"A" SHPK	18,942,913.10	Skualifikuar
5	"S" SHPK	19,406,721	Skualifikuar
6	"I." SHPK	24,171,581.14	Skualifikuar
7	BOE "XH" "C" SHPK	24,408,211	Skualifikuar

Referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka kualifikuar 2 (dy) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues OE “Sh” SHPK, ka s’kualifikuar 5 (pesë) B/OE të tjerë me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

Operatori Ekonomik “I” shpk

Bazuar në VKM nr.285, datë 11.05.2021, Neni 82, pika 3, ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë apo më pak se 2% e vlerës ekonomike të ofruar. Pas korigjimit të gabimeve rezultoi se shuma e gabimeve është 1.303.880 lekë, pra më shumë se 2% e 17.948.057.

Operatori Ekonomik “A. 2A- CO” shpk

Operatori ka paraqitur si punë të ngjashme një kontratë me Bashkinë Himarë për objektin: “Ndërtim i depos së re të ujit Kallarë” në vlerën 2.458.959 lekë me tvsh ndërkohë që sipas DST kjo vlerë duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet, pra 10.353.201 lekë pa tvsh.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur akt - mareveshje me prodhuesin/distributorin e shitjes, të firmosur përpara noterit, për furnizimin me Elektropompë Centrifugale (të specifikuar në preventivin e punimeve), ku të specifikohet se në rast të shpalljes fitues në procedurën e prokurimit operatori ekonomik do të furnizohet me Elektropompë Centrifugale gjatë gjithë periudhës të realizimit të kontratës.

Operatori Ekonomik “S” shpk

Mungon Raporti Auditit për Pasqyrat Financiare për vitin 2019 dhe 2020

Bazuar në VKM nr.285, datë 11.05.2021, Neni 82, pika 3, ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë apo më pak se 2% e vlerës ekonomike të ofruar. Pas korigjimit të gabimeve rezultoi se shuma e gabimeve është 407.669 lekë, pra më shumë se 2% e 19.406.721.

Operatori Ekonomik “I.” shpk

Tek Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 mungonjë Inxhinerat dhe mjete fadromë.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vetëdeklarim se prodhuesi është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe në rast se operatori ekonomik shpallet fitues do të paraqesë çertifikatën ISO 9001: 2015 (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë)

Bashkim Operatorësh Ekonomik “XH” shpk dhe “C”

Mungon licenca profesionale e operatorit ekonomik “XH.” shpk

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vetëdeklarim se prodhuesi është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe në rast se operatori ekonomik shpallet fitues do të paraqesë çertifikatën ISO 9001: 2015 (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë).

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

Ligjin Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; VKM RRPP Nr.285 datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit Publik”;

Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;

VKM Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores së sigurisë në kantier”;

VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike”

VKM Nr.68 datë 15.02.2001 “Për miratimin e standarteve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”;

VKM nr.58 datë 01.02.2006 “Për miratimin e rregullores për procedurat e kontrollit të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, për marrjen e certifikatës së vlerësimit të konformitetit për cimentot për të cilat ka rëndësi parësor rezistenca dhe qëndrueshmëria”.

#### **2.4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.**

1. Për objektin “Ndërtim KUZ Njësitë Administrative”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis Bashkisë Maliq dhe BOE “V” sh.p.k & “XH” sh.p.k & “A” sh.p.k me Nr.1717 Prot. datë 16.03.2021.*
- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;*
- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar.*

2) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Bashkisë Maliq dhe personit fizik z.S.K. me Nr.1705 Prot. datë 16.03.2021.*

- *Korrespondencat mes Bashkisë Maliq dhe personit fizik që kryen supervizionimin z. S.K.*

#### Kontratat

Punimet kryhen sipas kontratës për punë publike me Nr.1717 Prot. datë 16.03.2021 me objekt “Ndërtim KUZ Njësitë Administrative” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Maliq, të përfaqësuar nga Titullari z. G.T dhe BOE “V” sh.p.k & “XH” sh.p.k & “A” sh.p.k përfaqësuar me prokurë z. G.A me licencë profesionale përkatësisht NZ.0522/26, NZ. 1251/10 dhe NZ.4929/3. Vlera e kontratës është 14,438,580 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me personit fizik z. S.K me Nr.1705 Prot. datë 16.03.2021 me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0983/2, me vlerë të kontratës së shërbimit 264,707.3 lekë pa TVSH.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas kontratës së shërbimit Nr.4973Prot. datë 22.09.2021 të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe personit fizik z. P.P me licencë MK.1967/1 dhe vlerë të kontratës 47.674.3 lekë me TVSH.

#### Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga Drejtorja e Planifikim Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Maliq. Në këtë projekt janë parashikuar të ndërtohen sistemi i kanalizimeve për fshatrat Vreshtas, Sovjan, Pirc, Symiz dhe Klocë, konkretisht shtrim i tubave të brinjëzuar HDPE të dimensioneve 315mm dhe tub PVC kanalizimi për lidhjen e banesave me diametër 200 mm. Puseta shkarkimi për lidhjet familjare 50x50x100cm dhe puseta kontrolli 0.8x0.8x1.5m me kapak gize. Gjithashtu për fshatrat Vlocisht dhe Klocë është parashikuar sistemi i kanaleve të hapura me mur guri dhe struktura monolite betoni të armuar. Financimi i realizimit të punimeve civile, mbikëqyrja dhe kolaudimi është kryer me të ardhurat e vetë bashkisë.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 016.03.2021 dhe administruar në Bashkinë Maliq me Nr.1741 Prot. datë 17.03.2021.

Gjatë zbatimit të punimeve, për të zbatuar punimet sipas KTP dhe KTZ sasia e volumeve ndryshon sipas terrenit dhe problemeve që hasen gjatë zbatimit. Për këtë arsye mbikëqyrësi i punimeve ka përgatitur relacionet përkatëse dhe këto ndryshime volumesh janë brenda vlerës së kontratës fillestare. Sipas njoftimit të sipërmarrësit punimet kanë përfunduar më datë 16.06.2021 brenda afati të përcaktuar në kontratën fillestare.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim KUZ Njësitë Administrative”.		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr.1717 Prot. datë 16.03.202	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 14,438,580 lekë <b>BOE “V” sh.p.k &amp; “XH” sh.p.k &amp; “A” sh.p.k</b>	<b>16.Likuiduar deri dt</b>
<b>17-Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me TVSH 14,438,388 lekë -Vlera pa TVSH 12,031,990 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 3 muaj, Zbatuar 3 muaj. Fillimi punimeve: 16.03.2021 Përfundimi punimeve: 16.06.2021	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> P.F.S.K	Licenca Nr: MK. 0983/2	Kontrata Nr.1705 Prot. datë 16.03.2021
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> P.F.P.P	Licenca Nr: MK.1967/1	Kontrata Nr.4973Prot. datë 22.09.2021
<b>22.Akt Kolaudimi</b> datë 04.10.2021	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> Datë 25.11.2022	

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **143,686 lekë pa TVSH**. Nuk janë kryer verifikime në terren për arsyen se punimet e kryera janë të maskuara si pusetat janë në funksion.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në projekt dhe në preventivin bazë dhe atë të rishikuar është parashikuar që tubat e kanalizimeve të brinjëzuar të mbulohen me rërë. Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike, referuar materialit fotografik që ndodhet në të u konstatua se gjithë gjatësia e tubacionit të brinjëzuar HDPE nuk është mbuluar me shtresën e rërës. Referuar analizave të çmimit për F.V tub i brinjëzuar HDPE vlera e rërës për tub d=315mm është 154.58 lekë/ml por duke u bazuar në çmimin e ofertës për zërin F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm (përfshi 0.15 m<sup>3</sup> rërë) që është 900 lekë/m duke kryer ponderimin me çmimin e manualit rezulton se kostoja e rërës është 71 lekë/ml. Sipas situacionit përfundimtar dhe librezës së masave sasia totale e tubit të brinjëzuar HDPE me diametër 315 mm është 2024.3 ml, konkretisht 1002.5 m në fshatin Vreshtas, 560 m në fshatin Sovjan, 493 m në fshatin Pirg 177 m, në fshatin Symiz 40.8 m në fshatin Klocë 311 m. dhe 60402.17 lekë pa TVSH (1020.5m x 246.62 lekë/ml). Për sa më sipër kontraktori ka përfituar më tepër volumin e rërës për mbulimin e tubit në zërin F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm (përfshi 0.15 m<sup>3</sup> rërë) në vlerën prej 143,686 lekë pa TVSH (2024.3 m x 71 lekë/m).

<b>1. Titulli i gjetjes:</b>	Punime të situacionuara por të kryera në fakt jo në përputhje me specifikimet teknike dhe detajit të projektit.
<b>Situata:</b>	Në objektin sipas kontratës për punë publike me Nr.1717 Prot. datë 16.03.2021 me objekt <u>“Ndërtim KUZ Njësitë Administrative”</u> të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Maliq dhe BOE “V” sh.p.k & “XH” sh.p.k & “A” sh.p.k me Nr.1717 Prot. datë 16.03.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 14,438,580 lekë me TVSH lekë me afat përfundimi të punimeve 3 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Projekti fillestar;</i></li> <li>• <i>Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);</i></li> <li>• <i>Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;</i></li> <li>• <i>Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ndryshimet e miratuara nga AK;</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Korrespondencat mes Bashkisë Maliq dhe personit fizik që kryen supervizionimin z. S.K.</i></li> </ul> </li> </ul> <p>si dhe nga verifikimi i detajuar i analizës së çmimeve rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="500 447 1411 596"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Rrjeti i kanalizimeve</td> <td>F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm (përfshi 0.15 m3 (rërë)</td> <td>143,686</td> </tr> <tr> <td colspan="3" style="text-align: right;">SHUMA</td> <td><b>143,686</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.1.</p>	Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	Rrjeti i kanalizimeve	F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm (përfshi 0.15 m3 (rërë)	143,686	SHUMA			<b>143,686</b>
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)										
1	Rrjeti i kanalizimeve	F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm (përfshi 0.15 m3 (rërë)	143,686										
SHUMA			<b>143,686</b>										
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 <u>ku përcaktohet se:</u> “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</p> <p>-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 <u>ku përcaktohet se:</u> “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasisitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”</p> <p>-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3.</p> <p>- Kontrata e shërbimit të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe Personit Fizik me Nr.1705 Prot. datë 16.03.2021 me objekt: “Mbikëqyrje objekti Ndërtim KUZ Njësitë Administrative”, Neni 5 “Detyrimet e kontraktuesit”.</p>												
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 143,686 lekë pa TVSH.												
<b>Shkaku:</b>	Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit.												
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.												
<b>Rekomandimi:</b>	Bashkia Maliq të marrë masa, për arkëtimin e shumës 143,686 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “V ” sh.p.k & “XH ” sh.p.k & “A ” sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr.1717 Prot. datë 16.03.2021 për realizimin e punimeve civile.												

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi Person Fizik z. S.K sipas kontratës së shërbimit Nr.1705 Prot. datë 16.03.2021 me objekt: “Mbikëqyrje objekti Ndërtim KUZ Njësitë Administrative”.*

2. Për objektin **“Ndërtim KUZ Vlocisht Faza I”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

3) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis Bashkisë Maliq dhe BOE “A” sh.p.k & “N” sh.p.k me Nr.4699 Prot. datë 28.09.2020.*
- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;*
- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;*

4) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Bashkisë Maliq dhe personit fizik z. A.H me Nr.4797 Prot. datë 01.10.2020.*

- *Korrespondencat mes Bashkisë Maliq dhe personit fizik që kryen supervizionimin z. A.H.*

#### Kontratat

Punimet kryhen sipas kontratës për punë publike me Nr.4699 Prot. datë 28.09.2020 me objekt **“Ndërtim KUZ Vlocisht Faza I”** të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Maliq, të përfaqësuar nga Titullari z. G.T dhe BOE “A” sh.p.k & “N” sh.p.k me përfaqësues z. F.A me licenca profesionale NZ.4929/3 & NZ.4614/7. Vlera e kontratës është 10,322,460 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 2 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me personit fizik z. A.H me Nr.4797 Prot. datë 01.10.2020 me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2091/2, me vlerë të kontratës së shërbimit 247,739 lekë me TVSH.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas kontratës së shërbimit Nr.6672Prot. datë 31.12.2020 të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe personit fizik z. P.P me licencë MK.1967/1 dhe vlerë të kontratës 37.160.8 lekë me TVSH.

#### Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga Studio Projektimi “E” sh.p.k. Në këtë projekt janë parashikuar të ndërtohen sistemi i kanalizimeve për fshatin Vlocisht, konkretisht shtrim i tubave të brinjëzuar HDPE të dimensioneve 315mm, 350mm, 400mm, 500mm dhe tub PVC kanalizimi për lidhjen e banesave me diametër 110 mm. Puseta shkarkimi për lidhjet familjare 50x50x100cm, puseta kryesore 1x1.5x2m dhe puseta kontrolli 0.8x0.8x1.5m me kapak gize. Financimi i realizimit të punimeve civile, mbikëqyrja dhe kolaudimi është kryer me të ardhurat e vetë bashkisë.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 01.10.2020 dhe administruar në Bashkinë Maliq me Nr.4697/1Prot. datë 02.10.2020.

Gjatë zbatimit të punimeve, për të zbatuar punimet sipas KTP dhe KTZ sasia e volumeve ndrushon sipas terrenit dhe problemeve që hasen gjatë zbatimit. Për këtë arsye mbikëqyrësi i punimeve ka përgatitur relacionet përkatëse dhe këto ndryshime volumesh janë brenda vlerës së kontratës fillestare. Miratimi i ndryshimeve në preventiv i volumeve (+/-) është bërë me Vendimin Nr.04 datë 09.10.2020. Sipas njoftimit të sipërmarrësit punimet kanë përfunduar më datë 01.12.2020 kjo shkresë e administruar në bashki me Nr.4697/2Prot. datë 01.12.2020.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim KUZ Vlocisht Faza I”.</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr.4699 Prot. datë 28.09.2020	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 10,322,460 lekë BOE “A” sh.p.k & “N” sh.p.k	<b>16.Likuiduar deri dt</b>



<b>17-Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me TVSH 10,322,414 lekë -Vlera pa TVSH 8,602,011 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 2 muaj, Zbatuar 2 muaj. Fillimi punimeve:01.10.2020 Përfundimi punimeve: 01.12.2020		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> P.F.A.H	Licenca Nr: MK. 2091/2	Kontrata Nr.4797 Prot. datë 01.10.2020		
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> P.F.P.P	Licenca Nr: MK.1967/1	Kontrata Nr.6672Prot. datë 31.12.2020		
<b>22.Akt Kolaudimi</b> datë 08.02.2021	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> Datë 16.05.2022			

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **106,202.6 lekë pa TVSH**. Nuk janë kryer verifikime në terren për arsyen se punimet e kryera nuk janë të maskuara si pusetat janë në funksion.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në projekt dhe në preventivin bazë dhe atë të rishikuar është parashikuar që tubat e kanalizimeve të brinjëzuar të mbulohen me rërë. Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike, referuar materialit fotografik që ndodhet në të u konstatua se gjithë gjatësia e tubacionit të brinjëzuar HDPE nuk është mbuluar me shtresën e rërës. Referuar analizave të çmimit për F.V tub i brinjëzuar HDPE vlera e rërës është: për tub d=315mm vlera e rërës është 154.58 lekë/ml; për tub d=350mm nuk ka analizë çmimi por vlera e rërës do të merret 154.58 lekë/ml sa d=315mm; për tub d=400mm vlera e rërës është 194.7 lekë/ml dhe për tub d=500mm vlera e rërës është 246.62 lekë/ml. Sipas situacionit përfundimtar gjatësia e vendosur, tub i brinjëzuar d=315mm është 472 ml ku vlera e rërës është 10944.26 lekë pa TVSH ; tub i brinjëzuar d=350mm është 759 ml ku vlera e rërës është 17598.93 lekë pa TVSH ; tub i brinjëzuar d=400mm është 466.5 ml ku vlera e rërës është 17257.23 lekë pa TVSH ; tub i brinjëzuar d=500mm është 1020.5 ml ku vlera e rërës është 60402.17 lekë pa TVSH. Për sa më sipër kontraktori ka përfituar më tepër volumin e rërës për mbulimin e tubit në zërin F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm, d=350mm, d=400mm, d=500mm në vlerën prej 106,202.6 lekë pa TVSH.

<b>1. Titulli i gjetjes:</b>	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt dhe të dëmtuara.
<b>Situata:</b>	<p>Në objektin <b><u>"Ndërtim KUZ Vlocisht Faza I"</u></b> sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe BOE "A" sh.p.k &amp; "N" sh.p.k me Nr.4699 Prot. datë 28.09.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 10,322,460 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 2 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Projekti fillestar;</i></li> <li>• <i>Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);</i></li> <li>• <i>Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;</i></li> <li>• <i>Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;</i></li> <li>• <i>Ndryshimet e miratuara nga AK;</i></li> <li>• <i>Korrespondencat midis Bashkisë Maliq dhe personit fizik që kryen supervizionimin z. A.H.</i></li> </ul> <p>si dhe nga verifikimi i detajuar i analizës së çmimeve rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas</p>

	<p>specifikimeve teknike dhe detajit të projektit. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Rrjeti i kanalizimeve</td> <td>F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm (përfshi 0.15 m3 (rërë)</td> <td>106,202</td> </tr> <tr> <td colspan="3" style="text-align: right;">SHUMA</td> <td><b>106,202</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.2.</p>	Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	Rrjeti i kanalizimeve	F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm (përfshi 0.15 m3 (rërë)	106,202	SHUMA			<b>106,202</b>
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)										
1	Rrjeti i kanalizimeve	F.V tuba të brinjëzuar HDPE d=315mm (përfshi 0.15 m3 (rërë)	106,202										
SHUMA			<b>106,202</b>										
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”</i>, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</i></p> <p>-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 <i>“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”</i>, Kreu II, Pika 8.1 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasisë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”</i></p> <p>-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3.</p> <p>- Kontrata e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Maliq dhe personit fizik me Nr.4797 Prot. datë 01.10.2020 me objekt: <i>“Mbikëqyrje objekti Ndërtim KUZ Vlocisht Faza I”</i>, Neni 5 <i>“Detyrimet e kontraktuesit”</i>.</p>												
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 106,202.6 lekë pa TVSH.												
<b>Shkaku:</b>	Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit.												
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.												
<b>Rekomandimi:</b>	Bashkia Maliq të marri masa, për arkëtimin e shumës 106,202.6 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “A” sh.p.k & “N” sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr.4699 Prot. datë 28.09.2020 për realizimin e punimeve civile.												

## 2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 863/1 prot; datë 10.10.2023, me objekt: **“Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit”**, prej datës 01.01.2020 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

**2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;**

**2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në**

***bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;***

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 863/1 prot., datë 10.10.2023, me objekt: **“Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, prej datës 01.01.2020 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:**

- *Dokumentacioni në sistemin “E leje”;*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;*
- *Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;*
- *Dokumente të tjera nga arkiva, etj.*

Bashkia Maliq ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.5, datë 14.10.2020.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. *Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura*
2. *Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik*
3. *Saktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë*
4. *Dhënia e certifikatës së përdorimit*
5. *Deklaratat paraprake për kryerje punimesh*

➤ **Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për vitin 2020-2022**

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Maliq, gjatë periudhës 01.01.2020 deri më 31.12.2022 janë miratuar **23 leje zhvillimi, 6 leje ndërtimi** për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, **12 leje ndërtimi** për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>, **5 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup>, **39 deklarata** paraprake përkryerje punimesh dhe **18 certifikata përdorimi**, të paraqitura në Aneksin L1 dhe L2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar disa nga rastet e lejeve së ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> dhe disa miratime të certifikatave të përdorimit, të paraqitur në Aneksin L3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosrespektimin e kushteve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për ndërtimin e objekteve të prodhimit, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore.

**Titulli i gjetjes 1:** Mosrespektimi i kushteve të përcaktuara në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktuara sipas Vendimit.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua që në lejen e ndërtimit të miratuar nuk respektohet vëllimi maksimal i objektit të lejuar dhe respektimin e distancës nga kufiri i pronës, në përputhje me tipologjinë e ndërtimit, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1. **“Magazinë frigoriferike 1 kat”**, miratuar me vendimin Nr. 2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq. Në bazë të Planit të

Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.5, datë 14.10.2020, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësisë **MQ\_B\_EB1\_183/1**, në sistemin Bujqësor (B). Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 6446/2 Prot., datë 13/01/2021. Objekti i propozuar për zhvillimi bën pjesë në strukturat në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe zhvillimi i objektit bazohet në rregullat dhe kriteret për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore, në bazë të VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 "*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore*", i ndryshuar. Në bazë këtij vendimi, në pikën 10, përcaktohet që ndërtimet e objekteve për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme: **a) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej  $1 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ; b) Të respektojnë distancat minimale 7 metër nga kufijtë e pronës dhe 10 m nga ndërtesa të tjera.**

a) Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, vëllimi i objektit e tejkalon intensitetin e ndërtimit prej  $1 \text{ m}^3/\text{m}^2$ , të pasqyruar në llogaritjen e mëposhtme:

$$7.65\text{m} \times 50\text{m} \times 21\text{m} = 8032.5 \text{ m}^3$$

$$21\text{m} \times 3.4\text{m} \times 50\text{m} / 2 = 1785 \text{ m}^3$$

$$\text{Vëllimi i objektit} = 8032.5 + 1785 = 9817.5 \text{ m}^3$$

Parcela në të cilën zhvillohet objekti ka një sipërfaqe prej  $6715 \text{ m}^2$

**Intensiteti i ndërtimit është  $1.46 \text{ m}^3/\text{m}^2$ , duke tejkeluar intensitetin e lejuar prej  $1 \text{ m}^3/\text{m}^2$ .**

b) Në raport me kondicionin e respektimit të distancave, sipas pikë 10/b, të VKM-së 283, evidentohet që nuk respektohet distanca prej 7 metrash në orjentimin verior. Planvendosja e miratuar nuk përputhet me projektin e ndërtimit. Ndryshe nga projekti arkitektonik, në planvendosjen e miratuar pasqyrohet vetëm njëra strehë në orjentimin perëndimor, ndërsa streha tjetër e pozicionuar në krahun verior e evidentuar në planin e mbulimit, nuk paraqitet, **duke mos respektuar distancën e përcaktuar në kriteret e zhvillimit prej 7 metër nga kufiri i pronës**. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në neni 34, në pikën 7, përcaktohet se "*Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të quhet faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë distancat nga trupi i rrugës. Nuk kërkohet të respektojnë distancat e këtij neni elementet arkitektonike të fasadave, të cilat nuk përbëjnë sipërfaqe të shfrytëzueshme dhe nuk dalin nga fasada më shumë se 0.5 metër.*" Në rastin e mësipërm, streha në orjentimin verior e tejkalon përmasën e 0.5 metër. Më poshtë pasqyrohet plani i mbulimit në të cilin evidentohen të dy strehat.

c) Lartësia totale e ndërtimit nga 6.6 metra e pasqyruar tek të dhënat e zhvillimit është 10.05 metra në kulmin e parë të çatisë nga kuota e sistemimit dhe 11.55 metra në lartësinë e murit perimetral të objektit nga kuota e sistemimit, duke tejkeluar lartësinë maksimale të lejuar prej 8 metrash, sipas njësisë **MQ\_B\_EB1\_183/1**.

**2. "Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat"**, miratuar me vendimin Nr. 215-2021/6 Prot., datë 28/04/2021, me zhvillues "N" ShPK, në adresën Fshati Drithas, Libonik, Maliq. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.5, datë 14.10.2020, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësisë **MQ\_B\_B2\_246/2**, në sistemin Bujqësor (B). Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 5733/5 Prot., datë 08/01/2021. Në bazë të shkresës së AZHT-së dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, objekti i propozuar për zhvillimi bën pjesë në strukturat në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe zhvillimi i objektit bazohet në rregullat dhe kriteret për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore, në bazë të VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 "Për

përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar. Në bazë këtij vendimi, në pikën 4, përcaktohet që për stallat që mbarështojnë 10-50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 10 metër, ndërsa karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 3. Në bazë të pikës 3, përcaktohet që stallat që mbarështojnë 10- 50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, duhet të kenë këto karakteristika:

a) Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:

- 10 metër nga kufijtë e pronës;

- 500 metër nga qendrat e banuara;

- 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

b) Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 4,50 m;

c) Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 0.5 m<sup>3</sup>/m<sup>2</sup>

b) Lartësia totale e ndërtimit nga objekti në lartësinë e 1 kati është në lartësinë e dy kateve, nga lartësia 3.65 metra - 6.5 metra e pasqyruar tek të dhënat e zhvillimit është 7.80 metra në kulmin e çatisë nga kuota e sistemit **duke tejkaluar numrin e kateve dhe lartësinë maksimale të lejuar prej 4.50 metrash**, sipas përcaktimit ligjor të pikës 3, të VKM-së 283. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në neni 37, në pikën b, përcaktohet se: "Për llogaritjen apo vlerësimin sipas përcaktimve të kësaj rregulloreje, lartësia e ndërtimeve shprehet gjithmonë njëkohësisht në numër katesh dhe metra. Lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit nga kuota mesatare e sistemit të trotuarit rrethues të objektit në terren të sheshtë, deri në kulmin e mbulesës nga jashtë, për mbulesa të pjerrëta.

c) Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, **vëllimi i objektit e tejkalon intensitetin e ndërtimit prej 1 m<sup>3</sup>/m<sup>2</sup>, të pasqyruar në llogaritjen e mëposhtme:**

$$3.65 \text{ m} \times 80 \text{ m} \times 25 \text{ m} = 7300 \text{ m}^3$$

$$3.15 \text{ m} \times 80 \text{ m} \times 25 \text{ m} / 2 = 3150 \text{ m}^3$$

$$\text{Vëllimi i objektit} = 7300 + 3150 = 10450 \text{ m}^3$$

Parcela në të cilën zhvillohet objekti ka një sipërfaqe prej 14500 m<sup>2</sup>

**Intensiteti i ndërtimit është 0.72 m<sup>3</sup>/m<sup>2</sup>, duke tejkaluar intensitetin e lejuar prej 0.5 m<sup>3</sup>/m<sup>2</sup>.**

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 7, datë 30.11.2023

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Vendimi Nr.283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore".

-VKM 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 35, "Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës".

-VKM 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 37, "Lartësia e ndërtimeve", pika 1, gërma b;

-Ligji Nr.107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor.

**Ndikimi/Efekt:** Mosrespektimi i kushteve të përcaktuara në bazë të rregullave dhe kriterëve të përcaktura sipas legjislacionit në fuqi, ndikon në realizimin e ndërtimeve që nuk përkojnë dhe përputhen me tipologjinë e ndërtimit në tokat bujqësore. Tejkalimi i lartësisë në ndërtimit ndikon në mosrespektimin e lartësisë së lejuar të tipologjisë së ndërtimit, duke rritur vëllimin e objektit dhe rritjen e intensitetit të ndërtimit, duke mosrepektuar kushtet e përcaktura për ndërtimet në

tokat bujqësore. Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës cënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe zhvillimin e mëtejshëm të ndërtimeve të reja në parcelat me të cilat kufizohet, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Maliq.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Maliq të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara për objektet me funksion prodhimt, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, të plotësojnë të gjitha kriteret dhe rregullat për zhvillimin e tyre, duke respektuar lartësinë, intensitetin, vëllimin dhe distancat.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit nr.1 të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z.V.Q ; znj.A.SH .*

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2 për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z.R.S.*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhshmërinë e planvendosjes së miratuar në lejen e ndërtimit, të dhënave të treguesve të zhvillimit dhe projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje.

**Titulli i gjetjes 2:** Mospërputhja ndërmjet planvendosjes së miratuar në lejen e ndërtimit, të dhënave të treguesve të zhvillimit dhe projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se plani i vendosjes së strukturës të miratuar për leje ndërtimi, si edhe të dhënat e treguesve të zhvillimit të pasqyruar në planvendosje, nuk përputhen me projektin e ndërtimit. Gjithashtu në planvendosjen e miratuar nuk evidentohet aksesi për në parcelën në të cilën do të zhvillohet ndërtimi. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1. "*Magazinë frigoriferike 1 kat*", miratuar me vendimin Nr.2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Përg, Maliq. Në bazë të lejes së ndërtimit, planvendosjes dhe të dhënave të zhvillimit të pasqyruara në planvendosjen është miratuar për zhvillimin e një objekti në lartësinë e 1 kati. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit dhe relacionit teknik, objekti zhvillohet në lartësinë e dy kateve të ndërtimit. Në planvendosjen e miratuar nuk janë paraqitur të dhënat e sakta, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, neni 15, pika 1, gërma c; Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese. Nga verifikimi i projektit të ndërtimit, *sipërfaqja totale e ndërtimit nga 1050 m<sup>2</sup> është 1203.09 m<sup>2</sup>*, pasi objekti është në lartësinë e dy kateve dhe sipërfaqja e katit të dytë duhet të përfshihet në sipërfaqen e përgjithshme të ndërtimit. *Ndërsa vëllimi i objektit nga 6930 m<sup>3</sup> i pasqyruar tek të dhënat, nga verifikimi i projektit të ndërtimit është 9817.5 m<sup>3</sup>.*

2. "*Objekt 6 kate nga te cilat 5 kate banimi dhe nje kat i alternuar me njësi shërbimi dhe ambiente banimi dhe 1 kat parkimi nëntokë*", miratuar me vendimin Nr.78/2, datë 18/02/2020, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në Maliq. Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr.4412/2 Prot., datë 07/11/2019. Në bazë të shkresës Nr. 2752 Prot., më 04.11.2019, në të cilin shprehet mendimi i AZHT-së në lejen e zhvillimit, përcaktohet që: "Parcela e propozuar për

zhvillim bën pjesë në rastet përjashtimore sipas pikës 2, gërma a) dhe ë), të Vendimit Nr.1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”. Në zbatim të Vendimit Nr. 5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”, parcela e propozuar për zhvillim ndodhet brenda zonës së shpallur të urbanizuar. Në bazë të 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 14, në pikën 2, në kushtet për lëshimin e lejes së ndërtimit përcaktohet se: “Dhënia e lejes së ndërtimit kushtëzohet nga ekzistenca e infrastrukturës kryesore dhe dytësore në njësinë ku kërkohet ndërtimi. Ndërtimi i infrastrukturës mund të realizohet, sipas marrëveshjes me autoritetin e planifikimit dhe zhvillimit, me kontribut financiar ose në natyrë, sipas formave të përcaktuara në këtë rregullore.”. Në planvendosjen e miratuar nuk evidentohet aksesimi nëpërmjet infrastrukturës dytësore për në parcelën në të cilën do të zhvillohet ndërtimi. Gjithashtu edhe në dokumentacionin e pronësisë, në hartën treguese, evidentohet që parcela është e shkëputur nga aksi kryesor rrugor dhe për aksesimin e objektit përshkohet nëpërmjet një tjetër pasurie kufizuese.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 7, datë 30.11.2023

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, gërma c; Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese.

- Në bazë të 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 14, në pikën 2.

**Ndikimi/Efekti:** Mospasqyrimi i tyre në planvendosje ndikon në mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit të territorit, respektimin e distancave nga kufiri i pronës, distanca nga objekti në objekt dhe nga trupi i rrugës.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Maliq.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPKZHT Maliq të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar përputhshmërinë ndërmjet planit të vendosjes së strukturave dhe projekti të ndërtimit. Gjithashtu të verifikohet ekzistenca e infrastrukturës kryesore dhe dytësore, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z.V.Q; znj.A.SH.*

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.K.Q; znj.J.B.*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit edhe për një tipologji të ndryshme ndërtimi nga ajo e lejuar në zonë.

**Titulli i gjetjes 3:** Miratimi i lejes së ndërtimit për një tipologjisë të ndryshme ndërtimit nga ajo e lejuar në njësinë përkatëse.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se, në lejet e ndërtimit të miratuara për zhvillimin e objekteve me destinacion bujqësor/ blektoral, në tokë bujqësore, në projektin e ndërtimit dhe relacionin teknik janë propozuar edhe funksione të tjera, që nuk janë në përputhje me tipologjinë dhe destinacionin e lejuar. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

1. *"Magazinë frigoriferike 1 kat"*, miratuar me vendimin Nr. 2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq. Objekti nuk ka vetëm funksion magazinimi dhe grumbullimi të produkteve bujqësore, por në të pozicionohen edhe ambjente të tjera të tilla si: zyra për administratën (sallë mbledhjesh, zyrë për drejtorin, zyrë finance, arkiv), ambjent gatimi, tualete, dushem etj, hapësira të cilat evidentohen në projektin arkitektonik dhe përshkruhen në relacionin Teknik. Gjithashtu në verifikimin e ekstraktit historik të QKB-së, fusha e veprimtarisë është "grumbullim, përpunim, magazinim, import-eksport fruta perime si dhe tregti me shumicë e pakicë të fruta perimeve". **Funksioni i zyrave dhe administratës nuk përfshihet në tipologjinë e objekteve sipas VKM-së 283**, datë 01.04.2015, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhim, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blektorale, në tokë bujqësore"*, i ndryshuar. Në bazë të VKM-së 283, në kreun II.a, në pikën 3 përcaktohet që: *"Leja e ndërtimit për objektet e përcaktuara në kreun I, të këtij vendimi, jepet vetëm me kushtin e ruajtjes dhe mosndryshimit të destinacionit për qëllim bujqësor/blektoral të objektit për të cilin është lëshuar."*

2. *"Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat"*, miratuar me vendimin Nr. 215-2021/6 Prot., datë 28/04/2021, me zhvillues "N" ShPK, në adresën Fshati Drithas, Libonik, Maliq. Leja e ndërtimit është miratuar për zhvillimin e një objekti të tipologjisë stallë për 50 krerë gjedhë, në lartësinë e 1 kati. Në planvendosjen e miratuar nuk zhvillohet vetëm objekti i stallës, por pozicionohet edhe gjurma e një objekti që në projektin arkitektonik përcaktohet si objekt ndihmës funksional në lartësinë e dy kateve dhe një mbulesë për parkimin. Në projektin e ndërtimit, përkatësisht në relacionin teknik, në projektin hidroteknik, në projektin elektrik, në projektin e instalimeve të ngrohje-ftohjes dhe në projektin e mbrojtjes kundra zjarrit, objekti që në planvendosje dhe në projektin arkitektonik përcaktohet si objekt ndihmës funksional, **ka funksion objekti zyrash administrative, në mospërputhje me tipologjinë e lejuar të ndërtimit sipas VKM-së 283 dhe në mospërputhje me njësinë strukturore MQ\_B\_B2\_246/2**. Nga verifikimi i projektit në objektin e propozuar përfshihen ambiente zyrash, sallë mbledhjesh, kuzhinë, ambjente të nyjeve sanitare dhe ambjent fjetjeje, të pasqyruara në planimetritë e mëposhtme. Referuar shkresës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Nr. 11519 Prot., datë 29.12.2020 në sistemin elektronik të lejeve me lëndë "Kthim përgjigje mbi kërkesën për vlerësim të projekt propozimit: Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat + hangar 1 kat + zyra administrative", me vendndodhje në fshatin Drithas, Bashkia Maliq me zhvillues shoqërinë "N." ShPK, ku citohet shprehimisht: **Objekti "zyra" nuk përfshihet në tipologjinë e objekteve sipas VKM-së nr.283, datë 01.04.2015**, *"Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhim, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blektorale, në tokë bujqësore"*, i ndryshuar. Në miratimin e lejes së ndërtimit, me anë të shkresës me nr.1972, datë 02.03.2021, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka shprehur dakortësinë për përcaktimin në tipologjinë e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blektorale në tokë bujqësore, për objektin *"Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat"*, por pa përfshirë një godinë me funksion zyrash. Në bazë të **Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit** *"Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)"*, në parcelën e propozuar që ndodhet në sistemin Bujqësor (B), **objekti me funksion zyrash/ administratë në lartësinë e dy kateve nuk bën**



**pjesë në objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sectorial dhe autoritetet vendore të zhvillimit të territorit nuk lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi.**

*Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 7, datë 30.11.2023*

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- Vendimi Nr.283, datë 1.4.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”.

-Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)”.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e verifikimit të projektit të ndërtimit dhe tipologjisë së ndërtimit të lejuar, ndikon në lejimin e ndërtimit të tipologjive të ndryshme nga ajo e lejuar, në mospërputhje me njësinë në të cilën zhvillohet dhe kriteret të cilat lejohen në tokë bujqësore.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Maliq.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPKZHT Maliq të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa verifikuar tipologjinë e ndërtimit të propozuar në projektin e ndërtimit, që të jetë në përputhje me tipologjinë dhe destinacionin e lejuar sipas njësinë përkatëse.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z.V.Q; znj.A.SH.*

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z.R.S.*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **3 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja në sistemin e-Leje të dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e çertifikatës së përdorimit.

**Titulli i gjetjes 4:** Mosparaqitja në sistemin e-Leje e dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e çertifikatës së përdorimit.

**Situata:** Nga auditimi i çertifikatave të përdorimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e çertifikatës së përdorimit. Në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë përdorimi është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar); Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti “as build” i zbatuar. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratur për certifikatë përdorimi, me objekt:

1. “**Rikonstruksion godinë 2 kate + shtesë anësore (përshtatje për agroturizëm)**”, miratuar me vendimin Nr. 3267/2, datë 26/07/2021, me zhvillues z.TH.N, në adresën fshati Zvirinë, Njësia Administrative Pirg, në Maliq.

2. “**Rikonstruksion lokal dhe shtesë kati deri 3 kate**”, miratuar me vendimin Nr.6205/4 Prot.,

datë 23/04/2021, me zhvillues z.A.B dhe znj.Z.B, në Maliq.

3. **“Banesë individuale (2 kate)”**, miratuar me vendimin Nr. 5519/2 Prot., datë 14/12/2022, me zhvillues znj.R.M, në adresë Shëngjegj, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 7, datë 30.11.2023

**Kriteri:** VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma g.

**Ndikimi/Efekti:** Mospasqyrimi i dokumentacionit të plotë për pajisjen me certifikatë përdorimi ndikon në miratimin e saj jo në konformitet me të gjitha kriteret që duhet të plotësojë, duke ndikuar në realizimin e projektit të ndërtimit në terren jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Maliq.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Nga DPZHT Maliq të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z. V.Q, Inspektorët e zonës.*

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; z.A.E; znj. J.B; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z.R.S, Inspektorët e zonës.*

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.3, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; z.A.T; z. V.Q; z.R.S; Inspektorët e zonës.*

Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatuan 4 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara.

**Titulli i Gjetjes 5:** Miratimi i certifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar dhe zbatimin e punimeve në terren.

**Situata:** Nga auditimi i procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar nuk përputhej me zbatimin në terren të objektit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura me objekt:

1. **“Rikonstrukcion godinë 2 kate + shtesë anësore (përshtatje për agroturizëm)”**, miratuar me vendimin Nr. 3267/2, datë 26/07/2021, me zhvillues z.TH.N, në adresën fshati Zvirinë, Njësia Administrative Pirc, në Maliq. Në bazë të verifikimit të fotove të realizuara të objektit pas përfundimit të punimeve, të ngarkuara në sistemin e-leje, dhe projektit të ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, evidentohen disa ndryshime në realizimin dhe trajtimin e fasadave. Në katin përdhe nga trajtimi me vetrata druri dhe element ndarës të trajtuar me veshje me gur, është trajtuar me dritare duralumini, pa element ndarës. Gjithashtu në fasadën veriore mungojnë elementët dekorativë arkitektonik dhe nuk janë vendosur parmakët e drurit në ballkone. Ndërsa në fasadën perëndimore, në faqen kallkan, në ndryshim nga projekti i ndërtuar janë realizuar disa carje për ndërtimin e dy dritareve.

2. **“Rikonstrukcion lokali dhe shtesë kati deri 3 kate”**, miratuar me vendimin Nr.6205/4 Prot., datë 23/04/2021, me zhvillues z.A.B dhe znj.Z.B, në Maliq. Në bazë të verifikimit të fotove të

realizuara të objektit pas përfundimit të punimeve, të ngarkuara në sistemin e-leje, dhe projektit të ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, evidentohet që realizimi i objektit në terren nuk përputhet me projektin e ndërtimit. Gjithashtu nga verifikimi i fotogramit ajror evidentohet që në vitin 2022, objekti ka realizuar një shtesë volumi, duke shtuar një çati në katin e fundit të objektit, të evidentuar në fotot e mëposhtme.

**3. “Banesë individuale (2 kate)”**, miratuar me vendimin Nr. 5519/2 Prot., datë 14/12/2022, me zhvillues znj.R.M, në adresë Shëngjegj, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq. Në bazë të verifikimit të fotove të realizuara të objektit pas përfundimit të punimeve, të ngarkuara në sistemin e-leje, dhe projektit të ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, evidentohen disa ndryshime në realizimin e fasadave, ndryshim në fasadën perëndimore mbi portën hyrëse të garazhdit dhe zgjerimi i ballkonit.

**4. “Objekt 6 kate nga te cilat 5 kate banimi dhe nje kat i alternuar me njësi shërbimi dhe ambiente banimi dhe 1 kat parkimi nëntokë”**, miratuar me vendimin për leje ndërtimi me Nr.78/2, datë 18/02/2020 dhe me vendimin për certifikatë përdorimi me Nr.1849/2, datë 06/05/2022, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në Maliq. Gjatë punimeve të ndërtimit është pajisur me leje për ndryshim projekti gjatë ndërtimit të miratuar me vendimin Nr.6048/2 datë 18.11.2021, për ndryshimin e funksionit të katit përdhe nga funksion shërbimi në kopësht. Në bazë të verifikimit të fotove të realizuara të objektit pas përfundimit të punimeve dhe projektit të ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, evidentohet që realizimi i aksesit për personat me aftësi të kufizuar nuk është realizuar në përputhje me projektin dhe me standartet e projektimit për PAK, duke respektuar pendencën 6%, realizimin e korimanove dhe sinjalistika në bazë të standarteve.

Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 7, datë 30.11.2023

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Ligji 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3.

-VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/1, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi.

-Ligji Nr.9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

**Ndikimi/Efekti:** Zbatimi i realizmit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar, ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit, të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Maliq.

**Rëndësia:**E lartë.

**Rekomandime:** Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Maliq të marrë masa për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z. V.Q , Inspektorët e zones.*

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:*

z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; z.A.E; znj. J.B; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.A.T; z. R.S, Inspektorët e zonës

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit, të trajtuar më sipër me nr.3, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; z.A.T; z. V.Q; z.R.S; Inspektorët e zonës.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.4, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: z.G.T, Kryetar i Bashkisë Maliq; znj.E.J, me detyrë Drejtor i DPKZHT i Bashkisë Maliq; z.K.Q; znj.J.B.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën e administruar në KLSH me Nr.863/6 Prot., datë 05.02.2024 është observuar me anë të shkresës me Nr.6464/1 Prot., datë 02.02.2024, nga z.G.T, nga z.G.F, nga z.S.K, nga z.S.K, nga znj.O.I, nga znj.G.G, nga znj.F.D, nga znj.M.ZH, nga znj.M.SH, nga znj.N.Gj, nga znj.F.M, nga znj.I.P, nga znj.B.Q, nga znj. E.J dhe nga znj.S. H (M), si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt "**Magazinë frigoriferike 1 kat**", miratuar me vendimin Nr.2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq, përfaqësuesit e Bashkisë Maliq shprehen se: " 1. Referuar shkresës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Nr. 164 Prot., datë 08.01.2021 me lëndë "Kthim përgjigje mbi kërkesën për vlerësim të projektpropozimit "Magazinë frigoriferike 1 kat dhe ambiente për grumbullimin dhe mbajtjen e frutave 1 kat", (bashkëlidhur), me vendndodhje në fshatin Sovjan, Bashkia Maliq, me zhvillues z. A.L, ku citohet shprehimisht se: "nuk plotëson kushtet si më poshtë:

- vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 1 m<sup>3</sup>/m<sup>2</sup>.  
- nuk plotësohet kushti për distancën minimale 7 m nga kufijtë e pronës, ..., kjo distancë nuk është respektuar nga ana veriore.

2. Referuar shkresës së ARRSH Nr. 76 Prot., datë 06.01.2021 me lëndë "Aplikim për lloj leje "Leje Zhvillimi", nr. regjistri/prot. 6446" (bashkëlidhur), ku citohet shprehimisht se "Zhvillimi i objektit plotëson distancat nga aksi nacional dhe zhvillimi i tij të bëhet në rrugën e parcelës, në asnjë mënyrë direkt në rrugën kryesore"

3. Referuar shkresës së Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit Nr. 10 Prot., datë 07.01.2021 me lëndë "Kthim përgjigje" (bashkëlidhur), ku citohet shprehimisht se "... kërkojmë që subjekti duhet të realizojë studimin inxhiniero-sizmiologjik, ..., dhe më pas IGJEUM shpreh mendimin për këtë studim" .

4.Referuar shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me lëndë "Mbi aplikimin AN211220200032, në sistemin e-leje, i subjektit "Studio Projektim Irgen SGT Group" (bashkëlidhur), aktiviteti duhet ti nënshtrohet Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Për sa më sipër, projektideja e paraqitur nga kërkuuesi në aplikimin për Leje zhvillimi, nuk është miratuar nga ana e Bashkisë Maliq. Në aplikimin për leje ndërtimi, aplikuesi ka plotësuar mangësitë sipas pikës 4 të lejes së zhvillimit duke paraqitur projektin e ndërtimit me të dhëna të ndryshuara nga ai i paraqitur në lejen e zhvillimit (ky i fundit, i pa miratuar nga MBZHR dhe Bashkia Maliq). Projekti i ndërtimit i paraqitur në aplikimin për leje ndërtimi, është konfirmuar për përputhshmërinë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e cila me anë të shkresës Nr. 1803 Prot., datë 24.02.2021, citon shprehimisht:

"...pasi vlerësuam dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës suaj, ju vemë në dijeni si më poshtë:

-Projektpropozimi përfshihet në tipologjinë e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, sipas kreut I-rë, të VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar.

-Plotëson rregullat dhe kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në kreun II, të VKM Nr. 283, datë 1.04.2015, i ndryshuar.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural shpreh dakordësinë për përputhshmërinë e projektpropozimit: “Magazinë frigoriferike 1 kat”, me vendndodhje në fshatin Sovjan, Bashkia Maliq, me zhvillues z. A.L, për leje ndërtimi”.

Referuar Vendimit të KKT Nr. 12, datë 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në Njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)”, pika 6 “Autoritetet vendore të zhvillimit të territorit mund të vijojnë me miratimin e kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi për rastet sipas pikës 1 të këtij vendimi, vetëm pas:

a. Marrjes së konfirmimit nga Ministria e Linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit

Sa më sipër, Bashkia Maliq, pas marrjes së konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për t’u shprehur në lidhje me plotësimin apo jo të rregullave dhe kriterëve të përgjithshme e të veçanta të VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar, pra konfirmimin nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me anë të shkresës Nr. 1803 prot., datë 24.02.2021 me lëndë “Kthim përgjigje mbi kërkesën për vlerësim të projektpropozimit “Magazinë frigoriferike 1 kat”, me vendndodhje në fshatin Sovjan, Bashkia Maliq, me zhvillues z.A.L”, si dhe konfirmimin nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit me anë të shkresës Nr. 1617 Prot., datë 06.05.2021 me lëndë “Mbi kontrollin e konformitetit për pajisjen me Leje Ndërtimi për objektin “Magazinë frigoriferike 1 kat”, me vendndodhje në territorin e Bashkisë Maliq, me zhvillues z. A.L”, ka miratuar Lejen e Ndërtimit Nr. 2091/5, datë 04.06.2021 për objektin “Magazinë Frigoriferike 1 kat”, me të dhëna sipas Lejes së Ndërtimit, të konfirmuara nga institucionet e sipërpërmendura (shkresat bashkëlidhur).

-Në lidhje me llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për këtë objekt, referuar Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq Nr. 98, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2021”, për ndërtimet që destinohen për përdorim në sektorin e bujqësisë, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë është 2% e vlerës së investimit.

Referuar Preventivit të punimeve sipas dokumentave bashkëlidhur aplikimit për leje ndërtimi, vlera totale e investimit parashikohet 89,341,330 lekë, duke parashikuar në këtë vlerë edhe punimet për ndërkatën e zyrave, të tilla si: punime betoni dhe beton armeje, punime shtresash, punime dyer, dritare etj. Pra taksa e ndikimit në infrastrukturë, është llogaritur:

$2\% \times 89,341,330 = 1,786,827$  lekë, vlerë kjo e paguar nga ana e përfituesit të lejes bazur në VKB nr.98, datë 24.12.2020 si dhe pika 3/a, pika 4 e neni 27 të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht:

Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë, bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetiak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhetë ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1-3 % e vlerës së investimit. Kështu është llogaritur edhe nga ana jonë.

Shënim : Bëjmë me dije se për këtë objekt ende nuk kanë filluar punimet.”

**Oëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana juaj, sqarojmë se në bazë të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 29, pika a, përcaktohet që: “Kryetari i bashkisë është përgjegjës për vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë.”, pavarësisht miratimeve paraprake nga autoritetet përkatëse, leja e zhvillimit dhe e ndërtimit miratohet nga Bashkia Maliq. Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, duke rishqyrtuar preventivin e paraqitur janë përfshirë edhe punimet për katin e parë. Përsa më sipër, pretendimet tuaja merren pjesërisht në konsideratë.

**Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me “**Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat**”, miratuar me vendimin Nr. 215-2021/6 Prot., datë 28/04/2021, me zhvillues "N" ShPK, në adresën Fshati Drithas, Libonik, Maliq, përfaqësuesit e Bashkisë Maliq shprehen se: "Referuar aplikimit për Leje Zhvillimi Nr. 5733 Prot., datë 18.11.2020, shqyrtimit të projektidesë dhe mendimit të institucioneve përgjegjëse për t'u shprehur në lidhje me plotësimin apo jo të rregullave dhe kritereve të përgjithshme e të veçanta të VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar, Bashkia Maliq, ka hartuar Lejen e Zhvillimit Nr. 5733/5 Prot., datë 08.01.2021 duke dhënë kushtet zhvillimore sipas pikës 2 të Lejes së Zhvillimit dhe Vendimin lidhur me Projektidenë paraprake sipas pikës 4 të kësaj leje, ku citohet shprehimisht se: “Projektideja e dorëzuar nga kërkuesi bashkë me kërkesën për leje zhvillimi është pjesërisht në përputhje me rregullat e projektimit në fuqi, pasi paraqet këto mangësi: (dokumenti bashkëlidhidhur).

Mangësitë janë përcaktuar në shkresën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 11519 Prot., datë 29.12.2020 dhe janë lënë kusht në lejen e zhvillimit. Për sa më sipër, projektideja e paraqitur nga kërkuesi në aplikimin për leje zhvillimi, nuk është miratuar nga ana e Bashkisë Maliq. Në aplikimin për leje ndërtimi, aplikuesi ka plotësuar mangësitë sipas pikës 4 të lejes së zhvillimit duke paraqitur projektin e ndërtimit me të dhëna të ndryshuara nga ai i paraqitur në lejen e zhvillimit (ky i fundit, i pa miratuar nga MBZHR dhe Bashkia Maliq). Projekti i ndërtimit i paraqitur në aplikimin për leje ndërtimi, është konfirmuar për përputhshmërinë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e cila me anë të shkresës Nr. 1972 Prot., datë 02.03.2021 me lëndë “Kthim përgjigje mbi kërkesën për vlerësim të projektpropozimit: “Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat”, me vendndodhje në fshatin Drithas, Bashkia Maliq me zhvillues shoqërinë “N” shpk”, citon shprehimisht:

“...pasi vlerësuam dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës suaj, ju vemë në dijeni si më poshtë:

-Projektpropozimi përfshihet në tipologjinë e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, sipas kreut I-rë, të VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar-Plotëson rregullat dhe kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në kreun II, të VKM Nr. 283, datë 1.04.2015, i ndryshuar.

Sa më sipër Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural shpreh dakordësinë për përputhshmërinë e projektpropozimit “Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat”, me vendndodhje në fshatin Drithas, Bashkia Maliq me zhvillues shoqërinë “N” shpk për leje ndërtimi.

Referuar Vendimit të KKT Nr.12, datë 27.02.2019 “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në Njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)”, pika 6 “Autoritetet vendore të zhvillimit të territorit mund të vijojnë me

miratimin e kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi për rastet sipas pikës 1 të këtij vendimi, vetëm pas: a. Marrjes së konfirmimit nga Ministria e Linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Sa më sipër, Bashkia Maliq, pas marrjes së konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për t'u shprehur në lidhje me plotësimin apo jo të rregullave dhe kriterëve të përgjithshme e të veçanta të VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar, pra konfirmimin nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me anë të shkresës Nr. 1972 Prot., datë 02.03.2021, si dhe konfirmimin nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit me anë të shkresës Nr. 875 Prot., datë 04.03.2021, ka miratuar Lejen e Ndërtimit Nr. 215-2021/6, datë 28.04.2021 për objektin “Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat”, me të dhëna sipas Lejes së Ndërtimit, të konfirmuara nga institucionet e sipërpërmendura (shkresat bashkëlidhur). Në lidhje me mendimin e dërguar nga ana e ARRSH me anë të shkresës Nr. 1958 Prot., datë 23.02.2021, nga ana e Bashkisë Maliq, me anë të shkresës Nr. 215-2021/3 Prot., datë 12.03.2021 me lëndë “Njoftim për detyrimin e ndryshimit të projektit”, i është kërkuar subjektit aplikues të kryejë ndryshimet e mëposhtme në projektin e paraqitur për miratim: a) Të përcaktohet në planvendosje dhe të specifikohet aksesi në pronën në zhvillim në lidhje me rrugën b) Të hartohet një planvendosje me pozicionin e parcelës në zhvillim në lidhje me rrugën nacionale. Nga verifikimi i planvendosjes në rubrikën “Projekti i ndryshuar”, duket qartë se parcela e propozuar për zhvillim, pozicionohet në largësi të konsiderueshme nga rruga nacionale Drithas – Rrëmbec dhe aksesi për në pronë sigurohet nëpërmjet rrugeve të parcelave dhe jo nëpërmjet aksit nacional. Në lidhje me Njoftimin e fillimit të punimeve, sipas aplikimit Nr. 2367, datë 14.04.2023, në dokumentat bashkëlidhur aplikimit ndodhet edhe Proces Verballi Nr. 45, datë 03.04.2023 “Për konstatimin e kundravajtjes” nga ana e IMTV e Bashkisë Maliq, për kundravajtjen “shkelja e afatit të fillimit të punimeve”, si dhe Vendimi Nr. 44, datë 03.04.2023 “Për dënim me gjobë” në vlerën 100 000 lekë për kundravajtjen administrative “shkelja e afatit të fillimit të punimeve”, parashikuar nga ligji 107/2014 (i ndryshuar), neni 52, gërma dh.)”

#### **Oëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se në bazë të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 29, pika a, përcaktohet që: “Kryetari i bashkisë është përgjegjës për vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë.”, ndonëse miratimeve nga autoritetet përkatëse, leja e zhvillimit dhe e ndërtimit miratohet nga Bashkia Maliq. Në raport me marrjen e autorizimeve përkatëse, përkatësisht nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, merret në konsideratë. Përsa i përket njoftimit të punimeve nga ana e IMT-së Maliq, janë marrë masat administrative përkatëse, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Përsa më sipër, pretendimet tuaja merren pjesërisht në konsideratë.

#### **Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt “**Objekt për grumbullimin e produkteve bujqësore e medicinale, Drithas, Maliq**”, miratuar me vendimin Nr.6710/4, datë 28/03/2022, me zhvillues “A” ShPK, në adresën Rruga “Athina”, në Maliq, përfaqësuesit e Bashkisë Maliq shprehen se: “Në lidhje me faktin se “Lejet e ndërtimit për objektet e përcaktuara në VKM Nr. 283 datë 01.04.2015 jepen vetëm pasi të jetë verifikuar ekzistenca e infrastrukturave të nevojshme, përsa u përket rrugëve lidhëse, elektricitetit dhe ujit të pijshëm ose marjes përsipër të realizimit të tyre nga investitori njëkohësisht me ndërtimin e objekteve të sipërpërmendura” ju sqarojmë se: për objektin Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore e medicinale, Drithas, Maliq me zhvillues “A” ShPK, aplikuesi ka paraqitur •Sqarim se objekti dhe parcela që zhvillohet me Sip=12000m2 kufizohen në perëndim me rrugë 39 ml dhe ka komunikim vetëm me këtë rrugë ekzistuese dhe jo në veri në distancë 70 ml (distanca 70 ml në veri është distanca e objektit nga

kufiri i parcelës që zhvillohet) e cila shihet në planvendosjen e miratuar, në rubrika POZICIONI I SHESHIT SIPAS HARTËS KADASTRALE. •Lejë lidhjeje me Ujësjellës–Kanalizimeve Sh.A Maliq.

•Fotokopje të faturës për shlyerjeenergjie me ndërmarjen elektrike Nën /Stacioni Tec Maliq. Në lidhje me faktin se realizimi i aksesit në objekt bëhet nëpërmjet pasurisë shtetërore e llojit are ju bëjmë me dije se:

•Parcela që zhvillohet me sip=12000 m<sup>2</sup> është pjesë e pasurisë Nr.Pas 3/36,ZK.1553,fshati Drithas bashkia Maliq,Qarku Korçë të cilën subjekti “A” e ka me qira nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me kontratën Nr.6846Prot. nr.3318Rep, nr.1383Kol, datë 29.9.2014 dhe Amendim i Kontratës së Qirasë Nr.rep2319, Nr.Kol.293, datë 13.7.2021

•Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Struktura Teknike me shkresën Nr.7844prot., datë 23.11.2021 me lëndë: kthim përgjigje mbi kërkesën për vlerësim të projektpropozimit “Objekt per grumbullimin e produkteve bujqësore e medicinale “me vendodhje në fshatin Drithas,Bashkia Maliq, me zhvillues shoqërinë “A” shpk shpreh dakortësinë për përputhshmërinë e projektpropozimit “Objekt per grumbullimin e produkteve bujqësore e medicinale” me vendodhje në fshatin Drithas,Bashkia Maliq, me zhvillues shoqërinë “A” shpk për lejë ndërtimi.

•Në përfundim të shqyrtimit teknik, Grupi Teknik, konkludon se dokumentacioni i aplikimit Nr.AN211220210002, protokolluar në Bashkinë Maliq Nr.6710 Prot., datë 21.12.2021 "Leje Ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>", me aplikues znj. V.G, është i plotëdhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana juaj, në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion dhe rishqyrtimit të dokumentacionit, ky pretendim merret në konsideratë.

#### **Pretendimet e subjektit:**

Në lidhje me gjetjet e konstatuara me objekt “**Banesë individuale (2 kate)**”, miratuar me vendimin Nr. 5519/2 Prot., datë 14/12/2022, me zhvillues znj.R.M, në adresë Shëngjegj, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq, përfaqësuesit e Bashkisë Maliq shprehen se: " Në lidhje me faktin se në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e–leje nuk paraqitet projekti i zbatuar “as build” ju sqarojmë se sistemin e–leje, në aplikimi Nr.5519prot. datë 23.10.2022,në rubrikën e dokumenteve të detyrueshme, pika e 5, paraqitet projekti i zbatimit (as build) i njëjtë me projektin e miratuar, projekti me 15 fletë në Pdf i nënshkruar elektronikisht më datë 16.12.2021 nga z. TH.D përfaqësues i firmës zbatuese shoqëria “D” shpk sipas kontratës së sipërmarjes Nr.1799Rep., Nr.1052Kol., datë 24.8.2019 midis znj.R.M dhe shoqërisë “D” shpk. Në lidhje me faktin se në fotot e ngarkuara në sistemin e–leje evidentohen disa ndryshime në realizimin e fasadave ju bëjmë me dije se: Referuar dokumentacionit të detyrueshëm për aplikim për certifikatë përdorimi, në sistemin janë depozituar dokumentacionet si më poshtë, të nënshkruara elektronikisht nga personat përgjegjës dhe të shoqëruara nga Deklaratat e Përgjegjësive Profesionale të tyre:

-Mbikqyrësi në relacionin teknik, konfirmuar dhe nga firma zbatuese në konkluzione shprehet se: objekti nuk ka shmangie nga projekti i miratuar dhe është realizuar konform projektit të miratuar, Lejës së ndërtimit, KTP dhe KTZb dhe nuk janë shkelur kondicionet urbane.

-Kolaudatori sipas aktit të kolaudimit në konkluzione shprehet se: nuk konstatohet asnjë shkelje ligjore në dokumenta dhe në rezultatet teknike shprehet se: objekti është ndërtuar njëlloj sipas lejës së ndërtimit dhe projektit të miratuar si dhe objekti plotëson parametrat funksionale dhe ndërtimore për tu paisur me lejë përdorimi .



-Shoqëria ndërtuese në deklaratën teknike të përputhshmërisë së objektit shprehet se: punimet janë kryer në përputhje me projektin e miratuar, janë respektuar gjithë kondicionet urbane të përcaktuar në lejën e ndërtimit Nr.3293/3 datë 22.8.2019 dhe objekti në formë dimensionale, sipërfaqe dhe vëllim është sipas projektit të miratuar.

Në deklaratën noteriale nr.rep.164,Nr.kol.111 datë 11.01.2022 subjekti zbatues administratori i shoqërisë “D” shpk shprehet se: objekti banesë individuale 2 kat në pronësi të zhvilluesit R.M, ndodhur në fshatin Gurabardhë, Nj. Adm.Pojan,Bashkia Maliq është ndërtuar në përputhje me lejën e ndërtimit dhe projektin përkatës të miratuar.

Subjekti R.M me anë të shkresës nr.5929prot.datë 21.11.2022 ka dërguar në Bashkinë Maliq deklaratën noteriale Nr.Rep.1498, Nr.Kol.840 datë 19.11.2022 me deklaruese znj. R.M në prani të noteres K.V.T ku deklaroi në përgjegjësinë e saj se: dritaret e ndërtuara jashtë lejës së ndërtimit i ka mbyllur me mur. (Kopjen e së cilës e gjeni bashkëlidhur materialit) Përsa parashtrua më sipër me nr.5519/2 Prot datë 14.12.2022 është lëshuar Çertifikata e përdorimit në përputhje me kuadrin ligjor dhe n/ligjor në fuqi dhe aktet e kontrollit të lëshuar nga Sipërmarësi, Mbikqyrësi dhe Kolaudatori i objektit.”

#### **Oëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me observacionin e dërguar ana juaj, sqarojmë se në bazë të ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 42, në pikën 3, certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes dhe në bazë të nenit 29, pika c, është përgjegjës kryetari i bashkisë për dhënien e certifikatave të përdorimit. Lidhur me deklaratën e paraqitur për mbylljen e dritareve, merret në konsideratë për sa kohë kjo deklaratë është nënshkruar përpara lëshimit të certifikatës së përdorimit. Përsa më sipër, pretendimet tuaja merren pjesërisht në konsideratë.

## **2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore.**

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit me nr. 863/1 Prot, datë 10.10.2023, me objekt: “**Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), prej datës 01.01.2020 deri më 31.12.2022**, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

Vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

Ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilat kanë kryer kundravajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

Procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur mbi zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Mbi organizimin e strukturës së Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, “Për miratimin e numrit të punonjësve niveli i pagave”, me urdhërat përkatës të Kryetarit të Bashkisë janë emëruar z. N.M me detyrë Inspektor Ndërtimi, arsim i lartë dega juridik, E.S Inspektor Ndërtimi arsim të lartë 3+1 dega Marketing si dhe Kryeinspektori A.P me arsim të lartë, dega Gjeologji në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, e konkretisht neni 11 të tij, ku citohet se: *Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku/kombëtar duhet të kenë arsimin te lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.* Për të gjithë periudhën e auditimit struktura ka funksionuar me 3 punonjës, 1 Kryeinspektor si dhe 2 Inspektor në nivel sektori. Për periudhën

objekt auditimi, IMTV e Bashkisë Maliq dispononte programe pune vjetore dhe mujore, si dhe është bërë ndarje e detyrave përkatëse. Në terren IMTV është marrë me kontrollin e zbatimit të punimeve të ndërtimit në përputhje me dispozitat ligjore nga subjektet të pajisura me leje ndërtimi, me zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve.

Në planet mujore për vitet respektive 2020,2021,2022 IMTV ka përpiluar aktivitetin që do të kryhet i shtrirë në disa fusha si vijon, shqyrtimi i ankesave të ardhura nga komuniteti në fushën e ndërtimeve të mjedisit, shkëmbime informacione me institucionet përkatëse si D.P.K.ZH.T për lejet e ndërtimit, deklaratat paraprake të punimeve të miratuara gjatë muajit, shkëmbime i korrespondencës me institucione të tjera dhe Njësitë Administrative, kontroll periodik të objekteve etj.

IMTV ka inspektuar terrenin duke kontrolluar subjekte të ndryshme sipas dokumentacionin tekniko-ligjor që disponojnë ose që nuk disponojnë subjektet ndërtuese dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore, ku për shkeljet e konstatuara në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 9870 ,datë 16.07.2007 *“Për Inspektimin e Ndërtimit”*, i ndryshuar, nenit 81, të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 *“Për Planifikimin e Territorit”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të nxjerra, ligjit nr. 107/2014, datë 1.10.2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”* i ndryshuar , si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* të ndryshuar konstatoi disa problematika për vitet respektive 2020,2021,2022.Më konkretisht referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Kr/Inspektorit të Bashkisë Maliq është ushtruar kontroll në subjekte të ndryshme nga ku janë konstatuar kundrvajtje administrative, nga ku nga ana e tyre janë ndjekuar të gjitha procedurat ligjore të pasqyruara në *Aneksin nr. 1, pika 6, “Mbi të dhënat e IMTV Bashkia Maliq, viti 2022, bashkëlidhur Projektraportit të auditimit.*

-Sikurse shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme nga IMTV, janë vendosur 18 gjoba me vlerë 4,775,353 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 6 gjoba me 948,000 lekë ndërkohë që 12 gjoba me vlerë 3,827,353 lekë janë në proces arkëtimi. Nga ana e IMTV Bashkia Maliq me shkresat përkatëse ka njoftuar Drejtorinë e Financës dhe buxhetit për vjeljen e gjobave. Në Drejtorinë e financës, grupi i auditimit siguroi dokumentacionit e nevojshëm të rakordimit të debitorëve të krijuar nga vendosja e gjobave për vitin 2020,2021,2022.Nga auditimi i zbatimit të procedurave ligjore për vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”* dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”*, përkatësisht neni 16, ku përcaktohet se: Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj” u konstatua se është vepruar në plotësim të kësaj kërkesë ligjore.Për vendimet e gjobave të pa arkëtuara brenda afatit ligjor, përveç vlerës së gjobës, janë llogaritur edhe vlerat e kamatë vonesave në masën 2% të vlerës të gjobës për çdo ditë vonesë deri në 30 ditë, (ose në shumën 60% kamat vonesë mbi gjobën e vendosur), në zbatim të pikës 3, neni 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”*. Nga ana e IMTV Bashkia Maliq me shkresat përkatëse ka njoftuar Drejtorinë e Financës dhe buxhetit për vjeljen e gjobave. Gjatë periudhës së auditimit 01.01.2020 deri më 31.12.2022 janë nxjerrë vendime për prishje objektsh (kryesisht shtesa, shtëpi banimi, dyqane) të cilat nuk janë ekzekutuar nga IVMT Maliq për mungesë mjetesh. Gjithashtu nga ana e IMTV Maliq janë bërë njoftime subjekteve të ndryshme kundërvajtës për zbatimin vullnetar të urdhrave të dala nga Bashkia Maliq.

Kryeinspektori i IMTV, brenda afateve të përcaktuara ka vazhduar procedurat përkatëse me vendime respektive në zbatim të nenit 13, të ligjit nr. 9780 *“Për Inspektimin e ndërtimit”*. Në disa raste nga ana K/Inspektori dhe inspektorëve janë hartuar vendimet për pezullim punimesh. Përsa i

përket masave të ndëshkimit me gjobë për subjektet të cilat kanë shkelur dispozitat ligjore në fuqi, rezultoi se prej IMTV janë mbajtur procesverbalet përkatës dhe akt konstatime të shoqëruar me gjobë në zbatim të Ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar neni 5, gërma b si dhe ligjit nr.107/2014, i ndryshuar neni 52, pika 1 si dhe nenit 10 279 datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”.

#### **Nga auditimi u konstatua këto mangësi:**

**1.Titulli i gjetjes:**Mungesa e mjeteve bën që nga ana e IMTV të mos zbatohen detyrat funksionale të tyre , duke mos respektuar përcaktimet e Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007.

**Situata:**Nga intervistat e kryera me sektorin e IMTV pranë Bashkisë Maliq rezultoi se nuk disponojnë mjetet e nevojshme për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, duke mos respektuar përcaktimet e Ligjit Nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme” neni 5, “Detyrat e inspektoriatit ndërtimor dhe urbanistik të bashkisë komunës,ku citon që :Inspektoriatit vendos prishjen e ndërtimit të kundraligjshëm.Pra nga ana e Inspektorëve të IMTV në cdo rast konstatimi të kundravajtjes bën të pamundur përmbushjen e këtij detyrimi.

**Kriteri:** Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme” neni 5, “Detyrat e inspektoriatit ndërtimor dhe urbanistik të bashkisë komunës; VKM Nr.408, Dt.13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores se Zhvillimit të Territorit”.

**Shkaku:** Mungojnë mjetet e prishjes të objekteve pa leje.Mos bashkëpunim me IKMT Korçë.

**Ndikimi:**Mos zbatim të përcaktimeve të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, duke u lejuar që të ndërtohen objekte pa leje ndërtimi apo zhvillimi.

#### **Rëndësia: E lartë**

**Rekomandime:** Bashkia Maliq, IMTV të marrë masat e nevojshme që në rastet kur konstatohen ndërtime pa leje zhvillimi apo objekte në fazë ndërtimi të sigurojë mjetet e nevojshme duke zbatuar përcaktimet e ligjit në fuqi.

**2.Titulli i gjetjes:** IMTV Maliq nuk disponon mjeteve lëvizëse në përmbushjen e detyrave funksionale.

**Situata:** Nga të dhënat e marra si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që Inspektorët për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara në ligj nuk disponojnë mjete lëvizëse mbi ushtrimin e kontrollit në territor.Pra nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa që të sigurohen mjetet e nevojshme lëvizëse në përmbushje të detyrave funksionale të Inspektorëve të IMTV në kundërshtim me Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007, neni 4 ku citon: *Për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës mbështetet nga policia bashkiake/komunale dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga bashkia/komuna.*

**Kriteri:**Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, “Detyrat e inspektoriatit ndërtimor dhe urbanistik të bashkisë komunës; VKM Nr.408, Dt.13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores se Zhvillimit të Territorit”.

**Shkaku:** Kosto e lartë në rastin e blerjes së tyre.

#### **Rëndësia: E lartë**

**Rekomandime:** Bashkia Maliq të marrë masa, me qëllim mos pengimin në ushtrimin e detyrave funksionale të Inspektorëve të IMTV, të vendosë në dispozicion në çdo moment mjete lëvizëse, në rast se AK e vlerëson të arsyeshme sipas buxhetit të saj, të planifikojë blerjen e një automjeti.

**3. Titulli i gjetjes:** Mungesa e arsimimit përkatës sipas Ligjit të Inspektorit.

**Situata** Nga auditimi i dosjeve të personelit, me konkretisht nga auditimi i dosjes së sektorit të IMTV rezultoi se 2 Inspektorët nuk e kanë arsimin përkatës në kundërshtim me Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007 neni 11 ku citon: “Kryeinspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku/kombëtar duhet të kenë arsimin te lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit. Pra nga të dhënat në dosje rezultoi se 2 Inspektorët janë me profesion Jurist dhe njëri Ekonomist, dega juridik si dhe dega marketing.

**Kriteri:** Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme” , “Detyrat e inspektoriatit ndërtimor dhe urbanistik të bashkisë komunës; VKM Nr.408, Dt.13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores se Zhvillimit të Territorit”.

**Shkaku:** Mungesë kandidatësh në procedurat e rekrutimit të punonjësve.

**Rëndësia: E lartë.**

**Rekomandime:** Titullari i Bashkisë Maliq, të marrë masa për sistemimin e punonjësve sipas arsimimeve përkatëse, duke zhvilluar procedura rekrutimi sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në rastin e mungesës të kandidatëve këtë funksion ta mbuloj Inspektor përkatës i punësuar, pasi lënia e vendit vakant do të shkaktonte mos përmbushje e detyrave funksionale, duke penguar procesin e punës së IMTV.

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:**

VKM Nr.408, Dt.13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores se Zhvillimit të Territorit”, Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën me 863/6 prot, datë 05.02.2024, protokolluar në KLSH, “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

**Pretendimet e subjektit:**

1. Sa i përket akt konstatimit nr.4, Auditim në fushën e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territori”, në lidhje me punën e kryer nga IMTV për vitet objekt auditimi”, në lidhje me vendimet e prishjes ju sqarojmë se: Për secilin vendim prishje të marrë nga IMT-ja është kërkuar mjet për ekzekutimin e tyre, por si dhe është konstatuar nga ana jua, ka pasur mangësi jo vetëm mjetesh, por dhe personel të specializuar në prishjen e ndërtimeve, sepse ka pasur objekte që janë afër...

2. Është e vertetë që në organikën e IMT-së nuk ka mjet lëvizës por më cdo rast inspektimi është vënë në dispozicion mjet nga Drejtoria e Mekanikës të Bashkisë, përgjegjëse në menaxhimin...

3. Në lidhje me arsimin e dy(2) inspektorëve të IMT-së, megjithëse IMT nuk është përgjegjëse në rekrutimin e stafit ju sqarojmë se: Inspektori E.S me arsim Ekonomist dega marketing është transferuar pranë...

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:**

1. Sa i përket pretendimeve të mësipërme sic e kemi theksuar dhe në akt-konstatim në të cilin me observacionin të protokolluar në KLSH, ju bini dakort me konstatimet e bëra nga ana jonë, gjithashtu kushteve të vështira në të cilat ndodheni, citojmë këtu mungesë mjetesh lëvizëse si dhe mjete për prishjen e ndërtimeve pa leje, AK, Bashkia Maliq, IMTV pavarësisht kësaj referuar përcaktimete të Ligjit Nr.9789, datë 16.07.2007, në situata komplekse në të cilat mungesa e mjeteve është e pa evitueshme duhet që të bashpunonini me IKMT Korçë për vënien në dispozicion

*të të gjitha mjeteve të nevojshme ose të paraqisni kërkesë në Bashki për pajisjen me mjete.*

*2.Sic e theksuam dhe më sipër IMTV duhet të disponojë mjete lëvizëse, të cilat duhet të jenë në dispozicionin tuaj në cdo moment pasi në këtë mënyrë nuk pengon procesin e punës si dhe në cdo rast konstatimi të problematike të ndryshme ndërhyrja të jetë e menjëhershme.*

*3.Në lidhje me arsimin e inspektorëve të IMT ju sqarojmë se arsimim i z. N.M është në përputhje me Ligjin Nr.9 780 datë 16.07.2007, neni 11.Ndërkohë që për z. E.S, në kushtet në të cilat ndodheni, e kuptojmë situatën tuaj pasi është shumë e vështirë të rekrutohen punonjës kryesisht inxhinier, pasi interesi është shumë i ulët, dhe gjendur përballë kësaj situatë, nga ana juaj kjo detyrë është mbuluar nga Inspektori pa arsimimin përkatës. Si rrjedhojë e marrim të mirqene faktin që deri në momentin e zgjidhjes së situatës kjo detyrë funksionale të kryhet nga z. E.S.*

***Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet për pikën 1, 2.***

## **2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

Në zbatim të programit të auditimit nr. 863/1prot., datë 10.10.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Maliq, referuar drejtimit të auditimit nr. 7, për çështje të ndryshme të dala gjatë auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Në lidhje me ankesën e paraqitur nga shtetasi S.N, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 931/1 prot., datë 12.10.2022, me pretendimin se është skualifikuar padrejtësisht në procedurën e prokurimit me NR-REF NR-REF-44272-10-03-2022, procedura “Blerje kafe, çaj (për qendrën e pensionistëve), me fondi limit 337,500 lekë.

**Rrethanat:** Bashkia Maliq, zhvilloi procedurën me NR-REF-44272-10-03-2022, procedura “Blerje kafe, çaj (për qendrën e pensionistëve), me fondi limit 337,500. Në ftesën për ofertë ishte përcaktuar data e zhvillimit, kriteret/specifikimet teknike që duhet të përmbushin OE si dhe kërkesa mbi paraqitjen e mostrave. Në listën e dokumentave që duhet të paraqesin OE ishte kërkuar që:

OE i shpallur fitues duhet të sigurojë deri në përfundim të konsumit të kafesë ekspres të ri me mulli, me dy lugë, monofazë (në përdorim). Sipas klasifikimit përfundimtar në sistem ishte renditur në vend të parë OE “S.N” PF. Komision i blerjeve të vogla (KBV), nëpërmjet procesverbalit të mbajtur shpall fitues ofertën e OE të renditur i pari duke i dërguar njëkohësisht njoftimin e fituesit nëpër SPE. Më pas OE sipas përcaktimeve në ftesën për ofertë ka dërguar dokumentacionin e nevojshëm provues pranë AK si dhe ka paraqitur mostrat sipas përcaktimeve të bëra. Gjatë verifikimit të mostrave KBV vendosi që Aparati ekspresit i paraqitur nga OE nuk është në përputhje me specifikimet e përcaktuara në ftesën për ofertë pasi ishte trefazor dhe jo monofazë sic ishte përcaktuar në kriteret e ftesës për ofertë. Më pas ky komision kaloi tek OE i renditur i dytë nëpërmjet procesverbalit përkatës si dhe njoftimit të fituesit të dërguar në SPE. Ndërkohë OE i skualifikuar “S.N” paraqiti ankesë zyrtare protokolluar në Institucion me Nr. 5265 datë 12.10.2022 me pretendimin se skualifikimi i tij është i padrejtë pasi përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë. AK, Bashkia Maliq në mbështetje të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, Kreu XIV, “Ankimimi Administrativ”, neni 116, “Ankesat për prokurimet me vlerë të vogël”, VKM Nr. 285, datë 19.05.2022, “Për rregullat e prokurimit publik, Kreu XII, “Ankimim Administrativ”, neni 104, “Ankesat për prokurimet me vlerë të vogël” si dhe Udhëzimit Nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël”, i ktheu përgjigje OE, nëpërmjet vendimit me nr. 5256/2 prot., datë 11.10.2022 duke i shpjeguar arsyet e skualifikimit pasi ky i fundit nuk përmbush kriteret e ftesës për ofertë.

**Shpjegimet tona:** Nga auditimi i dosjes së procedurës me vlerë të vogël “Blerje kafe, çaj (për qendrën e pensionistëve)” me NR-REF-44272-10-03-2022 me fond limit 337,500 lekë rezultoi se AK, KBV ka vepruar në përputhje VKM Nr. 285, RRPP neni 56, pika 6 ku thotë:

*Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.*

**Si konkluzion:** vendimi i skualifikimit është i drejtë pasi në ftesën për ofertë kishte të përcaktuar qartë që ekspresi që do ti vihet në dispozicion AK duhet të jetë me 2 lugë, monofazë (në pëdorim). Duke qenë se ky kusht nuk u përmbush nga OE referuar VKM së mësipërme si dhe Udhëzimit të Blerjeve të Vogla komisioni veproi drejt duke e konsideruar si jo të përmbushur këtë pikë.

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Maliq nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Sektori i burimeve njerëzore nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma e auditimit dhe rregullorja për parandalimin e konflikteve të interesit. Veprime në kundërshtim nenin 16, 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, 1, ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1/1 germa (b). (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 21-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Maliq, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e gjurmës së auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit dhe rregulloren për parandalimin e konflikteve të interesit. Struktura e Burimeve Njerëzore, të evidentojnë nevojat e stafit për trajnime dhe të hartojë dhe zhvillojë programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen profesionale të tij.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procedurën e ngritjes dhe funksionimit të NJAB u konstatua se, Njësia e Auditimit të brendshëm në bashki ka funksionuar me strukturë në nivel sektori me 3 auditues, nga të cilët 2 auditues janë të çertifikuar ku përgjegjësi është i çertifikuar në vitin 2008, një specialist është çertifikuar në vitin 2021 ndërsa një specialist është i pa çertifikuar. Veprime këto në kundërshtim me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” sipas nenit 11, pika 2 shkronja “c” dhe dhe pika 3, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njesisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 21-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.2. Rekomandimi:** Bashkia Maliq të marr masa që Njësia e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të funksionojë me punonjës të çertifikuar, kërkesë e parashikuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Maliq ka diferenca të

dukshme me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 300,000,000 lekë, ndërsa realizimi 144,402,002 lekë, ose në masën 48.13%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 314,558,000 lekë, realizuar 267,798,000 lekë, ose në masën 85.13 % dhe me mos realizim në vlerën 46,760,000 lekë, ose 14.87%. *Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-54të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Maliq të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 300,000 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 144,068 mijë lekë ose 48 %, me një mosrealizim në vlerën 155,932 mijë lekë. Në plan janë përfshirë dhe detyrimet e prapambetura, nga viti 2020-2021 të cilat përfshijnë disa zëra, në vlerë 79,089,675 lekë ose 26.3% të totalit të planit.

Sa më sipër konstatohet se në planin e të ardhurave për vitin 2022, taksa e tokës është planifikuar për vlerën 60,000 mijë lekë ose 20 % e planit, kjo taksë nuk është mbledhur duke ndikuar ndjeshëm në realizimin e të ardhurave.

Gjithashtu me mosrealizim të dukshëm dhe që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi, janë taksat dhe tarifave familjeve, për vitin 2022, të ardhurat nga Taksa e tokës, Taksa ndërtese dhe Tarifa pastrimi gjelbërimi e ndriçimi janë planifikuar gjithsej në vlerën 155,917 mijë lekë ose 51.9 % e planit vjetor. Janë realizuar 74,852 mijë lekë ose 49 % të planit. Taksa e ndërtesës rezulton se në vitin 2022, nga 27,197 mijë lekë e planifikuar është realizuar 14,178 mijë lekë ose 52 %, me një mosrealizim në vlerën 13,019 mijë lekë.

Tarifa vendore (pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi) rezulton se në vitin 2022, nga 67,830 mijë lekë e planifikuar janë realizuar 32,205 mijë lekë ose 47 %, me një mosrealizim në vlerën 35,625 mijë lekë. Nga mosrealizimi i planit të të ardhurave si më sipër ka sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë vetëm për taksat familjare në vitin 2022 në vlerën gjithsej 43,439 mijë lekë. Në kundërshtim me: Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 22 dhe neni 23, VKB nr. 93, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-54të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Maliq të merren masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të bëhet një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore, kjo duke u mbështetur në burimet e krijimit të të ardhurave dhe arkëtimin e borxhit të akumuluar nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga familjet.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreditohet nga investimet, dhurimet dhe ndryshimi i gjendjes së inventareve dhe pakësohet nga amortizimi i vitit dhe nxjerrjet jashtë përdorimit. Vlera e raportuar në bilanc e ka mbivlerësuar këtë llogari për vlerën 8,033,127 lekë. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimin Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” për të dhëne informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

*Deri me datë 31.03.2024*

**6. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” përbëhet nga gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 30,991,777 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 24,825,314 lekë. Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në bilanc është regjistruar në shumën 131,433,695 lekë nuk kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje". Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” është mbivlerësuar për vlerën 75,616,604 lekë. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimin Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” për të dhëne informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

*Deri me datë 31.03.2024*

**7. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” përbëhet nga gjendja e llogarive të klasës 4 llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 60,57,133 lekë , 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 33,192,639 lekë ,431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa në vlerën 893,424 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 6,676,744 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 920,432 lekë dhe llogaria 467 “Kreditor të ndryshëm” në vlerën 114,473,247 lekë. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është regjistruar në bilanc për vlerën 30,933,239 lekë. Kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 185,750,380 lekë. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimin Nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta) për të dhëne informacion kontabël të saktë.

*Deri me datë 31.03.2024*

**8. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2009-2012 sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nëpërmjet VKM në Bashkinë Maliq janë transferuar 4113 pasuri. Në Bashkinë Maliq me VKM nr. 127, date



02.02.2009 janë transferuar 964 pasuri, me VKM Nr. 1154, date 13.08.2008 i janë transferuar ish komunës Pojan 362 pasuri, me VKM Nr. 660, date 11.06.2009 i janë transferuar ish komunës Libonik 629 pasuri, me VKM Nr. 826, date 21.11.2012 i janë transferuar ish komunës Pirq 376 pasuri, me VKM Nr. 01.04.2009 i janë transferuar ish komunës Vreshtas 362 pasuri, me VKM Nr. 524, date 30.06.2010 i janë transferuar ish komunës Gore 815 pasuri, me VKM Nr. 734, date 26.10.2011 2010 i janë transferuar ish komunës Moglicë 592 pasuri.

Nga pasuritë e transferuara 76 pasuri janë pajisur me çertifikatë pronësie, 11 pasuri janë të pajisura me çertifikatë përdorimi dhe 29 pasuri janë në proces rregjistrimi

Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e bashkisë Maliq nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezulton i pa përditësuar. Veprime këto në kundërshtim me neni 37 i ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Bashkia Maliq duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZVASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllëgisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

#### *Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Kapitalizimi (shesat) për vitin 2022 në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” janë në vlerën 51,094,487 lekë. Objektet rikonstruksion pallati viti 2021 në vlerën 4,052,067 lekë dhe përmirësim i banesave viti 2021 në vlerën 18,493,969 lekë janë kapitalizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” pa dokumentacionin justifikues të cilat janë situacioni përfundimtar dhe akt i marrjes në dorëzim. Aktivitet e mësipërme nuk janë të përfunduara dhe nuk janë në funksion të Bashkisë Maliq. Shpenzimet për aktivitet e mësipërme duhet të regjistrohen në llogarinë 23 “Investime”.

Kapitalizimi (shesat) për vitin 2022 në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë në vlerën 222,020,883 lekë. Objektet sistemim-asfaltim rruga Vloçisht-Drithas, mbikëqyrje, kolaudim në vlerën 1,946,352 lekë, mbushje gropash 2022 në vlerën 3,460,216 lekë, ndërtim stacion pompimi Vreshtas në vlerën 16,563,091 lekë, ujësjellësi Mançurisht-Plasë mbikëqyrje në vlerën 80,450,000 lekë dhe Rehabilitim ujitje sep Pojan faza II në vlerën 6,07,088 lekë janë kapitalizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” pa dokumentacionin justifikues të cilat janë situacioni përfundimtar dhe akt i marrjes në dorëzim. Aktivitet e mësipërme nuk janë të përfunduara dhe nuk janë në funksion të Bashkisë Maliq. Shpenzimet për aktivitet e mësipërme duhet të regjistrohen në llogarinë 23 “Investime”. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Maliq të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.212 “Ndërtesa e Konstruksione” dhe llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

#### *Deri me datë 31.03.2024*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se sipas të dhënave të QKB Bashkia Maliq, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 11% të aksioneve të “KRWM” Sh.a me NUIS “K.....O” e cila është shoqëri aksionere me objekt “Mbledhja, transporti, administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale”. Numri i aksioneve është 226 me vlerë nominale

16,550 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,740,300 lekë. Nga këto Bashkisë Maliq i përkasin 24.86 aksione me kapital në vlerë monetare 411,433 lekë.

Bashkia Maliq në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “K” sh.a me NUIS “L.....R” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Projektim, financim, zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve të sporteve të të gjitha llojeve me qëllim nxitjen dhe masivizimin e sportit. Numri i aksioneve është 350 me vlerë nominale 10,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,500,000 lekë.

Bashkia Maliq në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 8.67% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë” sh.a me NUIS “M.....N” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 8,670 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 867,000 lekë.

-Bashkia Maliq në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “Kombinati i Sheqerit” sh.a me NUIS “K.....I” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Dhënia me qira e objekteve për të mundësuar kryerjen e aktivitetit të shoqërisë në përputhje me këtë status”. Numri i aksioneve është 582,418 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 582,418,452 lekë.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 587,196,885 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar. Veprime këto në kundërshtim me Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Maliq, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar me vlerë kontabël 587,196,885 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

*Deri me datë 31.03.2024*

**11. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2022, ka qenë në vlerën 139,431,694 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 45,33,814 lekë. Referuar analizës së llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” konstatohet se nuk është kontabilizuar vlera 131,042,814 lekë e cila i përket investimeve në proces. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

*Deri me datë 31.03.2024*

**12. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Maliq më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 15,628,003 lekë ndërsa në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 24,825,314 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Në lidhje me shtesat apo pakësimet për këtë llogari, Drejtoria e Financës nuk disponon informacion. Për 24 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Maliq janë ngurtësuar fonde në vlerën 1,638,158 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Korçë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve dhe Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 1,638,158 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Maliq, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Maliq më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 61,623,275 lekë ndërsa në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 114,473,247 lekë. Në këtë llogaria është kontabilizuar llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” sipas udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kundër parti e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” është llogaria 470 “Të ardhura për tu marrë”.

Vlera e pullave dhe biletave regjistrohesh në llogarinë 532 “Vlera të tjera”. Mbështetja financiare për ndihmë ekonomike dhe paaftësinë janë fonde që vijnë nga buxheti i shtetit dhe regjistrohesh në llogaritë 520 “Disponibilitete në Thesar” në debi dhe 7202 “Grant korent nga buxheti për pagesa të posaçme të ISSH”. Regjistrimet e mësipërme kanë mbivlerësuar këtë llogari për vlerën 114,275,347 lekë. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Maliq të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”.

#### *Deri me datë 31.03.2024*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 16 procedurave me fond limit 493,118 mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej në 5 procedura me vlerë të fondit limit 269,675 mijë lekë të vlerës së fondit limit të audituar, ku OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimi të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK për vlerën totale të kontratave **223,021** mijë lekë.

Në këto kushte si dhe në funksion të zbatimit të ligjit “Për prokurimin publik”, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar B/OE e kualifikuar (fitues) duke shpallur përfundimisht fitues B/OE të rradhës, i cili i plotëson të gjitha kriteret e DST-ve, edhe pse realizimi i punëve do të kryej me një vlerë më të lartë monetare. Në rastet kur nuk ka pasur një të tillë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe të zhvillonte një procedurë tjetër me kushte me favorizuese (në rivlerësim të kriterëve) për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedure, me qëllim një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar në vlerën 269,675 mijë lekë, konkretisht procedurat:

1- Procedura me objekt “Ndërtimi i Ujësjellësit Maçurisht-Plasë” me fond limit 178,942 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “N” & “S” ShPK me vlerë kontrate 159,098 mijë lekë.

2- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III” me fond limit 11,431 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “V” ShPK, me vlerë kontrate 5,909 mijë lekë.

3- Procedura me objekt “Kuz Njësitë Administrative” me fond limit 18,886 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “V” ShPK, me vlerë kontrate 12,032 mijë lekë.

4- Procedura me objekt “Ndërtim KUZ Vloçisht faza 2” me fond limit 8,333 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “A” ShPK, me vlerë kontrate 6,274 mijë lekë.

5- Procedura me objekt “Ndërtim stacion pompimi Vreshtas + linja” me fond limit 52,083 mijë lekë, ku fitues është shpallur OE “N” ShPK me vlerë kontrate 39,708 mijë lekë.

Në procedurat e mësipërme janë konstatuar kriteret të paplotësuara nga OE/BOE e shpallur fitues nga KVO dhe të miratuara nga titullari i AK (kriteret ligjore/ dhe teknike), mangësi të cilat eventualisht ndikojnë edhe në zbatimin e kontratës, respektivisht:

-Mos pagesë të taksave lokale në të gjitha bashkitë ku subjektet, referuar ekstarktit historik, kanë ushtruar aktivitetin e tyre.

-Mungesë e licencës të lëshuar nga QKL me kodin III.7.B., edhe në rastin e BOE kur njëri prej tyre e disponon por të dy OE të bashkimit kanë pjesëmarrje në të gjitha zërat e punimeve sipas preventivit.

-Mos disponimi i makinerive sipas kriterëve apo kapaciteteve standarte të kërkuara.

-Mungesa e një preventivi ose akti ku të përcaktohet saktësisht pjesa e punës dhe elementet konkrete (zërat e preventivit) që do të kryejë secili nga anëtarët në rastin e Bashkimit të Operatorëve, sikundër kërkohet nga neni 74, pika 1 dhe 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

-Mungesa e një vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve (për të gjithë muajt) të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Në kushtet kur për zbatimin e një kontrate publike, nga Autoriteti Kontraktor, kontraktohet një operator ekonomik i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, efektivisht ky veprim mbart një risk potencial të shtuar për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar si dhe rezulton veprim në shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Maliq, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST, me pasojë kontraktimin në kushte paligjshmërie të fondeve publike për vlerën 223,021 mijë lekë.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i B/OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën dhe risk real për

shpenzimet e njësisë publike, pasi efektivisht ky veprim ndikon negativisht në qëllimin e AK për realizimin e punimeve brenda kohës dhe cilësisë së kërkuar.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 16 procedurave, rezulton se në 9 procedurat: “Ndërtimi i Ujësjiellit Maçurisht-Plasë”, “Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative faza III”, “Kuz Njësitë Administrative”, “Ndërtim KUZ Vloçisht faza 2”, “Rikonstruksion i fushës së futbollit”, “Rikonstruksion objekte ndërtimore 2022”, “Përmirësimi i banesave ekzistuese”, “Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative” dhe “Shërbim mirëmbajtje mjetet dhe eskavatorët” është evidentuar aplikimi i kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës.

Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumentuara, për shkak të moszbatimit të kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Njësia e Prokurimit*), çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa eventuale e konkurrencës.

Shkeljet konsistojnë në këto drejtime: kategori liçensë jo në përputhje me procedurën; numër punonjësish të paargumentuar; kërkesë për “*Çertifikatë për sigurimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik*” kur nuk ka punime elektrike; për punonjësit “*kontrata pune të firmosur përpara noterit (e vlefshme)*” kur nënshkrimi i kontratave të punës përpara noterit nuk është një akt i detyruar ligjërisht as për punëdhënësin dhe as për punëmarrësin.

- Njësia e Prokurimit, për hartimin dhe argumentimin e kriterëve, në pjesën më të madhe të tyre, është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik në referim të grafikut, volumeve të punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter apo liçence të kërkuar (psh. për cilat zëra konkretë të punimeve të preventivuara kërkohet një liçencë, mjet, pajisje apo ISO e caktuar, etj.).

- Gjithashtu në këto procedura është konstatua se, dosjet e procedurave edhe pse janë të shoqëruara me një inventar paraprak, nuk janë të numëruara në cdo faqe me laps të zi, në kundërshtim me gurmën (g), të nenit 8 të Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 “*Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH*”. Veprime në shkelje të nenit 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe nenit 41 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*” dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. nr. 258, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandimi:** Sektori i Prokurimit Publik (NjP përkatëse) në Bashkinë Maliq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet t’i argumentojë teknikisht dhe ligjërisht ato duke pasur gjithmonë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, grafikun e punimeve, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, harmonizimin me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë të OE, duke nxitur gjithashtu konkurrencën midis tyre.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq, në vitin 2020 është hartuar projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit “*Kuz Njësitë Administrative*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit: Ing. M.ZH, Ing. S.K dhe Ark. G.K. Referuar formimit profesional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, konstatohet se vetëm Ing. M.ZH është e pajisur me liçencën e projektimit nr. K. 2357. Gjithsesi liçenca e znj. M.ZH është për projektim të kategorive 3, 6 dhe 7, ndërkohë që për objektin “KUZ” kërkohet liçenca e kategorisë 5

(Projektues vepra hidraulike). Kjo situatë ka ndodhur pasi Bashkia Maliq, me qëllim shmangien e shpenzimeve, ka angazhuar punonjësit e saj për hartimi i projekt/preventivave duke mos kryer një procedurë prokurimi të mirëfilltë për përfitimin e objektit i cili mund të kryej nga specialistë/inxhinierë të licencuar.

Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 77-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Maliq, në lidhje me investimet që do të kryhen në të ardhmen, për të cilat është i nevojshëm hartimi paraprak i një projekt-preventivi, të marrë masa që ky i fundit të hartohet nga specialistë të pajisur me liçencë profesionale për kategorinë përkatëse.

*Në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit me objekt “Kuz Njësitë Administrative”, konstatohet se KVO ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave është hapur në datën 13.01.2021, KVO ka pasur detyrimin ligjor që vlerësimi i tyre të kryhej brenda datës 28.01.2022 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave është kryer në datën 02.02.2022, çka do të thotë, jashtë afatit të përcaktuar. Kjo situatë ka ndodhur pasi nga anëtarët e Komisioni të Vlerësimit të Ofertave është neglizhuar zbatimi i afateve të përcaktuara për fazën e vlerësimit duke vepruar në kundërshtim me nenin 66, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 77-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, të marrin masa që vlerësimi i ofertave të kryhet brenda afateve të përcaktuara nga aktet nënligjore në varësi të llojit të procedurës.

*Në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit me objekt “Kuz Njësitë Administrative”, rezulton se midis palëve është lidhur kontrata e sipërmarrjes me nr. 1717 prot., datë 16.03.2021, e cila është nënshkruar nga titullari i AK dhe nga administratori i OE “V” ShPK, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të anëtarëve të BOE, por jo nga anëtari tjetër i bashkimit. Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e një interpretimi të gabuar të akteve nënligjore, që AK ka kryer, në lidhje me përfaqësimin e palëve, duke vepruar në kundërshtim me nenin 74, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 77-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor (Bashkia Maliq), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, të marrë masa që, në rast se fitues i procedurës do të jetë një bashkim operatorësh ekonomik, kontrata të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të BOE.

*Në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Rezulton se në 4 procedura (-Rikonstruksion i fushës së futbollit, të stadiumit të qytetit Maliq; - Përmirësimi i banesave ekzistuese; - Shërbim mirëmbajtje mjetet dhe eskavatorët; - Sistemim asfaltim rrugë në Njësitë Administrative viti 2022), janë evidentuar problematika në fazën e hartimit të specifikimeve teknike si dhe përlogaritjes dhe dokumentimit të fondit limit.

Shkeljet apo problematikat konsistojnë në këto drejtime:

-Nuk janë dokumentuar apo pasqyruar analiza në lidhje me sasinë e mallit apo shërbimit që kërkohet të prokurohet;

-Specifikimet teknike nuk kanë të përcaktuar standartin e cilësisë në lidhje materialet që do të përdoren nga OE për realizimin e kontratës së prokuruar.

Shkak i problematikës është moszbatimi i plotë i kuadrit ligjor në fazën e hartimit të specifikimeve teknike si dhe përlogaritjes dhe dokumentimit të fondit limit nga personat përgjegjës (Njësia e Prokurimit). Mungesa e analizave në lidhje me sasinë e mallit/shërbimit që kërkohet të prokurohet apo hartimi i gabuar i specifikimeve teknike përbën një risk të shtuar si për realizimin e procedurës së prokurimit ashtu edhe për cilësinë e objektit që prokurohet si dhe rezulton në kundërshtim me nenet 34, 35 dhe 36 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” të VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 77-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1. Rekomandimi:** Sektori i Prokurimit Publik, Nj.P. apo komisioni përkatës, në Bashkinë Maliq, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës, duke hartuar dhe u bazuar paraprakisht, në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, të cilat të përcaktojnë qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

*Në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi intervistat e kryera me sektorin e IMTV pranë Bashkisë Maliq, rezultoi se: për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje nuk disponojnë mjetet e nevojshme. Pra, nga ana e Inspektoreve të IMTV në çdo rast konstatimi të kundërvajtes bën të pamundur përmbushjen e këtij detyrimi. Veprime në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” neni 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 157-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, të marrë masat e nevojshme që në rastet kur konstaton ndërtime pa leje zhvillimi apo objekte në fazë ndërtimi të sigurojë mjetet e duhura për prishjen e tyre referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

*Në vijimësi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e marra si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që inspektorët për përmbushjen e përgjegjësisë të parashikuara në ligj nuk disponojnë mjete lëvizëse mbi ushtrimin e kontrollit në territor. Pra nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa që të sigurohen mjetet e nevojshme lëvizëse në përmbushje të detyrave funksionale të Inspektorëve të IMTV. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007, neni 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 157-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**21.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, të marrë masat e duhura për planifikimin e fondeve, me qëllim marrjen (prokurimin) e një mjeti lëvizës në funksion të Inspektorëve të IMTV, për kryerjen e verifikimeve në terren.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi ushtrimin e veprimtarisë së Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit rezultoi se: bazuar në verifikimin e dosjeve të personelit, 2 nga Inspektorët e këtij sektori nuk e kanë arsimin përkatës. Pra, nga të dhënat në dosje rezultoi se 2 Inspektorët janë përkatësisht, një nëpunës me profesion Jurist (dega Juridik) dhe nëpunës tjetër Ekonomist (Marketing). Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007 neni 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 157-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, të marrë masat e duhura për plotësimin e pozicioneve të punës në sektorin e IMTV, sipas arsimimit përkatës me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale të IMTV.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**23.Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosrespektimin e kushteve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për ndërtimin e objekteve të prodhimit, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, për lejet e ndërtimit me objekt: 1."Magazinë frigoriferike 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq. 2."Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 215-2021/6 Prot., datë 28/04/2021, me zhvillues "N" ShPK, në adresën Fshati Drithas, Libonik, Maliq. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Vendimi Nr. 283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"; me VKM 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"; me Ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 142-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**23.1.Rekomandimi:** Nga DPZHT Maliq të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara për objektet me funksion prodhimit, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, të plotësojnë të gjitha kriteret dhe rregullat për zhvillimin e tyre, duke respektuar lartësinë, intensitetin, vëllimin dhe distancat.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**24.Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhshmërinë e planvendosjes së miratuar në lejen e ndërtimit, të dhënave të treguesve të zhvillimit dhe projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje. Gjithashtu në planvendosjen e miratuar nuk evidentohet aksesi për në parcelën në të cilën do të zhvillohet ndërtimi. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt: 1."Magazinë frigoriferike 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq. 2."Objekt 6 kate nga te cilat 5 kate banimi dhe një kat i alternuar me njësi shërbimi dhe ambiente banimi dhe 1 kat parkimi nëntokë", miratuar me vendimin Nr. 78/2, datë 18/02/2020, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në Maliq. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 15, pika 1, gërma c dhe me nenin 14, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 144-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1. Rekomandimi:** Nga DPKZHT Maliq të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar përputhshmërinë ndërmjet planit të vendosjes së strukturave dhe projekti të ndërtimit. Gjithashtu të verifikohet ekzistenca e infrastrukturës kryesore dhe dytësore, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**25.Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **2 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimit edhe për një tipologji të ndryshme ndërtimi nga ajo e lejuar në zonë. Në lejet e ndërtimit të miratuara për zhvillimin e objekteve me destinacion bujqësor/ blegtoral, në tokë bujqësore, në projektin e ndërtimit dhe relacionin teknik janë propozuar edhe funksione të tjera, që nuk janë në përputhje me tipologjinë dhe destinacionin e lejuar. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:1. "Magazinë frigoriferike 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 2091/5, datë 04/06/2021, me zhvillues A.L, në adresën fshati Gurishtë, Njësia administrative Pirg, Maliq. 2."Stallë për 50 krerë gjedhë 1 kat", miratuar me vendimin Nr. 215-2021/6 Prot., datë 28/04/2021,



me zhvillues "N" ShPK, në adresën Fshati Drithas, Libonik, Maliq. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Vendimi Nr. 283, datë 1.4.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”; Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 144-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**25.1. Rekomandimi:** Nga DPKZHT Maliq të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa verifikuar tipologjinë e ndërtimit të propozuar në projektin e ndërtimit, që të jetë në përputhje me tipologjinë dhe destinacionin e lejuar sipas njësinë përkatëse.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**26.Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan **3 praktika** tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja në sistemin e-Leje të dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e çertifikatës së përdorimit. Në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë përdorimi është projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar); Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje paraqitet vetëm projekti i ndërtimit i miratuar në lejen e ndërtimit, por nuk paraqitet projekti “as build” i zbatuar. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuar për certifikatë përdorimi, me objekt:

1. “Rikonstruksion godinë 2 kate + shtesë anësore (përshtatje për agroturizëm)”, miratuar me vendimin Nr. 3267/2, datë 26/07/2021, me zhvillues z. TH.N, në adresën fshati Zvirinë, Njësia Administrative Pirg, në Maliq. 2. “Rikonstruksion lokali dhe shtesë kati deri 3 kate”, miratuar me vendimin Nr.6205/4 Prot., datë 23/04/2021, me zhvillues z. A.B dhe znj. Z.B, në Maliq. 3. “Banesë individuale (2 kate)”, miratuar me vendimin Nr. 5519/2 Prot., datë 14/12/2022, me zhvillues znj.R.M, në adresë Shëngjegj, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin Neni 27/2, në pikën 1, gërma g.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 144-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**26.1. Rekomandimi:** Nga DPZHT Maliq të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**27.Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatuan 4 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara me objekt: 1.“Rikonstruksion godinë 2 kate + shtesë anësore (përshtatje për agroturizëm)”, miratuar me vendimin Nr. 3267/2, datë 26/07/2021, me zhvillues z.TH.N, në adresën fshati Zvirinë, Njësia Administrative Pirg, në Maliq. 2. “Rikonstruksion lokali dhe shtesë kati deri 3 kate”, miratuar me vendimin Nr.6205/4 Prot., datë 23/04/2021, me zhvillues z. A.B dhe znj. Z.B, në Maliq. 3. “Banesë individuale (2 kate)”, miratuar me vendimin Nr. 5519/2 Prot., datë 14/12/2022, me zhvillues znj. R.M, në adresë Shëngjegj, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq. 4.“Objekt 6 kate nga të cilat 5 kate banimi dhe një kat i alternuar me njësi shërbimi dhe ambiente banimi dhe 1 kat parkimi nëntokë”, miratuar me vendimin për leje ndërtimi me Nr. 78/2, datë 18/02/2020 dhe me vendimin për certifikatë përdorimi me Nr. 1849/2, datë 06/05/2022, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në Maliq. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”,

i ndryshuar, Neni 27/1, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nevojitet plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me certifikatë përdorimi; me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 144-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**27.1. Rekomandimi:** Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Maliq të marrë masa për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar. Nga IVMT Maliq të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Maliq), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim *shpërblimin e dëmit në vlerën 349038 lekë*, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Ndërtim KUZ Njësitë Administrative” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe BOE “V” sh.p.k & “XH” sh.p.k & “A” sh.p.k me Nr. 1717 Prot. datë 16.03.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 14,438,580 lekë me TVSH lekë me afat përfundimi të punimeve 3 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas dokumentacionit të dosjes teknike nga verifikimi i detajuar i analizës së çmimeve rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 1 (një) zë punimesh në shumën 143,686 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe Person Fizik me Nr.1705 Prot. datë 16.03.2021 me objekt: “Mbikëqyrje objekti Ndërtim KUZ Njësitë Administrative”, Neni 5 “Detyrimet e kontraktuesit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 77-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Maliq të marrë masa, për arkëtimin e shumës 143,686 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “V” sh.p.k & “XH” sh.p.k & “A” sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr.1717 Prot. datë 16.03.2021 për realizimin e punimeve civile.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Ndërtim KUZ Vlocisht Faza I” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe BOE “A” sh.p.k & “N” sh.p.k me Nr. 4699 Prot. datë 28.09.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 10,322,460 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 2 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas dokumentacionit të dosjes teknike nga verifikimi i detajuar i analizës së çmimeve rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 1 (një) zë punimesh në shumën 106,202 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me;-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe Person Fizik me Nr. 4797 Prot. datë 01.10.2020 me objekt: “Mbikëqyrje objekti Ndërtim KUZ Vlocisht Faza I”, Neni 5 “Detyrimet e kontraktuesit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 77-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq të marrë masa, për arkëtimin e shumës 106,202 Lekë pa TVSh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit nga BOE “A” sh.p.k & “N” sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr. 4699 Prot. datë 28.09.2020 për realizimin e punimeve civile.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën **87,234 mijë lekë**, vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **43,439 mijë lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është në vlerën **114,176 mijë lekë** e cila përbëhet nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifave e Biznesit në shumën **4,241 mijë lekë**;

- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë” në vlerën prej **16,771 mijë lekë**, që i përkasin subjekteve të mbartura që nga viti 2016.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181. me VKB nr. 93, datë 24.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Maliq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive **114,176 mijë lekë**, ku përveç masave shtrënguese të marra si

urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të paguar:

-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Maliq, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e të Ardhurave Bashkia Maliq, për periudhën e vitit 2022, në një rast nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, për sa i përket arkëtimin të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Maliq. Për vitin 2022 rezultojnë të pajisur me Autorizim/Licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 12 subjekte, të cilët 1 prej tyre nuk ka likuiduar detyrimin për 1,000,000 lekë. Subjekti “A.K” shpk, me NIPT nr. K.....C, nuk është i pajisur me Autorizim për ushtrim aktiviteti duke krijuar të ardhura të me vlerë prej 1,000,000 lekë, sa më sipër për këtë subjekt, nuk është aplikuar saktë tarifa vendore për pajisjen e subjekteve, me Autorizim/Licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante, dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, me pasojë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Maliq, në vlerën 1,000,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjekti “A.K” të vlerës **1,000,000 lekë**, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Maliq në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Korçë. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 25,530,138 lekë për 606 persona, kanë paguar detyrimet 222 persona me vlerë 6,758,614 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2022 gjithsej 438 persona me vlerë 16,771,524 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Maliq. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Maliq për periudhën nën auditim nuk janë

njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Maliq të jetë drejtuar ASHK Dega Korçë, për bllokimin e pasurisë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, dhe arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë për **438 persona** me vlerë **16,771,524 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Maliq.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga Aauditimi:** Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **4,241,736 lekë**, ku vetëm për vitin 2022 janë krijuar **49** debitorë nga biznesi në vlerë **1,251,149 lekë**, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Maliq. Sa më sipër vetëm për periudhën e vitit 2022 objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël për **44 subjekte në vlerën 942,964 lekë** dhe debitorët e biznesit të madh për **5 subjekte në vlerën 308,455 lekë**.

Drejtoria e të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime. Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 82 subjekte debitorë në vlerën 4,241,736 lekë, janë aktiv 82 subjekte të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa vendore. Ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 32-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, Drejtoria e të Ardhurave, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **4,241,736 lekë**, si më poshtë vijon:

*a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana*

e Sektorit të Taksave dhe Tarifave dhe Sektorit Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH., miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar nën 181 “*Mospagimi taksave dhe tatimeve*”.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **D. MASA DISIPLINORE.**

##### **Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Maliq**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

##### **A. “Vërejtje” në zbatim të pikës “a” të nenit 58, për 15 punonjës**

**1.Z. A.G.**, i cili ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Ardhurave Vendore për periudhën 21.07.2022-31.12.2022, për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Kreut XI- “*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, të ndryshuar dhe mos arkëtimin e debitorëve në vlerën totale **114,176 mijë** lekë. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 32-54*).

**2.Znj. A.SH.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave, për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Kreut XI- “*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, të ndryshuar dhe mos arkëtimin e debitorëve në vlerën totale **114,176 mijë** lekë. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 32-54*).

**3.Znj. E.Ç.**, me detyrë, Përgjegjëse e Kontrollit të Biznesit, për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Kreut XI- “*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, të ndryshuar dhe mos arkëtimin e debitorëve në vlerën totale **114,176 mijë** lekë. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 32-54*).

**4.Z.M.H.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Njësive Administrative, për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, Kreut XI- “*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, të ndryshuar dhe mos arkëtimin e debitorëve në vlerën totale **114,176 mijë** lekë. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 32-54*).

**5.Znj. E.J.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, për 3 raste në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe në 2 raste të miratimit të çertifikatave të përdorimit jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 144-159*).

**6.Z.A.T.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit /Administrimit të Lejave/Legalizimi, për 2 raste në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe në 3 raste të

miratimit të çertifikatave të përdorimit jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 144-159*).

**7.Z.V.Q**, me detyrë Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit /Administrimit të Lejave/Legalizimi, për 1 rast në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe në 2 raste të miratimit të çertifikatave të përdorimit jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 144-159*).

**8.Z.R.S**, me detyrë Specialist në Sektorin e Planifikimit të Territorit /Administrimit të Lejave/Legalizimi, për 1 rast në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe në 1 rast të miratimit të çertifikatave të përdorimit jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 144-159*).

**9.Z. G.F**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimet Njerzore dhe Prokurimet Publike, i cili, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 5 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 61, pika 2. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 77-142*).

**10.Znj. G.G**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve Publike, e cila, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 5 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 61, pika 2. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 77-142*).

**11.Z. S.K**, me detyrë Specialist në Sektorin e Hartimit dhe Implementimit të Projekteve, i cili, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 2 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 61, pika 2. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 77-142*).

**12.Znj. M.ZH**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Hartimit dhe Implementimit të Projekteve, e cila, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për 2 raste (procedura prokurimi) ka aplikuar kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 61, pika 2. Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 2 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 82. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 77-142*).

**13.Znj. F.D**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Aktiveve, e cila, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 3 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 82. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 32-54*).

**14.Znj. O.I**, me detyrë Specialiste e Sektorit të Prokurimeve Publike, e cila, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 2 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 82. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 77-142*).

**15.Znj. N.GJ**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit për Menaxhimin e Kontratave dhe Investimeve, e cila, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për 2 raste (procedura prokurimi) ka shpallur fitues OE të cilët nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 82. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 77-142).

#### **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit që janë rekomanduar masat disiplinore, Bashkia Maliq pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.
- b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.



## V. ANEKSET

### Periudha: 01.01.2022-31.12.2022: Pasqyra AB1:Struktura e AB të njësisë

Nr.	Viti	Emër Mbiemër	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	2022	A.B	Përgjegjës i Njësisë	Financë	33	16	2008	40orë/vit
2	2022	E. K	Specialist Auditi	Menaxhim-Marketing	9	3.5	2021	40orë/vit
3	2022	P.D	Specialiste Auditi	Financë			-	
4	2022	K.D	Specialiste Auditi	Financë	2	1	Nuk është e çertifikuar	

**Burimi:** Bashkia Maliq.

### Pasqyra AB2:Subjektet e audituara për vitin 2022

Nr.	Auditimet e planifikuara	Auditimet e planifikuara (ndryshuar dt,15.11.2022)	Nr.	Auditimet e realizuara
1	Drejtoria e Financës &Buxhetit (Detyrime të prapambetura)	Drejtoria e Financës &Buxhetit (Detyrime të prapambetura)	1	Drejtoria e Financës &Buxhetit (Detyrime të prapambetura)
2	Zbatimi i detyrave të lëna nga NJAB në vitin 2021	Zbatimi i detyrave të lëna nga NJAB në vitin 2021	2	Zbatimi i detyrave të lëna nga NJAB në vitin 2021
3	Spektori i Ujitje-Kullimit	Spektori i Ujitje-Kullimit	3	Spektori i Ujitje-Kullimit
4	Spektori i Rrugëve Rurale	Spektori i Rrugëve Rurale	4	Spektori i Rrugëve Rurale
5	Ujësjetllës-Kanalizime Sha Maliq	Ujësjetllës- Kanalizime Sha Maliq	5	Ujësjetllës- Kanalizime Sha Maliq
6	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit DPKZHT (Asetet)	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit DPKZHT	6	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit DPKZHT
7	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (Veprimet me thesarin)	Njësia Administrative Pirg	7	Njësia Administrative Pirg

**Burimi:** Bashkia Maliq

### Pasqyra AB3:Dosjet e zgjedhura për auditim

Nr.	Viti	Objektet e audituara	Përshkrimi i punës së Njësisë së Auditit të Brendshëm
1	2022	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit	Përbërja e dosjes
			Njoftim auditimi dokument nr.1 prot, datë 12.01.2022.
			Program auditimi nr. 100, datë 12.01.2022.
			Takimi fillestar datë 17.01.2022.
			Takim përmyllës datë 07.02.2022.

			Projekt Raport nr. 103/1 prot, date 18.02.2022.
			Raport Final nr. 103/2 prot, , datë 04.03.2022.
			Memorandum drejtuar Kryetarit të Bashkisë nr. 103/3 prot datë 11.03.2022.
			Urdhër i Kryetarit të Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve nr. 121, datë 17.03.2022.
			Vlerësim i riskut sipas problematikave i mesëm pikë 30.
		<b>Spektori i Rrugëve Rurale</b>	<b>Përbërja e dosjes</b>
			Njoftim auditimi dokument nr. 30 prot., datë 13.06.2022.
			Program auditimi nr. 3432 prot , datë 24.06.2022.
			Takimi fillestar datë 27.06.2022.
			Takim përmbyllës datë 08.07.2022.
			Projekt Raport nr.3432/1prot , datë 25.07.2022.
			Raport Final nr. 3432/2 , datë 05.08.2022.
			Memorandum drejtuar Kryetarit të Bashkisë datë 12.08.2022.
			Urdhër i Kryetarit të Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve nr.492, datë 22.09.2022.
			Vlerësim i riskut sipas problematikave i mesëm 21 pikë.
2	2022		

**Burimi:** Bashkia Maliq.

Aneksin nr. 1, pika 6 “Mbi të dhënat e IMTV Bashkia Maliq, viti 2022”.

Nr	Emer Mbiemer	Konstatimi/Vendimi i Gjebes Viti 2020		Shkresa derguar Dr Finances (Kontabilizim)	Shkresa dërguar në Zyres Juridike (kërkesë)
		Konstatimi	Nr. Serial/date	Lekë	
1	Gj. V	Nr.000025 Dt.27.01.2020 Nr.000024.dt.27.01.2020 50,000 (në process arkëtimit)		Nr.62 dt.29.01.2020	Nr.67 dt.18.02.2020 Vendim mbi lëshim urdhër ekzekutimi nr.401-(280)Vendimi dt.12.06.2020
2	D.H	Nr.000026 Dt.03.02.2020 Nr.000025.dt.03.02.2020. 500.000 (arkëtuar)		Nr.64 dt.03.02.2020	-
3	R.Ç	Nr.000027 dt.16.08.2020 Nr.000026 dt.27.05.2020 500.000 (në process arkëtimi)		Nr.70 dt.27.05.2020	Nr.72 dt.18.06.2020 Vendim mbi lëshim urdhër ekzekutimi nr.544-(365) Vendimi dt.24.01.2020
4.	A.I	Nr.000028 dt.22.05.2020 Nr.00027 dt.27.05.2020 500.000 (në process arkëtimi)		Nr.71.dt.27.05.2020	Nr.73dt.18.06.2020.Vendim mbi lëshim urdhër ekzekutimi nr.1680-(459) Vendim dt.22.07.2020
5.	N. E	Nr.000029 dt.18.16.2020 Nr.000028 dt.19.16.2020. 500.000( në process arkëtimi)		Nr.76.dt.19.06.2020	Kërkesë nr.81 protdt 08.07.2020.Vendim mbi lëshim urdhër ekzekutimi nr.627-416 dt.16.07.2020
6.	J.Sh	Nr.000030 dt 18.06.2020 Nr.000029 dt 19.06.2020. 500.000(në process arkëtimi)		Nr.77.dt 19.06.2020	Nr.83 dt.20.07.2020.Vendim mbi lëshim urdhëri të ekzekutimit nr.742-(515) Vendimi dt.30.07.2020.
7.	V.T	Nr.000031 dt 26.06.2020 Nr.000030 dt.02.12.2021 500.000(në proces arkëtimi)		Nr.80 dt.01.07.2020	Nr.84 dt.0.07.2020. Vendim mbi lëshim urdhëri të ekzekutimit nr.706-(470) Vendimi dt.29.07.2020
Nr	Emer Mbiemer	Konstatimi/Vendimi i Gjebes Viti 2021		Shkresaderguar Dr Finances	ShkresadërguarnëZyresJuridike

		<b>KonstatimiNr. Serial/datëLekë</b>		
1	P.T	Nr.000032 Dt.02.04.2021 Nr.000031.dt.02.04.2021 100.000(arkëtuar)	Nr.4 dt.02.04.2021	
2	M.A	Nr.000033Dt.07.05.2021 Nr.000032.dt.10.05.2021. 100.000(arkëtuar)	Nr.6 dt.10.05.2021	
3	M.M	Nr.000067 dt.16.08.2021 Nr.000033 dt.16.08.2021. 100.000(arkëtuar)	Nr.12 dt.16.08.2021	
4.	I.I	Nr.000068 dt.15.11.2021 Nr.000100 dt.16.11.2021. 300.000(Marëveshje bashkpunimi me dr finances pagese me këste)	Nr.17.dt.16.11.2021	Kërkesënr.1767prot.dt.17.01.2022(Gjy katës).Vendim lëshim urdhër ekzekutimi nr.161-(139) Vendim dt.24.01.2022
5.	A.T	000069 dt.15.11.2021 Nr.000101 dt.16.11.2021 300.00((Marëveshje bashkpunimi me dr finances pagese me këste)	Nr.18.dt.16.11.2021	Kërkesë nr.176 protdt 17.01.2022.(Gjykatës)
6.	A.T	Nr.000070 dt 23.11.2021 Nr.000102 dt 25.11.2021. 926.713(në process arkëtimi)	Nr.20.dt 26.11.2021	Nr.25 dt.20.12.2021.Vendimbilëshimurdhë ritëekzekutimit nr.2988-(2471) Vendimi dt.29.12.2021.
7	“R. P”	Nr.000072 dt.12.04.2022 Nr.000104.dt.14.04.2022. 50 000 (arkëtuar)	Nr.46 Dt.15.04.2022	-
8	M.A	Nr.000073 dt.12.07.2022 Nr.000105.dt.13.07.2022 200 000 (arkëtuar)	Nr.9 dt.13.07.2022	-
9	S.M	Nr.000074 dt.03.2022 Nr.000106.dt.03.08.2022 48,068(arkëtuar)	Nr.11 Dt.03.08.2022	-
10	I.S	Nr.000075 dt.29.09.2022 Nr.000107.dt.03.10.2022 50 000 (në process arkëtimi)	Nr.14. dt.03.10.2022	Nr.17 dt.02.12.2022.Vendimbilëshimin e urdhëritë ekzekutimit.Nr.339 (292) Vendimi.

11	Sh.B	Nr.0076.dt.14.11.2022 Nr.000108dt.16.11.2022 100,572(në process arkëtimi)	Nr16. dt.17.11.2022	Nr.18dt.06.12.2022.Vendimmbilëshim in e urdhërit të ekzekutimit. Nr.Vendimi 313-(270).
----	------	---	------------------------	--

### Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

**Pasqyra PF3:** Detajet e nënrubrikës “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete Monetare në arkë			
512	Mjete monetare në bankë			
520	Disponibilitete në thesar	131,433,695	94,329,216	37,104,447
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera	1,356,740	1,298,510	58,230
54	Akreditiva dhe paradhënie			
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë			
	<b>Totali</b>	<b>132,790,435</b>	<b>95,627,726</b>	<b>37,162,709</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

### Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF4** më poshtë.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	16,784,777	10,464,533	6,320,244
32	Inventar i imët	32,286,328	26,987,204	5,299,124
33	Prodhim në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarëve			
	<b>Totali</b>	<b>49,071,105</b>	<b>37,451,737</b>	<b>11,619,368</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

#### Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF5 më poshtë.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>			
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Loka			
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma te tjerë shoqërore			
44	Institucione te tjera publike			
466	Kreditore per mjete ne ruajtje			
468	Debitorë te ndryshëm	63,463,222	57,566,699	5,896,523
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	30,933,239	28,968,027	1,965,22
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit			
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)			
	<b>Totali</b>			
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>			
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore			
473	Llogari të pritjes të marrëdhënies me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			
	<b>Totali</b>	<b>94,396,461</b>	<b>86,534,726</b>	<b>7,861,735</b>

Burimi: Bashkia Maliq

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF10 më poshtë.

**Pasqyra PF10:** Detajet e nënrubrikës “Ndërtesa Konstruksiione”.

Nr	Ndërtesa, Konstruksiione(kosto historike)	Vlera Neto	Shtesa 2022	Vlera Neto 31.12.2022
1	Zyrat e Bashkisë, rikonstrukcion 2017	34,772,823		34,772,823
2	Rikonstrukcion Soleta	175,014		175,014
3	Rikonstrukcion Salla e Mbledhjeve	326,472		326,472
4	Rrethimi i Zyrave	220,130		220,130
5	F V Dyer Dritare te Brendshme	320,257		320,257
6	Rikonstrukcion Soleta	75,668		75,668

7	Rikonstruksion Zyra e Gjendjes Civile	192,767		192,767
8	FV tra elektrik	219,605		219,605
9	Shkolla e Vjetër, Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Maliq	27,694,030		27,694,030
10	Shkolla 9- vjeçare bibliotekë	76,252		76,252
11	Shkolla Fillore Fshat Maliq	22,876		22,876
12	Shkolla Fillore Gocë	152,504		152,504
13	Shkolla e Vjetër, Rikonstruksion Shkolla Kopanec, Supervizim, Kolaudim	2,253,288		2,253,288
14	Kopshti Maliq, Rikonstruksion Kopshti Maliq	5,426,924		5,426,924
15	Rikonstruksion Kopshti Terove + Maliq, Kolaudim, mbikëqyrje	1,722,148		1,722,148
16	Shkolla e Mesme, Rikonstruksion Rik. njejt sanitare, supervizim, kolaudim	9,651,470		9,651,470
17	Materniteti i vjetër	93,503	30,000	123,503
18	Pallati i kulturës,	676,658		676,658
19	Rikonstruksion Qendra Shëndetësore Fshati Maliq	722,934		722,934
20	Rikonstruksion Qendra Shëndetësore Fshati Kolanec	508,637		508,637
21	Rikonstruksion Qendra Shëndetësore Fshati Gocë	440,121		440,121
22	Rikonstruksion Qendra Shëndetësore Plovisht	502,987		502,987
23	Rikonstruksion Qendra Shëndetësore Maliq, supervizim, kolaudim	2,618,871		2,618,871
24	Ndërtim Godina Klubit të Futbollit Maliq,shkallët,bankinat	5,720,600		5,720,600
25	Ndërtim Terrene Sportive Shkolla 9- vjeçare dhe e Mesme	1,545,551		1,545,551
26	Rikonstruksion Çatia tek Pallati i Kombinatit	1,223,081		1,223,081
27	Ndërtim Thertore ne Qytet	176,946		176,946
28	Rikonstruksion Banjat Publike	461,286		461,286
29	Ndërtim Garazh per Mjetet e Bashkisë	186,207		186,207
30	Rikonstruksion fasadat, rrugët kryesore Qytet Maliq	31,696,149		31,696,149
31	Lulishte para Bashkisë	1,165,831		1,165,831
32	Lulishte tek Shkolla e Mesme	301,591		301,591
33	Lulishte tek Kisha Blloku 1 dhe Blloku 2	3,958,056		3,958,056
34	Rikonstruksion tualete, çati njësitë, mbikëqyrje kolaudim	6,105,711		6,105,711
35	Rikonstruksion objekte shkollore, Faza I dhe II, mbikëqyrje, kolaudim	25,277,600		25,277,600
36	Punime ndërtimi në shkolla (Word Vizion)	401,694		401,694

37	Rikonstruksion objekte administrative, mbikëqyrje, kolaudim	2,678,437		2,678,437
38	Kioske vendroje	187,579		187,579
39	Rikonstruksion godina e bashkisë, Faza II, mbikëqyrje, kolaudim	29,333,246		29,333,246
40	Rikonstruksion objekti zjarrfikës, mbikëqyrje, kolaudim	3,141,652		3,141,652
41	Adoptimi i godinës së ish laboratorit për strehim social, mbikëqyrje kolaudim	5,186,286		5,186,286
42	Ndërtim vepra përkujtime	626,028		626,028
43	Rikonstruksion pallate blloku 2 Maliq	348,257		348,257
44	Përmirësim i banesave per komunitete te varfra	8,784,917		8,784,917
45	Përmirësimi i banesave 2020,2021	9,585,958		9,585,958
46	Rikonstruksion objekte ndërtimore, faza I,II,III, mbikëqyrje kolaudim	1,023,783		1,023,783
47	Rikon stadiumi Faza I-rë, mbikëqyrje, kolaudim	2,864,143		2,864,143
48	Sistemim lulishte Kisha Maliq, mbikëqyrje, kolaudim	739,473		739,473
49	Rik.obj. ndertim, magazina 2021	-	1,565,236	1,565,236
50	Suvatim i jashtëm magazina, kol	-	1,305,269	1,305,269
51	Rik.Stadium, Faza I	-	6,546,720	6,546,720
52	Rik.Pallate viti 2021, mbik	-	4,090,784	4,090,784
53	Ndërtim fari+terrene, mbik kol	-	1,343,613	1,343,613
54	B/financim DORCAS	-	1,181,725	1,181,725
55	Kopshti Maliq, Rikonstruksion K. Maliq, kol	-	8,422,702	8,422,702
56	Rik. objekte arsimore	-	1,091,160	1,091,160
57	Përmirësimi i banesave 2021	-	6,988,309	6,988,309
58	Përmirësimi i banesave 2022	-	18,493,969	18,493,969
59	Ndërtesa e shkollës Vashtëmi	10,125,937		10,125,937
60	Ndërtesa e shkollës Libonik	9,305,161		9,305,161
61	Ndërtesa e shkollës Vloçisht	14,067,512		14,067,512
62	Ndërtesa e shkollës Pocestë	15,250		15,250
63	Ndërtesa shkolla Klocë	762,518		762,518
64	Ndërtesa shkolla Symiz	3,022,185		3,022,185
65	Ndërtesa shkolla Drithas Poshtë	1,524,471		1,524,471
66	Ndërtesa shkolla Drithas	5,885,093		5,885,093



67	Ndërtesa shkolla Pocestë	11,392,512		11,392,512
68	Ndërtesa kopshti Vloçisht	299,718		299,718
69	Ndërtesa e Njësisë Administrative	10,411,072		10,411,072
70	Ndërtesa pallati i kulturës Vloçisht	290,061		290,061
71	Gjelbërim Troje	1,894,703		1,894,703
72	Rruga Vashtëmi	274,468		274,468
73	Lulishte ,Lozhan,Mesmal,Strelcë	1,059,289		1,059,289
74	Ndërtesa e komonës Gorë	3,965,091		3,965,091
75	Shkolla Lozhan Fshat	457,511		457,511
76	Shkolla Desmirë	136,296		136,296
77	Shkolla Strelcë	4,369,664		4,369,664
78	Shkolla Mesmal	5,829,738		5,829,738
79	Shkolla Mocan	89,215		89,215
80	Shkolla e mesme Lozhan	11,755,789		11,755,789
81	Ndërtim banjo publike Moglicë	201,397		201,397
82	Rikonstruksion Zyrat e komunës, rrethim, sistemim	1,066,141		1,066,141
83	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Lumaj	75,848		75,848
84	Shkolla Moglicë	4,693,882		4,693,882
85	Shkolla Gopesh	192,103		192,103
86	Shkolla Zerec ,rikonstruksion	732,185		732,185
87	Shkolla Dushar ,Rikonstruksion	350,228		350,228
88	Shkolla Nikollarë	847,065		847,065
89	Shkolla Popçisht, Rikonstruksion	135,882		135,882
90	Shkolla Kodras	7,488		7,488
91	Komuna Pirg	3,963,939		3,963,939
92	Lapidari Pirg	48,537		48,537
93	Kabina elektriktrike Sovjan	145,095		145,095
94	Qendra shëndetësore Veliternë	763		763
95	Qendra shëndetësore Zvirinë	2,094,867		2,094,867
96	Qendra shëndetësore Kakaç	766,088		766,088

97	Qendra shëndetësore Leminot	16,775		16,775
98	Qendra shëndetësore Sovjan	7,625		7,625
99	Qendra shëndetësore Pirg	2,663,985		2,663,985
100	Ambulanca Gurishtë	808,240		808,240
101	Shkarje dheu Pirg	2,283,740		2,283,740
102	Modernizimi i gjendjes civile Pirg	456,150		456,150
103	Shkolla Pirg, rrethimi	16,998,517		16,998,517
104	Shkolla Pirg e re	11,494,598		11,494,598
105	Shkolla Sovjan	9,692,970		9,692,970
106	Shkolla Shqitas	14,157,825		14,157,825
107	Shkolla Gurishtë	456,705		456,705
108	Shkolla Leminot	2,845,888		2,845,888
109	Shkolla Zvirinë	1,474,520		1,474,520
110	Shkolla Navoselë	865,780		865,780
111	Shkolla Qershizë	8,316		8,316
112	Shkolla Veliternë	7,440,155		7,440,155
113	Shkolla Kakaç	3,180,859		3,180,859
114	Kopshti Sovjan	763		763
115	Kopshti Veliternë	3,050		3,050
116	Shkolla Burimas, Rikonstrukcion	3,843,571		3,843,571
117	Shkolla Zemblak	274,087		274,087
118	Shkolla Zemblak e re	14,300,268		14,300,268
119	Shkolla Pendavinj	375,254		375,254
120	Mbik shkolla pend f II 20	8,475		8,475
121	Shkolla Rembec	5,333,580		5,333,580
122	Shkolla Orman	9,932,986		9,932,986
123	Shkolla Terove	107,458		107,458
124	Shkolla Zvezde	20,379,322		20,379,322
125	Shkolla Plase	9,412,016		9,412,016
126	Shkolla Kreshpanj	25,840		25,840

127	Shkolla Rov	135,402		135,402
128	Shkolla Shëngjergj	176,904		176,904
129	Shkolla Pojan	992,826	35,000	1,027,826
130	Kopshti Terove	45,705		45,705
131	Kopshti Rembec	60,468		60,468
132	Kopshti Plase	530,453		530,453
133	Tenda per varet	364,727		364,727
134	Ndërtim shkolla Rrëmbec	49,664,100		49,664,100
135	Pallati i Kulturës Burimas	297,345		297,345
136	Pallati i Kulturës Zëmbak	2,598,925		2,598,925
137	Pallati i Kulturës Pojan	807,405		807,405
138	Zyrat e Komunës	2,341,721		2,341,721
139	Nd.d.uji Burimas,Shëngjergj	1,078,843		1,078,843
140	Sporti	6,249,669		6,249,669
141	Kabine Elektrike Pojan	805,796		805,796
142	Depo Baze Prodhuese	34,614		34,614
143	Nd.tregu rural Plasë	22,633,689		22,633,689
144	Ndërtim Kopshti +zyra Sheqeras	212,716		212,716
145	Çerdhe Sheqeras	190,606		190,606
146	Shkolla Sheqeras,rikonst,rrethim	10,339,972		10,339,972
147	Zyra komunës + kinema,meremetim	2,885,235		2,885,235
148	Shkolla Vreshtas,rrethim	11,759,890		11,759,890
149	Shkolla Bregas,Rik.depo,meremetim	12,013,819		12,013,819
150	Kopshti Bregas	1,512,798		1,512,798
151	Shkolla vjetër Podgorie	5,909,246		5,909,246
152	Shkolla mesme Podgorie, rehabilitim	29,962,349		29,962,349
153	Kopshti i ri Podgorie	4,627,703		4,627,703
154	Rrethim varreza Vreshtas	1,901,848		1,901,848
155	Rrethim varreza Bregas	195,264		195,264
156	Rrethim varreza fshati Podgorie	448,914		448,914

157	Kabinë elektrike Podgorie	54,075		54,075
158	Kabinë elektrike Bregas	372,123		372,123
159	Ndërtim Q.Sh Podgorie,rrethim	2,845,458		2,845,458
160	Rrethim Q.SH Sheqeras	304,682		304,682
161	Ndërtim mur guri lagj.2 Podgorie	665,397		665,397
162	Ndërtim kabinë elektrike Vreshtas	225,509		225,509
163	Rrethim sistemim +shkolla Kopolë,kol	689,338		689,338
164	Rrethim sist. fusha fusha sportit Vreshtas	1,391,019		1,391,019
165	Rrethim mur mbajtës lgj.xhami Podgorie	482,717		482,717
166	Fusha sportit Sheqeras projekt	45,745		45,745
167	Fusha sportit Kopolë projekt	45,745		45,745
168	Fusha sportit Podgorie	1,595,004		1,595,004
169	Ura Podgorie,rikontr muri	897,961		897,961
170	Kontribut kanal vaditës Podgorie	560,381		560,381
171	Rikonstruksion ura Vreshtas	1,425,551		1,425,551
172	K.U.B Podgorie	1,807,071		1,807,071
173	K.U.B Sheqeras	1,476,767		1,476,767
174	K.U.B +sist qëndër Bregas	326,780		326,780
175	Ndërtim sheshi Podgorie	709,874		709,874
176	Kanal vaditës	100,640		100,640
	<b>Total</b>	<b>669,490,872</b>	<b>51,094,487</b>	<b>720,585,359</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF11** më poshtë.

**Pasqyra PF11:** Detajet e nënrubrikës “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”.

Nr	Rrugë, rrjete ,vepra ujore(kosto historike)	Vlera Neto	Shtesa 2022	Gj.31.12.2022
1	Rikontruksion Rruga Kryesore	6,218,035		6,218,035
2	Sistemim Rruge Dytesore Qytet	15,148,438		15,148,438
3	Sistemim Rruga Fshati Maliq,rikon	7,753,169		7,753,169
4	Rrethim i Varrezave Fshati Maliq	39,615		39,615

5	Rruget e Fshatrave	46,638		46,638
6	Vendosje Tabela per Emrat e rrugeve	276,449		276,449
7	Ndricim rrugor	380,315		380,315
8	Sistemim Asfaltim rruga Krastafilak	4,036,303		4,036,303
9	Rikonstruksion Rruga 1 Maji Faza e I-re	2,188,761		2,188,761
10	Bashkefinancim Terrene Sportive	113,322		113,322
11	Rikonstruksion Rruga 1 Maji Faza e II-te	1,916,384		1,916,384
12	Sistemim Asfaltim Ruga e Bllokut 3	1,614,980		1,614,980
13	Asfaltim rruga e Bllokut nr 3,Mbikqyrje Kolaudim	6,069,871		6,069,871
14	Bashkefinancim Rruge REC	879,770		879,770
15	Projekti i Rrugeve	229,767		229,767
16	Rruge ,KUZ Blloku nr 4	4,039,085		4,039,085
17	Sistemim Asfaltim Unaza e Qytetit	16,862,223		16,862,223
18	Trotuare ne Qytet ,Supervizim	28,660,009		28,660,009
19	Ndërtim rruge,trotuare,kolaudim	10,974,393		10,974,393
20	Rrethrotullimi Qyteti Maliq	1,367,953		1,367,953
21	Asfaltim Rruga Fshat Maliq,Kolaudim, Mbikqyrje	33,059,019		33,059,019
22	Asfaltim rruga e biçikletave	2,231,662		2,231,662
23	Asfaltim blloku nr 3 Maliq	1,485,182		1,485,182
24	Sist-asf rruge Maliq dhe Nj.A, FII 2017,mbikqyrje,kolaudim	17,287,603		17,287,603
25	Sist-asf rruge Maliq dhe Nj.A, FI 2017,mbikqyrje,kolaudim	20,060,277		20,060,277
26	Sist-asf rruge Maliq dhe Nj.A, FIII 2017,mbik,kol	3,345,041		3,345,041
27	Sistemim-asfaltim Maliq,Nj.A ,Faza I,Viti 2018,Mbikqyrje	20,876,959		20,876,959
28	Sistemim-Asfaltim rrugë në Nj.A ,Faza II	4,198,366		4,198,366
29	Sistemim-asfaltim Maliq,Nj.A ,Faza II,Viti 2018,Mbikqyrje,Kolaudim	8,397,319		8,397,319
30	Riparim vepra ujore,mbik ,kol	99,517		99,517
31	Riveshje rrugësh dhe mbushje gropash me asfalt,Mbikqyrje Kolaudim	2,042,708		2,042,708
32	Shkurre dekorative(bush)	462,069		462,069
33	Shkurre dekorative	199,660		199,660
34	Tub plastik + sprucator	2,852		2,852

35	KUB në Qytet,bashkëfinancim	9,821,808		9,821,808
36	Studim gjeologjik	228,182		228,182
37	Kanale ujitës dhe kullues	170,006,475		170,006,475
38	Kanalet sekondare Velitërnë,Sovjan,Pirg	10,138,290		10,138,290
39	Diga Leminot	50,894,278		50,894,278
40	Portbarazhi Kolektor i Sovjanit,mbik,kolaudim	2,652,229		2,652,229
41	Ndërtim Porta dhe ura në fushën e Maliqit,Faza I,II,viti 2018,Mbikqyrje	11,975,367		11,975,367
42	Sistemim-Asfaltim rrugë Zvirinë,Faza I,II,mbik,kolaudim	16,614,338		16,614,338
43	Sistemim-Asfaltim rruga e Vaskave,kolaudim	11,257,402		11,257,402
44	Sistemim-Asfaltim rruga Plasë,kol,mbikq	6,850,614		6,850,614
45	Ndërtim ujësjellësi Popçisht,Mbikqyrje ,Kolaudim	2,754,227		2,754,227
46	Ndërtim Ujësjellësi Bregas,Strelcë	16,228,660		16,228,660
47	Rrjeti i brendshëm ujësjellësi Mesmal,mbikq,kolaudim	2,728,698		2,728,698
48	Rrjeti i brendshëm ujësjellësi Symiz	2,417,365		2,417,365
49	K.U.Z Vloçisht,ndertim 2021,2022	9,411,239	8,508,477	17,919,716
50	Shpim pusi fshati Burimas	528,176		528,176
51	Depo uji fshati Sovjan	939,021		939,021
52	Ndërtim Stacion pompimi Kishnik-Sheqeras	13,925,293	4,639,379	18,564,672
53	Rrjeti i brendshëm Uj.Symiz,Faza I,II,Mbik,Kol	2,070,375		2,070,375
54	Rrjeti i brendshëm Uj.Shqitas,Faza I,II,Mbik,Kol	2,334,225		2,334,225
55	Ndërtim linja+shpim pusi,mbik,kol	3,732,636		3,732,636
56	Rrjeti i brendshëm Uj.Kreshpanj Mbik,Kol	1,761,464		1,761,464
57	Ujesjellsi Mancurisht-Plase,Mbik	17,698,466	80,450,000	98,148,466
58	Mbik,Kol :Ripar vep ujo Poj Zemb FII 20	29,509		29,509
59	Mbik,Kol Miremb kanali Rembec	32,716		32,716
60	Rehabil ujitjes SEP Pojan,F I,F.II	6,097,450	11,428,521	17,525,971
61	Sistem asf rr Nja 2020,Faza I,II,III,mbik,kol	28,947,536		28,947,536
62	Sist asf rr+ sheshe 20,faza I,II	9,954,901		9,954,901
63	Kol sis asfruge ne nja 2021	22,529		22,529
64	Rehab rruga lapidari-Zvezde	1,247,064		1,247,064

65	Rivesh+mbushje gropash 2020,mbik,kol	721,269		721,269
66	Diga Zëmlak	36,014,947		36,014,947
67	Proj.Rrjeti i Brendshëm	110,922		110,922
68	Proj. rrjet i brend ujës F.Maliq	110,922		110,922
69	Projekt.Rikost.Ujësjetllësi Strelcë	355,429		355,429
70	Projekt.Rikost.Ujësjetllësi Mesmal	53,952		53,952
71	Projekt.Rikost.Ujësjetllësi Lozhan	132,908		132,908
72	Projekt ujësjetllësi fshati Kodras	118,845		118,845
73	Projekt Rik.Ujësjetllësi Sovjan	172,206		172,206
74	Projekt Rik.Ujësjetllësi Çaushti	68,455		68,455
75	Projekt Ujësjetllësi Velitërnë	23,769		23,769
76	pr ujesjells zemblak	202,829		202,829
77	projekt shpim pusi	142,614		142,614
78	Rikonst ujësjetllësi Zvezde	316,920		316,920
79	Pr.ujësjetllësi Rov	60,215		60,215
80	Pr.ujësjetllësi Pendavinj	124,391		124,391
81	Pr.puse,furnizim me ujë komuna	96,978		96,978
82	Pr.ujësjetllësi Pojan	370,796		370,796
83	Pr.depo uji,stacion pompash	378,402		378,402
84	Pr-prev linja ujësjetllësi Orman	132,305		132,305
85	Projekt rruga çezma e Zalos	174,306		174,306
86	Sist-Asf rr Nj.A,Vashtëmi 2021 F II	-	8,730,600	8,730,600
87	Sist-Asf. rr Nj.A,Kolanec 2021 FII	-	720,240	720,240
88	Rehabil.rr Gorë Moglicë,betonim 2021, 22,kol,mbik	-	6,220,528	6,220,528
89	Mbushje gropash në rrugë kol,mbik	-	3,460,216	3,460,216
90	Mbikq ,Sist-Asfaltim rrugë sheshe,Maliq 21,mbik,kol	102,810	8,056,220	8,159,030
91	Sist-Asf rrugë Kakaç,2021	-	7,106,776	7,106,776
92	Sist-Asf rruga Vloçisht-Drithas,mbik,kol	-	1,946,352	1,946,352
93	Ndërtim KUZ Burimas 2021	-	1,957,824	1,957,824
94	Ndërtim KUZ Sovjan 2021,mbik ,Kol	-	1,284,159	1,284,159

95	Ndërtim KUZ Klocë,2020	-	3,276,360	3,276,360
96	Ndërtim KUZ Kishnik,2020	-	3,504,600	3,504,600
97	Ndërtim KUZ Sovjan,2020	-	1,641,180	1,641,180
98	Ndërtim KUZ Pirg ,2020	-	2,812,920	2,812,920
99	Ndërtim KUZ Symiz ,2020	-	1,404,144	1,404,144
100	Ndërtim KUZ Vreshtas 2021	-	2,506,656	2,506,656
101	Ndërtim KUZ Vashtëmi 2021	-	1,448,124	1,448,124
102	Ndërtim KUZ Drithas Lart 2021,mbik,kol	-	5,237,915	5,237,915
103	R.B. ujësjellës Velitërnë,kol	-	5,281,505	5,281,505
104	R.B. ujësjellës Gurishtë	-	1,368,038	1,368,038
105	R.B. ujësjellës Symiz	-	160,650	160,650
106	R.B. ujësjellës Leminot	-	609,342	609,342
107	Mbik,kol Mirëmb vepra ujore,F I, F II	-	145,125	145,125
108	Nd.Stacion Pompimi Vreshtas,projekt	-	16,563,091	16,563,091
109	Skema Leminot	-	10,684,450	10,684,450
110	Rikostruksion Rruga Moglicë Gopesh	719,129		719,129
111	Rikostruksion Rruga Lumanj Peshtan	1,659,098		1,659,098
112	Rikostruksion rruga Nikollarë -Lumaj	925,074		925,074
113	Rikostruksion ura Lumaj-Peshtan	423,358		423,358
114	Rikostruksion rruga Zerec,Mur mbajtës	728,777		728,777
115	Ura e re GjiN s,Rikonstruksion	3,312,146		3,312,146
116	Rruga e re GjiN s	161,225		161,225
117	Rikostruksion ura fshati Peshtan	741,550		741,550
118	Rikostruksion e rrugës Popçisht	105,113		105,113
119	Ura e re këmbësore Dushar	268,203		268,203
120	Rikostruksion e rrugës Popçisht	31,297		31,297
121	Ndërtim ura e re këmbësore e fshatit Kodras	315,973		315,973
122	Rikostruksion rruga GjiN s -Osojë	315,795		315,795
123	Rikostruksion rruga Moglicë Zerec Dushar	784,377		784,377
124	Hapje e rrugës Gopesh-Qafa e Lenies-Uji i Ftohtë	1,171,615		1,171,615



125	Riparim i rrugës Dushar,Kodras,Osojë,Zerec	356,915		356,915
126	Ndërtim Hyrje Dalje Ura Osojë	2,810,256		2,810,256
127	Rikostruksion rezervuari fshati Gopesh	541,291		541,291
128	Rrugë me çakull Moglicë	3,350,732		3,350,732
129	Rik . Mur mb .Mesmal	235,947		235,947
130	Ura Moglicë	239,107		239,107
131	Sistemim qëndra Moglicë,Viti 2011	134,057		134,057
132	Rikonstruksion oborri zyrat e komunës Moglicë,viti 2013	312,515		312,515
133	Rruga Tresovë	5,305,631		5,305,631
134	Rruga e fshatit Lozhan i ri	9,107,272		9,107,272
135	Rruga Dolan	2,718,832		2,718,832
136	Rr Lozhan i ri kr zv-lozh	27,917,935		27,917,935
137	Rruga Moçan	3,567,488		3,567,488
138	Rruga Desmirë	5,945,813		5,945,813
139	Rruga Strelcë	17,786,105		17,786,105
140	Rruga e brendshme Mesmal	1,610,386		1,610,386
141	Ura Babjen	2,972,906		2,972,906
142	Projekte dhe rrugë	145,120,326		145,120,326
143	Projekt rrugë Vloçisht	432,380		432,380
144	Projekt rrugë të brendshme Libonik	323,268		323,268
145	Riparim rrugët Vloçisht Libonik,Symiz	53,909		53,909
146	Asfaltim rrugët e komunës	638,342		638,342
147	Projekt K.U.Z Pocestë	237,833		237,833
148	Projekt menaxhim mbetje urbane	47,567		47,567
149	Projekt rikonstruksion ura	69,447		69,447
150	Asfaltim Rruga Vloçisht,Vashtëmi,Libonik,Mbikqyrje Kolaudim	10,669,801		10,669,801
151	Rehabilitim rr.Pylli I Fazanëve,Mbikqyrje Kolaudim	13,838,347		13,838,347
152	Riparim urash Pirg	745,852		745,852
153	K.U.B Sovjan	7,102,595		7,102,595
154	K.U.B Pirg	11,158,060		11,158,060

155	Riparim mure mbajtëse të rrugëve	394,754		394,754
156	Rrjeti ndriçues Sovjan	235,454		235,454
157	Rrjeti ndriçues Pìrg-Zvirinë	1,675,847		1,675,847
158	Rrjeti ndriçues Pìrg	193,437		193,437
159	Ura Leminot	2,040,338		2,040,338
160	Rrethimi i varrezave Kakaç	63,092		63,092
161	Asfaltim rruga qëndër Pìrg	18,035,710		18,035,710
162	Asfaltim rruga Velitërnë	3,931,324		3,931,324
163	Asfaltim rruga Zvirinë	7,315,652		7,315,652
164	Rivitalizim rruga Sovjan	25,436,243		25,436,243
165	Rivitalizim Rr.Sovjan Luadishtë	46,647,476		46,647,476
166	Sistemim Asfaltim Rr.Leminot	26,662,864		26,662,864
167	Asfaltim rruga Pìrg Shqitas	14,108,404		14,108,404
168	Asf.rruga nacionale Shqitas	10,010,148		10,010,148
169	Shtrim rrugë me çakëll Pìrg	12,721,062		12,721,062
170	Mbushje grope me asfalt	1,368,013		1,368,013
171	SP.kanal vaditës	1,347,718		1,347,718
172	Riparim rrugë dhe mure mbajtëse te varreve Pìrg	296,181		296,181
173	Kanalet Zvirinë,Petrushë ,Vreshtas	18,210,104		18,210,104
174	Rikonstr.ndricimi rrugor Pojan	821,140		821,140
175	Asfaltim rruga Orman	6,708,741		6,708,741
176	Investim rruga Zvezde	2,812,639		2,812,639
177	Rikon.rruga Pojan-Shingjergj	1,920,939		1,920,939
178	Rikonstr.rruga Kreshpanj	10,800,484		10,800,484
179	Rikonstr. Rruga Burimas	7,286,246		7,286,246
180	Asfaltim rruga Zemblak	8,921,344		8,921,344
181	Rruget e Pojanit,sist-asf rruge 2021,faza I,Faza II	7,842,022	7,123,574	14,965,596
182	Asfaltim rruga hyrese Pojan,rik	3,977,491		3,977,491
183	Asfaltim rruge lidhese lagje fsh.Pojan	2,269,921		2,269,921
184	Asfaltim rruga e Rathes	6,725,549		6,725,549

185	Asfaltim Unaza Pojan	2,425,949		2,425,949
186	Rikonstr.cati rruge Pojan	1,129,568		1,129,568
187	Sistemim trotuaresh Pojan	2,389,873		2,389,873
188	Asfaltim unaza Pojan	2,045,803		2,045,803
189	Asf.rruga hyrja e varezave Pojan	8,768,615		8,768,615
190	Asf.rruga Orman-Sheqeras	20,210,559		20,210,559
191	Asf.rruga e varezave Pojan	8,816,417		8,816,417
192	Asf. Rruga ish magazinat Pojan	2,410,407		2,410,407
193	Bashkfin per mbetjet e ngurta	426,434		426,434
194	Rikonstruksion ura Orman	3,214,313		3,214,313
195	Rikons.fusha e sportit Pojan	3,954,706		3,954,706
196	Rrethim varezash Pojan	1,837,116		1,837,116
197	Rrethim varezash Shingjergj	447,886		447,886
198	Rrethim varezash Terove	385,552		385,552
199	Rrethim varezash Zvezde	674,144		674,144
200	Rrethim varezash Plase	233,552		233,552
201	Rrethim varezash Burimas	202,958		202,958
202	Rrethim varezash Zemblak	73,459		73,459
203	Rrethim varezash Pendavinj	123,673		123,673
204	Rrethim varezash Kreshpanj	172,429		172,429
205	Rrethim varezash Rov	442,949		442,949
206	Rrethim varezash Orman	281,356		281,356
207	Rrethim varezash Rembec	678,060		678,060
208	Shkembim Zemblak	846,401		846,401
209	Ura Shëngjergj	475,420		475,420
210	Rikonstruksion kanal kullues Pojan	871,342		871,342
211	Kanaliz.ujrave te bardha te Komunes	7,323,931		7,323,931
212	Kanaliz.ujrat e bardha Pojan	1,739,386		1,739,386
213	Prita Zëmbak,kol	1,379,852		1,379,852
214	Asfaltim rr.Pojan-Zvezdë, Mbikqyrje, Kolaudim	5,741,681		5,741,681

215	Ndërtim këmbët e urës Orman,mbik,kol	6,024,460		6,024,460
216	Sistemim Asfaltim Rruga Kuc -Orman ,kol,mbik	83,493,232		83,493,232
217	Rr.Pojan -Zvezdë,mbik,kol	30,975,450		30,975,450
218	Rehabilitim prroi Zvezdë,kol,mbik	3,404,739		3,404,739
219	Rr.Pendavinj-Pojan-Zvezdë,kolaudim,mbikqyrje	30,701,494		30,701,494
220	Rruga Podgorie-Vreshtas,rik	18,858,216		18,858,216
221	Kontribut rruga Podgorie	734,110		734,110
222	Rruga Vreshtas Qëndër	1,389,028		1,389,028
223	Sist-Asf Rr.Vreshtas	2,459,362		2,459,362
224	Rruga Podgorie,rikonstruksion	8,437,424		8,437,424
225	Rruga Bregas	619,513		619,513
226	Asf Rr.Sheqeras,mbikqyrje,kolaudim,FI,FII,21,22	24,825,193	14,417,538	39,242,731
227	Rikonstruksion rrugë dytësore Sheqeras	1,042,293		1,042,293
228	Rruga Asf.kthesa e Rëmbecit, Sheqeras	27,161,636		27,161,636
229	Rikonstruksion Rr.Sheqeras shkolla	949,205		949,205
230	K.U.B sistemim Qendra Bregas	932,955		932,955
231	Instalim interneti	460,103		460,103
232	Ndërtim rrjeti ndriçim rrugor	279,044		279,044
233	Rikonstruksion Rr. Haxhi-Zalo	1,256,739		1,256,739
234	Rik-sistem-asfal Rr të brendshme Podgorie	18,808,727		18,808,727
235	Asfaltim Unaza Bregas	3,888,910		3,888,910
236	Ndërtim ure shkolla kopole	197,678		197,678
237	Ndërtim rruga varreza Sheqeras	315,337		315,337
238	Ndërtim rrjeti ndriçim rruga komunës	1,356,644		1,356,644
239	Ndërtim pritë vaditje lumi Patok	204,584		204,584
240	Rruga fure Vreshtas	768,697		768,697
241	Kolaudim ,mbikq gjelbërim publik	52,482		52,482
242	K.U.B Sheqeras	353,039		353,039
243	Riparim rruge me çakull loti 1,2,3	640,811		640,811
244	Sistemim fshati Kopole	1,050,421		1,050,421

245	Kanali Petrushë Vreshtas	32,431,640		32,431,640
246	Asfaltim rruga Petrushë-Vreshtas	99,983,249		99,983,249
	<b>Total</b>	<b>1,697,424,621</b>	<b>222,694,504</b>	<b>1,920,119,125</b>

Burimi: Bashkia Maliq

**Pasqyra statistikore nr. 7.b “Aktivet afatgjata me vlerë neto” që ka të bëjë me amortizimin vjetor 2022.**

**Pasqyra PF12:** Detajet e nënrubrikës “Aktivet afatgjata me vlerë neto”.

Nr.Reference Llogarije	Teprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Pakësimet gjatë vitit		Teprica në fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	A.akumuluar	Teprica neto
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	3,464,088	527,925	2,936,163	446,666	0	446,666	0	3,464,088		3,464,088
202	3,464,088	527,925	2,936,163	446,666	0	446,666	0	3,464,088		3,464,088
21-28	3,30,434,378	680,024,376	2,629,410,002	296,176,122	141,742,963	7,505,202	7,05,202	3,598,105,298	84,262,137	2,783,843,161
210	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
211	13,174,567	0	13,174,567	0	0	0	0	13,174,567	0	13,174,567
212	877,814,744	173,087,510	704,727,234	51,094,487	35,236,362	0	0	928,909,231	208,323,872	720,585,359
213	2,142,306,989	354,988,520	1,787,318,469	222,694,504	89,893,848	0	0	2,365,001,493	444,882,368	1,920,119,125
214	74,219,464	15,385,224	58,834,240	8,527,743	2,941,712	1,585,628	1,585,628	81,161,579	16,741,308	64,420,271
215	96,866,068	63,722,234	33,143,834	5,102,001	6,628,767	2,396,010	2,396,010	99,572,059	67,954,991	31,617,068
218	104,861,866	72,840,888	32,020,978	8,757,387	7,042,274	3,523,564	3,523,564	110,095,689	76,359,598	33,736,091
<b>Shuma</b>	<b>3,312,898,466</b>	<b>680,552,301</b>	<b>2,632,346,165</b>	<b>296,622,788</b>	<b>141,742,963</b>	<b>7,951,868</b>	<b>7,505,202</b>	<b>3,601,569,386</b>	<b>814,262,37</b>	<b>2,787,307,249</b>

Burimi: Bashkia Maliq

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF 15** më poshtë.

**Pasqyra PF15:** Detajet e nënrubrikës “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

Objekti	Operatori Ekonomik	Nr.fat	Data	Shuma
Pastrimi (Detyrim tetor )	K	301	14.11.2022	2,205,024
Pastrimi (Detyrim nentor )	K	334	13.12.2022	2,106,334
Detyrim ton mbetje (tetor)	K	49	11.11.2022	1,129,839
Detyrim ton mbetje nentor)	K	54	05.12.2022	1,073,081
Blerje pelet per ngrohje	S	299	22.12.2022	217,800
Blerje pelet per ngrohje	S	300	23.12.2022	217,800
Gaz per ngrohje	K	652	22.12.2022	360,036

Blerje uniforma policie	E.M	51	05.12.2022	644,400
Blerje kripe dhe granil	M.M	156	22.12.2022	280,500
kartolina + zarfa	P. P	82	21.12.2022	100,000
Blerje karburant	ALF	168	18.11.2022	322,567
Blerje karburant	ALF	170	25.11.2022	45,796
Blerje karburant	ALF	173	30.11.2022	143,058
Blerje karburant	ALF	178	03.12.2022	199,820
Blerje karburant	ALF	179	06.12.2022	66,462
Blerje karburant	ALF	184	07.12.2022	16,068
Blerje karburant	ALF	185	19.12.2022	584,871
Blerje karburant	ALF	191	31.12.2022	109,569
Blerje karburant	M.	375	11.11.2022	348,000
Blerje karburant	M.	376	11.11.2022	637,536
Blerje karburant	M.	383	13.11.2022	153,225
Blerje karburant	M.	388	16.11.2022	111,500
Blerje karburant	M.	393	23.11.2022	101,650
Blerje karburant	M.	399	25.11.2022	149,800
Blerje karburant	M.	413	02.12.2022	152,440
Blerje karburant	M.	416	06.12.2022	150,480
Blerje karburant	M.	417	06.12.2022	10,450
Blerje karburant	M.	425	09.12.2022	122,760
Blerje karburant	M.	421	14.12.2022	117,600
Blerje karburant	M.	435	16.12.2022	101,000
Blerje karburant (BENZINE)	M.	435	16.12.2022	7,120
Blerje karburant	M.	439	19.12.2022	19,998
Blerje karburant	M.	440	20.12.2022	137,360
Blerje karburant	M.	450	24.12.2022	123,380
Blerje karburant	M.	459	30.12.2022	144,474
Blerjeaparet tahogragi(digjital+ aksesore)	O.	487	22.12.2022	408,000
Shpz aktiv mesazh urimi + zarfa	P.P	94	28.12.2022	352,800
Blerje fishekzjarre	S.A	376	07.12.2022	116,400
Blerje ndricuesa 2022	I.	34373	19.12.2022	3,984,600
Rikonstrukcion Qendra komunitare kult Dh Orgocka Faza I	S.	70	29.12.2022	7,899,420
Mbushje gropash ne rruge 2022(Diference)	I.	17	07.11.2022	1,925,545
Sistem asf rruga gryka Vlocisht Drithas poshte sit perfundimtar	V.	363	18.11.2022	3,725,647

Sistemim asfaltim rruge Ne Nja viti 2022 SIT NR 1	V.	367	16.12.2022	12,493,428
Rehabilitim I ujitjes SEP pojan viti 2021	SH.	111	27.12.2022	5,107,125
M. Blerje karburant per mjetet	M.	338/2022	12.10.2022	440,239
Sit nr 1 Sistem asf rruga Gryka Vlocisht -Drithas	V.	279/2022	13.09.2022	10,178,049
Energji				1,041,380
Uje				97,789
Posta Sherbim postar				306,993
Telefoni fiks				1,920
Pagese interneti				36,000
<b>Totali</b>				<b>60,527,133</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

### Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”,

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF18** më poshtë.

Objekti i prokurimit	Viti i krijimit	Operatori Ekonomik	Shuma në lekë
NDERTIM UJESJELLES VLOCISHT ASF. RRUGE	2015	L.	74,980
BASHKE FINANCIM UJESJELLES I ORMAN ND. ASF.RRUGE	2015	T.	136,439
RIKONSTRUKSION RRUGA PODGORIE	2015	P.	174,711
NDERTIM KOPSHTI BREGAS	2015	M.	36,989
RIKONSTRUKSION UJESJELLES BREGAS LGJ GREKEVE	2015	S.	33,073
ASFALTIM RRUGA SHEQERAS -RREMBEC	2015	E.	30,572
TRANSPORT MBETJE TE NGURTA LANDFILL	2015	A.	26,100
KUB SHEQERAS	2015	A.	22,266
RIKONSTRUKSION RRUGE BRENDSHME MESMAL	2015	C.	80,952
RIKONSTRUKSION SHKOLLA SHQITAS	2015	S.	51,896
MODERNIZIMI GJ.CIVILE	2015	E.	29,486
RIKONSTRUKSION RRUGA FSH.LEMINOT	2015	V.	500,000
RIKONSTRUKSION SHKOLLA FSH.ZOTILAN	2015	I.	29,947
RIKONSTRUKSION UJESJELLES LEMINOT	2015	A.	12,600
RIKONSTRUKSION ZYRAT E KOMUNES	2015	A.	19,390
NDERTIM BANJO SHKOLLA 9-VJECARE ZEREC	2015	A.	17,400

RIKONSTRUKSION REZERVUAR GOPRSH	2015	L.	14,100
NDERTIM RRUGA GJIRIKAS	2015	E.	189,631
RIKONSTRUKSION REZERVUAR GOPESH	2015	V.D	19,674
GJELBERIM TERITORI I KOMUNES	2015	A.	56,526
NDERTIM LULISHTE ZYRAT E KOMUNES	2015	GJ.	6,934
RIKONSTRUKSION RRUGA POPCISHT	2015	S.P	8,630
HAPJE RRUGA GOPESH QAFE LENIE-UJE I FTOHTE	2015	A.	49,938
RIKONSTRUKSION RRUGADUSHAR,KODRAS,OSOJE,ZEREC	2015	Y.	15,924
<b>Total</b>			<b>1,638,158</b>

**Burimi:**Bashkia Maliq

Aneksi L1\_Tabela përmbledhëse në të cilën paraqiten të dhënat në lidhje me aplikimet dhe miratimet e zhvilluara gjatë vitit 2022, në Bashkinë Maliq.



<b>Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i lejes</b>	<b>Numri i aplikimeve</b>	<b>Numri i miratimeve</b>
1	Certifikatë përdorimi	27	18
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	71	39
3	Leje infrastrukture	1	1
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	19	12
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	4	1
6	Leje për ndryshim funksioni	2	1
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	8	4
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	0	0
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	5	4
10	Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	0	0
11	Leje zhvillimi	39	23
12	Njoftim për fillim punimesh	29	19
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	0	0
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	9	5
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	12	6
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	0	0
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	0	0

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i lejes së ndërtimit</b>	<b>Aplikanti</b>	<b>Zhvilluesi</b>	<b>Vendimi Leje ndërtimi</b>	<b>Sipërfaqe totale ndërtimi</b>	<b>Preventivi Sipas subjektit</b>
1	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate dhe 1kat nën/tokë	O. L	EKB	Vendim Nr.78/2 datë 18.02.2020	2467 m2	95,740,302 Lekë
2	Shtese 1kat ne lartësi në objekt ekz.1kat	V.G	L.E	Vendim Nr.1599/4 datë11.9.2020	199 m2	6,433,819 Lekë
3	Banesë individuale 1 kat	N.S	A. B	Vendim Nr.1621/3 datë 28.5.2020	126 m2	3,459,647 Lekë
4	Magazinë për prodhime bujqësore	Gj. I	F.P	Vendim Nr.2036/5 datë 22.12.2020	305 m2	6,721,189 lekë
5	Mur rrethues	L.B	S.V	Vendim Nr.3807/3 datë 15.9.2020	70 m2	244,972 lekë

6	Magazine bujqesore 2 kate	K.K	T.K	Vendim Nr.5329/4 datë 04.12.2020	194.1 m2	4,949,057 lekë
7	Stalle per 50 krere gjedhe 1 kat	S.P	N .	Vendim Nr.215-2021/6 28.04.2021	2200 m2	78,384,440 Lekë
8	Magazine frigoriferike 1 kat	S.P	A.L	Vendim Nr.2091/5 datë 04.06.2021	1050 m2	89,341,330 Lekë
9	Banese individuale 2 kate	K.K	A.XH	Vendim Nr.2260/4 datë 09.06.2021	203.6 m2	6,592,772 lekë
10	Qender Komunitare/Kishe	L.B	F.O	Vendim Nr.2333/3 datë 28.05.2021	248 m2	32,838,060 lekë
11	Vile njekateshe dhe me nencati	P.P	A.M	Vendim Nr.2382/6 datë 13.07.2021	120	4,150,043 Lekë
12	Banese individuale 1 kat	K.K	E.K	Vendim Nr.2389/8 datë 05.07.2021	90 m2	2,950,916 lekë
13	Shtese anesore dhe kati ne ndertim ekzistues 1 kat me siperfaqe deri ne 250 m2	D.Q	A.L	Vendim Nr.3208/3 datë 05.08.2021	244 m2	9,569,186 lekë
14	Mbulim me cati fallco (banese ekzistuese 2 kate)	K.K	O.Ç	Vendim Nr.3649/3 datë 05.08.2021	253.5 m2	459,132 lekë
15	Banese 1 kat	V.G	A.T	Vendim Nr.3694/4 datë 14.09.2021	122 m2	4,145,490 lekë
16	Banese 1 kat	V.G	I.I	Vendim Nr.3773/4 datë 13.09.2021	130 m2	4,145,490 Lekë
17	Mbulim me cati fallco - banese individuale	K.K	D.M	Vendim Nr.6333/4 datë 09.02.2022	77.3 m2	650,104 Lekë
18	Objekt per grumbullimin e produkteve bujqesore e medicinale Drithas Maliq	V.G	A.	Vendim Nr.6710/4 datë 28.3.2022	1012 m2	31,731,039 Lekë
19	Rikonstruksion kati perdhe, shtese anesore dhe shtese kati, Kisha "Fjala e Gjalle", Vlocisht	P.P	F.M	Vendim Nr. 120/2 datë 01.3.2022	147.05 m2	5,215,472 Lekë
20	Banese 1 kat	V.G	E.N	Vendim Nr.193/3 datë 08.4.2022	42 m2	1,833,250 lekë
21	Banese 1 kat	L.B	A.F	Vendim Nr.3603/5 datë21.9.2022	133 m2	5,681,624.67 Lekë
22	Rikonstruksion kati përdhe,shtesë anësore dhe kati (1kat) në banesë ekzistuese (1 kat),pa ndryshim funksioni	F.Q	F.B	Vendim Nr.4448/2 datë 20.9.2022	244.47 m2	5,295,229 Lekë
23	Shtesë papafingo në banesë ekzistuese 1kat	S.X	A.SH	Vendim Nr.5258/5 datë 13.12.2022	56.72 m2	2,505,812.5 lekë

Aneksi L2\_Tabelat përmbledhëse në të cilën paraqiten lejet e ndërtimit të miratuara dhe të dhënat në lidhje me certifikatat e përdorimit në Bashkinë Maliq.

Certifikatat e përdorimit				
Nr.	Nr. Prot.	Datë	Objekti	Zhvilluesi
1	3339	20.07.2020	Instalim nyje asfalti mobile	A.
2	4363	10.09.2020	Objekt per grumbullimin e produkteve bujqesore	I.P
3	4424	15.09.2020	Shtese Autoservis	A.A
4	4513	17.09.2020	Objekt per grumbullimin e produkteve bujqesore	I.P
5	4656	25.09.2020	Objekt per grumbullimin e produkteve bujqesore	I.P
6	4675	28.09.2020	Banese Individuale 1 kateshe	I.B, L.B
7	5093	19.10.2020	Banese Individuale 1 kateshe	I.B, L.B
8	5434	05.11.2020	Banese 2 kate	J.K
9	6192	10.12.2020	Shtese Autoservis	A.A
10	6205	11.12.2020	Rikonstruksion lokali dhe shtese kati deri ne 3 kate	A.B
11	1573	08.03.2021	Banese individuale 2 kate	T.M, E.M
12	1955	29.03.2021	Rikonstruksion godine 2 kate dhe shtese anesore (pershtatje per agroturizem)	TH.N
13	2898	21.05.2021	Banese individuale 1 kateshe	A.B
14	3267	10.06.2021	Rikonstruksion godine 2 kate dhe shtese anesore (pershtatje per agroturizem)	TH.N
15	5740	29.10.2021	Magazinim. Frigorifer, perpunim produkte bujqesore	I.F
16	6647	20.12.2021	Banese individuale 2 kate	R.M
17	42	09.01.2022	Magazinim. Frigorifer, perpunim produkte bujqesore	I.F
18	1672	22.03.2022	Magazinë bujqësore 2kt	T.K
19	1849	31.3.2022	Objekt banimi dhe shërbimi (kopësht) 6kate me 1 kat nëntokë	E.K.B
20	2450	27.4.2022	Servis Automjetesh 2 kate, Symiz	P.T
21	2680	12.5.2022	Banesë individuale 1kat dhe çati e shfrytëzuar	A.M
22	4754	19.9.2022	Banesë 1 kat	E.N
23	5182	13.10.2022	Banesë 2 kat	P.K
24	5357	14.10.2022	Kishë	F.O
25	5519	23.10.2022	Banesë 2 kate	R.M
26	5637	31.10.2022	Xhamia symiz	F.M
27	5953	23.11.2022	Banesë 1 kat	E.N

Aneksi L3\_Tabela në të cilën paraqiten lejet e ndërtimit që janë përzgjedhur për tu audituar në bazë të analizës së riskut.

Nr.	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi i lejes së ndërtimit	Sipërfaqe totale ndërtimi	Preventivi sipas subjektit
1	Magazinë frigoriferike 1 kat	A.L	Vendim Nr.2091/5 datë 04.06.2021	1050 m <sup>2</sup>	89,341,330 lekë
2	Stallë për 50 krerë gjedhe 1 kat	N	Vendim Nr.215-2021/6 datë 28.04.2021	2200 m <sup>2</sup>	78,384,440 lekë

3	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kate dhe 1kat nën/tokë	EKB	Vendim Nr.78/2 datë 18.02.2020 Vendimi Nr.1849/2, datë 06/05/2022	2467 m <sup>2</sup>	95,740,302 lekë
4	Objekt për grumbullimin e produkteve bujqësore e medicinale Drithas Maliq	A	Vendim Nr.6710/4 datë 28.3.2022	1012 m <sup>2</sup>	31,731,039 lekë
5	“Rikonstruksion godinë 2 kate + shtesë anësore (përshtatje për agroturizëm)”	Z.TH.N	Vendimin Nr. 3267/2, datë 26/07/2021		Certifikatë përdorimi
6	“Rikonstruksion lokali dhe shtese kati deri 3 kate”	Z. A.B dhe Znj. Z.B	Vendimin Nr. 6205/4, datë 23/04/2021		Certifikatë përdorimi

